Grup autorësh

LIBËR PËR MËSUESIN

Letersia 11

BOTIME

pegi

BOTIME

pegi

Redaktor letrar: Arlon LIKO
Paraqitja grafike: Lindita PRELA
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë

© Botime Pegi, korrik 2017
Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht të zotëruara nga Botime Pegi shpk. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

Botime Pegi: tel: +355/ 042 468 833; cel: +355/ 069 40 075 02;
e-mail: botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al
Sektori i shpërndarjes: cel: +355/ 069 20 267 73; 069 60 778 14;
e-mail: marketing@botimepegi.al
Shtypshkronja Pegi: cel: +355/ 069 40 075 01;
e-mail: shtypshkronjapegi@yahoo.com

Përmbajtje

Plani analitik PËR TREMUJORIN E PARË 4
Plani analitik PËR TREMUJORIN E DYTË 11
Plani analitik PËR TREMUJORIN E TRETË 17
PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 21

Fusha: GJUHA DHE KOMUNIKIMI

Lënda: LETËRSI

Shkalla: 5

Klasa: XI

Viti shkollor: 2017-2018

Plani analitik

PËR TREMUJORIN E PARË

(Shtator – Dhjetor)

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe(a)
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës(b)

Nr	**Tematika / kapitulli** (d)	**Temat mësi-more**(e)	**Situata e të nxënit**(f)	**Metodologjia dhe vep-rimtaritë e nxënësve** (g)	**Vlerësimi** (h)	**Burimet** (i)
1	**Teoria e letërsisë 4 orë**	Letërsia dhe gjinitë letrare.	Karakteri historik i gjinive letrare Letërsia dhe gjinitë letrare.	Informacion I ri- stuhi mendimesh- reflektim dhe rifreskim njohurish- praktikë e drejtua- punë e pavarur	Vlerësimi i **përgj**igjeve me gojë	Teksti mësimor Vepra artistike të gjinive të ndryshme Fragmente tëndryshme nga letërsia e huaj dhe ajo shqiptare
2		Veçoritë e llojeve të gjinisë epike. .	Epika në vargje, epi heroik, fetar dhe idilik. Epika në prozë romani, novella, përralla etj, romani policor, fantasik, psikologjik etj	Diskutim –Reflek-tim-Analizim-Praktikë e pavarur	Vlerësim diagnostikues Vlerësimi **për të nxënë** (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor Vepra artistike të gjinive të ndryshme
3		Veçoritë e llojeve të gjinisë lirike dhe dramatike.	Lloje të gjinisë lirike: elegjia, himni, soneti, lirika mod-ern. Lloje të gjinisë dramatike: tragjedia, komedia, drama.	Kontroll njohurish- stuhi mendimesh- piramida e mendimit	Vlerësimi **për të nxënë** (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor
4		Figurat stilistike. Stili. Figurat letrare. Gjuha e figurshme.	Figurat e kuptimit: . Figurat e shqiptimit poetic. Figurat e Fjalëve dhe të shprehjeve. Figurat e sintaksës poetike	Pema e mendimit- Punë në grupe- Praktikë e pavarur	Vlerësimi I **përgj**igjeve me gojë Vlerësimi I punës në grup Vlerësim mes nxënë-sish	Teksti mësimor Vepra artistike të gjinive të ndryshme

Nr	Tematika / kapitulli (d)	Temat mësimore(e)	Situata e të nxënit(f)	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve (g)	Vlerësimi (h)	Burimet (i)
5	**Romantizmi** **2 orë**	Romantizmi. Kushtet historike e shoqërore të lindjes dhe të zhvillimit të romantizmit	Identiteti romantik. Romantizmi i ***përjetshëm.*** Stuhi dhe vrull.	Pyetje përgjigje Diskutim Hartë koncepti Hartë personazhesh	Vlerësimi I **përgj**igjeve me gojë Vlerësimi I punës në grup Vlerësim mes nxënësish	Teksti mësimor Vepra artistike të gjinive të ndryshme
6		Romantizmi. Përfaqësuesit kryesorë dhe veprat e tyre.	Risitë e lëvizjes. Shkrimtare të periudhës së romantizmit. Veçoritë e romantizmit	Diskutim, Lexim i drejtuar, Reflektim	Vlerësimi I **përgj**igjeve me gojë	Teksti mësimor Vepra artistike të gjinive të ndryshme
7	**Johan Volfgang Gëte** **5 orë**	Johan Volfgang Gëte Jeta dhe vepra.	Gëte poet, dramaturg, narrator	Diskutim-Kubimi-Analizim-Pesë vargëshi	Vlerësimi I **përgj**igjeve me gojë Vlerësimi I punës në grup Vlerësim mes nxënësish	Teksti mësimor Fragmente nga veprat e tij
8		Analizë e veprës: Tragjedia "Fausti"	Analizë Personazhet Studim teksti	Diskutim – Vëzhgim - Stuhi mendimesh – Punë në grupe	Vlerësimi I **përgj**igjeve me gojë Vlerësimi I punës në grup Vlerësim mes nxënësish	Teksti mësimor Vepra e plotë
9		Fragment: "Pakënaqësia dhe ankthi **për d**ituri e Faustit" . Pakti mes Faustit dhe Mefistofelit (v. 1583-1711)	Studim teksti	Lexim dhe mendim I drejtuar-Reflektim-Punë në grup-Praktikë e pavarur	Vlerësimi I **përgj**igjeve me gojë Vlerësimi I punës në grup Vlerësim mes nxënësish	Teksti mësimor

Nr	Tematika / kapitulli (d)	Temat mësimore(e)	Situata e të nxënit(f)	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve (g)	Vlerësimi (h)	Burimet (i)
10		Fragment:Shtëpia e Margaritës: "tempull" dhe "burg" (v. 2687-2728)	Studim teksti	Leximi drejtuar-Ditari dypjesësh-Punë individuale	Vlerësimi I **përgj**igjeve me gojë Vlerësimi I punës në grup Vlerësim mes nxënësish	Teksti mësimor
11		Fragment:Fausti utopist (v. 11559-11586) Filemoni dhe Baukida (v. 11233-11373)	Studim teksti	Koment Analizë Përshkrim	Vlerësimi **për të nxënë** (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor
12	**5 orë**	Viktor Hygo Jeta dhe vepra.	Roli i Hygoit në letërsi Prijësi i romantizmit Hygoi si poet, prozator dhe dramaturg	Lexim i strukturuar Marrje informacioni	Vlerësimi i **përgj**igjeve me gojë Vlerësimi i punës në grup Vlerësim mes nxënësish	Teksti mësimor
13		Analizë e veprës: Katedralja e Parisit.	Sfondi historik Lufta mes së mirës dhe së keqes Subjekti. Personazhet Studim teksti	Stuhi mendimesh-Krahasim personazhe	Vlerësimi I **përgj**igjeve me gojë Vlerësimi I punës në grup Vlerësim mes nxënësish	Teksti mësimor Vepra e plotë
14		Fragment: "Esmeralda "	Studim teksti	Analizë dhe koment Lexim i drejtuar, rrjeti i diskutimit, praktikë e pavarur	Vlerësimi **për të nxënë** (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor

Nr	Tematika / kapitulli (d)	Temat mësimore(e)	Situata e të nxënit(f)	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve (g)	Vlerësimi (h)	Burimet (i)
15		Fragmenti XXVIII. "Një lot për një pikë ujë"	Studim teksti	Analizë – koment – diskutim, punë në grupe	Vlerësimi I **përgj**igjeve me gojë Vlerësimi I punës në grup Vlerësim mes nxënësish	Teksti mësimor
16		Fragmenti XLIII. "Tri zemra burrash, të mbrujtura ndryshe"	Studim teksti	Analizë – lexim i drejtuar në grupe ekspertësh, koment Ditari dypjesesh	Vlerësimi I **përgj**igjeve me gojë Vlerësimi I punës në grup Vlerësim mes nxënësish	Teksti mësimor
17		Punë me shkrim: Eseja e analizës letrare	Hapat për shkrimin e esesë Planifikimi, Hartimi, Rishikimi I shkrimit.	Reflektim-Analizim-Shkrim I lirë	Vlerësimi i **të nxën**it (përmbledhës)	Fletore të punëve me shkrim, Portofoli i nxënësit
18		Punë me shkrim: Eseja e analizës letrare	Shkruani një ese letrare për librin tuaj të preferuar, ose për veprën e fundit që keni lexuar, duke u përqendruar në hapat për shkrimin e esesë. Vlerësimi I esesë	Diskutim Ritregim Shkrim funksional	Vlerësimi i **të nxën**it (përmbledhës	Fletore të punëve me shkrim, Portofoli i nxënësit
19	**5 orë**	Xhorxh Gordon Bajron Jeta dhe vepra.	Qëndrimi kritik ndaj shoqërisë aristokrate Krijimtaria letrare e Bajronit dhe romantizmi i tij	Parashikim ndërmjet fjalëve kyçe-Reflektim-Analizim	Vlerësimi I **përgj**igjeve me gojë Vlerësimi I punës në grup Vlerësim mes nxënësish	Teksti mësimor

Nr	Tematika / kapitulli (d)	Temat mësimore(e)	Situata e të nxënit(f)	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve (g)	Vlerësimi (h)	Burimet (i)
20		Analizë e veprës: Shtegtimet e Çajld Haroldit	Koha e krijimit. Struktura. Poeti dhe personazhi Studim teksti	Diskutim përmes shqyrtimit të përbashkët- Tabela e parashikimeve-Lexim I drejtuar	Vlerësimi I **përgj**igjeve me gojë Vlerësimi I punës në grup Vlerësim mes nxënësish	Teksti mësimor Vepra e plotë
21		Koment: Fragmenti: "Rebelimi i Çajld Haroldit" I/2, 3, 4, 6; III/12, 13, 15, 16	Studim teksti	Reflektim-Analizim-Shkrim I lirë- Vlerësim	Vlerësimi I **përgj**igjeve me gojë Vlerësimi I punës në grup Vlerësim mes nxënësish	Teksti mësimor
22		Koment. Fragmenti. . "Çajld Haroldi **në Shq**ipëri"	Studim teksti	Lexim dhe mendim I drejtuar-Ditari trepjesësh-Punë individuale	Vlerësimi I **përgj**igjeve me gojë Vlerësimi I punës në grup Vlerësim mes nxënësish	Teksti mësimor
23		Koment. Fragmenti: "Çajld Haroldi **në** Itali" Kënga IV/ 42, 43, 54, 55, 56, 57	Studim teksti	Lexim I drejtuar-Portretizim personazhi	Vlerësimi I **përgj**igjeve me gojë Vlerësimi I punës në grup Vlerësim mes nxënësish	Teksti mësimor
24		Përsëritje	-Flisni mbi kushteve historike-shoqërore që ndikuan në zhvillimin e rrymës romantike dherëndësinë e tyre. -Identifikoni gjinitë letrare që u lëvruan gjatë romantizmit. Analizoni tiparet kryesore të shkrimtarëve romantikë.	Stuhi mendimesh-Harta e koncepteve-bashkëbisedim.	Vlerësimi **për të nxënë** (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor

Nr	Tematika / kapitulli (d)	Temat mësimore(e)	Situata e të nxënit(f)	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve (g)	Vlerësimi (h)	Burimet (i)
25		Bisedë letrare	- Rëndësia e letërsisë romantike. - Sfondi historik dhe kulturor ku u zhvillua kjo letërsi. - Përfaqësuesit dhe veprat e tyre kryesore. Analizë **vepre**	Diskutim Ritregim Shkrim funksional	Vlerësimi **për të nxënë** (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor
26		Bisedë letrare	- Rëndësia e letërsisë romantike. - Sfondi historik dhe kulturor ku u zhvillua kjo letërsi. - Përfaqësuesit dhe veprat e tyre kryesore. Analizë **vepre**	Diskutim Ritregim Shkrim funksional	Vlerësimi **për të nxënë** (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor
27		Testi I tremujorit të parë				
28	**Romantizmi shqiptar .** **1 orë**	Romantizmi shqiptar .	Identiteti dhe kultura kombëtare Tipari dallies i romantizmit Shqiptar Tiparet e ngjashme të romantizmit shqiptar me atë evropian	Stuhi mendimesh-Përmbledhje e strukturuar-Punë e drejtuar	Vlerësimi I **përgj**igjeve me gojë Vlerësimi I punës në grup Vlerësim mes nxënësish	**Teksti mësimor**

Fusha: GJUHA DHE KOMUNIKIMI

Lënda: LETËRSI

Shkalla: 5

Klasa: XI

Viti shkollor: 2017-2018

Plani analitik

PËR TREMUJORIN E DYTË

(Janar - Mars)

Nr	Tematika / kapitulli (d)	Temat mësimore(e)	Situata e të nxënit(f)	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve (g)	Vlerësimi (h)	Burimet (i)
29	**Romantizmi shqiptar 5 orë**	Jeronim De Rada Jeta dhe vepra	Kontributi letrar dhe gjuhësor Krijimtaria.	Stuhi mendimesh – praktika e drejtuar - tabela e pyetjeve	Vlerësimi I **përgj**igjeve me gojë Vlerësim mes nxënë-sish	Teksti mësimor
30		Analizë e veprës: "Këngët e Milosaos"	Struktura. Subjekti. Vlerat dhe stili Studim teksti	Diskutim – Vëzhgim - stuhi mendimesh – punë në grupe	Vlerësimi I **përgj**igjeve me gojë Vlerësimi I punës në grup Vlerësim mes nxënë-sish	Teksti mësimor Vepra e plot**ë**
31		Koment:Fragmenti: "Këngët e Milosaos"	Studim teksti	Lexim dhe shpjegim – Stuhi mendimesh –Punë në grupe	Vlerësimi I **përgj**igjeve me gojë Vlerësimi I punës në grup Vlerësim mesnxënësish	Teksti mësimor
32		Koment:Fragmenti: "Këngët e Milosaos"	Studim teksti	Prezantimi I punes -Pyetje – përgjigje –Analizë – Ditari dypjesësh- punë e pavarur	Vlerësimi I **përgj**igjeve me gojë Vlerësimi I punës në grup Vlerësim mes nxënë-sish	Teksti mësimor
33		Koment:Fragmenti: "Këngët e Milosaos"	Studim teksti	Prezantim – Lexim dhe shpjegim teksti – Analizë – Rrjeti I diskutimit- praktikë e drejtuar	Vlerësimi I **përgj**igjeve me gojë Vlerësimi I punës në grup Vlerësim mes nxënë-sish	Teksti mësimor

Nr	Tematika / kapitulli (d)	Temat mësimore(e)	Situata e të nxënit(f)	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve (g)	Vlerësimi (h)	Burimet (i)
34	Naim Frashëri **5 orë**	Naim Frashëri Jeta dhe vepra. .	Veprat e para. Tiparet e veprës naim-iane	Stuhi mendimesh- praktikë e drejtuar, rrjeti I diskutimit	Vlerësimi I përgjigjeve me gojë Vlerësimi I punës në grup Vlerësim mes nxënë-sish	Teksti mësimor
35		Analizë e veprës: "Lulet e verës"	Motivet. Gjuha e përdorur. Studim teksti	Prezantim- stuhi men-dimesh- punë në grupe – reflektim kuptimor	Vlerësimi I përgjigjeve me gojë Vlerësimi I punës në grup Vlerësim mes nxënë-sish	Teksti mësimor Vepra e plotë
36		Koment:Fragmenti: "Atdheu"	Studim teksti	Lexim, interpretim- ditari dypjesësh,	Vlerësimi I përgjigjeve me gojë Vlerësimi I punës në grup Vlerësim mes nxënë-sish	Teksti mësimor
37		Koment:Fragmenti: "Fyelli"	Studim teksti	Lexim dhe prezantim – Re-flektimi kuptimor –Tabela e figurave	Vlerësimi I përgjigjeve me gojë Vlerësimi I punës në grup Vlerësim mes nxënësish	Teksti mësimor
38		Koment:Fragmen-ti:"Lulja"	Studim teksti	Stuhi mendimesh-Harta e koncepteve	Vlerësimi I përgjigjeve me gojë Vlerësimi I punës në grup Vlerësim mes nxënë-sish	Teksti mësimor

Nr	**Tematika / kapitulli** (d)	**Temat mësimore**(e)	**Situata e të nxënit**(f)	**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** (g)	**Vlerësimi** (h)	**Burimet** (i)
39		Punë me projekt. Prezantimi I projektit Faza I	Synimet e projektit Hapat e punës për realizimin e një reviste Fazat e projektit	Stuhi mendimesh-Prezantim – Punë **në** grupe	Portofoli I nx**ënësve**	Teksti mësimor Revista **të ndryshme**
40	**Realizmi** **1 orë**	Përfaqësuesit kryesorë dhe veprat e tyre. Kushtet historike dhe shoqërore të lindjes dhe zhvillimit të realizmit Tiparet dhe parimet e letërsisë realiste	Kushtet historike dhe shoqërore të lindjes dhe zhvillimit të realizmit Tiparet dhe parimet e letërsisë realiste	Bashkebisedim, Diagrami I Venit, lexim I drejtuar, hartë konceptesh, praktikë e pavarur	Vlerësimi I **përgj**igjeve me gojë	Teksti mësimor Materiale nga internet.
41	Honore Dë Balzak **5 orë**	Realizmi Honore Dë Balzak Jeta dhe vepra. .	Jeta përmes librave Idetë dhe tematika. Risitë e Balzakut dhe tipare thelbësore të krijimtarisë së tij Personazhe të krijuara nga Balzaku	Stuhi mendimesh – pyet-je-përgjigje -diagram I Venit – Reflektimi kuptimor	Vlerësimi I **përgj**igjeve me gojë Vlerësimi I punës në grup Vlerësim mes nxënë-sish	Teksti mësimor
42		Analizë e veprës: Xha Gorioi	Temat dhe linjat e romanit Studim teksti	Lexim dhe shpjegim – stuhi mendimesh –Hap pas hapi – Praktikë e drejtuar - Rrjeti I diskutimit	Vlerësimi I **përgj**igjeve me gojë Vlerësimi I punës në grup Vlerësim mes nxënë-sish	Teksti mësimor Vepra e plot**ë**
43		Koment. Fragmenti: "Pensioni i zonjës Voker"	Studim teksti	Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme – Lexim dhe shpjegim – Diskutim - Punë e pavarur	Vlerësimi **për të nxënë** (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor Vepra e plot**ë**

Nr	Tematika / kapitulli (d)	Temat mësimore(e)	Situata e të nxënit(f)	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve (g)	Vlerësimi (h)	Burimet (i)
44		Koment. Fragmenti:"Një djalosh pa përvojë"	Studim teksti	Analizë përmes shembujve – Diagrami I Venit – Praktikë e pavarur	Vlerësimi **për të nxënë** (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor Vepra e plotë
45		Koment. Fragmenti:"Agonia e xha Gorioit"	Studim teksti	Lexim I drejtuar-Punë në grupe - Vështrim krahasues	Vlerësimi **për të nxënë** (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor Vepra e plotë
46	Realizmi 5 orë	Gustav Flober Jeta dhe vepra	Risitë e Floberit në letërsi, Veprat kryesore të tij	Pema e mendimit - Punë me grupe - Stuhi mendimesh – Diskutim	Vlerësimi **për të nxënë** (i vazhdueshëm)	- Teksti mësimor
47		Analizë e veprës: Romani "Zonja Bovari"	Subjekti. Raporti i autorit me personazhet Studim teksti	Stuhi mendimesh – Pema e mendimit – Diagrami I Venit – Pyetje – përgjigje	Vlerësimi **për të nxënë** (i vazhdueshëm)	- Teksti mësimor Vepra e plotë
48		Koment. Fragmenti:"Mërzia"	Studim teksti	Lexim dhe shpjegim - Pyetje përgjigje - Ditari dypjesësh - Krahasim. Diagrami I Venit - Tabela e figurave	Vlerësimi **për të nxënë** (i vazhdueshëm)	- Teksti mësimor
49		Koment. Fragmenti: "Panairi bujqësor"	Studim teksti	Lexim dhe shpjegimteksti - Ditari dypjesësh - Praktikë e drejtuar – Tabela e figurave - Praktikë e pavarur	Vlerësimi **për të nxënë** (i vazhdueshëm)	- Teksti mësimor
50		Koment. Fragmenti: "Vdekja e Emës"	Studim teksti	Koment-analize	Vlerësimi **për të nxënë** (i vazhdueshëm)	- Teksti mësimor
51		Përsëritje	Tiparet e romantizmit në letërsinë e huaj dhe atë shqipe Tiparet kryesore të veprave të romantikëve	Konkurs, pyetje-përgjigje, pyetje me shtjellim	Vlerësimi **për të nxënë** (i vazhdueshëm)	- Teksti mësimor

Nr	**Tematika / kapitulli** (d)	**Temat mësimore**(e)	**Situata e të nxënit**(f)	**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** (g)	**Vlerësimi** (h)	**Burimet** (i)
52		Testi I tremujorit **të** dytë				
53		Bisedë letrare	- Rëndësia e letërsisë realiste. - Sfondi historik dhe kulturor ku u zhvillua kjo letërsi. - Përfaqësuesit dhe veprat e tyre kryesore. Analiz**ë vepre**	Diskutim Ritregim Shkrim funksional	Vlerësimi **për të nxënë** (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor Vepra e plot**ë**

Lënda: LETËRSI

Shkalla: 5

Klasa: X

Viti shkollor: 2017-2018

Plani analitik

PËR TREMUJORIN E TRETË

(Prill - Qershor)

Nr	**Tematika / kapitulli** (d)	**Temat mësimore**(e)	**Situata e të nxënit**(f)	**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** (g)	**Vlerësimi** (h)	**Burimet** (i)
54	Bisedë letrare	Analizë **vepre.** Lexim dhe interpretim pjesësh nga letërsia realiste	Diskutim Ritregim Shkrim funksional	Vlerësimi **për të nxënë** (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor Vepra e plotë	
55	5 orë	Fjodor Dostojevski Jeta dhe vepra	Veprat e para Etapat e krijimtarisë Tipare të veprës së Dostojevskit	Një pyetje shumë përgjigje – Përmbledhje e strukturuar - stuhi mendimesh - Diskutim	Vlerësimi **për të nxënë** (i vazhdueshëm)	- Teksti mësimor
56		Analizë e veprës: Vëllezërit Karamazov	Struktura e romanit Temat e romanit Mesazhet e romanit Studim teksti	Stuhi mendimesh – Pema e mendimit – Diagrami I Venit – Pyetje – përgjigje	Vlerësimi **për të nxënë** (i vazhdueshëm)	- Teksti mësimor Vepra e plotë
57		Koment. Fragmenti: Ferri është vuajtje për atë që nuk mund ta duash më	Studim teksti	Stuhi mendimesh – Pema e mendimit –Diagrami I Venit – Pyetje – përgjigje	Vlerësimi **për të nxënë** (i vazhdueshëm)	- Teksti mësimor
58		Koment. Fragmenti: Mitjën e Marrin	Studim teksti	Lexim dhe shpjegim teksti – Punë në grupe – rrjeti I diskutimit	Vlerësimi **për të nxënë** (i vazhdueshëm)	- Teksti mësimor
59		Koment. Fragmenti: Ivani dhe Djalli	Studim teksti	Lexim dhe shpjegim teksti – Punë në grup - Diskutim	Vlerësimi **për të nxënë** (i vazhdueshëm)	- Teksti mësimor
60		Përsëritje	Autorët më të rëndësishëm të realizmit. Veprat e tyre Tablotë e jetës dhe temat e mëdha që u bënë pjesë e veprave të realizmit Analizimi I raporteve ëe kanë me personazhet e tyre/	Pyetje-përgjigje, analizë përmes shembujve-punë në grupe, prezantim-lexim dhe interpretim	Vlerësimi **për të nxënë** (i vazhdueshëm)	- Teksti mësimor

Nr	**Tematika / kapitulli** (d)	**Temat mësimore**(e)	**Situata e të nxënit**(f)	**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** (g)	**Vlerësimi** (h)	**Burimet** (i)
61		Punë me shkrim	Shkruajmë letra për çështje letrare	Shkrim i strukturuar	Vlerësim paraprak motivues	Fletore të punëve me shkrim, Portofoli i nxënësit
62		Punë me shkrim	Shkruajini një letër një mikut tuaj, ku të përshkruani mbresat tuaja nga libri i fundit që keni lexuar	Shkrim sipas modelit Shkrim i iirë	Vlerësimi i **të nxën**it (përmbledhës)	Fletore të punëve me shkrim, Portofoli i nxënësit
63	Letërsia e fundshekullit XIX 1 orë	Letërsia e fundshekullit XIX	Konteksti shoqëror, politik e letrar i gjysmës së dytë të shek. XIX	Informacioni i ri Evokimi	Vlerësimi **për të nxënë** (i vazhdueshëm)	- Teksti mësimor Material historike
64	5 orë	Sharl Pier Bodler Jeta dhe vepra.	Kritiku më i madh i artit të shek. XIX Krijimtaria letrare e Bodlerit dhe risitë	Shpjegim Strukturim i informacionit të ri	Vlerësimi **për të nxënë** (i vazhdueshëm)	- Teksti mësimor Vepra e plotë
65		Analizë e veprës: Lulet e së keqes Koment. Poezia Korrespondenca	Gjuha dhe stili i veprës Kriteret strukturore Poetika: simbolizmi dhe alegorizmi Studim teksti	Hartë koncepti dhe personazhi Pema e mendimit	Vlerësimi **për të nxënë** (i vazhdueshëm)	- Teksti mësimor
66		Koment. Poezia Albatrosi	Studim teksti	Lexim i strukturuar Punë në grupe Diskutim	Vlerësimi **për të nxënë** (i vazhdueshëm)	- Teksti mësimor
67		Koment: Mjellma	Studim teksti	Punë në grupe Vlerësim	Vlerësimi **për të nxënë** (i vazhdueshëm)	- Teksti mësimor Vepra e plotë

Nr	**Tematika / kapitulli** (d)	**Temat mësimore**(e)	**Situata e të nxënit**(f)	**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** (g)	**Vlerësimi** (h)	**Burimet** (i)
68		Koment. Poezia Spleen .	Studim teksti	Punë në grupe Shkrim funksional	Vlerësimi **për të nxënë** (i vazhdueshëm)	- Teksti mësimor Vepra e plotë
69		Përsëritje	Kushtet në të cilat lindi letërsia e gjysmës së dytë të shekullit XIX Identifikoni rrymat dhe nënrrymat kryesore letrare të kësaj periudhe dhe specifikoni gërshetimet midis tyre. Shpjegoni rolet dhe përdorimin e figurave më të dashura për simbolistët si: analogjia, sintestezia, metafora etj.	Diskutim Tabela përmbledhëse	Vlerësimi **për të nxënë** (i vazhdueshëm)	Teksti **mës**imor
70	Projekt	Projekt Faza II	Përshkrimi i produktit të projektit		Vlerësimi i **të nxën**it (përmbledhës)	Portofoli i nxënësit
71	Projekt	Projekt. Faza III	Vlerësimi i projektit		Vlerësimi i **të nxën**it (përmbledhës)	Portofoli i nxënësit
72		Testi tremujorit të tretë				Portofoli i nxënësit

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE **Dt.___/____/__**

<table>
<tr><th>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</th><th>Lënda: Letërsi</th><th>Shkalla: V</th><th>Klasa:</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Letërsia dhe gjinitë letrare.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Nxënësi/ja përdor gjuhën e figurshme dhe analizon përdorimin e saj në situata të ndryshme (duke lexuar një poezi, ese a fragment nga roman a novelë).</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
Kompetenca e të menduarit
Kompetenca digjitale</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
- klasifikon veprat letrare sipas gjinive;
- identifikon prirjet e letërsisë bashkëkohore në lidhje me ndarjen mes gjinive letrare;
- lexon dhe interpreton pjesë nga gjini të ndryshme letrare;
- analizon dhe krahason veprat letrare të ndara sipas gjinive.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:
Krijim gjuhësor
Letërsi parashkrimore
Gjini letrare
Gjini epike
Gjini lirike
Gjini dramatike</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: tekste të ndryshme letrare, libri i nxënësit.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: arte, kinematografi, TIK.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve
Diskutim-Pema e mendimit-Pyetje-përgjigje-Punë në grupe</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizimi i orës së mësimit

Hapi 1. Diskutim. Rikujtojmë së bashku me nxënësit mbi konceptin letërsi dhe zhvillimin e saj. Nxënësit janë të lirë të japin mendimet e tyre duke ilustruar dhe me shembuj (veprat e para në letërsi).</td></tr>
</table>

Hapi 2. Pema e mendimit. Pasi i strukturojmë mendimet mësuesi/ja shkruan në dërrasë togfjalëshin "gjini letrare". Nxënësit e plotësojnë me informacionet që dinë duke i kërkuar ndihmë dhe mësuesit/es.



Hapi 3. **Pyetje-përgjigje**. Mësuesi/ja i drejton pyetje klasës dhe merr përgjigje.

- Çfarë është gjinia letrare dhe përse veprat letrare klasifikohen në gjini të ndryshme?
- Për sa shekuj qëndruan të papërziera kufijtë mes gjinive letrare në Evropë? (Gjatë mesjetës e deri në Rilindjen Evropiane, kufijtë mes gjinive letrare ishin të qartë.)
- Çfarë prirjeje ka letërsia bashkëkohore në lidhje me ndarjen e qartë mes gjinive letrare? (Letërsia moderne dhe ajo postmoderne dallohen për një shkrirje të kufijve të gjinive letrare)
- Cila gjini letrare mendoni se është zhvilluar më tepër gjatë kohës që letërsia nuk ishte e shkruar? (Letërsia gojore)
- Përse është i dobishëm klasifikimi i veprave në gjini letrare? (tri gjinitë kryesore letrare shërbejnë për të grupuar tekstet letrare, në bazë të tipareve strukturore dhe tematike)
- Cilët janë faktorët që ndikuan në ndryshimin e kufijve mes gjinive letrare?

Hapi 4. **Punë në grupe**. Klasa ndahet në grupe ku secilit i ngarkohet nga një detyrë.

Grupi 1. Gjeni dy tekste epike dhe tregoni se si realizohet rrëfimi në to. "Ilada", "Odisea" dhe "Cikli i Kreshnikëve".

- e marrin temën nga ngjarje historike;
- autori përveçse rrëfen ngjarjet, shpreh ndjenjat dhe mendimet e tij;
- në llojet epike rrëfimi bëhet përgjithësisht në vetën e tretë, por edhe në vetën e parë.

Grupi 2. Për secilën nga veprat e mëposhtme, përcaktoni gjininë letrare.

- "Shumë zhurmë për asgjë" - Uilliam Shekspir - Dramatike
- "E penguara" - Ismail Kadare - gjini epike
- "Kostandini dhe Doruntina" - Populli gjini epike

Grupi 3. Gjeni një fragment nga "Epi i Gilgameshit", ose "Eposi i Kreshnikëve" dhe analizoni në të kohët e foljeve. Si përligjet kjo zgjedhje në raport me gjininë letrare së cilës i përkasin këto vepra?

Kane gjete lumin ngri akull
Kane nise vashat me lype krojet
Kane gjete krojet tane ngri hej!
Ka dale Muji me kreshnike
A thue ndeshet me ndoj gja malit
Sa shpejt diellin ma zu reja!
Shpejt ma endi njei pelhure t'gjane e t'gjate
E ia ka veshun majat rreth e rrotull

E qan me dhembje të mafdh Enkidujin
dhe tfillet Gilgameshi nëpër fushë
shpirtin nga dhembja e kam të copëtuar
sepse prej vdekjes frikë e madhe m'zuri,
prandaj po bredh andej-këndej nëpër vapë
Tek i fuqishmi Utnapishtim jam nisur
që e ka gjetur jetën e pasosur,
jam nisur në rrugë dhe tek ai shpejto

Këngët epike ngjasojnë me tekstin tregimtar, sepse rrëfejnë ngjarje, aventura.
Poeti nuk shfaqet në rrëfim, por prania e tij bëhet e dukshme përmes veprimit të personazheve dhe dialogut.
Tema e veprës epike është heroike.
Fabula përmban linja të shumta paralele.
Heronjtë janë të jashtëzakonshëm (perëndi, gjysmëperëndi, luftëtarë të jashtëzakonshëm etj.).
Pjesëmarrja e elementit të mrekullueshëm etj.
Figurat stilistike më të përdorura janë: hiperbola, epiteti, similituda, epinalepsa etj.
Foljet janë në kohën e tashme dhe të shkuar dhe në pjesën më të madhe në mënyrën habitore.

Grupi 4. Në një tekst letrar lirik gjeni tërësinë e fjalëve që përdoren për të shprehur ndjenjat dhe mendimet e poetit.

*Ca **pika shiu** ranë mbi qelq.*
*Për ty unë befas ndjeva **mall.***
Jetojmë të dy në një qytet,
Dhe rrallë shihemi sa rrallë.
Edhe m'u duk pak e çuditshme
Si erdh kjo vjeshtë, ky mëngjes.
***Qiejt e ngrysur** pa lejlekë*
*Dhe **shirat pa ylber** në mes.*

Vlerësimi: Mësuesi/ja vlerëson nxënësit për:

a) përgjigjet e sakta dhe të argumentuara mbi gjinite letrare;
b) për punën në grup ku secili arriti t'u përmbahet detyrave.

Detyrat dhe puna e pavarur: Shkruani një ese argumentuese me titull: "Letërsia, formë universale e artit përtej gjinive letrare dhe gjeografisë".

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda: Letërsi**	**Shkalla: V**	**Klasa:**
Tema mësimore: Veçoritë e llojeve të gjinisë epike		**Situata e të nxënit:** Nxënësi dëgjon dhe lexon pjesë të ndryshme nga gjinia epike. Gjergj Elez Alia, Cikli i Kreshnikëve	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: - rendit llojet e gjinisë epike; - përcakton funksionet kryesore të gjinive epike; - analizon gjuhën që përdoret në llojet e ndryshme.		**Fjalët kyçe:** Gjini epike, mit, legjendë, përrallë, tregim, novelë, Roman.	
Burimet: teksti i nxënësit, materiale te ndryshme të ndryshme epike, filmike.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** arte, kinematografi, TIK.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Diskutim-Di/Dua të di/Mësova-Stuhi mendimesh-Praktikë e pavarur			

Organizimi i orës së mësimit

Hapi 1. **Diskutim**. Lexojmë detyrat e shtëpisë. Pas leximit të esesë diskutojnë së bashku për mënyrën e ndërtimit, strukturën dhe gjuhën e përdorur.

Hapi 2. **Di/Dua të di/Mësova**

Di	**Dua të Di**	**Mësova**
Epika shfaqet në dy forma letrare: në prozë dhe në vargje. Rrëfejnë gjerësisht për një temë të caktuar. Format më të hershme kanë qenë: poema epike, epe, epose. Paraqiten me detaje bëma heroike ose ngjarje tepër të rëndësishme. Rrëfimi përbëhet nga linja të shumta që zhvillohen paralelisht.	Zhvillimin e poemës epike, llojet e saj dhe karakteristikat e secilit prej tyre.	Poema epike-forma më e vjetër e poezisë gojore. Poemat epike më të hershme, si "Epi i Gilgameshit", "Mahābhārata" (e vedave indiane), "Iliada" dhe "Odiseja". Poemat epike janë të recitueshme, kanë figura letrare të ngulitura, si p.sh.: hiperbola, epitete, krahasime¸ si dhe formula të qarta hyrjeje dhe mbylljeje të rrëfimit. Poema epike të krijon idenë e një varianti të një ngjarjeje reale a historike, që është tepër e njohur për lexuesin. **Miti** përcaktohet si rrëfimi për një ngjarje, që lidhet me zanafillën e prejardhjen e botës, me besimet religjioze apo krijimin e kombeve e të gjuhëve.

Letërsitë evropiane kanë në themel krijime epike kolektive, si p.sh.: "Kënga e Nibelungëve" (Gjermani), "Kënga e Rolandit" (Francë) etj. Gjinia epike në prozë përfshin forma të letërsisë gojore, si: miti, legjenda, përralla. Kronologjikisht, këto forma janë edhe më të vjetrat sa i takon prozës epike.		**Legjenda** është një tekst letrar, në bazë të së cilit qëndron një ngjarje që ka ndodhur ose një ngjarje historike. **Përralla** është një vepër në prozë që rrëfen ngjarje të trilluara me elemente e personazhe fantastik. **Tregimi** është një nga llojet e letërsisë epike narrative, i shkruar në prozë, ku rrëfimi realizohet për një hapësirë të kufizuar e për më pak personazhe. **Novela** është një lloj i ndërmjetëm letrar i gjinisë epike, që shtrihet mes tregimit dhe romanit **Romani** është lloji më i gjerë i gjinisë letrare epike. Tematikat e romanit vërtiten rreth tablove të gjera të jetës.

Hapi 3. **Stuhi mendimesh**. Pas marrjes së këtij informacioni mësuesi/ja i drejton klasës pyetje të ndryshme dhe nxënësit japin përgjigjet e tyre.

- Çfarë është epika dhe cilat janë llojet e kësaj gjinie?
- Cilat janë funksionet kryesore që mund të kryejë teksti i përrallës?
- Ku ndryshon miti nga legjenda? Ku ndryshon romani nga epi/eposi?
- Cilat janë modelet arketipe në legjendën e Rozafatit?

Hapi 4. **Praktikë e pavarur**. Nxënësit punojnë me pyetjet e studimit të tekstit.

- Për secilën nga veprat e mëposhtme, përcaktoni llojin letrar.
  "Vjeshta e Xheladin Beut", Mitrush Kuteli - tregim
  "Muzeu i pafajësisë", Orhan Pamuk - roman
  "Gjergj Elez Alia", Populli - legjendë
  "Lum Lumi", Ali Podrimja - poemë epike
- Gjeni një fragment nga "Iliada" ose "Odiseja" dhe shihni se si përshkruhen personazhet. Me çfarë figurash letrare realizohet përshkrimi?

Personazhet dhe heronjtë jepen të fuqishëm dhe monumentalë prandaj përdoren epitet e fuqishme si p.sh.:

1. Akil Hyjnori, këmbëshpejti; Atena sykaltra; Odise mendtaku; Menelau zëmadhi; Hektor lavdimadhi, i ndritshmi; Paridi mashtrues grash, Helenë krahëbardhë; Priam gojëmbli; Ares gjykatari; Eos(Agimi) gishtatrëndafili.

2. Zeusi (Kryeperendia qe ka ne dorë fatin e njerëzve dhe të perëndive ka epitete si: rrufehedhës, mizor etj.

ANALIZË E PERSONAZHEVE

Karakteret e tyre janë të fuqishëm dhe të derdhur në bronx.

1) Akili – Ngrihet në majën e piramidës dhe dallohet nga të tjerët. Gjysmëperëndi dhe gjysmënjeri ai përfaqëson idealin e epokës homerike. Ai nuk trembet nga asgjë. Përkundrazi

në momentet kur vdekja i qëndron në krye ai sulet mbi armikun. I rreptë, gjakatar por me një zemër të butë dhe të ndjeshme. Ai derdh lot kur Priami i lutet për trupin e Hektorit. 2) Hektori – Ai që i përngjan më shumë Akilit për nga guximi dhe trimëria. Ai udhëhiqet nga dashuria e tij për atdheun. Hektori është më i plotë se Akili në raport me respektin që ai gëzon për njerëzit dhe për familjen e tij. I martuar, i matur, i dhembshur, baba, bashkëshort besnik, i ndjeshëm ndaj problemeve që kanë të tjerët. Por përsëri Akili është ideali i epokës homerike. 3) Agamemnoni, Menelau, Diomedi, Ajaksi – Sundimtari kryeneç, despot po edhe trim. 4) Helena – Simbol i bukurisë së përsosur hyjnore. Ndryshon gjendje nga fillimi në fund. Pasioni i dashurisë për Paridin shndërrohet në neveritje për të pas largimit të turpshëm nga fusha e betejës të Paridit. Pendohet për veprimin e bërë (Largimin nga Menelau.)Përshkruhet nga pleqtë trojanë si: *Panë Helenën që po vinte për s'largu* *Sa shpejt nën zë mes tyre zun' te thoshin:* *Nuk duhen sharë për besë Trojanë e Akej –* *Që për këte grua hoqën aq mundime* *Vite me rradhë;me te vërtetë perqaset* *Për bukuri me zonjat përendesha.* 5.) Andromaka – është mishërim i besnikërisë bashkëshortore. Shpalos virtyte morale të larta si: Nënë, grua, bijë etj.
Vlerësimi: Mësuesi/ja mund të bëjë një vlerësim të vazhdueshëm me gojë për përparimin e nxënësve, me qëllim identifikimin e njohurive, interesave, aftësive apo shkathtësive që kanë fituar nxënësit në lidhje me tematikën.
Detyrat dhe puna e pavarur: Nxënësit janë të lirë të zgjedhin midis dy detyrave: 1. Interpretoni me shkrim thënien e studiuesit francez R. Bart: "Miti nuk është as gënjeshtër, as rrëfim: është lakim". Mbani parasysh arsyet se përse kanë lindur mitet dhe ndryshimet e tyre nga legjendat dhe përrallat. 2. Gjeni informacion për 5-10 perëndi greke, që janë pjesë e mitologjisë dhe tregoni se çfarë personifikojnë ato.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.¬___/____/__

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</td><td>Lënda: Letërsi</td><td>Shkalla: V</td><td>Klasa: XI</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Veçoritë e llojeve të gjinisë lirike dhe dramatike</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Lexojmë pjesë të ndryshme lirike dhe dramatike nga Pushkini, Bajroni.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
Kompetenca e të menduarit
Kompetenca digjitale</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
- përcakton gjininë lirike dhe llojet e kësaj gjinie;
- përcakton gjininë dramatike dhe llojet e kësaj gjinie;
- analizon dhe krahason tragjedinë tradicionale me atë moderne;
- analizon shembuj të ndryshëm nga gjinia lirike dhe ajo dramatike;
- krahason tiparet e epikë dhe dramatike, përmes shembujve.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:
Gjinia dramatike, gjinia lirike, katarsis.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: pjesë të ndryshme lirike dhe dramatike, libri i nxënësit, materiale të ndryshme nga interneti https://youtube/25faoXpVNpA</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: arte, kinematografi, Tik.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve
Diskutim-Harta e koncepteve-Pyetje përgjigje zinxhir-Punë dyshe-Praktikë e pavarur</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizimi i orës së mësimit
Hapi 1. Diskutim dhe harta e koncepteve. Kontroll dhe lexim i detyrave të shtëpisë. Diskutojmë rreth tyre duke e lidhur edhe me informacionin e ri me gjininë lirike dhe dramatike. I përvijojmë mendimet nëpërmjet hartës së koncepteve.</td></tr>
</table>



Hapi 2. Pas përcjelljes së informacionit mësuesi/ja rendit **pyetje zinxhir** dhe pret përgjigje nga nxënësit.

- Çfarë është gjinia lirike dhe cilat janë llojet e kësaj gjinie?
- Çfarë është gjinia dramatike dhe cilat janë llojet e kësaj gjinie? Ku ndryshon poema lirike nga poema epike?
- Përse lirika konsiderohet si një lloj letrar subjektiv? Si realizohet katarsisi në tragjedi?
- A mendoni se pastrimi shpirtëror i spektatorit/lexuesit arrihet vetëm përmes kësaj vepre artistike, apo mund të ndodhë edhe gjatë leximit të një romani ose të një epopeje?
- Përse mendoni se tragjedia moderne priret të mos e respektojë parimin e unitetit të vendit, kohës dhe veprimeve?

Hapi 3. **Punë dyshe.** Një nxënës lexon pyetjen, tjetri përgjigjet.

- Lexoni poezinë "Lirija" të Ndre Mjedës dhe përcaktoni se cilit lloj lirik i përket ajo. (Elegji)
- Si realizohet solemniteti në tekstin e Himnit tonë Kombëtar? Çfarë figurash letrare ka himni dhe me çfarë lloj rimash kemi të bëjmë? (Nëpërmjet forcës së fjalëve, figurave letrare si :apostrofi,epitete,anafora etj)

- Lexoni poezinë "Kam shikimin tand në shpirt" të Martin Camajt dhe argumentoni nëse kemi të bëjmë me lirikë tradicionale ose moderne duke interpretuar të gjitha rrafshet e poezisë.

Kam shikimin tand në shpirt
dhe melodinë e pavdekshme
të gjakut në pasion. Etj.

- Çfarë të përbashkëtash dhe çfarë ndryshimesh ka kjo poezi e Camajt me poezinë "Bukuria" të Naim Frashërit?

Hapi 4. **Praktikë e pavarur**. Nxënësit punojnë me shembuj konkretë.

✓ Në poemën "Bagëti e Bujqësi" të Naim Frashërit, gjeni fjalët që përshkruajnë ndjenjat dhe ato që përshkruajnë natyrën. Ka më shumë fjalë që përshkruajnë ndjenjat apo natyrën?

O malet' e Shqipërisë e ju o lisat' e gjatë! *(natyra)*
Fushat e gjëra me lule, q'u kam ndër mënt dit' e natë!
Ju bregore bukuroshe e ju lumenjt' e kulluar!
Çuka, kodra, brinja, gërxhe dhe pylle të gjelbëruar!
Do të këndonj bagëtinë që mbani ju e ushqeni,
O vendëthit e bekuar, ju mëndjen ma dëfreni.

(ndjenja)

Ti Shqipëri, më ep nderë, më ep emrin shqipëtar,
Zëmrën ti ma gatove plot me dëshirë dhe me zjarr.
Shqipëri, o mëma ime, ndonëse jam i mërguar,
Dashurinë tënde kurrë zemëra s'e ka harruar.

✓ Cilës fushë tematike mund t'i përkasin fjalët e një elegjie? Thoni pesë fjalë që janë të panatyrshme për t'u përfshirë në tekstin e një poezie elegjiake.

✓ Çfarë kuptimi ka fjala *komedi* në veprën e Dante Aligerit "Komedia Hyjnore"? Përse përdoret ky titull, kur në fakt nuk kemi të bëjmë me një vepër komike? (Sipas poetikës mesjetare, **Komedi** quhej një vepër që fillonte **me të keq dhe mbaronte me të mirë**.)

Vlerësimi: Mësuesi/ja vlerëson nxënësit për:

a) përgjigjet e sakta dhe të argumentuara mbi gjinitë lirike dhe dramatike;
b) për punën dyshe dhe të pavarur ku secili nxënës arrin të japë përgjigje.

Detyrat dhe puna e pavarur: Zgjidhni një tekst të një gjinie të caktuar dhe kthejeni në një gjini tjetër, duke përshtatur karakteristikat stilistike e gjuhësore të gjinisë që përzgjodhët. Lexoni dhe vlerësoni punët e njëri-tjetrit.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.¬___/____/__

<table>
<tr><th>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</th><th>Lënda: Letërsi</th><th>Shkalla: V</th><th>Klasa: XI</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Figurat stilistike</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: 1. Shohim në video-projektor pjesë të interpretuara nga aktorët tanë më të mirë duke e përqendruar vëmendjen te figurshmëria që mbartin këto krijime.
2. Lexojmë pjesë të ndryshme nga poetët tanë më të mirë (Migjeni, Fishta, Kadare, Poradeci) dhe dallojmë figurat letrare.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
Kompetenca e të menduarit
Kompetenca digjitale</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
- grupon figurat letrare sipas kuptimit, ndërtimit dhe shqiptimit;
- analizon figura të ndryshme letrare në pjesë te ndryshme: poezi, prozë.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe: Figurat stilistike, shqiptim poetik, sintaksë poetike.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: pjesë të ndryshme letrare: poezi, prozë, libri i nxënësit.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: gjuhë shqipe, stilistika, fjalori i gjuhës së sotme shqipe.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve
Diskutim-Pyetje-përgjigje-Kllaster-Punë në grupe</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizimi i orës së mësimit
Duke qenë se ky informacion është zhvilluar dhe vitin e kaluar sugjeroj që të zhvillohet si orë praktike dhe si detyrë e parë e portofolit.
Hapi 1. Diskutim. Në fillim kontrollojmë dhe lexojmë detyrat e shtëpisë. Pas leximit mësuesi/ja bën një pyetje:
• Si është përdorur gjuha në poezitë që ju keni gjetur apo në esenë që keni krijuar?
• A keni përdorur figura letrare? (Nxënësit japin mendimet e tyre)</td></tr>
</table>

Hapi 2. **Pyetje-përgjigje.** Kllaster. Mësuesi/ja i drejton pyetje klasës rreth figurave letrare:

- Si grupohen figurat letrare?
- Ku ndryshojnë paralelizmi figurativ dhe personifikimi?
- Cila është ajo figurë që ka lindur nga paralelizmi mes jetës së njeriut dhe jetës e natyrës së kafshëve?
- Ku ndryshojnë simboli dhe alegoria?
- Krahasoni elipsën dhe enumeracionin. Cila figurë është më e përdorshme nga lirika moderne?

Hapi 3. **Kllaster.** Pas këtyre pyetjeve, nxënësit japin përgjigjet e tyre ku njëkohësisht mësuesi/ja në dërrasë ka shkruar togfjalëshin "figura sintaksore". Nxënësit i përvijojnë mendimet e tyre duke plotësuar klasterin.



Hapi 4. **Punë në grupe**. Klasa ndahet në grupe ku secilit grup i ngarkohet një detyrë.

Grupi 1. Në një tekst përralle ose fabule analizoni personifikimet dhe alegoritë. Ilustroni me shembuj secilin rast.

A është çdo personifikim medoemos edhe alegori? Jepni shembuj konkretë nga tekste letrare, në funksion të përgjigjes suaj. Shembull: Vaji i bylbylit Ndre Mjeda, Dhelpra dhe rrushtë

Grupi 2. Ilustroni me shembuj rastet kur inversioni (e anasjella) shërben:

- për të respektuar strukturën metrike dhe rimën: "Melankoli" K. Trebeshina
- për të theksuar një gjymtyrë të caktuar të grupit sintaksor të fjalëve "E dashura shkruan përsëri" Gëte

Në një vëllim poetik të një prej shkrimtarëve të njohur shqiptarë gjeni sa më shumë figura të kuptimit, të tingullit, të fjalëve dhe shprehjeve dhe të sintaksës poetike, duke interpretuar për çdo rast funksionin që ato kanë në poezi. (mund të merrni dy poezi: "Pa ty", "Në studion dimërrore" I. Kadare ose "Dremit Liqeri", "Vdekja e Nositit" L. Poradeci.

Grupi 3. Në strofën e mëposhtme, çfarë figure retorike është mbizotëruese: apostrofa apo pasthirrma? Argumentoni përgjigjen tuaj.

O Meri, eja në dritare;
Është ora jonë e dëshiruar!
Ç'kushtojnë mijëra thesare
Përpara syve të adhuruar!
Mundim të madh do të duroja,
Si skllavi që duron i strukur,
Kur zemrën tënde ta fitoja
Moj Meri Morison e bukur!
("Meri Morison" R. Bërns)

- Gjeni figurat e shqiptimit poetik në këtë strofë:
  Mbrëmë pashë në ëndërr
  një ëndërr të vjetër
  Jeta kishte vend për marrëzinë
  marrëzia s'kishte vend për jetën. (Xh. Spahiu) (epanastrofe)
- Cilave figura letrare u korrespondojnë korbi në poezinë "Një ditë e ka dhe korbi" të M. Camajt dhe korbi në fabulën "Dhelpra dhe korbi"? Çfarë funksioni kryejnë ato? (simboli)

Grupi 4. Në poezinë "Anës lumenjve", gjeni të paktën 5 metafora që janë të shprehura me emra, me folje dhe mbiemra dhe shpjegoni funksion e tyre në krijimin e imazhit poetik.
Në fragmentin e mëposhtëm, thoni se cilët emra të përveçëm janë përdorur me kuptim metonimik.

"**Balzaku** në Francë fillon të lexohet në shkollë dhe nga numri i botimeve në qarkullim mund të thuhet se vazhdon të lexohet edhe pas mbarimit të saj. Por, nëse në Itali do të bëhej një sondazh, kam frikë se Balzaku do të renditej nga fundi. Të pasionuarit e Dikensit në Itali përbëjnë një elitë njerëzish që kur takohen menjëherë fillojnë e kujtojnë personazhe e episode si të flisnin për njerëz të njohur. Vite më parë, Mishel Bytor, që jepte mësim në Amerikë, i lodhur nga pyetjet e vazhdueshme mbi **Emil Zolanë** që nuk e kishte lexuar kurrë, vendosi ta lexonte të gjithë ciklin "Rougon Macquart". Ai zbuloi se ishin krejt ndryshe nga ç'i kishte menduar: një gjenealogji e mrekullueshme mitologjike dhe kozmogonike, të cilën më pas e përshkroi dhe në një ese të mrekullueshme."

Grupi 5. Gjeni një poezi ku figura e polisindetit është e pranishme. Cilat janë lidhëzat që janë përdorur? A janë ato vetëm bashkërenditëse, apo edhe nënrenditëse? P.sh., *"Dhe ditët nuk na janë aq plot"* Ezra Paund.
Gjeni dy ose tri tekste që i përkasin gjinisë elegjiake. Si flitet për vdekjen dhe të vdekurin në to? Në mënyrë të drejtpërdrejtë, apo përmes eufemizmash? Argumentoni rast pas rasti zgjedhjen e autorit. "Juvenilja" Ndre Mjeda.

Vlerësimi: Mësuesi/ja vlerëson nxënësit për përgjigjet e tyre në mënyrë të vazhdueshme si dhe për punën në grup që ata kryejnë këtë orë. Ky vlerësim mund të përdoret edhe për vlerësim portofoli.

Detyrat dhe puna e pavarur: Shkruani një ese duke përdorur figura stilistike, pasi të keni lexuar poezinë "Krahët" të Agollit, ose realizoni një pikturë të frymëzuar prej saj.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

<table>
<tr><th>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</th><th>Lënda: Letërsi</th><th>Shkalla: V</th><th>Klasa: XI</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Romantizmi. Kushtet historike e shoqërore të lindjes dhe të zhvillimit të romantizmit. Lëvizja “ Stuhi dhe vrull” Përfaqësuesit. Risitë</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Të shohin pjesë nga “Fausti” Gete.
https://youtube/8p1veDbXcrA
Lexojmë pjesë nga letërsia romantike duke nxjerrë në pah karakterin humanist të tyre, botëkuptimin,
forcën shprehëse (pjesë nga Pushkini).</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
Kompetenca e të menduarit
Kompetenca digjitale</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
- përcakton lindjen e romantizmit dhe fushat në të cilat u pasqyrua më tepër;
- rendit kushtet historike dhe shoqërore që patën rëndësi në lindjen dhe zhvillimin e tij;
- krahason termat romantizëm i përjetshëm dhe romantizëm historik;
- analizon lindjen dhe zhvillimin e lëvizjes “Stuhi dhe vrull”.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:
Romantizmi
Identiteti romantik
Pararomantizmi
Romani gotik
Stuhi dhe vrull</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: materiale të ndryshme (foto,video), teksti i nxënësit.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: kinematografi, histori, arte, TIK</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve
Pyetje-përgjigje-Diskutim-Hartë konceptesh-Punë në grupe</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizimi i orës së mësimit
Hapi 1. Pyetje-përgjigje. Në fillim kontrollojmë dhe lexojmë detyrat e shtëpisë duke vlerësuar detyrat e njëri-tjetrit. Më pas diskutojmë me nxënësit rreth termit “Romantizëm” ku secili prej tyre është i lirë të japë mendime se çfarë dinë, çfarë kanë lexuar për të. Pas 5 minutave diskutim mësuesi/ja i drejton pyetje klasës.</td></tr>
</table>

1. Ç'dini ju për romantizmin?
2. Kur u zhvillua ai?
3. Cilët janë romantikët e huaj edhe ata shqiptarë?
4. Cilat janë disa nga veprat romantike?

Hapi 2. **Diskutim**. Diskutojmë bashkë me nxënësit për vlerat reale të romantizmit. Si u hodh poshtë rregulla e tri njësive? Çfarë fryme u dha autorëve dhe veprave të tyre liria për të zgjedhur temën dhe natyrën e veprës a të konfliktit në të? Nxënësit janë të lirë të japin mendimet e tyre.

Hapi 3. **Hartë konceptesh**. Të gjitha konceptet mbi romantizmin i përmbledhim.





Hapi 4. **Punë në grupe**. Nxënësit punojnë me pyetjet e studimit të tekstit Grupi i parë punon me pyetjet 1, 3, 5, 7, 9. Grupi i dytë punon me pyetjet 2, 4, 6, 8, 10. Pas përgatitjes nxënësit japin përgjigjet e tyre duke iu referuar dhe informacionit në libër.
Vlerësimi: Mësuesi/ja vlerëson nxënësit në mënyrë të vazhdueshme për temën e dhënë dhe për punën në grup.
Detyrat dhe puna e pavarur: Gjeni në internet materiale të ndryshme mbi zërat femërorë të kësaj periudhe letrare.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

<table>
<tr><th>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</th><th>Lënda: Letërsi</th><th>Shkalla: V</th><th>Klasa:</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Veçoritë e romantizmit.
Gjinitë dhe llojet letrare që solli romantizmi në letërsi (ora e dytë)</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Lexojmë materiale historike mbi zhvillimin që pati Evropa përpara se romantizmi të zhvillohej
Romantizmi në kulturën europiane-Wikipedia
<u>https://sq.wikipedia.org/wiki/Romantizmi_në_kulturën_europiane</u>
materiali që mund të përdoret është poshtë temës së ditarit në ndihmë të mësuesit.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
Kompetenca e të menduarit
Kompetenca digjitale
Kompetenca personale</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
- përcakton vlerat reale të romantizmit dhe hedhjen poshtë të rregullave të tri njësive;
- identifikon frymën që u dha autorëve dhe veprave të tyre liria për të zgjedhur temën dhe natyrën e veprës a të konfliktit në të;
- përshkruan ndjenjat që mbizotëronin në veprat e kësaj periudhe,si u kombinuan ato me njëra-tjetrën;
- diskuton mbi tonin prekës, karakterin lirik dhe patetik të veprave të kësaj periudhe;
- Flet mbi gjinitë letrare që u lëvruan gjatë romantizmit dhe për raportet midis tyre.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:
Drejtime letrare
Kulti i natyrës
Idealizim i pasioneve
Analizë subjektive</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: libri i nxënësit, burime nga Wikipedia.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: arte, kinematografia.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve
Lexim i drejtuar-Diskutim dhe analizim-Pyetje-përgjigje</td></tr>
</table>

Organizimi i orës së mësimit

Hapi 1. **Lexim i drejtuar.** Kontrollojmë dhe lexojmë detyrat e shtëpisë. Lexojmë materialet që nxënësit kanë sjellë për zërat femërorë në letërsi. Më pas bëjmë lidhjen midis mësimit të kaluar dhe informacionit të ri.



Hapi 2. **Diskutim dhe analizim**. Mësuesi/ja hedh për diskutim mes nxënësve dy tema që kanë të bëjnë më informacionin ri. Nxënësit janë të lirë të thonë fjalën e tyre duke argumentuar mendimet.

1. Diskutoni për vlerat reale të romantizmit. Si u hodh poshtë rregulla e tri njësive? Çfarë fryme u dha autorëve dhe veprave të tyre liria për të zgjedhur temën dhe natyrën e veprës a të konfliktit në të?
2. Diskutoni mbi tonin prekës, karakterin lirik dhe patetik të veprave të kësaj periudhe.

Hapi 3. **Pyetje-përgjigje**. Kjo rubrikë ndërtohet me pyetjet e tekstit. Mësuesi/ja drejton pyetje dhe nxënësi përgjigjet

- ✓ Cilat janë notat kryesore të romantizmit? Si vlerësohet përmbajtja e tij? Analizoni traditat dhe risitë e tij në raport me kohën dhe vendet ku u shfaq.
- ✓ Pse disa shkrimtarë si Bajroni, Sheli, Hajne, Pushkin u quajtën shkrimtarët e mëdhenj patriotë?
- ✓ Përshkruani ndjenjat që mbizotëronin veprat e kësaj periudhe. Si kombinohen ato me njëra-tjetrën? Sa vend zënë ato që quheshin tema kryesore dhe si perceptohen këto në vende e autorë të ndryshëm?

✓ Si vjen sot te ju heroi i jashtëzakonshëm i kësaj kohe? A jeni dakord me shprehjen se ai veproi në rrethana po të jashtëzakonshme? ✓ Pse u ngrit kulti i natyrës? Shpjegoni lidhjen njeri-natyrë. ✓ Flisni mbi gjinitë letrare që u lëvruan gjatë romantizmit dhe për raportet midis tyre?
Vlerësimi: Mësuesi/ja bën vlerësime për përgjigjet e marra gjatë kësaj ore mësimi.
Detyrat dhe puna e pavarur: Diskutoni mbi ekranizime të veprave të këtyre autoreve ose mbi filma kushtuar vetë atyre.

Material që mund të përdoret në situatën e të nxënit në mësimin për romantizmin. Lexohet nga mësuesi/ja ose u jepet nxënësve për ta lexuar pjesë-pjesë.

Romantizmi në kulturën europiane

Mes shekujve XVII-XIX, në Evropë filloi të shfaqej një lëvizje e re kulturore, e cila u quajt romantizëm. Me kalimin e kohës, romantizmi mori përhapje të gjerë në shumicën e vendeve të Evropës. Kjo lëvizje u shfaq në kulturë e në art, sidomos në letërsi, në pikturë, në muzikë etj. Aty zënë vend ndjenjat e njeriut, imagjinata dhe mjeshtëria artistike e autorëve. Kjo rrymë kulturore mori përmasa posaçërisht në shekullin XIX.

Letërsia

Shkrimtarët romantikë në veprat e tyre trajtuan tema të ndryshme dhe i kushtuan rëndësi përshkrimit të natyrës, popullit dhe vendit të tyre, dashurisë etj. Ndër shkrimtarët më të njohur romantikë në Gjermani ishin Johan Gëte (1749-1832) dhe vëllezërit Jakob (1785-1863) e Vilhem (1786-1859) Grim. Përmes këtyre veprave ata nxitnin ndjenjën kombtare, krenarinë e popullit Gjerman dhe domosdoshmërinë për bashkimin e Gjermanisë. Ndër këta shkrimtarë më të njohurit ishin: Valter Skot (1771-1832) nga Anglia, Viktor Hygo (1802-1885) nga Franca, Aleksandër Pushkini (1799-1837) nga Rusia etj.

Piktura

Përveç në letërsi, romantizmi u shfaq edhe në pikturë. Piktorët Anglezë ishin të frymëzuar më së shumti nga natyra. Kështu piktori Konstebëll në veprat e tij pikturonte natyrën e bukur të Anglisë. Në Francë piktori Delakrua u bë simbol i romantizmit dhe veprat e tij frymëzim për piktorët e tjerë. Në mesin e shumë veprave të tij, më e njohura është tabloja "Liria dhe Barrikada".

Muzika

Kompozitorët dhe muzikantët romantikë u përpoqën që, përmes veprave të tyre, të emocionojnë dëgjuesit. Ndër kompozitorët më të njohur u shquan polaku Fridrih Shopen, hungarezi Franc List, rusi Petar Çajkovski, çeku Smetana etj. Edhe kompozitorët Gjermanë dhe Austriakë frymëzoheshin nga këngët folklorike. Kështu, Ludvig van Bet'hoveni zgjeroi edhe më tutje orkestrën duke futur sërish instrumente të reja. Xhuzepe Verdi krijoi shumë opera të bukura me motive të ndryshme.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt. ___/____/__

<table>
<tr><th>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</th><th>Lënda: Letërsi</th><th>Shkalla: V</th><th>Klasa:</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Johan Volfgang Gëte
Jeta dhe vepra. Gëte poet, dramaturg, narrator</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:Nxënësi njeh dhe ndërton kuptimin e duhur mbi figurën e Gëtes dhe krijimtarinë e tij letrare. Rolin e padiskutueshëm që pati jo vetëm në letërsinë gjermane por dhe në atë evropiane.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
Kompetenca e të menduarit
Kompetenca e të nxënit
Kompetenca digjitale</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
- rendit disa nga punët që kreu Gëte dhe diskuton rreth ndikimit të tyre në veprën e ti;
- tregon lidhjen e shkrimtarit dhe krijimtarisë së tij me Vajmarin;
- shpjegon motivet dhe optimizmin që buron të tij;
- diskuton mbi vlerat që përcjell romani psikologjik, shoqëror dhe epistolar.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:
Shkrimtar klasik
Faza titanike
Klasicizëm vajmaras,
Olimpiku i vajmarit
Poet dramatik
Themelues i romanit</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: teksti i nxënësit, libri i nxënësit, materiale nga interneti, vepra letrare “Fausti”.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: histori, gjuhë shqipe, arte.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme-Diskutim-Harta e koncepteve-Lexim i drejtuar-Minikonkurs</td></tr>
</table>

Organizimi i orës së mësimit

Hapi 1. **Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme**. Në fillim kontrollojmë detyrat e shtëpisë dhe lexojmë disa prej tyre. Më pas kalojmë në kontrollin e njohurive të mëparshme nëpërmjet metodës së diskutimit.

Ç'quajmë romantizëm? Kur daton zhvillimi i romantizmit? Cilët janë përfaqësuesit kryesorë? Kur u zhvillua lëvizja "Stuhi dhe Vrull" dhe çfarë të reje solli? Cila janë tiparet e romantizmit? etj.

Hapi 2. **Harta e koncepteve**. Në këtë moment mësuesi/ja shkruan në dërrasë emrin "Gëte", të cilin e lidh me informacionin e marrë më përpara si përfaqësues i denjë i romantizmit.



GËTE DRAMATURG			
DRAMAT HISTORIKE		**DRAMAT ETIKE**	
“Gëci i Berlinhingenit”	**“Egmonti”**	**“Ifigjenia në Tauridë”**	**“Torkuato Taso”**
Gëci, kalorësi me dorë hekuri, personazh historik i shek. XVI, i ngritur nga Gëte në lartësinë e heroit kombëtar, vihet në krye të fshatarëve kryengritës dhe bëhet mishërim i burrërisë dhe i frymës liridashëse. Përpiqet të zhdukë padrejtësitë dhe të realizojë bashkimin e Gjermanisë. Personazh i ndershëm, i fortë, guximtar, i çiltër dhe i thjeshtë, lartëson virtytet dhe dinjitetin e popullit gjerman.	Egmonti, personazh historik i Vendeve të Ulëta të shek. XVI, i ndershëm, trim, besnik e i sinqertë, i tradhtuar, burgoset dhe dënohet. Në burg ai kupton vlerën e lirisë, por refuzon të bashkëpunojë me dukën e Albës dhe flijohet bashkë me të fejuarën. Për Egmontin lumturia qëndron në drejtësinë e veprimeve të njeriut. Dashuria që flijon veten për idealet e lirisë, i jep veprës një forcë shekspiriane.	Subjekti i marrë nga Euripidi,ka përmbajtje dhe përfundim të ndryshëm. Në Tauridë (Krimea e sotme), Ifigjenia, personazhi i pakrahasueshëm me asnjë tjetër personazh të Gëtes, pret vëlla Orestin të ndjekur nga Erinitë dhe mikun e tij Piladin. Mëshira dhe dashamirësia e saj, besimi të zotat, mallëngjen mbretin Toante, qetëson shpirtin e tronditur të vëllait dhe pajton hyjnitë qiellore me fisin e Tantalideve.	Torkuato Taso poeti italian,i shek. XVI, i përzënë nga oborri, sepse ka tentuar të përqafojë princeshën Eleonorë, detyrohet të pranojë ndihmën e kundërshtarit të tij. Drama trajton konfliktin mes ideales që aspiron poeti dhe realitetit që i zhgënjen aspiratat e njeriut të pastër, viktimë e një shoqërie që shkel ndjenjat fisnike njerëzore, ëndrrën për një shoqëri humaniste.



Hapi 3. **Lexim i drejtuar**. Nxënësit lexojnë në mënyrë individuale informacionin e ri duke u mbështetur edhe te tabela, harta e koncepteve dhe diskutimi që u zhvillua në klasë.

Hapi 4. **Minikonkurs**. Në këtë fazë zhvillohet një konkurs në klasë. Klasa ndahet në katër ekipe. Secili ekip zgjedh përfaqësuesin që do t'u përgjigjet pyetjeve. Konkursi do të ndahet në dy faza.

Faza e parë do të ketë pyetje rrufe – që duan përgjigje të shpejta dhe të shkurtra.

Faza e dytë do të ketë pyetje që duan kohën e tyre për t'u përgjigjur.

Ekipit të parë do t'i drejtohen këto pyetje:

1. Si nisi jeta letrare e Gëtes? Me ç'rrethana të jetës lidhet fillimi i krijimtarisë së tij?
2. Renditni disa nga punët që kreu Gëte dhe diskutoni rreth ndikimit të tyre në veprën e tij.
3. Cila qe lidhja e shkrimtarit dhe e krijimtarisë së tij me Vajmarin?
4. Nga frymëzohen kryeveprat lirike të Gëtes? Shpjegoni motivet dhe optimizmin që buron prej tyre.
5. Ku mbështeten rrëfimet e baladave të Gëtes? Ç'karakter kanë ato?
6. Cili ishte modeli i tij në dramë? Çfarë e ndihmon klasifikimin e dramave të tij, në historike dhe etike?
7. Ç'mesazh përcjell personazhi i Egmontit?
8. Analizoni notat biografike te "Torkuato Taso".
9. Analizoni kodin etik te romani "Afritë përzgjedhëse".
10. Diskutoni mbi vlerat që përcjellin romani psikologjik, shoqëror dhe epistolar. (Pyetja e fundit është e vlefshme për të të dyja grupet)

Ekipit të dytë do t'i drejtohen këto pyetje:

1. Si ndikoi edukimi i Gëtes në krijimtarinë e tij?
2. Si ndikoi Italia në artin dhe personalitetin e Gëtes?
3. Pse Gëte identifikohet më shumë si poet? Si e vlerëson ai poezinë?
4. Pse themi që poezitë-himne lidhen me lëvizjen "Stuhi dhe vrull", të krijuar dhe të mbështetur nga Gëte?
5. Ç' ndikime pati krijimtaria e tij? A është vepra "Divani perëndimor-lindor" tregues i tyre?
6. Si lartësohet figura e Gëcit në dramën me të njëjtin emër?
7. Ç'mishëron Ifigjenia? Si gërshetohen tek ajo humanizmi dhe subjekti grek?
8. Përshkruani ngjarjet kryesore të romanit "Vuajtjet e djaloshit Verter". Pse ndikoi te bashkëkohësit kjo vepër?
9. Vlerësoni rëndësinë e veprës "Vilhelm Masteri".
10. Diskutoni mbi vlerat që përcjellin romani psikologjik, shoqëror dhe epistolar. (Pyetja e fundit është e vlefshme për të të dyja grupet)

Në fund shpallet dhe ekipi fitues në bazë të një sistemi pikësh. Në fund përmbledhim gjithë informacionin që morëm.

Vlerësimi: Mësuesi/ja vlerëson nxënësit për përgjigjet e sakta që dhanë gjatë bashkëbisedimit dhe konkursit që u zhvillua në klasë.

Detyrat dhe puna e pavarur: Të sjellin vlerësime për figurën e Gëtes nga autorë, studiues dhe mendimtarë të të gjitha kohërave.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</td><td>Lënda: Letërsi</td><td>Shkalla: V</td><td>Klasa:</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Analizë e veprës: Tragjedia “Fausti”</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Letërsia antike greke pati ndikimet e saj në letërsinë evropiane. Sa ndikoi ajo te veprat e Gëtes? Diskutim (marrim në shqyrtim një pjesë nga krijimtaria e tij.)</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
Kompetenca e të menduarit
Kompetenca digjitale</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
- shpjegon zanafillën e subjektit dhe stimulimin që i jep autori personazhit në zhvillim e sipër;
- analizon strukturën e veprës dhe dallon si shtjellohet personazhi kryesor në lidhje me ato episodike;
- përshkruan figurën e Faustit përmes kalimit të tij nga një personazh plot dëshira në një njeri të veprimit dhe që u gëzohet vetëm veprave të mira;
- rendit figurat femërore dhe mesazhet që përcjell ai përmes tyre;
- përshkruan tiparet e veprës që tregojnë se në të zënë fill disa gjini letrare;
- vlerësoni kontributin e Gëtes në kulturën gjermane dhe atë botërore si pararendës dhe nxitës i zhvillimeve të kohës.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:
Faust
Mefistofel
Urfaust
Djall
Dashuri
Magji</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: vepra “Faust”, libri i nxënësit, libri digjital, pjesë të ndryshme filmike.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: arte, kinematografi, TIK.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve
Diskutim-Ndërtim i njohurive-Lojë dyshe</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizimi i orës së mësimit
Hapi 1. Diskutim. Në fillim të orës dëgjojmë informacionet dhe vlerësimet që kanë sjellë nxënësit për figurën e Gëtes. Këto informacione kanë të bëjnë me rolin e tij në letërsinë gjermane, gjuhën që përdorim, mesazhet që përcolli etj.
Hapi 2. Ndërtimi i njohurive të reja. Mësuesi/ja shkruan në dërrasë fjalën “Faust” dhe së bashku me nxënësit fillon ta plotësojë atë mbi mjegullën që është krijuar për figurën e tij legjendare, historike, popullore etj.</td></tr>
</table>



Më pas analizojmë strukturën e veprës si dhe tregojmë subjektin. Nxënësit që paraprakisht e kanë lexuar veprën ndërhyjnë, flasin, tregojnë me fjalët e tyre atë që ata kanë lexuar.



AKTI V. Fausti kolonizator dhe utopist

Vdekja e Faustit

Fausti:

- përmbledh historinë e njerëzimit në kërkim të diturisë;
- nuk heq dorë nga jeta;
- personifikon shpirtin e ri, bashkëkohor, afirmimin e aspiratave,forcave krijuese të njeriut;
- bashkëjetojnë dy prirje shpirtërore në konflikt: njëra e tërheq poshtë drejt botës materiale, tjetra e tërheq lart drejt absolutes e pafundësisë;
- gjithnjë synon dhe arrin, por nuk kënaqet me ato që ka arritur;
- është i bindur se vetëm veprimi e dinamizmi e mbajnë gjallë jetën;
- fitorja mbi natyrën shënon veprën e tij më të madhe dhe fundin e udhëtimit të tij

me veprimtarinë e tij të dobishme ai e ka mundur egoizmin dhe e ka kuptuar se lumturia nuk mund të jetë kurrë e plotë, nëse nuk ndahet me njerëzit e tjerë.

Personazhet

Mefistofeli

- paraqitet nga Zoti si shpirti i mohimit;
- utilitar, skeptik dhe pragmatist
- është zëri i pavetëdijes, pasqyra e keqe e Faustit;
- ai ia plotëson dëshirat e tij (të këqija e të mira) dhe tregohet kështilltar i keq, tinëzar e cinik;
- është alteregoja e njeriut, shok rruge i yni, mëdyshja jonë, vetja jonë djallëzore;
- simbolizon shpirtin e mohimit, pa të cilin nuk mund të ketë zhvillim të vërtetë;
- ai është faktori thelbësor i botës, faktori negativ i aftë të krijojë kontradiktat që janë kushti bazë i zhvillimit.

Margarita

- personazhi më poetik i Gëtes, i frymëzuar nga përvoja nostalgjike e dashurisë rinore e të dëlirë, por të humbur;
- karakterizohet nga natyrshmëria, përkushtimi, besimi në dashuri, droja dhe rezervimi, thjeshtësia e karakterit, morali i pastër, edukata fetare e shndërrojnë atë në vajzën e ëndrrave
- është mishërim i dashurisë së dëlirë; vetëmohuese që u zbulohet njerëzve në formën më të përsosur, në dashurinë e gruas, simbol i zbutjes dhe i shpëtimit të shpirtrave;
- është motra poetike e shpirtërore e Beatriçes.

Hapi 3. **Lojë dyshe**. Nxënësit punojnë me njëri-tjetrin duke iu referuar pyetjeve të studimit të tekstit. Pyetjet nga (1-15)
Vlerësimi: Mësuesi/ja vlerëson nxënësit në mënyrë të vazhdueshme për përgjigjet që dhanë në diskutim dhe lojën dyshe që zhvilluan me njëri-tjetrin.
Detyrat dhe puna e pavarur: Të lexojnë fragmentin "Pakënaqësia dhe ankthi për dituri e Faustit", "Natë". Pakti mes Faustit dhe Mefistofelit (v.1583-1711) nga vepra " Fausti".

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt. ___/____/__

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda: Letërsi**	**Shkalla: V**	**Klasa:**
Tema mësimore: Fragment: "Pakënaqësia dhe ankthi për dituri e Faustit". Pakti mes Faustit dhe Mefistofelit		**Situata e të nxënit:**Nxënësit lexojnë fragmentin e dhënë në tekst me informacionin e duhur duke treguar mjetet shprehëse që ka përdorur.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: - rendit detajet që tregojnë gjendjen e shqetësuar të Faustit; - diskuton rreth problemeve që paraqiten në fragment. - analizon dy thirrjet që i japin teatralitet monologut të Faustit; - identifikon vlerat morale që propagandon autori në këtë këngë; - jep mendimin e tij rreth paktit që bëjnë dy personazhet.		**Fjalët kyçe:** Fausti Mefistofeli Djall Ëngjëll	
Burimet: libri digjital, teksti i nxënësit, vepra letrare "Fausti".		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** arte, gjuhë shqipe, Tik.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Lexim i drejtuar-Punë në grupe-Praktikë e drejtuar-Ditari dypjesësh			
Organizimi i orës së mësimit ***Hapi 1.*** **Lexim i drejtuar**. Mësuesi/ja vendos një nxënës të lexojë fragmentet e "Pakënaqësia dhe ankthi për dituri e Faustit" "Natë" ndërsa këtë fragment "Pakti mes Faustit dhe Mefistofelit" (v. 1583-1711) nga vepra "Fausti e lexojmë me role. Gjatë leximit japim dhe komentet e nevojshme për t'u njohur më mirë me episodet e dhëna në libër			

"Pakënaqësia dhe ankthi për dituri e Faustit" Natë

Fausti del për herë të parë në skenë. Ai shpreh dëshpërim, sepse shkenca e tij e shumëfishtë nuk e rrok të vërtetën e botës, thelbin e natyrës krijuese. Në planin ideologjik dhe njohës fragmenti sqaron forcat që lëvizin Faustin, të cilin e shpëton nga vetëvrasja tingulli i kambanave dhe kori i grave të gëzuara për festën e Pashkëve. Edhe Faustin e pushton kjo ndjenjë, ndaj ai i kundërvë ankthit të tij të dijetarit, thjeshtësinë dhe qetësinë e jetës së përditshme. Në librat e tij Fausti dallon shenjën e Makrokozmosit (unitetin sintetik të Gjithësisë) dhe Shpirtin e Tokës (parimin dinamik dhe krijues që shtyn në veprim dhe në shkatërrim). Ai evokon Shpirtin e Tokës (shpirtin krijues e jetësor, forcën thelbësore të veprimit) që shfaqet dhe nxit monologun faustian të ndërprerë nga Vagneri, ndihmësi i Faustit. Mbas largimit të tij Fausti vazhdon dialogun.

Pakti mes Faustit dhe Mefistofelit

Në këtë skenë shfaqet Mefistofeli, i cili ka hyrë edhe më parë në studio me pamjen e një qeni rrugësh. Mefistofeli e di tashmë gjendjen e dëshpëruar të Faustit prandaj i bën propozimin e tij. Në këtë skenë realizohet pakti-bast i vërtetë mbas një diskutimi të gjatë mes dy personazheve

Hapi 2. **Punë në grupe**. Klasa ndahet në dy grupe.

Grupi i parë punon me këto detyra të cilat i përmbahen fragmentit "Natë": Në fillim u drejtojmë pyetje të përgjithshme rreth fragmentit për ta kuptuar më mirë atë:

- Në cilin moment të subjektit të dramës jemi këtu? - jemi në momentin kur Fausti del për herë të parë në skenë. Ai shpreh dëshpërim, sepse shkenca e tij e shumëfishtë nuk e rrok të vërtetën e botës, thelbin e Natyrës krijuese.
- Cilat detaje e tregojnë gjendjen e shqetësuar të Faustit? - Epitetet që ai përdor (i ngrati, Më tepër mend nga ç'kisha s'kam tregojnë pikërisht gjendjen e shqetësuar në të cilën ndodhet Fausti.
- Çfarë nuk i pëlqen atij në sistemin e edukimit dhe të dijes?
- Ku duket që Fausti është njeri i veprimit? Ç'marrëdhënie vendos ai me kohën, Vagnerin, natyrën, dijen dhe vlerën e tyre reale?
- Ku shprehet dëshira e Faustit për njohjen e botës dhe ndryshimet që rrisin vetëdijen njerëzore?
- S'kam pasuri e s'kam florinj... Çfarë tregon shprehja për rëndësinë që Fausti u jep gjërave?
- Pse Fausti e quan veten i ngrati? Kujt i drejtohet ironia e tij?
- Ç'rol ka ndikimi i Vagnerit te Fausti? Si e portretizon Fausti atë?
- Ç'vegim i shfaqet Faustit dhe çfarë paralajmëron ai?
- Cila është dilema që karakterizon mekanizmin e vetëzbulimit? Gjeni pyetjen retorike që e shpreh.

Grupi i dytë punon me këto detyra të cilat i përmbahen fragmentit "Pakti mes Faustit e Mefistofelit": Në fillim u drejtojmë pyetje të përgjithshme rreth fragmentit për ta kuptuar më mirë atë.

- Cili është sinjali që ndryshon mendjen e Faustit? Ç'kuptim ka ai, sipas jush?
- Në ç'raport me të përditshmen e vendos Fausti këtë sinjal që ndryshon shpirtin njerëzor?

- Si e josh Mefistofeli Faustin? Si e vë ai në lëvizje mekanizmin e të menduarit për ndryshim te Fausti?
- Cilat janë burimet e fuqisë së Faustit? Si i mohon autori gëzimet dhe kotësitë që vijnë nga kjo jetë?

Hapi 3. **Praktikë e drejtuar**. Punojmë me pyetjet e të dyja pjesëve.Mësuesi/ja jep ndihmën e nevojshme e më pas nxënësit japin përgjigjet e tyre

1. S'kam pasuri e s'kam florinj... Çfarë tregon shprehja për rëndësinë që Fausti u jep gjërave? - Fausti vlerëson te njeriu shpirtin dhe jo pasurinë.

   Ç'shpreh enumeracioni: doktorët, mësuesit, priftërinjtë, shkresarët? - përdorimi i enumeracionit tregon intelektin, botën e madhe të Faustit, studimet e shumta që ai ka kryer.

   Analizoni dy thirrjet që i japin teatralitet monologut të Faustit. Ç'vegim i shfaqet Faustit dhe çfarë paralajmëron ai? Analizoni situatat e Faustit midis shpirtit, zërit të Vagnerit, Zotit dhe vetes.
2. Zgjero kuptimin e vargut: Prap' veç mes njerëzve je njeri. - ***Duan të të tërheqin në botën e gjerë, larg vetmisë që mban në amulli ndjenjat dhe limfën (energjinë) njerëzore. Mjaft luajte me penën tënde që ta gëlltit jetën si grabitqar; edhe shoqëria më e keqe të bën të ndihesh si njeri mes njerëzish. Kjo nuk do të thotë që të shtyjmë drejt njerëzve më të këqij. Nuk jam njëri prej djajve të fuqishëm; nëse do të bashkohesh me mua për t'i hedhur hapat në jetë, pranoj me dëshirë të bëhem i yti, kokë e këmbë.***
3. Pse Fausti nuk e beson Mefistofelin? Ç'kërkon të thotë ai përmes vargut: Një shërbëtor si ti sjell rrezik...?

Hapi 4. **Ditari dypjesësh.**

Fraza	Komenti
Ty, o ndër vdektarët më i ngrati?	Nëpërmjet apostrofit "o ndër vdektarët" Fausti kërkon të na tregojë duke qenë se jemi qenie të vdekshëm, kërkojmë të realizojmë qëllimet dhe dëshirat që i kemi vënë vetes. Epiteti "i ngrati" tregon shpirtin e përulur dhe të dhembshur të njeriut.

Fraza	Komenti
Që te çukit si shkabë mu në gji...?	Në fjalët e Mefistofelit shfaqet dhe një herë karakteri i tij thumbues drejt Faustit që kërkon ta çojë drejt shthurjes për ta larguar nga rruga e drejtë. Nëpërmjet krahasimit si shkabë kërkon të na krahasojë shpirtin e pikëlluar të Faustit dhe dëshirën për të jetuar.

Vlerësimi: Mësuesi/ja bën vlerësim të vazhdueshëm për përgjigjet që nxënësit dhanë gjatë rubrikave të ndryshme, në punën në grup dhe atë individuale.

Detyrat dhe puna e pavarur: Shkruani një ese temë përfundimin e Faustit: "Natyra është një mister".

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt. ___/____/__

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</td><td>Lënda: Letërsi</td><td>Shkalla: V</td><td>Klasa:</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Fragment: Shtëpia e Margaritës: “Tempull” dhe “Burg”</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Nxënësi zbulon kënaqësinë e të lexuarit dhe bëhet i vetëdijshëm për shumëllojshmërinë e perceptimit të botës, duke e vlerësuar letërsinë si mjet kyç për të pasuruar botën emocionale, për të zhvilluar imagjinatën dhe të menduarit kritik.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
Kompetenca e të menduarit</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
- rendit detajet që tregojnë hijeshinë e shtëpisë së Margaritës dhe domethënien e saj;
- përshkruan idealizimin e shtëpisë së Margaritës dhe ndjenjën e poetit për të;
- shpjegon shpirtëzimin e mbrëmjes tregon funksionin e këtij perceptim artistik.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:
Fausti
Margarita
Altar
Afsh i thekshëm dashuror</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:
Libri digjital, teksti i nxënësit, materiale nga interneti, vepra letrare “Fausti”.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:
gjuha shqipe, arte, tik.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve
Diskutim-Lexim i drejtuar-Koment dhe analizë-Praktikë e pavarur</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizimi i orës së mësimit
Hapi 1. Diskutim. Mësuesi/ja kontrollon detyrat e shtëpisë dhe më pas disa nxënës i lexojnë ato. Pas leximit diskutohet mbi të përbashkëtat e esesë dhe vet misionit të Faustit në natyrë.
Hapi 2. Lexim i drejtuar. Një nxënës lexon fragmentin e dhënë. Në monologun e mëposhtëm, nga skena “Mbrëmje”, shprehen hapur “dy prirjet shpirtërore” ose forcat kundërshtuese që lëvizin Faustin dhe që fuqizohen nga konteksti dhe nga kontrasti mes tij e Mefistofelit. Ai hyn në shtëpinë e Margaritës për ta joshur me një kuti me dhurata. Ai ndien hijeshinë e mjedisit, njëkohësisht të mbyllur dhe të mbrojtur. Fausti e quan shtëpinë e Margaritës vend të shenjtë dhe burg (në një burg të vërtetë do ta gjejë Fausti Margaritën në skenën që mbyll pjesën e parë). Plotësia e jetës që Fausti imagjinon në atë botë të vogël (me kufizimet e saj), rregulli, pastërtia, dashuria familjare, bëhet e mundur nga traditat patriarkale që mbizotërojnë aty. Kontrasti është edhe në shpirtin e Faustit: në fund, i dyzuar, jo pa ankth, ai pyet veten.</td></tr>
</table>

Hapi 3. **Koment dhe analizë**. Punohet me pyetjet e studimit të tekstit.

- ✓ Renditni detajet që tregojnë hijeshinë e shtëpisë së Margaritës dhe domethënien e tyre.
  →Disa nga detajet janë: vend i rregullt, i pastër dhe i vogël.
- ✓ Shpjegoni titullin e kësaj skene. Ç'nënkuptojnë fjalët tempull dhe burg, sipas jush?
  →Në monologun e mëposhtëm, nga skena "Mbrëmje", shprehen hapur "dy prirjet shpirtërore" ose forcat kundërshtuese që lëvizin Faustin dhe që fuqizohen nga konteksti dhe nga kontrasti mes tij e Mefistofelit. Tempull është vend i shenjtë ndërsa burg vend i errët. Fjalët **tempull** dhe **burg** duket sikur qëndrojnë në antitezë me njëra-tjetrën sepse brenda shtëpisë së Margaritës shkrihen të dyja bashkë. Edhe pastërtia hyjnore, shpirt i dëlirë si dhe mungesa e lirisë dhe e të jetuarit bukur.
- ✓ Ku duket që Fausti ka rënë në dashuri? Çfarë e magjeps Faustin në këtë fragment?→
  O Vash' ç'duar ke!
  Parajsën paske sjellë përmbi dhe!

  I gjori Faust, jo, s'të njihkam më!
  Një tis magjik mos më mbështjellë?
  Qëparë' më shtynte thjesht lakmia,
  Tani më ka molisur dashuria.
- ✓ Si përdoren kontrastet për të nxjerrë në pah dy prirjet shpirtërore të Faustit? →
  Kontrastet përdoren për të nxjerrë në pah gjendjen shpirtërore të Faustit në momentet kur ndodhet në shtëpinë e Margaritës e vendosur përball kjo me vetë gjendjen shpirtërore të Faustit përballë Mefistofelit.

Hapi 4. **Praktikë e pavarur**. Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur me pyetjet e studimit të tekstit.

- ✓ Gjeni në tekst figura letrare si: metafora, oksimoroni, antiteza etj., dhe shpjegoni kuptimet e tyre.

Metaforë	**Oksimoron**	**Antitezë**
Vesë shprese	Afsh i thekshëm dashuror	Vend i shenjtë – çip (burg)
Endirë paqeje	Varfëri-begati	
Frymë qetësie	Burg-lumturi	

Ç'vlerë fitojnë vargjet prej foljeve? Si ndihmojnë ato në përshpejtimin e përshkrimit faustian?
Përdorimi i foljeve rrëmbemë, ndjej, shoh, gjej, merrmë etj. tregojnë gjendjen emocionale të Faustit përballë Margaritës si dhe faktin e ikjes, largimit nga vorbulla e rutinës së përditshme dhe shkuarjen në gjirin e natyrës.

Vlerësimi: Mësuesi/ja bën vlerësim të vazhduar me gojë për përparimin e nxënësve, me qëllim identifikimin e njohurive, interesave, aftësive apo shkathtësive që kanë fituar nxënësit në lidhje me temën e trajtuar.

Detyrat dhe puna e pavarur: Krahasoni ndjenjat e ngjashme të Romeos shekspirian dhe të Faustit.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt. ___/____/__

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</td><td>Lënda: Letërsi</td><td>Shkalla: V</td><td>Klasa:</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Fragment: Filemoni dhe Baukida</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Nxënësi zbulon kënaqësinë e të lexuarit nëpërmjet fragmentit duke zbuluar figuracionin e përdorur dhe gjuhën e përdorur nga Gëte në pjesët e komentuara.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
Kompetenca e të menduarit</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
- identifikon dy momentet kryesore që e bëjnë ngjarjen dramatike;
- analizon urrejtjen që ndien Fausti për botën e vjetër dhe për kufizimet e lirisë;
- analizon idenë e Faustit mbi misionin e njerëzve për të kryer të mira ndaj njerëzimit;
- përcakton rolin që kryejnë personazhet në pasurimin skenik të veprës.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:
Fausti
Mefistofel</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:
Libri digjital, teksti i nxënësit, materiale nga interneti.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:
gjuha shqipe, arte, TIK.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve
Diskutim-Kuptim dhe shpjegim teksti-Koment vargjesh-Reflektim dhe diskutim dijesh</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizimi i orës së mësimit
Hapi 1. Diskutim. Mësuesi/ja kontrollon detyrat e shtëpisë dhe më pas disa nxënës i lexojnë ato. Pas leximit të detyrave të shtëpisë mësuesi/ja vendos një nxënës të lexojë fragmentin Filemoni dhe Baukida.
Hapi 2. Kuptim dhe shpjegim teksti. Episodi i Filemonit dhe Baukidës, shkatërrimi i kasolles dhe vrasja e tyre, zhvillohet gjatë dy skenave “Pallati” dhe “Natë e thellë”. Fausti e ngarkon Mefistofelin t’i transferojë, me hir a me pahir, dy pleqtë larg nga prona e tyre, në një fushë tjetër. Skena e dytë ka në fillim një pauzë lirike, protagonist i së cilës është Linke, roja që ka si detyrë (sipas modeleve tipike të tragjedisë antike) të paraqesë ngjarjet. Mefistofeli ngarkon tre nga ndjekësit e tij të përfundojnë operacionin, duke i përzënë pleqtë nga kasollja e tyre. Urdhri i tejkalon kufijtë e parashikuara: kasolles i vënë flakën, dy pleqtë me shtegtarin që është mysafir i tyre, vdesin; humbin edhe kasollja me pemët e blirit dhe hijet që lëshonin ato. Pas shpjegimit që i bëjmë tekstit punojmë me disa pyetje të studimit të tekstit.</td></tr>
</table>

- ✓ Ç'pjesë të personalitetit të Faustit shfaqen në fragment? Si mund të kuptohet sjellja e tij? → Fausti këtu na del i zgjuar, këmbëngulës dhe kërkon të rrokë veprën e tij kryeveprën e mendjes njerëzore me një vështrim për ta bërë të veten.
- ✓ Cilat janë dy momentet kryesore që e bëjnë ngjarjen dramatike? → Faustin e pezmaton tingëllimi i kambanës, sepse i kujton mospërmbushjen e dëshirës së tij, kurse Mefistofeli, duke qenë djall ndien neveri kur dëgjon kambanën e kishës.
- ✓ Si e shpjegoni vargun: Te bliri dua të rri? → Ky varg tregon kundërshtimin dhe këmbënguljen për të qëndruar në pronën e vet.
- ✓ Çfarë kujton Mefistofeli në momentin e kërkesës së Faustit për largimin e dy pleqve? → Mefistofeli i kujton Faustit konceptin e të qenit i drejtë për të justifikuar urdhrin që do të vinte më pas.
- ✓ Me cilën histori ngjan ajo e Filemonit dhe Baukidës? Sa besnik i qëndron Gëte mitit? → Metamorfoza e Ovidit. Ai e rimerr këtë mit, e ripropozon temën e mikpritjes dhe dashurisë bashkëshortore.

Hapi 3. **Koment vargjesh.**

- ✓ A distancohet Fausti nga Mefistofeli? Komentoni vargjet:

Ku vajti, pra, vullneti im
Shkëmbim kërkova, jo shkretim
Ky akt mizor më shtyn këtu
Mallkimin tim të hedh mbi ju.

Vargu	Komenti
Ku vajti, pra, vullneti im Shkëmbim kërkova, jo shkretim Ky akt mizor më shtyn këtu Mallkimin tim të hedh mbi ju.	

Hapi 4. **Reflektim dhe diskutim dijesh**. Mësuesi/ja fton nxënësit të diskutojnë mbi këto vargje që përcjell Fausti: Bota e vjetër e vlerave digjet në altarin e një progresi mbase të tmerrshëm. Diskutoni mbi dykuptimësinë e vargjeve të kësaj skene. Cili është qëllimi i autorit në këtë rast?

Vlerësimi: Mësuesi/ja bën vlerësim të vazhduar me gojë për përparimin e nxënësve, me qëllim identifikimin e njohurive, interesave, aftësive apo shkathtësive që kanë fituar nxënësit në lidhje me temën e trajtuar.

Detyrat dhe puna e pavarur: Të hulumtojnë dhe të sjellin materiale mbi figurën e Viktor Hygoit.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

<table>
<tr><th>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</th><th>Lënda: Letërsi</th><th>Shkalla: V</th><th>Klasa:</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Viktor Hygo
Jeta dhe vepra.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Nxënësi dëgjon dhe reflekton mbi gjuhën e përdorur nga Viktor Hygo në materiale të ndryshme (fragmente nga romani “ Të mjerët” etj.)</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
Kompetenca e të menduarit</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
- përcakton ndikimi e jetës familjare në kujtimet e Hygoit;
- përshkruan kontributin e tij në politikë, shoqëri dhe në çështjet e paqes;
- rendit dy drejtimet letrare simbolizmin dhe realizmin dhe tregon se si janë të trajtuara te Hygoi;
- klasifikon periudhat e krijimtarisë letrare të Hygoit si poet, dramaturg, romancier.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:
Viktor Hygo
babai i poezisë moderne franceze
meditim i brendshëm</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:
Libri digjital, teksti i nxënësit, materiale nga interneti, foto, pjesë të ndryshme filmike.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:
gjuha shqipe, arte, tik, histori.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve
Lexim dhe diskutim-Skemë rreze-Ndërtimi i njohurive të reja-Metoda e klasterit-Lexim dhe interpretim</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizimi i orës së mësimit
Hapi 1. Lexim dhe diskutim. Në fillim të orës kontrollojmë dhe lexojmë disa nga detyrat. Pas leximit nxënësit nxjerrin përfundimet e detyrës duke e lidhur atë dhe me vetë jetën e Viktori Hygo.

Hapi 2. Skemë rreze. Në këtë fazë të orës së mësimit mësuesi/ja shkruan në dërrasë emrin Viktor Hygo dhe fton nxënësit që të japin mendimet e tyre rreth tij.

.</td></tr>
</table>



Hapi 3. **Ndërtim i njohurive të reja**. **Metoda e kllasterit.** Mësuesi/ja ndërton informacion mbi rolin e Hygoit si poet, prozator, dramaturg dhe të veçantat që solli ai në letërsinë europiane





Hapi 4. **Lexim dhe interpretim**. Nxënësit lexojnë thënie nga Viktor Hygo duke i komentuar ato

Citate, fragmente të shkëputura nga viti '93...

"Nuk ka gabim që mund të ndreqet, guximi duhet shpërblyer dhe pakujdesia duhet dënuar."

"Të bësh sikur nuk ke asgjë në çaste të vështira."

"Të njohësh është diçka, por të dish është më mirë."

"Të luftosh është më mirë se sa të fundosesh."

"Ka raste kur të ikësh do të thotë të shpëtosh."

"Nuk mund të jesh hero kundër Atdheut tënd."

"Të ngresh kurthe do të thotë të bësh luftë për shtatë pale qejfe."

"Vdekja le të bëjë të sajën; punë për të. Ai që hedh hapin i pari, ndoshta gris këpucën i fundit."

Vlerësimi: Mësuesi/ja bën një vlerësim diagnostikues me qëllim identifikimin e njohurive paraprake plus interesave apo aftësive që paraqesin nxënësit.

Detyrat dhe puna e pavarur: Të hulumtojnë dhe të sjellin pjesë filmike nga filmi "Katedralja e Parisit".

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</td><td>Lënda: Letërsi</td><td>Shkalla: V</td><td>Klasa:</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Analizë e veprës: Katedralja e Parisit.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Nxënësi kupton se si përvojat letrare ndikojnë duke ndërtuar përvoja personale, vlera dhe qëndrime që vlejnë më vonë në perceptimin e botës.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
Kompetenca e të menduarit</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
- përcakton sfondin historik në të cilin janë zhvilluar ngjarjet në këtë roman;
- rendit linjat kryesore të subjektit, ndërthurjet dhe ndodhitë që ndjekin njëra-tjetrën;
- identifikon rolin e personazheve në vepër.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:
Katedrale
Kuasimondo
Esmeralda
Klod Frolo
roman historik</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:
Libri digjital, teksti i nxënësit, materiale nga interneti, pamje filmike.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:
gjuha shqipe, arte, tik, histori.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve
Diskutim-Ndërtimi i njohurive të reja-punë në grupe-Skemë rreze</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizimi i orës së mësimit
Hapi 1. Diskutim. Në fillim diskutojmë për personazhet e veprës duke ilustruar mendimet me pamje filmike të shfaqura në video projektor.

Hapi 2. Ndërtim i njohurive të reja. Kllaster. Mësuesi/ja në video projektor shfaq disa foto nga opera Katedralja e Parisit dhe i fton nxënësit të bëjnë portretizimin e tyre. Më pas ajo bën lidhjen me temën e dhënë.</td></tr>
</table>



Hapi 3. **Punim në grupe**. Ndahet klasa në grupe dhe nxënësit punojnë me pyetjet.

Grupi i parë pyetjet:

1. Çfarë natyre ka romani "Katedralja e Parisit"? Si ndërthuren tek ai llojet e romanit?
2. Rrëfeni linjat kryesore të subjektit, ndërthurjet dhe ndodhitë që ndjekin njëra-tjetrën.

Grupi i dytë pyetjet:

1. Në cilin sfond historik zhvillohet ngjarja? Cilin detaj thekson Hygo?
2. Përshkruani dimensionet që merr subjekti sa më shumë që i afrohet fundit.

Grupi i tretë pyetjet:

1. Pse romani titullohet "Katedralja e Parisit"? Çfarë përfaqëson në të vërtetë Katedralja?
2. A konsiderohet Esmeralda një figurë fatale, si personazhet e antikitetit?

Hapi 4. Skema rreze. Vendosim në tabelë tri personazhet meshkuj në këtë roman: Kuazimodo, Klod Vrolo, Febys. Më pas nxënësit e plotësojnë atë në bazë të këndvështrimeve që kanë krijuar pas leximit të romanit.



Vlerësimi: Mësuesi/ja bën një vlerësim diagnostikues me qëllim identifikimin e njohurive para-prake plus interesave apo aftësive që paraqesin nxënësit.

Detyrat dhe puna e pavarur: Të japin dallimet dhe të përbashkëtat midis filmit dhe librit.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</td><td>Lënda: Letërsi</td><td>Shkalla: V</td><td>Klasa:</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Fragment:
“Esmeralda”</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Nxënësi zbulon kënaqësinë e të lexuarit dhe bëhet i vetëdijshëm për shumëllojshmërinë e perceptimit të botës, duke e vlerësuar letërsinë si mjet kyç për të pasuruar botën emocionale, për të zhvilluar imagjinatën dhe të menduarit kritik.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
Kompetenca e të menduarit</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
- lexon dhe komenton tekstin e dhënë;
- analizon faktet që e përcaktojnë poetin e pjesës teatrale me subjekt fetar si qesharak por praktik;
- diskuton rreth magjepsjes që ngjall Esmeralda.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:
Kuazimodo, Esmeralda, Jupiteri, Grenguari, efekti magjik, cigania bukuroshe, gungaç.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:
Libri digjital, teksti i nxënësit, materiale nga interneti, pamje filmike.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:
gjuha shqipe, arte, tik.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve
Lexim i drejtuar-Pyetje- përgjigje-Hapi i diskutimit-Praktikë e pavarur</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizimi i orës së mësimit
Hapi 1. Lexim i drejtuar. Mësuesi/ja vendos një nxënës që të lexojë fragmentin e marrë nga romani. Gjatë leximit bëjnë dhe komentet dhe shpjegimet e nevojshme. Në pesë kapitujt e parë Hygoi na njeh me personazhet e romanit, vendin dhe datën ku zënë fill ngjarjet (Sheshi i Katedrales së Parisit, 6 janar 1482). Hygoi përshkruan me vërtetësi një festë mesjetare, ku këndohet, vallëzohet, bëhen lodra të ndryshme, procesione, shfaqje teatrale të quajtura mistere (me subjekt fetar rreth asaj që ndodh me njerëzit pas vdekjes, në botën tjetër), moralitete (me karakter didaktik, që i mëson njerëzit të jenë të mirë e të nënshtruar), mrekulli (për mrekullitë e bëra nga shenjtorët para se të vdisnin) etj. Me nota humori përshkruhet zgjedhja e një pape dhe procesioni me në krye Kuazimodon. Në fragmentin e mëposhtëm, Esmeralda nuk paraqitet dhe as përshkruhet. Autori jep vetëm magjinë që ngjall ajo te spektatorët.</td></tr>
</table>

Hapi 2. **Pyetje-përgjigje**. Pas leximit mësuesi/ja i drejton pyetje nxënësve. ✓ Tregoni çfarë ndodh në kapitujt e parë të librit, para se të dalë në skenë Esmeralda. ✓ Çfarë tregon biseda e dëgjuar nga poeti në turmë? Ç'detaje për jetën e qytetit sjell ajo? ✓ Ç'detaje zbulon autori për Esmeraldën? ✓ Si duket misioni i poetit në këtë fragment? Ku qëndron pamundësia e tij? ✓ Si përcillet ndjenja e turmës te dëgjon poetët? ***Hapi 3.*** **Hapi i diskutimit**. Nxënësit diskutojnë mbi vlerat morale që shpallen në këtë fragment si dhe mbi evoluimin që pëson figura e Esmeraldës. ***Hapi 4.*** **Praktikë e pavarur**. Nxënësit punojnë në fletore në mënyrë individuale. ✓ Shpjegoni në kontekste të tjera shprehjen frazeologjike: Ky ishte grushti i fundit i fatit. ✓ Gjeni në paragrafin e parë fjalë a shprehje që dëshmojnë teatralitetin dhe ironinë e autorit.
Vlerësimi: Mësuesi/ja bën një vlerësim diagnostikues me qëllim identifikimin e njohurive paraprake plus interesave apo aftësive që paraqesin nxënësit.
Detyrat dhe puna e pavarur: Interpretoni me role fragmentin e mësipërm.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa:
Tema mësimore: Fragmenti XXVIII. "*Një lot për një pikë ujë*"		**Situata e të nxënit:** Nxënësi kupton se të lexuarit është jo vetëm kënaqësi estetike por edhe reflektim mbi veprën lidhur dhe me procesin e zhvillimit të tyre.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: - lexon dhe komenton tekstin e dhënë; - analizon faktet që e përcaktojnë poetin e pjesës teatrale me subjekt fetar si qesharak por praktik; - diskuton rreth magjepsjes që ngjall Esmeralda.		**Fjalët kyçe:** Kuazimodo Esmeralda Jupiteri Grenguari Efekti magjik	
Burimet: Libri digjital, teksti i nxënësit, materiale nga interneti, pamje filmike.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** gjuha shqipe, arte, tik.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Analizë-Koment-Diskutim-Punë në grupe			

Organizimi i orës së mësimit

Hapi 1. **Analizë**. Pas lojës me role që bënë nxënësit me fragmentin e dhënë kalojmë në analizën që i bëjmë kësaj pjese.

- ✓ ***Shoqëria mesjetare e paraqitur nga Hygoi në këtë roman zbavitet me torturën, të cilën e ka ngritur në kult. Kjo duket nga qëndrimi i turmës që kënaqet e lumturohet nga mundimet e Kuazimodos, i cili nga ana e tij nuk e kupton arsyen e lidhjes në shtyllën e turpit.***

Analizojmë pamjen e Kuazimodos si protagonist në këtë vepër, lidhjen që ka me objektin e Katedrales, si dhe lidhjen që ka me personazhet e tjerë në këtë fragment.

Hapi 2. **Koment**. Paragrafi i parë

Paragrafi i parë	Koment
Kuazimodo dukej (së paku në vështrim të parë) sikur qëndronte përsëri gjakftohtë. Në fillim ai ishte munduar t'i këputse prangat pa rënë në sy dhe pa bërë shumë lëvizje{...}Kjo qe një përpjekje e fuqishme, e lemerishme, e dëshpëruar, por prangat e regjura të prevostit të Parisit nuk u këputën {...} Rrahja me kamxhik kishte marrë fund{...} Po për Kuazimodon ende nuk kishte marrë fund gjithçka{...}dhe kjo për lavdinë më të madhe të aforizmit të vjetër të Jan Kumenit, që e lidhte fiziologjinë me psikologjinë: *Surdus absurdus.* E kthyen pra sahatin, nga ana tjetër dhe e lanë, gungaçin të mbërthyer te dhoga, me qëllim që të kënaqej drejtësia plotësisht.	

Hapi 3. **Diskutim.** Pas leximit diskutojmë se si e zbulon Hygoi turmën nëpërmjet vendosjes së Kuazimodos përballë saj.

Hapi 4. **Punë në grupe**. Mësuesi/ja e ndan klasën në grupe dhe përcakton detyrat.

Grupi 1. Të shpjegojë lidhjen e personazheve në këtë fragment.
Të shkruajë nga dy epitete për Esmeraldën dhe Kuazimodon.

Grupi 2. Të shpjegojë si gërshetohen te Kuazimodo i quajtur Gungaç, pamja fizike, emri dhe fati i tij.
Të shpjegojnë krahasimin e zgjatur në fund të paragrafit të dytë

Grupi 3. Të tregojnë se a mund të krahasojnë Kuazimodon në shtyllën e turpit, me Prometeun e Mbërthyer
Të tregojnë pse togfjalëshi fytyrë e urryer, në të vërtetë, nuk e bën Kuazimodon të urryer
Pasi kanë punuar me detyrat e ngarkuara fillojnë t'i bëjnë ato prezente përpara klasës dhe mësueses.

Vlerësimi: Mësuesi/ja bën një vlerësim diagnostikues me qëllim identifikimin e njohurive paraprake plus interesave apo aftësive që paraqesin nxënësit.

Detyrat dhe puna e pavarur: Të përshkruajnë zhvillimin e personazhit të Kuazimodos përgjatë fragmentit.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

<table>
<tr><th>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</th><th>Lënda: Letërsi</th><th>Shkalla: V</th><th>Klasa:</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Fragment XLIII. “Tri zemra burrash, të mbrujtura ndryshe”</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Të shohin pjesë nga filmi “Katedralja e Parisit” dhe të anaizojnë personazhet. https://youtube/E_kMF17bq3w</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
Kompetenca e të menduarit</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
- përshkruan ndjesitë e Esmeraldës;
- shpjegon mbështetjen e turmës ndaj Kuazimodos në këtë fragment;
- diskuton si ndjenjat e priftit ndaj Esmeraldës bien në kundërshtim me njëratjetrën;
- analizon shkrirjen e dy personazheve në një në këtë fragment.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:
Klod Frolo, djall, nënqeshje e lemerishme, ceremoni ogurzezë.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:
Libri digjital, teksti i nxënësit, materiale nga interneti, pamje filmike.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:
gjuha shqipe, arte, TIK.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve
Analizë-Lexim i drejtuar në grupe ekspertësh-Diagrami i Venit-Ditari dypjesësh</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizimi i orës së mësimit
Hapi 1. Analizë. Kontrollojmë detyrat e shtëpisë dhe një nxënës i lexon detyrën duke na përshkruar evoluimin që ka pësuar figura e Kuazimodos. Më pas e analizojmë atë duke iu referuar dhe fragmentit “Esmeralda”.

Hapi 2. Lexim i drejtuar në grupe ekspertësh. Mësuesi/ja vendos një nxënës që të lexojë fragmentin e dhënë duke punuar edhe me pyetje e studimit të tekstit. Mësuesi/ja i drejton pyetje klasës.
Esmeralda fajësohet për vrasjen e Febysit, ndërkohë që thikën atij ia ka ngulur Klod Frolo, i cili vazhdon ta akuzojë vajzën edhe në gjyq, derisa atë e dënojnë me vdekje. Arqidhjaku e akuzon, sepse është i zemëruar ngaqë vajza nuk pranon të bëhet e dashura e tij. Esmeralda mundohet të mbrohet në gjyq, mirëpo akuza rëndohet edhe më shumë kur atë e akuzojnë jo vetëm si vrasëse, por edhe si magjistare. Në fragmentin e mëposhtëm përshkruhet skena kur Esmeraldën e çojnë për ta ekzekutuar. Pranë saj ndodhet Kuazimodo.</td></tr>
</table>

1. Përshkruani ndjesitë e Esmeraldës. E mjera vajzë, e frikësuar, dukej, sikur e kishte hedhur vështrimin dhe mendjen në skutat e errëta të kishës. Buzët e saj të bardha lëvrinin sikur ajo po falej.
2. Ku e kërkon shpëtimin ajo? Te Zoti dhe te Febysi
3. Diskutoni si ndjenjat e priftit ndaj Esmeraldës bien në kundërshtim me njëra-tjetrën. – Që në fjalët që prifti thotë në fillim: ***Vajzë a iu lutët Zotit,t'jua falë gabimet dhe fajet tuaja?*** Dhe më pas kur i afrohet të veshi dhe i thotë: ***A më do? Unë dhe tani mund të të shpëtoj***.
4. Cilat detaje tregojnë që dënime të tilla ishin më se të zakonshme për kohën kur janë vendosur ngjarjet? - Kjo ishte formula e llahtarshme, me të cilën mbaronin zakonisht këto ceremoni ogurza.
5. Si e shpjegoni mbështetjen e turmës ndaj Kuazimodos në këtë fragment? - sepse dhe vetë Kuazimodo ishte pjesë e turmës.

Hapi 3. **Diagrami i Venit**. Nxënësit diskutojnë mbi shkrirjen e dy personazheve Kuazimodos dhe Esmeraldës.



Hapi 4. **Ditari dypjesësh**. Nxënësit punojnë me komente fragmentesh.

Fragment	**Koment**
Befas ai u duk te një cep i galerisë së mbretërve të Francës, të cilën e përshkoi duke vrendur si i marrë me prenë e vet në duar dhe duke thirrur: Strehim! Turma prapë shpërtheu në duartrokitje. - Rroftë!Rroftë! - thërriste populli dhe kjo britmë e fuqishme,që gjëmonte deri në bregun tjetër të lumit,e habiti turmën e mbledhur në sheshin Grev, si dhe të vetmuarën, që ia kishte qepur sytë trikëmbëshit!	

Vlerësimi: Mësuesi/ja bën një vlerësim diagnostikues me qëllim identifikimin e njohurive paraprake plus interesave apo aftësive që paraqitesin nxënësit.

Detyrat dhe puna e pavarur: Shkruani një prozë poetike me ndodhinë e kësaj pjese.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

<table>
<tr><th>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</th><th>Lënda: Letërsi</th><th>Shkalla: V</th><th>Klasa:</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Punë me shkrim: Eseja e analizës letrare</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Nxënësit dëgjojnë, lexojnë, shkruajnë ese të ndryshme duke analizuar gjuhën, figuracionin.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
Kompetenca e të menduarit
Kompetenca digjitale
Kompetenca qytetare</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
- dallon elementet e tekstit letrar, të cilat shqyrtohen në secilin shkrim;
- rendit etapat kryesore të shkrimit të esesë;
- përcakton strukturën e esesë;
- shkruan ese letrare me tema të ndryshme.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:
Ese
Shkrim me karakter kritik
Klasifikime tematike</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: Libri “Si të shkruajmë një ese” botim i qendrës për arsim demokratik, teksti i nxënësit etj.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: arte, histori, gjuhë shqipe.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve
Reflektim-Analizim-Shkrim i lirë</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizimi i orës së mësimit
Hapi 1. Reflektim. Në fillim të orës mësuesi/ja u kërkon nxënësve të flasin ato që dinë (që kanë bërë dhe vitin e kaluar) mbi esenë:
1. Ç’quajmë ese? Çfarë trajton ajo?
2. Si klasifikohen esetë?
3. Ç’quajmë ese letrare?
4. Çilat janë hapat për shkrimin e eseve?
Të gjitha përgjigjet e dhëna të nxënësve i përmbledhim në skemë rreze dhe më pas në një kllaster.</td></tr>
</table>



Hapi 2. **Analizime.** Pasi rikujtuam dhe reflektuam mbi ato që kemi mësuar për esenë, kalojmë në analizimin e tyre nëpërmjet shembujve të librit. Marrim dy esetë nga E. Koliqi dhe I. Kadare.

- Që të dyja janë ese letrare.
- I janë përmbajtur strukturës.
- Koliqi ka përdorur të folurën e Veriut të Shqipërisë, Kadare ka përdorur gjuhën letrare.

Hapi 3. **Shkrim i lirë.** Dukë u bazuar te dy esetë e librit, nxënësit punojnë në fletore në një shkrim të lirë, duke iu mbështetur një fragmenti letrar nga teksti, të krijojnë një ese letrare.

Vlerësimi: Në këtë orë nuk behët vlerësim.

Detyrat dhe puna e pavarur:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda: Letërsi**	**Shkalla: V**	**Klasa:**
Tema mësimore: Punë me shkrim: Ese: Shkruani një ese letrare për librin tuaj të preferuar ose për veprën e fundit që keni lexuar.		**Situata e të nxënit:** Nxënësit shkruajnë duke iu përmbajtur të gjithë elementeve të esesë letrare.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të nxënit Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: - shkruan një ese letrare; - respekton strukturën e eseve; - përdor gjuhë të figurshme dhe shkrim origjinal; - rishikon dhe kontrollon esenë.		**Fjalët kyçe:** Ese Shkrim me karakter kritik Klasifikime tematike	
Burimet: Teksti i nxënësit, libri që kanë përzgjedhur.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** arte, gjuhë shqipe.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Kontroll njohurish-Shkrim i lirë-Lexim dhe vlerësim			
Organizimi i orës së mësimit ***Hapi 1.*** **Kontroll njohurish.** Së bashku me nxënësit rikujtojmë ato që mësuam dhe trajtuam orën e kaluar mbi esenë, llojet e saj, hapat e shkrimit të esesë etj. ***Hapi 2.*** **Shkrim i lirë.** Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur me temën. Ato kujdesen që jo vetëm të hedhin mendimet e tyre në letër por edhe të tregojnë kujdes për strukturën, idenë origjinale, ndërtimin kuptimor të fjalive, shkruajnë pa gabime. ***Hapi 3.*** **Lexim dhe vlerësim**. Mësuesi/ja mbledh fletoret, i lexon, i korigjon dhe vendos nota sipas kësaj tabele vlerësimi.			
Vlerësimi: Nxënësi vlerësohet sipas kësaj tabele.			

Shtjellimi i idesë	Stili dhe origjinaliteti	Organizimi dhe struktura	Saktësia gjuhësore (sintaksa dhe drejtshkrimi)	Totali
2 pikë	2 pikë	2 pikë	2 pikë	8 pikë

Detyrat dhe puna e pavarur: Rishikim i punëve të tyre.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE **Dt.___/____/__**

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda: Letërsi**	**Shkalla: V**	**Klasa:**
Tema mësimore: Xhorxh Gordon Bajron. Jeta dhe vepra.		**Situata e të nxënit:** Duke iu referuar historisë kujtojmë ç'kemi mësuar apo lexuar për Ç. Harold, ardhja e tij në Shqipëri, vendet që vizitoi, përshtypjet e tij etj.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: - përcakton ndryshimin e Bajronit nga romantikët e tjerë; - analizon gërshetimin në vargje të poetit romantik me atë satirik; - renditin veprat e Bajronit.		**Fjalët kyçe:** Çajld Harold Bajron Ali Pashë Tepelena Lord anglez Bajronizëm	
Burimet: Teksti i nxënësit, veprat Çajld Harold, i burgosuri i Shilonit.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** histori, arte, gjuhë shqipe.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Rishikim nëpërmjet fjalëve kyçe-Skema rreze-Harta e shkrimtarit-Pyetje përgjigje			

Organizimi i orës së mësimit

Hapi 1. **Rishikim nëpërmjet fjalëve kyçe.** Mësuesi/ja shkruan në dërrasë disa fjalë (Çajld Harold, Bajron, Ali Pashë Tepelena, lord anglez, bajronizëm) e më pas i lë nxënësit të mendohen se çfarë u kujtojnë këto fjalë. Nxënësit japin mendimet e tyre mbi secilën fjalë kyçe. Pas disa minutash ku nxënësit japin mendimet e tyre, hedhin e presin fjalë-fjali me njëri-tjetrin, mësuesi/ja hedh një pyetje: A kanë lidhje këto fjalë me njëra-tjetrën?

Hapi 2. **Skema rreze.** Të gjitha mendimet e nxënësve mbi Bajronin i mbledhim në këtë skemë rreze.



Hapi 3. Harta e shkrimtarit.



Hapi 4. **Pyetje-përgjigje.** Pasi kemi përcjellë informacionin e ri i bëjmë pyetje klasës për të parë se sa është përthithur ky informacion nga nxënësit.

1. Nga cilat legjenda u frymëzua Bajroni në rininë e tij?
2. Ç›përmbajtje kishin vëllimet e tij të para me poezi?
3. Pse ishin të vlefshme për krijimtarinë e tij udhëtimet që bëri?
4. Pse ndodhi konflikti i Bajronit me aristokracinë e kohës?
5. Përse patën sukses të menjëhershëm dy këngët e para të poemës "Shtegtimet e Çajld Haroldit"?
6. Ç'vend zënë Gjeneva, Italia e Greqia në jetën dhe krijimtarinë e tij?
7. Si i vlerësoi kritika frymën dhe prirjet e veprave të Bajronit?
8. Pse ndryshon Bajroni nga romantikët e tjerë? Ç'karakteristika ka poezia e tij?
9. Si gërshetohen në vargje poeti romantik me atë satirik?
10. Pse shkrimtari dhe jeta e tij u kthyen në model për të rinjtë? Ç'përfaqëson në të vërtetë bajronizmi?
11. Çfarë veçorish kanë heronjtë e "Poemave orientale"?
12. Ç'rrëfen poema "Don Zhuan"? Si funksionon satira dhe loja në këtë vepër dhe çfarë mesazhi përcjell ajo?

Vlerësimi: Mësuesi/ja mund të bëjë një vlerësim të vazhdueshëm me gojë për përparimin e nxënësve, me qëllim identifikimin e njohurive, interesave, aftësive apo shkathtësive që kanë fituar nxënësit në lidhje me tematikën.

Detyrat dhe puna e pavarur: Të lexojmë vargje nga vepra "I burgosuri i Shilonit".

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

<table>
<tr><td>Fusha:Gjuha dhe komunikimi</td><td>Lënda: Letërsi</td><td>Shkalla:V</td><td>Klasa:</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Analizë e veprës: Shtegtimet e ÇajldHaroldit.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Nxënësi dëgjon, lexon dhe reflekton mbi karakteristikat e një vepre lirike-epike, gjuha, stili, origjinaliteti.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
Kompetenca e të menduarit.
Kompetenca digjitale</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
- përcakton natyrën e Shqipërisë dhe përshtypjet e udhëtimit të heroit në këngën e dytë;
- analizon prirjen iluminist të autorit në këngën e tretë;
- vlerëson notat e optimizmit në këngën e katërt;
- rendit karakteristikat e poemës liriko-epike.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:
Greqi
Shqipëri
Spanjë
Itali
Çlirim kombëtar
Vajza nga Saragoza</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: Vepra e Bajronit, libri i nxënësit, foto të Bajronit në udhëtime të ndryshme.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: histori, arte, gjuhë shqipe.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve
Kontroll njohurish-Analizë vepre kllaster-Punë në grupe-Reflektim kuptimor</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizimi i orës së mësimit
Hapi 1. Kontroll njohurish. Nëpërmjet leximit të pjesëve të ndryshme nga veprat e Bajronit: “I burgosuri i Shilonit”, “Çajd Harold” etj. Renditin tiparet e veprave të tij; disa nga momentet kryesore të krijimtarisë, rolin që luajtën udhëtimet etj.
Hapi 2. Analizë vepre. Kllaster</td></tr>
</table>



Hapi 3. **Punë në grupe.** Klasa ndahet në grupe dhe mësuesi/ja cakton detyra për secilin grup.

Grupi i parë: Ndërton strukturën e veprës.

Grupi i dytë: Përshkruan natyrën e Shqipërisë dhe përshtypjen e udhëtimit të heroit në këngën e dytë.

Grupi i tretë: Analizon prirjen iluministe të autorit në këngën e tretë.

Grupi i katërt: Dallon notat e optimizmit në këngën e katërt.

Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur në grup e më pas prezantojnë punën e tyre.

Hapi 4. Reflektim kuptimor. Duke lexuar e analizuar veprën e Bajronit si poemë liriko-epike vëmë re disa karakteristika që i pamë edhe në analizë.

Karakteristikat e poemës liriko-epike

- *Poeti identifikohet me personazhin për dy arsye:*
  a) Itinerari i njëjtë i udhëtimeve
  b) Karakteri i ngjashëm
- *Rrëfimi:*
  a) Në tri këngët e para përdoret veta e tretë
  b) Në këngën e katërt përdoret veta e parë
- Çajld *Haroldi është hero romantik:* melankolik, i pasionuar pas natyrës, së bukurës dhe kulturës, zëdhënës i idealeve, aspiratave të Bajronit.
- *Figuracioni i pasur* (epitete, metafora, apostrof, kontrast, hiperbol etj.)

Vlerësimi: Mësuesi/ja mund të bëjë një vlerësim të vazhdueshëm me gojë për përparimin e nxënësve, me qëllim identifikimin e njohurive, interesave, aftësive apo shkathtësive që kanë fituar nxënësit në lidhje me tematikën.

Detyrat dhe puna e pavarur: Të lexojnë këngën e parë dhe të tretë: "Rebelimi i Çajld Haroldit".

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

<table>
<tr><th>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</th><th>Lënda: Letërsi</th><th>Shkalla: V</th><th>Klasa:</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Koment: Fragmenti: Rebelimi i Çajld Haroldit I/2, 3, 4, 6 III/12, 13, 15, 16</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Nxënësi zbulon kënaqësinë e të lexuarit dhe bëhet i vetëdijshëm për shumëllojshmërinë e perceptimit të botës duke vlerësuar letërsinë si mjet kyç për të pasuruar botën emocionale, për të zhvilluar imagjinatën dhe për të nxitur mendimin kritik.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
Kompetenca e të menduarit</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
- lexon dhe komenton fragmentin;
- përshkruan karakterin e Haroldit në këtë këngë;
- gjen dhe analizon figurat letrare;
- diskuton mbi elementët autobiografik të fragmentit.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:
Rebelim
Albiona
Relike
Shtegtim
Arratisje
Hero fitimtar</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: materiale nga interneti, libri i nxënësit, fragmente.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: histori, arte, gjuhë shqipe.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve
Lexim i drejtuar-Punë në grupe-Punë e pavarur-Diskutim</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizimi i orës së mësimit
Hapi 1. Lexim i drejtuar. Një nxënës lexon fragmentin e dhënë e më pas punojmë me pyetjet të cilat na e pasqyrojnë më mirë atë.
Suksesi dhe ndikimi shumë i madh i Bajronit lidhen me mitin që rrethoi jetën e tij. Në figurën e protagonistit Harold (që mishëron heroin romantik), elementet autobiografike janë më se të dukshme. Meditimet dhe emocionet që përjetoi gjatë udhëtimeve, ai i pasqyroi në poemën “Shtegtimet e Çajld Haroldit”. Në strofat e Këngës së parë, Bajroni na njeh me protagonistin, të cilit, jeta me dëfrime por e zbrazët i ka sjellë zhgënjime, pakënaqësi e mërzitje. Atdheu i duket si një burg që i zë frymën, prandaj vendos të largohet dhe të ndërmarrë një udhëtim. Në strofat e Këngës së tretë shpaloset romantizmi aristokratik i Bajronit: tema e arratisjes, e heroit romantik që largohet nga grigja e njerëzve të thjeshtë; e natyrës mike, bashkëbisedueses së tij të vetme. Haroldi krenar jeton në gjendjen tipike të izolimit të individit romantik: i vetëm, larg botës së zakonshme të njerëzve, përçmimin për të cilët e shpreh nëpërmjet termit grigjë (në origjinal). Miqtë dhe bashkëbiseduesit e heroit romantik janë: natyra me peizazhet e saj më vetmitare dhe të skajshme (malet, oqeani, shkretëtira, pylli, shpella). Në këtë pjesë të poemës mbizotëron tema tipike romantike e vetmisë në natyrë, e cila pasqyron pasionet e njeriut. Po aq e dukshme është metafora e librit të natyrës, faqet e të cilit reflektohen në ujërat e liqenit.</td></tr>
</table>

1. Çfarë dëshmojnë tonet poetike të vargjeve të para?
   ➔ Tonet poetike dëshmojnë dëshpërimin, pakënaqësinë ndaj këtij realiteti.
2. Cila është përshtypja e parë që ju krijohet për heroin?
   ➔ Ishte një njeri i paturpshëm dhe pa karakter, ku shqetësimi i vetëm i tij ishte të argëtohej, të vishej, të hante, të pinte me këdo dhe kudo.
3. Në cilën strofë shprehet vlerësimi i Bajronit për traditat e mira?
   ➔ Shprehet në strofën I/3

   As prozë o vjershë e ëmbël-mjaltë që mburr
   O zbukuron dot turpe që s'i bën një burrë.

Hapi 2. **Punë në grupe.** Mësuesi/ja ndan klasën në grupe dhe përcakton detyrat.

Grupi i parë: Tregon hap pas hapi figurën e Haroldit. (si ndryshon ai)



Grupi i dytë: Përshkruajnë bukurinë e natyrës që shpalos autori në vargjet III/13, të dallojnë paralelizmin figurativ.

➔ Ku ngriheshin male, aty i kish miqt' e dashur;
Ku ushtonte oqeani, aty e kish shtëpinë;
Ku hapej qielli i kaltër e ajri i pastër,
Kish qef të brithte, aty e kish fuqinë;
Val't, shkumën, pyllin, shpellën, shkretëtinë,
I kishte shokë, e ata i flisnin qartë.

Në këtë strofë Bajroni përshkruan natyrën e cila vendoset përball gjendjes shpirtërore të vetë autorit.

Grupi i tretë: Protagonisti dhe autori kanë gjëra të përbashkëta. Përcaktoni elementet autobiografike.



Hapi 3. **Punë e pavarur.** Nxënësit punojnë në mënyrë individuale me gjuhën e tekstit dhe figuracionin e përdorur.

- Gjeni dhe analizoni figurat letrare në I/4.

Vargu	***Figura***
U thek në diellin e mesditës	Metaforë
Si miza	Krahasim
Prej bastrës mund t'i thahej gjithë pranvera/ por pa ju hapur mirë burimit dera	Metonimi
U kthyen lulet ferra	Antitezë

Veçoni fjalët: relik, hi, varr, poezi. A formojnë ato një enumeracion rritës? A kanë ngarkesën e duhur emocionale për të shfaqur idenë që autori ka për vlerat?

➔ Këto fjalë formojnë një enumeracion rritës. Autori shpreh idenë se kur dikush të ndyn emrin, sado të shkëlqyer ta kesh pasur ; as prejardhja dhe as krijime të ëmbla si mjalti nuk e zbukurojnë dhe as e shenjtërojnë krimin.

- Ç' ngarkesë emocionale dhe konotacion shprehin fjalët: shtegtim, arratisje dhe izolim?

➔ Këto fjalë përcjellin ndjenjën e vetmisë, largimit, ikjes drejt vendeve ku njeriu ndjehet ndryshe.

Hapi 4. **Diskutim.** Ftohen nxënësi të diskutojnë rreth kësaj teme: Revolta dhe arratisja nga realiteti, karakteristikë e heroit romantik. Nxënësit japin mendimet e tyre duke ilustruar me shembuj nga teksti si dhe duke marrë heronj si Çajld Harold, Milosau, Esmeralda.

Vlerësimi: Mësuesi/ja mund të bëjë një vlerësim të vazhdueshëm me gojë për përparimin e nxënësve, me qëllim identifikimin e njohurive, interesave, aftësive apo shkathtësive që kanë fituar nxënësit në lidhje me tematikën.

Detyrat dhe puna e pavarur: Shkruani një ese të shkurtër me temë "Çajld Haroldi në ditët e sotme".

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE **Dt.___/____/__**

<table>
<tr><th>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</th><th>Lënda: Letërsi</th><th>Shkalla: V</th><th>Klasa:</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Koment: Fragmenti: Çajld Haroldi në Shqipëri</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Lexojmë materialin për udhëtimin e Çajld Haroldit në Shqipëri të shkruar nga Faik Konica (materiali është vendosur në fund të fletës së ditarit). Ky material mund të lexohet nga mësuesja ose nga një nxënës.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
Kompetenca e të menduarit</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
- rendit disa nga vetitë e Shqiptarëve që dalin në fragmentin e dhënë;
- shpjegon vlerat e dashurisë dhe të humanizmit shqiptar;
- analizon muzikalitetin e marshit ushtarak në katër vargjet e fundit;
- portretizon figurën e gruas shqiptare sipas Bajronit;
- ilustron me shembuj admirimin dhe vlerësimin që tregon Haroldi për mikpritjen e shqiptarëve.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:
Skënderi
Nënë e ashpër
Burrash të rreptë
Shkëmbinjtë e Sulit
Bijtë e Shqipërisë
Tamburxhi</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: Vepra e Bajronit, libri i nxënësit, foto të Bajronit në udhëtime të ndryshme.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: histori, arte, gjuhë shqipe.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve
Diskutim-Lexim dhe interpretim-Punë në grupe-Pyetje, përgjigje-Punë e pavarur-Analizë figurash</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizimi i orës së mësimit
Hapi 1. Diskutim. Kontrollojmë detyrat e shtëpisë e më pas lexojmë disa prej tyre. Pas leximit diskutojmë me nxënësit se si do të ishte Çajld Haroldi në ditët e sotme dhe ku do të ndryshonte me Haroldin e hershëm.
Hapi 2. Lexim dhe interpretim. Nxënësit lexojnë njëri pas tjetrit fragmentin e dhënë. Çajld Haroldi, admirues i popujve liridashës dhe luftëtarë, e çmon Shqipërinë si një nënë të ashpër burrash të rreptë, trima dhe besnikë. Shpirtit të saj rebel i përgjigjet natyra sa e bukur, aq edhe e ashpër. Në mikpritjen dhe bujarinë shqiptare, ai gjen një model të pastër të dashurisë dhe të vlerave të larta humane. Përshkrimi i Shqipërisë dhe i popullit të saj bëhet në strofat 38-73. Vargjet për Shqipërinë vijojnë edhe në marshin luftarak të ushtarëve të Ali Pashës “Tamburxhi! Tamburxhi!”, të cilin Bajroni e harton mbi bazën e këngëve luftarake shqiptare.</td></tr>
</table>

Hapi 3. **Punë në grupe.** Mësuesi/ja ndan klasën në grupe dhe përcakton detyrat për secilin grup.

Grupi i parë: Gjeni figurat që përdoren për të përshkruar një lumë ndjenjash. Identifikojini dhe shpjegojini ato.

Vargu	***Figura***	***Shpjegimi***
O tok e Shqipëris, ku leu Skënderi	Apostrof	Thërret për ta sjellë më afër tokën e shqiptarëve.
Nënë ***e ashpër*** *burrash* ***të rreptë***	Epitet	Tregon cilësinë e nënës shqiptare dhe rreptësinë e burrave shqiptar.
Kryqi po zbret, minarja ngrihet përbri	Metaforë	Tregon ikjen nga bota e krishterë evropiane dhe hyn në botën islamike.

Grupi i dytë: Renditni disa nga vetitë e shqiptarëve që dalin në këtë fragment.

➔ Vetitë e shqiptarëve:
- Të rreptë
- Trima
- Besnikë
- Mikpritës
- Të ashpër
- Të egër

Grupi i tretë: Portretizoni gruan shqiptare duke u nisur nga vargjet që i kushtohen asaj.

➔ Gruaja shqiptare këtu na del:
- E nënshtruar
- Besnike
- Bashkëshorte e devotshme
- Nënë shumë e mirë

(kënga II/61)

Grupi i katërt: Përshkruani vallen e famshme shqiptare duke e krahasuar me poezinë "Vallja Shqiptare" e Ismail Kadaresë.

➔ Vallja Shqiptare e Ismail Kadaresë

Tri herë opinga rrahu dheun
Sikur kërkoi leje prej tij
Pastaj shamia palët ndehu
Me qetësi dhe madhështi.

Kështu midis qiellit edhe botës
Vallja u lind, vallja u shpall
Këmba sinjale i çon tokës
Dhe dora qiellit i jep lajm.

Në këtë poezi Kadareja kërkon tëna trasmetoi mesazhe edhe nëpërmjet valles shqipëtare. Duke na e bërë atë jo vetëm argëtim por edhe histori më vete.

.....

➔ *Se aty nga mezi i natës tër'saqen'*
Ja nisën qejfit vendçe me të madhë;
Çdo Palikar heth shpatën tej e k'cen;
Zën'dor'përdor'këndojnë për gaze e halle,
Dhe hidhen me ato fustanella të bardha n'valle

Afër mesnatës shoqëruesit e Bajronit ia nisin këngës së tyre; luftëtarët Suliotë flakin tej shpatën dhe kërcejnë dorë për dore pas njëri tjetrit me fustanet që u dridhen; këndojnë këngë të gëzuara dhe të trishtuara

Hapi 4. **Pyetje-përgjigje.** Mësuesi/ja i drejton pyetje klasës:

- Si shfaqet Shqipëria përmes apostrofës: O tokë, O Shqipëri, o nënë?
  - ➔ Nëpërmjet apostrofës ajo na shfaqet:
    - o E fortë
    - o E ashpër
    - o E ndjeshme
- Çfarë vëren së pari syri dhe shpirti i poetit sapo ndeshet me tokën dhe natyrën tonë? A hiperbolizon ai?
  - ➔ Sapo ndeshet me tokën dhe me natyrën tonë shpirti i poetit vëren bukurinë e natyrës; shkëmbin e errët të Sulit, çukat e larta të Pindit si dhe njerëz të mençur, burra të ashpër dhe të egër përpara armikut, të cilat jepen të hiperbolizuara.
- Ç'lloj strofe përdor Bajroni? A ndikon ajo në patosin e përgjithshëm dhe mënyrën e interpretimit të vargjeve?
  - ➔ Përdor strofa 9-vargëshe spenseriane të cilat ndikojnë në patosin e përgjithshëm dhe mënyrën e interpretimit të vargjeve.
- Cilat kontraste zbulojnë figurën e Aliut?
  - ➔ Rri pshetur mbi divan të butë epshtor
    Aliu, burr'luftrash dhe njeri mizor;
    Por tash po i bie një ëmbëlsi n'fytyrë
    Dhe djell nderim për këtë plak madhor,
    E ke si zor në shpirt të tij për të hyrë,
    Ku fshihen krimet që u vë njollën turpi i ndyrë

Ali Pashë Tepelena na shfaqet një burrë i fortë por edhe mizor.

- Pse heroit i është neveritur jeta në luks dhe në pasuri?
- Si argëtoheshin luftëtarët shqiptar?

Hapi 5. **Punë e pavarur.** Nxënësit punojnë në mënyrë praktike me vargun, strofën dhe figuracionin e përdorur.

- Gjeni llojin e këtyre fjalëve nga pikëpamja e formimit dhe shpjegoni rolin e tyre në përshkrimet e kësaj kënge: kryetrimi, fatbardhëve, shpirtzinë, gjysmëhëna.
  - ➔ Këto janë fjalë të përbëra (kompozita) të formuara emër + mbiemër/ndajfolje + emër. Përdorimi i këtyre fjalëve na shpreh botën e brendshme të heroit dhe mjedisin ku jeton.

Hapi 6. **Analizë figurash.**

- Pse strofën ku flitet për trimat shqiptarë, autori e nis me një inversion të dukshëm?
  - ➔ Të rreptë' janë bijt e Shqipëris, po i kan' – inversion për të theksuar rreptësinë e shqiptarëve.
- Shpjegoni antitezën e ndërtuar mbi fjalët mik dhe armik në vargun: Ç'armik për vdekje, por sa miq besnik!
  - ➔ Nëpër kësaj antiteze Haroldi kërkon të na tregojë se shqiptarët janë besnikë, mikpritës por njëkohësisht dhe armiq për ata që duan t'i pushtojnë dhe t'i skllavërojnë.

Vlerësimi: Mësuesi/ja mund të bëjë një vlerësim të vazhdueshëm me gojë për përparimin e nxënësve, me qëllim identifikimin e njohurive, interesave, aftësive apo shkathtësive që kanë fituar nxënësit në lidhje me tematikën

Detyrat dhe puna e pavarur: Ktheni këngën në prozë poetike.

Material plotësues në ndihmë të mësuesit për rubrikën situata e të nxënit.

Udhëtimi i Lord Bajronit në Shqipëri

Nga Faik Konica

"Ja tek e pa veten në breg të panjohur, nga të gjithë admiruar, kur shumëkush tutet duke e vështruar"… Me këto vargje nis Kënga e dytë e *Çajld Haroldit* dhe tërë ajo vazhdimësi strofash magjepse që do pavdekësonin shqiptarët, tek kishin nevojë për pavdekësi. Duhen lëçitur e rilëçitur ato faqe për të ndjerë thellë entuziazmin që i ngjallte Bajronit Shqipëria dhe shqiptarët; por, para atyre këngëve me burim hyjnor, ne vazhdojmë të parapëlqejmë letrat, shënimet, kujtimet, gjithçka që, e shkruar nga penë më familjare dhe më pak e përpunuar, shfaq më shumë gjendjen shpirtërore të Lord Bajronit.

Ballkani gjëmonte në atë kohë nga emri i një shqiptari i cili, bujar i thjeshtë, kishte arritur aq fuqi sa të kërcënonte seriozisht praninë e turqve në Evropë. Lavdia e Ali Tepelenit ishte shtrirë madje gjer në Perëndim; kështu mbreti Gustave-Adolphe, duke shkuar për në Jeruzalem, ktheu rrugë enkas për t'u pjekur me të. Lord Bajroni, në një letër drejtuar së ëmës (*Letra nga Preveza,* 13 tetor 1809), flet për udhëtimin e tij nëpër Shqipëri dhe pritjen që i bëri atij Aliu i Tepelenës: "Përshkova brendësinë e viseve të Shqipërisë për të vajtur e për t'i bërë vizitë pashait. Shkova në Tepelenë, vendlindja e Lartësisë së tij (his Highness's birth-place) rreth njëqind e pesëdhjetë milje larg që këtej, ku ndenja tri ditë. Pashai quhet Ali dhe është njeri me shumë zotësi; qeveris krejt Shqipërinë, domethënë: Ilirinë e lashtë, Epirin dhe një pjesë të Maqedonisë".

Kalama Albania, 1851, nga Edëard Lear

Përshtypja e atij udhëtimi gjithë magjepsje, përmes maleve të Shqipërisë, me bukuri të zymtë dhe madhështore shfaqet kryesisht tek poema e Çajld Haroldit. Ai i tregon së ëmës vajtjen e tij në Janinë: "Kur mbërrita në Janinë, kryeqyteti i tij, pas një udhëtimi prej tri ditësh, mësova se Veziri ishte në Iliri, me ushtrinë e tij, për të rrethuar Ibrahim pashën në kështjellën e Beratit. Kishte marrë vesh se një anglez i shquar kishte ardhur për të vizituar shtetet e tij dhe kishte dhënë urdhra që, me të mbërritur unë, të më gatitnin një shtëpi dhe të më jepnin falas gjithçka që do të ishte e nevojshme. U bëra disa dhurata shërbenjësve, por as që bëhej fjalë që unë

të paguaja gjithë sa konsumoja për vete". Dhe më tej: "U hipa kuajve të Vezirit dhe vajta të shoh sarajet e tij dhe ato të nipërve; janë gjithë shkëlqim, por si shumë zbukuruar me ar e mëndafshe." Nuk do vonojë dhe ai do rifillojë udhëtimin me kalë përmes udhëve të gjata, monotonia e të cilave i shpërblehet me hijeshinë e trevave që përshkon, "me bukurinë më fshatarake" që ka parë mëndonjëherë. Pas nëntë ditësh, sos në Tepelenë. Ja se si e tregon pritjen që iu bë: "Më shpunë te një sallon i shkëlqyer dhe vjen sekretari i pashait që më pyeti për shëndetin. Aliu më priti të nesërmen. Kisha veshur një uniformë të plotë oficeri të shtatmadhorisë dhe mbaja një kordhë të hijshme. Salla ishte e shtruar me mermer: një shatërvan mes saj lëshonte ujët, ndërsa muret ishin veshur me qilima të kuq otomanë. Veziri më priti në këmbë, veçori e madhe nga ana e një myslimani, dhe më uli në krahun e tij të djathtë. Kisha marrë me vete një terxhuman për raste të veçanta, por këtë herë, një mjek i Aliut, i quajtur Femlario, dhe që e kuptonte latinishten, përmbushi funksionin e duhur. Kërkesa e parë e pashait ishte se përse unë kaq i ri, isha larguar nga vendi im. Shtoi pasandaj se ministri anglez, kapiteni Leake, i kishte thënë se unë vija nga një familje e madhe; dhe m'u lut të përcillja nderimet e tij për time më, dhe unë po ua paraqes ato në emër të Ali Pashait. Më tha se ishte i bindur që unë isha njeri nga sërë e lartë, ngaqë i kisha veshët e vegjël, leshrat me bukle dhe duart të holla e të bardha; nuk e fshehu që sjellja dhe kostumi im i kishin pëlqyer. M'u lut ta konsideroja si një baba, për aq kohë sa do të isha në Shqipëri, duke më siguruar se më shihte si birin e tij; në fakt, më trajtoi si një fëmijë, duke më dërguar njëzet herë në ditë bajame, sherbete, fruta dhe gliko".

Bajroni me kostumin shqiptar

Shfaqja e maleve të Shqipërisë, "me epërsi të dukshme në bukuri, krahasuar me peizazhet më tërheqëse të Greqisë", veçoria e zakoneve, karakteri kalorësiak i shqiptarëve, kostumi i tyre "më i shkëlqyeri në botë", gjithçka do t'i bëjë Bajronit përshtypje të tillë që do t'i mbetet në mendje përgjithnjë. Admirimi dhe simpatia që ushqen për "bijtë krenarë të Shqipërisë" shfaqen në fjalën më të vogël që thotë. Dhe domosdo, nuk do të ishte me interes të paktë po të tregohej – përkrah kësaj simpatie dhe këtij admirimi për shqiptarët -, përbuzja e fshehur keq që i ngjallte "greku gënjeshtar e hileqar" (*Child Harlod's piligrimage*, II, pasim – dhe gjetkë.) Në thellësi të zemrës së tij, lord Bajroni nuk mund t'ua falte grekëve zhgënjimin që pësoi; i mbushur tejet me kujtime nga lashtësia klasike, kishte fluturuar ai vetë në ndihmë të Greqisë gjithë entuziazëm; por kushedi sa iu desh të vuante me idealin e plagosur, kur gjeti, në vend të Akilejëve e Tezejëve siç pandehte, Tartaninë, madje pa mendjen e Tartarinit; kur gjeti, në vend të perëndive, bij të Fidias, majmunë dhe marioneta (kukulla teatri); në vend të njerëzve, papagaj; në vend të gojartëve të një gjuhe që do duhej të kishte brishtësinë e lirave dhe shkëlqimin e cimbaleve, skatostomë që venë e flasin shatra-patra një nga zhargonet më të llahtarshme, tek e quajnë edhe atë vetë lordhosss Viroonnn (Lord Bajron) – gjë që me siguri duhet ta ketë nervozuar e ta ketë bërë njëkohësisht për të qeshur;

kur gjeti, në vend të athinasve të dikurshëm, banorë të rëndomtë të Athinës. Ky zhgënjim, që gati nuk bie në sy në poemat e tij, shfaqet më ndonjë rast në letërkëmbimin e tij në mënyrë krejt të hapur. Kështu, duke bërë të vetën një distikë greke kundër grekëve: *Ώ Αθηα πρωτη χωρα / Τι γαϊδαρους τρεφεις τωρα – O Athinë, truall i parë në botë,*/ Ç'gomerë vete e ushqen ti sot!*" (**Po e jap të traskriptuar ashtu siç e lexoj tek lord Bajroni, pa theks, pa shpirt. Letër nga Athina, nga kuvendi franciskan, 7 mars 1811, në përmbledhjen e përmendur. Shënim i autorit Faik Konica*), ai e shoqëron gjithë këtë me komente aspak mikluese për grekët. Nga ana tjetër, duke i goditur paraprakisht në pretendimet e tyre zonjat greke që kërkonin të rifitonin famën e modeleve të Fidiasit dhe të Praksitelit, ai thotë: "Gratë shqiptare janë shumë më të bukura nga gratë greke, dhe kostumi i tyre është shumë më piktoresk".

Bajroni dhe Hajdeja, vajza e hamendesuar e Ali Pashes

Lord Bajroni shpreh edhe më qartë përshtypjet e veta në letrën e gjatë që ai i shkruante së ëmës nga Preveza, paragrafë të së cilës po i përmendim: "I dua shumë shqiptarët; nuk janë të gjithë muhamedanë, ka mes tyre edhe fise të krishtera; por feja që kanë, nuk bën dallim të madh nga zakonet dhe mënyra e tyre e të jetuarit. Janë trupat më të mira të ushtrisë turke. Në udhëtim e sipër, kalova një herë dy ditë dhe më pas tri ditë, në një kazermë në Salonë, dhe asnjëherë nuk më kanë zënë sytë ushtarë aq të durueshëm e bindur sa ata, edhe pse kam qenë në garnizonet e Maltës e të Gjibraltarit, ku kam parë mjaft trupa spanjolle, franceze, siciliane e angleze. Asgjë nuk më vodhën dhe gjithnjë kam qenë i mirëprituri i tyre, duke ndarë me mua ushqimet dhe qumështin që kishin". Më pas, Bajroni flet për një shqiptar i cili, pasi e bujti dhe e mikëpriti në vatrën e vet, atë dhe bashkudhëtarët e tij, nuk pranoi të shpërblehej me para; dhe kur Bajroni këmbënguli që të pranonte të paktën disa sekenë ari, shqiptari i dha një përgjigje të tillë, bukuria e së cilës do shpërfillej veç prej shpirtrash gatuar me tregti: "Dua që të më doni, e jo të më paguani".

"I dua shumë shqiptarët", i shkruante Bajroni së ëmës, duke shprehur njëkohësisht shkakun e një simpatie të tillë, me qëllim që edhe e ëma të ushqente dashuri për ta. Dhe ndjeni tani ironinë dhe urrejtjen e këtyre fjalëve që ai i shkruante mikut të vet Drury: "I dua grekët; janë kopukë qerratenj, me tërë veset e turqve, por pa guximin e tyre" (Letër drejtuar Drury, 3 maj 1810). Të interesuarit janë të lutur të kontrollojnë këtë thënie, ashtu sikurse edhe ato të mëparshmet.

Ja pra, si shprehej lordhos Vrion duke folur për grekët; dhe këto fjalë mund të shërbenin si pikënisje për një studim interesant e të thellë që ndoshta do nxirrte si konkluzion se, duke luftuar për një popull të përbuzshëm e të përbuzur, lord Bajroni nuk kishte në mendje veçse ata helenë të dikurshëm, krijues të Bukurisë, raca hyjnore e të cilëve prehej, e bërë hi, mbi dheun e Helladës së ripopulluar, dhe ata malësorë të Shqipërisë të cilët, të padjallëzuar në heroizmin që i karakterizonte, kishin pleksur kauzën e tyre me atë të grekëve të rremë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</td><td>Lënda: Letërsi</td><td>Shkalla: V</td><td>Klasa:</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Koment: Fragmenti: Çajld Haroldi në Itali kënga IV/42, 43, 54, 55, 56, 57</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Lexojmë, dëgjojmë dhe diskutojmë mbi materiale të ndryshme historike që flasin për Italinë e atyre viteve.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
Kompetenca e të menduarit</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
- rendit problematikat që ka Italia dhe që i pasqyron Haroldi;
- dallon emrat e njerëzve të rëndësishëm në vende reale dhe shpjegon raportin e tyre me realitetin politik;
- analizon përdorimin e figurave letrare.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:
Itali
Stoli varri
Galileon e ndritur
Tempull i shenjtë
Poet i prozës
Ballin e Petrarkës</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: Vepra e Bajronit, libri i nxënësit, materiale nga interneti.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: histori, arte, gjuhë shqipe.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve
Diskutim-Lexim i drejtuar-Ditar dypjesësh-Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizimi i orës së mësimit
Hapi 1. Diskutim. Kontrollojmë detyrat dhe lexojmë disa prej tyre. Ndalemi sidomos në mënyrën se si është ndërtuar proza poetike, sa është ruajtur konteksti, si është përdorur gjuha.

Hapi 2. Lexim i drejtuar. Një nxënës lexon tekstin e dhënë duke e shpjeguar atë. Autori ndodhet në Itali që nga viti 1816. Në këtë këngë, autori jo vetëm që kujton njerëz të mëdhenj, ngjarje nga e kaluara e lavdishme, por njëkohësisht paraqet gjendjen e mjeruar të Italisë së pushtuar dhe të copëzuar. Ai evokon figura të rëndësishme të jetës kulturore, artistike, politike të vendit dhe u bën thirrje italianëve të jenë më të fortë e të vendosur për të shporrur pushtuesin. Italia, me të shkuarën dhe me artin e saj ka tërhequr edhe poetë të tjerë anglezë, si Shelli, Kits etj.

Analizojmë disa nga pyetjet:
- Si e shpreh Haroldi kontaktin me Italinë?
➔ Kontaktin me Italinë Haroldi e jep nëpërmjet apostrofit Ah, Itali, Itali! Duke e bërë shkaktare të dhimbjeve të përhrshme ku në ballin e saj është skalitur turpi nga pushtimi dhe sundimi i huaj.
- Cilat janë problematikat e këtij vendi?
➔ Gjendja e mjeruar e Italisë së pushtuar dhe të copëzuar në vitin 1816.</td></tr>
</table>

Hapi 3. **Ditar dypjesësh.** Lexojmë fragmentet dhe i komentojmë ato.

Vargu	***Komenti***
Si elementet, këta katër shpirtra Mund të krijonin botën...?	Këto katër mendje mund të krijonin gjithësinë, mund të ndërtonin copat e mantelit perandorak për ta ringjallur nga rrënojat.

Vargu	***Komenti***
Dhe asgjë mermeri i vendit tyre s'tha? S'e nxori dot një bust gurorja e tij?	Në këto vargje bëhet fjalë për vdekjen e Dantes dhe Petrarkës ku nëpërmjet mermerit ai mundohet të na lartësojë figurën e tyre por njëkohësisht i bën thirrje botës për tu ndërtuar atyre të paktën një bust.

Hapi 4. **Punë individuale.** Nxënësit punojnë në klasë disa nga pyetjet.

- Dalloni emrat e njerëzve e vendet reale. Shpjegoni raportin e tyre me realitetin poetik.
  - ➔ Emrat realë: Dante, Mikelanxhelo, Galileo, Petrarka, Skipjo, Makiaveli, Kanova. Vendet reale: Itali, Alpe, Lumi Po, Kisha Santa Kroçe në Firence. Ka një raport të ndërsjellët midis tyre, janë vende ku ata punuan, jetuan dhe zhvilluan krijimtarinë e tyre.
- Shpjegoni pyetjet retorike dhe thoni pse i përdor autori ato.
  - ➔ 100 Tregime dashurie na dha – krijuesi i novelave të dashurisë, poet i prozës dhe i shpirtit krijues Petrarka.
  - ➔ Mos Atdheu i la larg tij si gjall' dhe vdekur? – kërkon të tregojë që atdheu, Italia e tyre e dashur, sa qenë gjallë por edhe disa vite pas vdekjes nuk arriti ti vlerësonte kurrë.
- Shpjegoni lidhjen midis dy fjalëve me fuqi emocionale të ndryshme: bukuri dhe stoli varrimi.
  - ➔ Nëpërmjet këtyre fjalëve paradoksale heroi kërkon të na japë nga njëra anë lartësimin e figurave dhe veprave të tyre kurse nga ana tjetër indiferencën e shtetit ndaj tyre.
- Shpjegoni efektin e fjalëve: plaçkatarë dhe dalzotës
  - ➔ Që të dyja janë antiteza dhe kërkon të tregojë efektin e dy të kundërtave ku nga njëra anë janë pushtuesit dhe nga ana tjetër janë luftëtarët e vërtetë të popullit.

Vlerësimi: Mësuesi/ja mund të bëjë një vlerësim të vazhdueshëm me gojë për përparimin e nxënësve, me qëllim identifikimin e njohurive, interesave, aftësive apo shkathtësive që kanë fituar nxënësit në lidhje me tematikën.

Detyrat dhe puna e pavarur: Gjeni në internet materiale mbi figurat e njohura që përmend autori në fragment.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

<table>
<tr><th>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</th><th>Lënda: Letërsi</th><th>Shkalla: V</th><th>Klasa:</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Përsëritje</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Nxënësit dëgjojnë, lexojnë, reflektojnë mbi zhvillimet që pësoi letërsia në periudhën e romantizmit, përfaqësuesit kryesor të saj dhe veprat e tyre.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
Kompetenca e të menduarit
Kompetenca digjitale</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
- përcakton kushtet historike-shoqërore që ndikuan në zhvillimin e rrymës romantike;
- identifikon gjinitë letrare që u lëvruan gjatë romantizmit;
- analizon tiparet kryesore të shkrimtarëve romantikë;
- analizon elementet e metrikës te Gëte dhe Bajroni: rima, ritmi, muzikaliteti, lloji i vargut etj.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:
• Rrymë romantike
• Gjini letrare
• Romantizëm i përjetshëm
• Motive
• Optimizëm
• Kompozicion i veprës</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: libri i nxënësit, materiale nga interneti.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: histori, arte, gjuhë shqipe.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve
Diskutim-Pyetje-përgjigje-Punë në grupe</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizimi i orës së mësimit
Klasa vendoset në formë ovale për të zhvilluar një bashkëbisedim të hapur midis nxënësve dhe mësuesit/es.

Hapi 1. Diskutim. Mësuesi/ja shtron për diskutim këto çështje:
- Ndikimi i romantizmit në ditët tona.
- Mesazhet që përcjellin për njeriun personazhet si Kuazimodo dhe Esmeralda.
- Filmat që i kanë marrë subjektet nga veprat e kësaj periudhe.
Nxënësit japin mendimet e tyre duke ilustruar me materiale nga interneti, video, foto ose informacione të shkruara.</td></tr>
</table>

Hapi 2. **Pyetje-përgjigje.** Për të përmbledhur më mirë gjithë njohurit që kemi marrë këtë tremujor mësuesi/ja i drejton pyetje klasës.

1. Cilat ishin kushtet historike-shoqërore që ndikuan në zhvillimin e rrymës romantike?
2. Cilat gjini letrare u lëvruan gjatë romantizmit?
3. Si shkrihen heroi dhe poeti te Bajroni?
4. Si e paraqet Shqipërinë rrëfimi i Haroldit?
5. Si e propagandojnë moralin e pastër heronjtë romantikë në veprën e Hygoit?
6. Ç'teknika të rrëfimit kemi në veprën Katedralja e Parisit?
7. Ç'përfaqëson termi Bajronizëm?

Hapi 3. **Punë në grupe.** Mësuesi/ja ndan klasën në grupe dhe përcakton detyrat.

Grupi i parë: Dalloni burimin e frymëzimit, motivet dhe optimizmin që buron prej kryeveprave lirike të Gëtes.

Grupi i dytë: Analizoni kompozicionin e veprës "Fausti".

Grupi i tretë: Analizoni elemente të metrikës te Gëte dhe Bajroni: rima, ritmi, muzikaliteti, lloji i vargut etj.

Grupi i katërt: Analizoni tiparet kryesore të shkrimtarëve romantik.

Pas përgatitjes nxënësit japin përgjigjet e tyre.

Vlerësimi: Mësuesi/ja mund të bëjë një vlerësim të vazhdueshëm me gojë për përparimin e nxënësve, me qëllim identifikimin e njohurive, interesave, aftësive apo shkathtësive që kanë fituar nxënësit në lidhje me tematikën.

Detyrat dhe puna e pavarur: Shkruani një ese me temë "Heroi jam unë".

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa:
Tema mësimore: Bisedë letrare "Eugjen Onjegin" Pushkin. Kjo orë do të zhvillohet e ndarë në dy pjesë.		**Situata e të nxënit:** Nxënësit dëgjojnë, lexojnë, reflektojnë mbi veprën të cilën do ta analizojmë nëpërmjet metodologjisë së mësimdhënies në favor të nxënësve.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: - përcakton momentet kryesore të jetës së Pushkinit; - tregon subjektin e veprës "Eugjen Onjegin"; - analizon gjuhën e përdorur nga autori; - portretizon personazhet që ndërtojnë subjektin në këtë vepër.		**Fjalët kyçe:** • Tatjana • Onjegin • Shoqëri aristokrate • Mendim kritik • Figuracion i pasur • Jet mondane • Lenski	
Burimet: libri i letërsisë, gjuha shqipe, materiale nga interneti, romani "Eugjen Onjegin".		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** histori, arte, gjuhë shqipe, letërsi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Diskutim-Analizë vepre-Lexim dhe interpretim			

Organizimi i orës së mësimit

Hapi 1. **Diskutim.** Në fillim diskutojmë me nxënësit mbi figurën e Aleksandër Pushkinit, të njërit prej emrave më të rëndësishëm të letërsisë romantike ruse. Nxënësit japin mendimet e tyre për atë informacion që kanë si dhe lexojnë materialet që kanë sjellë. Më pas mësuesi/ja shkruan në dërrasë emrin e Pushkin dhe nxënësit e plotësojnë ato.



Hapi 2. **Analizë vepre.** Mësuesi/ja bën një rezyme të përgjithshme rreth romanit që do të trajtojmë në këto dy orë mësimi.

Romani "Eugjen Onjegin" është romani i parë realist në letërsinë ruse. Heroi është një personazh Eugjen Onjegin, një aristokrat petërburgas, i velur dhe i mërzitur nga jeta mondane e kryeqytetit i cili shkon në fshat për t'i qëndruar pranë xhaxhait që po jepte shpirt, për t'u bërë trashëgimtar i pasurisë së tij jo të vogël. Në fshat ai njihet me Tatjana Llarinën një vajzë e thjeshtë, me botë të pasur poetike, me shpirt të madh, që e dashuron Onjeginin me tërë çiltërsinë e shpirtit të saj. Onjegini nuk e pranon dashurinë e Tatjanës. Tatjana martohet me një njeri që nuk e deshi kurrë. Pas disa kohësh Tatjana tashmë e martuar takohet me Onjeginin. Ai pendohet për atë që kishte bërë, kërkon që të rikthehet me të, por fisnikja Tatjanë nuk pranon. Në fund Onjegini mbetet skllav i jetës së tij boshe.

Hapi 3. **Lexim dhe interpretim.** Nxënësit lexojnë pjesë të ndryshme nga romani duke interpretuar saktë gjuhën e përdorur nga Pushkini si dhe mesazhet që përcjellin. Disa nga pjesët më të bukura të këtij romani janë "Letra e Tatjanës Onjeginit", "Dueli Onjegin-Lenski" etj.

Nxënësit analizojnë figuracionin e përdorur në pjesë të ndryshmë. Duke qënë se Pushkini është përfaqësues i romantizmit heronjtë e tij e gjejnë qetësinë te natyra.

Kjo analizë vepre mund të mbështetet në këto etapa:

1. *subjekti i veprës;*
2. *personazhet, portretizimi i tyre;*
3. *linja e subjektit, ndërhyrjet brenda saj;*
4. *mesazhet që përcillen;*
5. *figuracioni i përdorur;*
6. *kompozicioni i veprës.*

Nxënësit janë të lirë të trajtojnë këto etapa si në mënyrë individuale ashtu edhe në grup.

Vlerësimi: Mësuesi/ja gjatë këtyre dy orëve mund të bëjë një vlerësim të vazhdueshëm me gojë për përparimin e nxënësve, me qëllim identifikimin e njohurive dhe për analizën që i bënë veprës.

Detyrat dhe puna e pavarur: Të lexojnë pjesë nga Pushkini.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt.___/____/__

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda: Letërsi**	**Shkalla: V**	**Klasa: XI**
Tema mësimore: Jeta dhe veprimtaria e J. De Radës		**Situata e të nxënit:** Bisedë, diskutim rreth kontributit letrar e gjuhësor te shkrimtarit	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: - përcakton rolin e De Radës në letërsinë shqiptare; - klasifikon sipas periudhave veprimtarinë e De Radës; - analizon krijimtarinë letrare e gjuhësore; - vlerëson rolin e shkrimtarit sinovator në fushën letrare e gjuhësore.		**Fjalët kyçe:** Romantik Motivi atdhetar Ligjërimi i pasur Ndjeshmëri lirike Nivel i lartë artistik Mbledhës i folklorit	
Burimet: Libri i nxënësit, burime nga interneti, kritika letrare.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** gjuhë shqipe. histori, TIK.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Stuhi mendimesh-Praktike e drejtuar-Tabela e pyetjeve			

Organizimi i orës së mësimit

Parashikimi: Stuhi mendimesh

Nxënësit diskutojnë mbi romantizmin shqiptar dhe veçoritë e tij. Ndërtohet kllasteri.



Ndërtimi i njohurive - Praktikë e drejtuar

Ndahen nxënësit në grupe dhe ndërtohet tabela mbi jetën dhe veprimtarinë e De Radës.

Grupi i parë – Fëmijëria dhe arsimimi; plotësohet tabela.

Vendlindja	Maki Kozencë
Mësimet e para	Mësimet e para i mori në vendlindje më pas ndjek kolegjin ku shkruan edhe veprën e parë italisht "Odiseo".
Interesi ndaj folklorit	Pas kolegjit mbledh folklorin në krahinën e vet duke njohur edhe muzën e tij të frymëzimit për poemën "Milosao", vajzën e një bariu.
Studimet e larta	Studion për drejtësi në Napoli duke marrë pjesë në lëvizjet kalabreze por më pas iu kushtua tërësisht kauzës shqiptare.
Kontributi letrar e gjuhësor	Në 1848 botoi gazetën "L'Albanese d'Italia" ku përkrahu fuqishëm lëvizjet për çlirim kombëtar. Më 1883 gazeta e tij "Flamuri i arbrit" i bënte jehonë ngjarjeve shqiptare, kulturës së lashtë të popullit shqiptar. Në gjuhësi botoi shkrime gjuhësore si dhe në konferenca të ndryshme mbrojti fuqishëm tezën e lashtësisë së gjuhës shqipe dhe prejardhje e saj prej pellazgjishtes.

Grupi i dytë – Krijimtaria letrare e studime të ndryshme.



Grupi i tretë – Vlerësime të kritikës për krijimtarinë e De Radës.

Sipas Çabejit, autori e pasuroi letërsinë me një botë të re, me motive e figura origjinale duke ringritur epokat e lavdishme.

Sipas Kadaresë "Milosao" është unike në lirinë e ndërtimit të saj dhe novatorizmi i De Radës duket që në vargjet e para të poemës.

Përforcimi i njohurive - Tabela e pyetjeve

Pyetja	Përgjigjja
Ku qëndron rëndësia e veprës së parë të De Radës?	
Pse motivi i poemës Serafina Topia shënon edhe dramën e jetës së saj?	
Cila është vlera e poemës Skënderbeu i pafan?	
Cili është kontributi i tij në gjuhësi?	

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për përgatitjen shkencore dhe punën në grup.
Vlerësim diagnostikues dhe motivues.

Detyrat dhe puna e pavarur: Sillni në klasë materiale mbi vlerësimet për veprën "Milosao".

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

Fusha:Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla:V	Klasa:XI
Tema mësimore: Analizë: "Këngët e Milosaos"		**Situata e të nxënit:** Bisedë dhe diskutim rreth subjektit,strukturës,vlerave dhe stilit.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompentenca e te shprehurit dhe komunikimit. Kompetenca e të menduarit. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: -Identifikon poemën romantike epiko-lirike lloj krye-sor i romantizmit shqiptar. -Analizon poemën duke u ndalur në të skemën e anal-izës së tekstit poetik -Diskuton rreth sintetizimit dhe fragmentarizmit në këtë poemë -Vlerëson rolin e novatorizmit të De Radës në letërsinë shqipe.		**Fjalët kyçe:** Poemë epiko-lirike Hero romantik Fragmetarizëm Sintetizim Heshtje artistike Novatorizëm	
Burimet: Libri i nxënësit, burime nga interneti, poema "Milosao",		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuha shqipe, tik, histori	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve **Diskutim, vezhgim, stuhi mendimesh, punë në grupe.**			

Organizimi i orës së mësimit:

Hapi I- Diskutim-Lexohen detyrat e shtëpisë për vlerësimet rreth De Radës

Hapi II- Stuhi mendimesh

Nxënësit përmbledhin mendimet e tyre rreth poezisë së De Radës.



Hapi i III-Vëzhgim

Nxënësit pasi kanë lexuar materialin në libër dhe nga kërkimet në internet, plotësojnë skedën e poemës.

Titulli	Këngët e Milosaos
Autori	Jeronim de Rada
Lloji	Poemë epiko-lirike
Struktura	Përbëhet nga 30 këngë në botimin e I, heshtja si mjet artistik
Tema, motivet	Ngjarjet jetësore në MOTIN E MADH të Skënderbeut, motivi atdhetar dhe motivi i dashurisë.
Konteksti historik	Poema u bën jehonë betejave në Shkodër në vitet 1837, por ngjarjet vendosen në shekullin e XV.
Konteksti letrar	U botua në vitin 1838 dhe i përket romantizmit shqiptar
Hapësira	Ngjarjet vendosen në Shkodër, por toponimia i përket provincës Maki, vendlindjes së poetit.
Sistemi i personazheve	Milosao heroi tipik romantik, djali i sundimtarit të Shkodrës, që ngrihet më lart se mjedisi, në luftën e brendshme të tij midis ndjenjes dhe detyrës, me botë të gjerë shpirtërore. Rina, mishëron idealin romantik të vajzës së dashuruar,të bashkëshortes dhe nënës ideale, por njëkohësisht edhe brenda mentalitetit të mbyllur që mendon vetëm për lumturinë e saj familjare dhe pafuqishme për të përballuar sfidat e jetës . Nëna dhe motra e Milosaos janë përshkruar thjesht, por e plotësojnë mirë sistemin e personazheve. Nëna e Milosaos është tipike e gruas së klasës së pasur që ushtron pushtetin mbi gjithçka, mbartëse e mentalitetit konservator, por megjithatë ajo është këmbëngulëse ndaj Milosaos për detyrën e tij ndaj atdheut.
Idetë	Idetë filozofike, ku jeta jepet në lëvizje të pandërprerë, ku lumturia dhe fatkeqësia nuk e përjashtojnë njëra tjetrën. Idetë demokratike të barazisë midis njerëzve. Idetë estetike të përjetimit të kategorisë të së bukurës.
Mesazhe	Dhimbja dhe lumturia i japin kuptim jetës dhe qëllim për të ecur përpara për të përballuar edhe sfidat më të vështira. Jeta ka kuptim kur lëmë pas gjurmë pozitive.
Veçoritë artistike	Novator në zbërthimin e botës së brendshme të personazheve,vetërrëfimi si mjet i fuqishëm lirik, kompozicioni ndërtohet si një bashkësi këngësh të veçanta por heshtja dhe nënteksti i lidh me njëra –tjetrën. Natyra është një mjet i fuqishëm artistik në këtë poemë. Nuk mund të kuptohen heronjtë romantikë pa të. Të gjitha stinët janë pasqyruar aty duke dhënë mesazhe të rëndësishme . Ardhja e pranverës me kthimin në shtëpi, takimi dhe lindja e dashurisë në vjeshtë ku piqet gjithçka, ashtu edhe ndjenja e tyre. Lumturia dhe ngohtësia familjare me erën e dhe diellin e ngrohtë, dimri me erën e tij të ftohtë që sjell fundin e jetës.
Metrika	Vargu i bardhë trokaik popullor

Hapi i IV-Punë në grupe

Grupi I-Punohen ushtrimet 1,2,3

Grupi II-Ushtrimet 4,5,6.

Grupi III-Ushtrimet 7,8,9

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për përgatitjen shkencore dhe të menduarit kritik si edhe organizimin e punës në grup.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 11 fq.114.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

<table>
<tr><th>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</th><th>Lënda: Letërsi</th><th>Shkalla: V</th><th>Klasa:X I</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Studim teksti (Kënga e I)</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Studim teksti, diskutim për jetën në lëvizje të përhershme.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:
Kompetenca e të shprehurit dhe komunikimit
Kompetenca e të menduarit
Kompetenca e të nxënit për të mësuar
Kompetenca qytetare</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
- diskuton mbi imazhin që transmetojnë dukuritë natyrore që pasojnë njëra-tjetrën;
- identifikon fjalët kyç që shprehin lirizmin dhe elementet realiste në këtë këngë;
- analizon gjendjen shpirtërore të heroit dhe lidhjen e tij me natyrën dhe vend-lindjen;
- interpreton figurat kryesore letrare;
- vlerëson rolin e De Radës si misionari i një poezie të re.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:
Heroi lirik
Lis
Hare
Lëvizje
Natyra
Pëllumbesha
Poezia e re</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: Libri i nxënësit, Poema “Milosao”, interneti,
vlerësime të kritikës.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:
gjuhë shqipe, histori, tik.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve
Stuhi mendimesh-Lexim-Shpjegim-Punë në grupe</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizimi i orës së mësimit
Parashikimi-Stuhi mendimesh-Punë me grupe

Pas diskutimit të detyrave të shtëpisë, nxënësit së bashku me mësuesin/en përmbledhin vlerësimet për origjinalitetin e krijimtarisë së De Radës.
• E koncepton realitetin si kontrast midis jetës si luftë dhe si burim gëzimi.
• Fantazia e tij krijuese dallohet për një tematikë të gjerë dhe larmi të portreteve njerëzore.</td></tr>
</table>

- Nuk mjaftohet me këndvështrimin lirik të ndjenjave, por u dha atyre edhe një ngjyrim objektiv, duke pasqyruar konflikte të tendosura.
- Përdor detajin dhe nëntekstin si mjete të fuqishme artistike.
- Shkrin zhanre të ndryshme.
- Konciziteti, fragmentarizmi, heshtja janë mjete artistike tërësisht origjinale.

Ndërtimi i njohurive: Lexim i drejtuar-shpjegim

- Lexohet kënga e parë e poemës. Heroi lirik Milosao, bir i sundimtarit të Shkodrës po kthehet në atdhe. Gjithçka që i kap syri në natyrë (tipike për romantikët), e bën atë të duket jo vetëm i përmalluar, por edhe i entuziazmuar, djaloshar, në lëvizje dhe ndryshim të pandërprerë.
  Fjalët kyç në vargjet e para, *lis* dhe *uj*ë, dy elemente të rrënjosura në natyrë, në syrin e Milosaos jepen në ndryshim. Lakonizmi në vargjet e para shprehet qartë edhe nëpërmjet elipsës në vargu e dytë... *uj*ë *t*ë *ri* n*ë det...*
- Por në kontrast me botën që ndryshon, simboli i poezisë shqipe nuk ka ndryshuar me gjithë vështirësitë e kohës, por ka ngelur në brigjet ku ka lindur.
- Antiteza ere – e moçme e shpreh qarte këtë ide.
- Fluturimi i pëllumbit dhe trokitja e tij në qelqet e dritares së poetit shpreh qartë idenë e një poezie të re që po lindte dhe De Rada do të jetë misionari i kësaj poezie. Ai ndihet fatlum për këtë mision dhe këtë e shpreh qartë epiteti dhe inversioni që e thekson më shumë atë: *tek e bardha shpia ime*
- Përdorimi i vetës së II (ti) bën të mundur shkrirjen e heroit lirik me lexuesin.
- Detajet në lëvizje jepen nëpërmjet foljeve *kish ndëruar*, *kaltëronte, përzien...*
- Detajet nga vendlindja "rrushët, kallëzoret" bëjnë lidhjen me realitetin të heroit lirik.
- Krahasimet që ndërton autori në të dy raste lidhen me fjalën *hare*, për ta lidhur edhe më shumë me gjendje e tij shpirtërore: *si hareja qe del sysh.*
- Përdorimi i similitudës në fund të këngës te figura e vajzës, që vëren ndryshimin e papritur në trupin e saj, është trajtuar me elemente sensuale që lidhet me figurën e poetit djaloshar.
- Ritmi i brendshëm në këtë poezi krijohet pavarësisht mungesës së rimës nga:
  - ✓ përsëritja e pjesës mohuese;
  - ✓ zhvendosjet artistike;
  - ✓ gërshetimi i elementeve rrëfyese realiste me elementet lirike.

Përforcimi i njohurive: Punë me grupe. Fjala dhe përdorimi i saj.

<u>*Grupi 1:*</u> Shpjegoni lëvizjet dhe larminë e natyrës.
<u>*Grupi i II:*</u> Analizoni gjendjen shpirtërore të heroit lirik dhe lidhjen e tij me natyrën.
<u>*Grupi i III:*</u> Ndjesitë e De Radës përmes simbolikës së pëllumbit

Vlerësimi: Vlerësim diagnostikues dhe vlerësim motivues me notë. Nxënësit do të vlerësohen për saktësinë e njohurive shkencore, të menduarin kritik si dhe organizimin e punës në grup**.**

Detyrat dhe puna e pavarur: Rubrika detyra dhe këshilla.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tema mësimore: Studim teksti (Kënga XXII)		**Situata e të nxënit:** Studim teksti, bisedë mbi lumturinë.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të folurit dhe të komunikuarit Kompetenca e të shkruarit			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: - diskuton mbi temën që mbizotëron në këtë këngë; - përcakton paralelizmin midis natyrës dhe ndjenjave të poetit; - analizon kontrastin si figuracionin kryesor në vargun refren të këngës; - vlerëson mesazhet e rëndësishme që përcjell autori; - vlerëson veçoritë artistike të këngës.		**Fjalët kyçe:** Refren Diell Mëmë Era Fle Djep Kontrast	
Burimet: Libri i nxënësit, Poema "Milosao", Interneti, Vlerësime të kritikës.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** gjuhë shqipe, tik, arte.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Prezantimi i punës-Pyetje-përgjigje-Analizë-Ditar dypjesësh			
Organizimi i orës së mësimit: ***Hapi 1.*** **Prezantimi i detyrave të shtëpisë.** Nxënësit vlerësohen për detyrat e shtëpisë. ***Hapi 2.*** **Pyetje-përgjigje** ✓ Cila është ideja universale që shprehin vargjet e para të këngës? ✓ Cila veçori artistike mbizotëron në këto vargje? ✓ Pse përdoret e përsëritur fjala *hare*? ✓ Cila është gjendja shpirtërore e poetit që mbizotëron në këto vargje? ✓ Cilat janë veçoritë stilistike që tregojnë novatorizmin e autorit? ***Hapi 3.*** **Analizë e këngës** • Kjo është kënga e lumturisë së Milosaos, ku ardhja e verës e gjen atë pranë familjes. Vargu i parë i këngës do të përsëritet e do të kthehet në refren të lumturisë. • Kjo ndjenjë shprehet qartë me anë të kontrastit... *Bie po s'dua t*ë *fle*...			

Është kulmi i ndjenjave dhe arritja e lumturisë, pasi vështirësitë kanë kaluar, ai është i lumtur. Pengesat shoqërore mes tij dhe Rinës i sheshoi tërmeti që ra në Shkodër, (një zgjidhje nga jashtë veprës, artificiale nga poeti) dhe tashmë ai është martuar dhe trashëguar.
I duket gati e pabesueshme, si një ëndërr, që po të flerë nuk do ta gjejë përsëri... i duhet të shijojë çdo moment të saj. Në vargun e dytë përdoret përsëri veta e dytë ku edhe lexuesi merr pjesë në lumturinë e tij.

- Përdorimi i pjesës mohuese... *mos ma mbyll ti derën*... në formën urdhërore, plotëson figurën e heroit romantik, i cili nuk mund të shkëputet dot nga natyra, pasi ajo është pjesë e lumturisë së tij.
- Elementi i erës simbolizon lëvizjen,gjallërinë, ndjesinë e lumturisë, ndryshimet e mëdha në jetën e heroit.
- Dielli është elementi tjetër i natyrës që shkrihet metë dhe ndriçon lumturinë e tij. Dielli është burim i jetës, pa të nuk do të kishte jetë në tokë.
- Një gjetje domethënëse artistike është paralelizmi i diellit me mëmat, pasi edhe ato janë burimi i jetës.
- Dielli metaforik u kujton mëmave të shkuarën, rininë, që u solli lumturinë.

Njëkohësisht dielli tregon se jeta vazhdon në lëvizje të përhershme, ai do të perëndojë, por do të lindë përsëri ashtu si edhe jeta e njeriut.

Në tri vargjet e mëposhtme, autori me stilin e tij lakonik përshkruan figurën e Rinës të përshkallëzuar nga vajzë, në grua, në nënë duke realizuar kështu lumturinë e tij familjare.
Përsëritja e fjalës *hare* vazhdon të plotësojë tablotë e këngëve të mëparshme që shoqëron entuziazmin e heroit.
Vargjet e fundit nën ritmin e lëkundjes së djepit plotësojnë detajet intime familjare, ku përsëritja e vargut që bëhet refren i lumturisë së tij krijon ritmin e brendshëm në këtë këngë, shoqëruar nga ritmi i përkundjes së djepit, lëvizja e erës, shpërndarja e ngrohtësisë së diellit.

Hapi 4. **Punë e pavarur**

Kjo rubrikë do të plotësohet me anë të ditarit dypjesësh.

Analizoni vargjet

Vargu	Komenti
Mos e mbyll ti derën....	Përdorimi i vetës së dytë, shkrirja me lexuesin, lidhja me ngrohtësinë dhe bukurinë e verës si ngrohtësia e vatrës familjare.
Të hyjë dielli i pafajshëm...	Epiteti metaforik, dielli burim i jetës, simbol i saj që vazhdon, perëndon dhe lind përsëri.
Kohën e shkuar u kujton..	
Me hare nëpër shtëpi....	

Vlerësimi: Vlerësim diagnostikues, vlerësim individual i vazhduar, vlerësim për organizimin e punës në grup.

Detyrat dhe puna e pavarur: Rubrika detyra dhe këshilla.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

<table>
<tr><th>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</th><th>Lënda: Letërsi</th><th>Shkalla: V</th><th>Klasa: XI</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Studim teksti: Kënga XXX</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Nëpërmjet studimit të tekstit, nxënësi arrin të kuptojë se kështu do të rritet vizioni dhe botëkuptimi i tij për jetën.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
Kompetenca e të menduarit
Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
- diskuton për paralelizmin midis natyrës dhe gjendjes emocionale të heronjve romantikë.
- krahason figurën e lisit në këngën e parë dhe në këngën e fundit;
- argumenton nëse fundi i poemës është pesimist apo jo;
- përshkruan figurën e Milosaos në këndvështrim krahasues me këngën e lumturisë.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:
Lis
Era e maleve
Valë e pasosur
Vatër
Ëndërr</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: libri i nxënësit, materiale nga interneti, kritika letrare,etj.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:
gjuhë shqipe, histori, tik.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve
Prezantim, lexim dhe shpjegim teksti-rrjeti i diskutimit-praktikë e drejtuar</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizimi i orës së mësimit:
Hapi 1: Prezantimi i detyrave të shtëpisë dhe vlerësimi i tyre.

Hapi 2: Lexim dhe shpjegim teksti.
Është kënga e fundit e poemës. Në këtë këngë mbizotëron atmosfera e dimrit me erën e ftohtë që fryn nga mali. Milosao pas një sërë fatkeqësish familjare, vdekjes së djalit dhe Rinës se tij, kur nuk ka më se çfarë të humbasë, shkon në luftë dhe plagoset rëndë. Dëshira e tij e fundit është që të shohë për të fundit herë Shkodrën dhe të motrën. Gjithçka që ai përjetoi ishte aq e vrullshme dhe njëkohësisht aq sa e bukur edhe e dhimbshme. Jeta përsëri do të vazhdojë, porsi valët e përhershme të detit që i largohen dhe i afrohen sërish atij pafundësisht.</td></tr>
</table>

Hapi 3. **Analizë teksti.**

Vargu i parë i këngës krijon lidhjen e përhershme të natyrës me heroin lirik. Por ndryshe nga kënga e parë ku mbizotëron pranvera dhe këngës XXII ku mbizotëronte vera, këtu mbizotëron dimri, pasi heroi ynë është në çastet e fundit të jetës.

Lisi i cili në këngën e parë ishte i papërulur, në kulmin e lulëzimit të tij, ashtu si poeti plot me entuziazëm rinor. Tashmë *lisi* është përulur nga era e ftohtë e dimrit e cila simbolizon jetën që po fiket.

Metonimia...*e rrëzoi hijen e lisit* e pasqyron qartë këtë ide.

Në këtë këngë del qartë dhe natyra patriotike e Milosaos, pasi më në fund ai e kreu denjësisht detyrën ndaj atdheut. Për të shprehur krenarinë për këtë akt sublim, autori me stilin e tij lakonik përdor elipsën dhe metoniminë në vargun *gjaku im te lumi....*

Folja këtu mungon pasi atij nuk i interesojnë veprimet, fjalët, por gjaku i derdhur, simbol i aktit të tij ndaj atdheut.

Jeta do të vazhdojë përsëri dhe fjalët e tij të fundit janë të mbushura me mall e dhimbje për jetën që la pas e për vendlindjen, duke përgjithësuar fatin e heroit me fatin e arbëreshit që jeton dhe vdes me brengën e ndarjes nga mëmëdheu.

Jeta e tij ishte shumë e shkurtër, por e mbushur me dashuri, lumturi, dhimbje, si një hapje-mbyllje sysh, si një ëndërr e shkurtër.

Hapi 4. **Rrjeti i diskutimit**

po	Fundi i poemës është pesimist?	jo

Hapi 5. **Praktikë e drejtuar**

Nxënësit p+unojnë me ushtrimet e rubrikës: Fjala dhe kuptimi i saj.

Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësve do të jetë i motivuar pas tri orësh studim teksti, për detyrat e shtëpisë, si edhe për argumentet në diskutimin e dhënë. Bëhet vlerësim i vazhduar, si edhe vlerësim për punën në grup.

Detyrat dhe puna e pavarur: Rubrika detyra dhe këshilla.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tema mësimore: Naim Frashëri, jeta dhe vepra		**Situata e të nxënit:** Bisedë rreth këndvështrimit filozofik të Naim Frashërit mbi jetën dhe botën.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e të menduarit Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: - diskuton për krijimtarinë e N. Frashërit dhe botëkuptimin e tij; - identifikon notat romantike në krijimtarinë e tij; - përshkruan mënyrën se si realizohet himnizimi i vendlindjes dhe i natyrës shqiptare; - shpjegon botëkuptimin naimjan mbi dukuritë e panteizmit dhe metempsikozës.		**Fjalët kyçe:** Rilindës Romantik Iluminist Panteist Nota himnizuese Heroi lirik	
Burimet: Teksti i nxënësit, vëllimi "Lulet e verës" burime nga interneti, kritika letrare.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** filozofi, histori, tik, arte.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Stuhi mendimesh-praktikë e drejtuar-rrjeti i diskutimit			

Organizimi i orës së mësimit

Parashikimi: **Stuhi mendimi.** Nxënësit diskutojnë mbi krijimtarinë e Naim Frashërit pasi u është lënë detyrë nga ora e kaluar. Dy-tre nxënës recitojnë vargje nga "Bagëti e bujqësi" ku do të theksohet himnizimi i natyrës shqiptare si një nga elementet e rëndësishëm të romantikëve shqiptarë për nxitjen e ndërgjegjes kombëtare. Recitohen vargje nga "Lulet e verës" për të nxjerrë në pah motivet kryesore të veprës së N.Frashërit. Mësuesi/ja përmbledh njohuritë kryesore të nxënësve në skemën e mëposhtme.



Ndërtimi i njohurive: Praktikë e drejtuar

Nxënësit ndahen në grupe dhe përmbledhin materialin e pasqyruar në libër.

Grupi i parë: plotëson skedën për jetën dhe veprimtarinë patriotike.

Emri	Naim Frashëri
Fëmijëria	Lindi në Frashër të Përmetit, ku mori mësimet e para nga hoxha i fshatit për gjuhet e huaja. Më pas ndoqi gjimnazin "Zosimea".
Formimi kulturor	Në gjimnazin "Zosimea" u vu nën ndikimin e Iluminizmit francez dhe gjuhëve të tjera të huaja, të cilat e zgjeruan vizionin e tij filozofik.
Kthimi në atdhe	Për shkak të një sëmundjeje të rëndë u detyrua të kthehej në atdhe ku punoi në doganë.
Veprimtaria patriotike	Mori pjesë në përkrahjen e L.SH.P. Drejtoi me të vëllanë Shoqërinë e Stambollit dhe drejtoi e revistat "Drita e Dituria".

Grupi i dytë: Krijimtaria letrare. Plotësohet organizuesi grafik.

BOTËKUPTIMI FILOZOFIK DHE FETAR

VEPRAT

"Bagëti e bujqësi"
"Lulet e verës"
'Qerbelaja'
"Histori e Skënderbeut"
"Ëndërrimet"

U ndikua nga filozofia e Volterit, Kantit, Rusos, Dekart, Darvin.

Bektashizmi
Panteizmi
Metempsikoza
(kalimi i shpirtit nga nje trup në një tjetër)

TIPARET

- Romantik
- Humanist
- Ndërkulturor
- Qasja ndaj kulturave të tjera
- Zhanre të ndryshme

Grupi i tretë: Vlerësime nga personalitete të fushave të ndryshme.

Sipas Çabejit.....
Sipas Rexhep Qoses.....

Përforcimi i mësimit: Rrjeti i diskutimit

Përse Naimi është një nga udhëheqësit kryesorë të lëvizjes për Çlirim Kombëtar?
Nxënësit do të diskutojnë duke u ndalur te himnizimi i të kaluarës së lavdishme dhe heroit tonë kombëtar. Motivet patriotike në veprat e tij, himnizimi i natyrës shqiptare, i virtyteve të shqiptarit etj.

Vlerësimi: Vlerësim individual për njohuritë shkencore, shprehësinë e mendimit kritik, punën në grup.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 9 faqe 123.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda: Letërsi**	**Shkalla: V**	**Klasa: XI**
Tema mësimore: Analizë vëllimi "Lulet e verës"		**Situata e të nxënit:** Bisedë rreth motiveve, botëkuptimit filozofik, veçorive të krijimtarisë poetike.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca qytetare Kompetenca të mësuarit për të nxënë			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: - evidenton motivet kryesore të poezisë së Naim Frashërit; - shpjegon himnizimin e bukurisë shqiptare të së kaluarës historikë, të virtyteve të shqiptarëve; - tregon marrëdhënien e ngushtë midis bukurisë dhe dashurisë në vepër.		**Fjalët kyçe:** Dashuri Himnizim Bukuri Panteizëm Metempsikozë	
Burimet: Libri i nxënësit, vëllimi "Lulet e verës", burime nga interneti, tabelë digjitale.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** filozofi, arte, histori etj.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Prezantim-Stuhi mendimesh-Punë në grupe-Reflektim kuptimor			

Organizimi i orës së mësimit:

Hapi 1. **Prezantimi i detyrave të shtëpisë.**

Nxënësit prezantojnë esenë e zhvilluar në shtëpi: "Naimi me veprën e tij krijoi atdheun poetik".

Nxënësit japin mendimet e tyre në lidhje me temën dhe mësuesi/ja përmbledh argumentet e tyre.

Hapi 2. **Stuhi mendimesh.**

Përmblidhen mendimet e nxënësve të pasqyruara tek eseja e mësipërme.

Atdheu poetik sipas Naim Frashërit →
- Motivet patriotike, shoqërore filozofike
- Himnizimi i natyrës dhe historisë shqiptare
- Heroi lirik si hero kombëtar, humanizmi
- Kombi mbi fenë. Feja e shqiptarit është shqiptaria

Hapi 3. **Punë në grupe.**

Nxënësit të ndarë në grupe shpjegojmë motivet dhe veçoritë artistike të veprës "Lulet e verës".

Grupi i parë: **Motivi filozofik**

Naimi është poeti që krijoi poezinë filozofike. Në botëkuptimin e tij filozofik, Naimi nuk ka kundërvënie midis fesë dhe shkencës. Naimi pranon tri elemente në krijimin e materies: *zjarri, uji, ajri.*

Tri janë çështjet kryesore të filozofisë së tij.



ZOTI është krijuesi i tërë universit dhe i shkrirë kudo (panteizmi), ai ka krijuar gjithçka edhe njeriun e ditur dhe me moral të lartë (pikëpamja etike). Nga pikëpamja atdhetare e sheh Zotin si shprehje të vëllazërimit e bashkimit.



I tërë universi jepet në lëvizje të përhershme nëpërmjet dukurisë së përsëritjes. Me këtë autori aludon rikthimin e epokës së lavdishme të Skënderbeut. Dukuria e përsëritjes shoqërohet me dukurinë e metempsikozës.

Njeriu në poezinë e Naimit është njeriu i ditur e i moralshëm.

Jeta dhe vdekja ne poezinë e Naimit jepen nëpërmjet ndjenjës së lumturisë dhe dhimbjes.

Jeta simbolizohet nga pranvera, vera me ngjyrat dhe bukuritë e tyre.

Vdekja trajtohet ne planin personal dhe në atë filozofik. Humbjet e njerëzve të dashur shoqërohen me poezi me nota elegjiake. Në konceptin filozofik ai shfaq idenë e jetës pas vdekjes. Simbolika e vdekjes është stina e dimrit.

Grupi i dytë: **Motivi atdhetar**

Ky motiv shprehet në poezinë e Naimit nëpërmjet: dashurisë për vendlindjen, himnizimit të bukurisë së saj.

Himnizimi i së kaluarës historike, dëshirës për progres e lidhur kështu me idetë iluministe, jehonës që u bëri ngjarjeve të ndryshme historike të kohës, dashurisë për gjuhën shqipe. Nxënësit lexojnë vargje nga poezitë për t'i pasqyruar sa më qartë ato. Poezitë *"Shpreh", "Përse"* shprehin të përmbledhura idetë filozofike, iluministe dhe humaniste me dëshirën e madhe të ndryshimit të Shqipërisë. Poezia "Korça" i kushtohet hapjes së shkollës së parë shqipe në Korçë me nota të larta të himnizimit të gjuhës shqipe.

Grupi i tretë: **Motivi erotik**

Në këtë motiv zë vend të rëndësishëm shkrirja e bukurisë së jashtme të sendeve dhe dukurive të natyrës me bukurinë shpirtërore njerëzore. Në ciklin "Bukuria" dashuria dhe bukuria janë të pandashme nga njëra-tjetra, bukuria perceptohet nëpërmjet dashurisë si ndjenjë dhe dashuria s'mund të ekzistojë pa të bukurën.



Bukuria jepet pa cilësi konkrete fizike të karakterit dhe mosha përherë e re. Naimi ngelet soditës duke adhuruar nga larg dhe duke vuajtur një dashuri platonike të njëanshme. Bukuria është kudo në univers, aty ku gjendet perëndia dhe shfaqjen më të përsosur e gjen te vetë njeriu. ***Hapi 4.* Reflektim kuptimor.** Nxënësit punojnë me ushtrimet 1-6 për të kontrolluar nivelin e të nxënit dhe të studimit të tekstit.
Detyrat dhe puna e pavarur: Ese argumentuese: "E bukura sipas meje". **Vlerësimi:** Vlerësim i vazhduar për njohuritë e nxënësve, për të menduarit kritik dhe për punën e pavarur.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda: Letërsi**	**Shkalla: V**	**Klasa: XI**
Tema mësimore: Studim teksti: Poezia "Atdheu".		**Situata e të nxënit:** Bisedë në lidhje me motivet patriotike të Naim Frashërit.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca qytetare Kompetenca e të mësuarit për të nxënë			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: - dallon motivet kryesore të kësaj poezie; - shpjegon ndikimin e folklorit në krijimtarinë e poetit; - analizon funksionin e figurave të apostrofit dhe antitezës; - portretizon poetin si misionari i Rilindjes Kombëtare.		**Fjalët kyçe:** Motivi patriotik Vendlindje Apostrofë Filozofia Ndikim nga folklori	
Burimet: Teksti, vëllimi poetik, kritika të botuara.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** gjuhë shqipe, tik, arte.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Stuhi mendimesh-lexim interpretim-reflektim për kuptimin-ditar dypjesësh			
Organizimi i orës së mësimit ***Hapi 1.* Stuhi mendimesh.** Nxënësit diskutojnë mbi përmbledhjen poetike "Lulet e verës", motivet kryesore, veçoritë artistike.  Nxënësit diskutojnë për veçoritë e secilit cikël duke i ilustruar me vargje.			

Hapi 2. **Lexim interpretim.**

- ✓ Lexohet poezia nga nxënësit me intonacionin e duhur në të gjitha pjesët ku shprehet krenaria, dashuria për vendin e tij, urimet dhe mallkimet që shpreh në vargjet e fundit duke i theksuar ato.
- ✓ Interpretimi i poezisë do të bazohet në motivin kryesor të kësaj poezie, atë patriotik.
- ✓ Vargu i parë i kësaj poezie fillon me një apostrofë duke iu drejtuar drejtpërsëdrejti atdheut, si te poema e madhe "Bagëti e bujqësi" për të shprehur më fuqishëm lidhjen e tij të ngushtë me të. Ai e krahason me njerëzit më të dashur të gjakut të tij, të cilët janë të përjetshëm në shpirtin e tij. Për ta cilësuar në vetitë e tij atdheut i vesh mbiemra në shkallën sipërore, për ta përshkallëzuar maksimalisht ndjenjën. I drejtohet në vetë të dytë, saqë duket si një dialog mes të dyve duke i patur pranë.
- ✓ Lidhja me atdheun bëhet më e ngushtë pasi në tokën e tij ndodhen eshtrat e njerëzve të tij më të dashur,
- ✓ Antiteza *lindi – vdiq* përmbledh ciklin jetësor të njeriut dhe ai filloi dhe mbaroi aty, në atdheun e tij. Kjo tokë bëhet akoma më e rëndësishme, sepse aty prehen eshtrat e të parëve dhe përjetësohet historia. Poeti e thërret me emrin më te dashur *nënë,* sepse vetëm nëna që na ka dhënë jetën është e patjetërsueshme. Ndaj dhe poeti i vesh cilësi kozmike të përjetshme, gati hyjnore, duke e cilësuar me epitetin kompozitë "faqehënë" duke e përjetësuar atë.
- ✓ Vargjet e fundit të poezisë janë një lutje drejtuar zotit për ta begatuar vendin e tij me urimin për një të ardhme plot begati dhe me një mallkim për armiqtë e tij.
- ✓ Metrika. - Poezia është shkruar me rime të puthur, por për të mbajtur më shume ritmin shërbejnë edhe përsëritjet e fjalëve brenda vargut siç është dhe epanastrofeja, pasi një ritëm i tillë shpreh fuqishëm dhe vrullshëm ndjenjat patriotike të poetit.

Hapi 3. **Reflektim për kuptimin.**

Nxënësit do të punojnë ushtrimet në rubrikat: "Reflektim dhe vlerësim dijesh" dhe "Fjala dhe përdorimi i saj".

Hapi 4. **Ditar dypjesësh.**

Plotësoni tabelën me elementet që shprehin patriotizmin e poetit në: adhurimin për të, kujtimet e të parëve, lidhjen e ngushtë si nënë-bir, dëshirat për të ardhmen e ndritur të tij.

Vargu	Shpjegimi

Vlerësimi: Vlerësim diagnostikues, vlerësim i vazhduar për njohuritë e nxënësve dhe për të menduarit kritik.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Rubrika: Detyra dhe këshilla. Reflektoni mbi misionin e poetit mbështetur në poezinë "Fjalët e qiririt".

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

<table>
<tr><th>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</th><th>Lënda: Letërsi</th><th>Shkalla: V</th><th>Klasa: XI</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Studim teksti: Poezia “Fyelli”</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Bisedë dhe studim teksti për veçoritë e poezisë filozofike të Naim Fra shërit.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit
Kompetenca e të menduarit
Kompetenca qytetare
Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
- identifikon vargjet ku shprehet humanizmi dhe dhimbja poetike;
- shpjegon simbolikën e fyellit dhe të zjarrit;
- interpreton mesazhin e poezisë;
- përshkruan me imtësi ndjesitë e unit lirik dhe filozofik.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:
Poezi meditative filozofike
Humanizëm
Uni lirik
Uni fetar
Uni filozofik</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: Teksti i nxënësit, kritika letrare etj.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:
arte, histori, filozofi.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve
Lexim dhe prezantim-Reflektim kuptimor-Tabela e figurave</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizimi i orës së mësimit
Parashikimi-Lexim dhe prezantim
Lexohen disa prej detyrave të shtëpisë në të cilat nxënësit kanë portretizuar poetin si misionar të Rilindjes ku me “Fjalët e qiririt”: Në mes tuaj kam qëndruar/edhe jam duke u përvëluar/që tu jap pakëz dritë...poeti shpreh misionin e tij si poet që të ndriçojë mendjet e njerëzve, për t’i ndërgjegjësuar që të dalin nga errësira e padijes dhe prapambetjes, të arsimohen dhe zhvillohen si kombet e tjera të qytetëruara. Poeti nuk nguron të vetësakrifikohet për progresin e kombit të tij për një rilindje në jetën dhe mendimin e prapambetur të shqiptarëve. Poeti do të shkrihet si qiriri sepse është i sigurt se do të lërë pas veprën e tij si trashëgimi brezave.
Prezantimi i poezisë “Fyelli”. Lexohet me intonacion nga nxënësit.
Kjo poezi shënon kulmin e mendimit filozofik të N. Frashërit. Ashtu si ligjërata e qiririt, ku qiriri është vetë poeti, edhe në këtë ligjëratë poetike fyelli është vetë poeti apo njeriu që flet, qesh, këndon, vajton, shpreh idealet e tij. Në këtë poezi janë shkrirë katër unët:</td></tr>
</table>

- *Uni lirik,* fyelli është përzierë me zjarrin e brendshëm të shpirtit poetik.
- *Uni naimian* është shprehur tek humanizmi i tij që rri pranë tyre,shqetësohet dhe sakrifikohet për ta, bën thirrje që ta kuptojnë.
- *Uni fetar* i cili shprehet me shkrirjen e zjarrit të perëndisë që krijoi boten,me zjarrin e shpirtit të poetit dhe gjen shprehje me shkrirjen e njeriut me Zotin.
- *Uni filozofik* ku shpirti zjarrtë i poetit së bashku me zjarrin e Perëndisë bëhet një dhe i përjetshëm.

Ndërtimi i njohurive - Reflektim kuptimor

Kjo poezi ashtu si edhe "Fjalët e qiririt" flet hapur për misionin e poetit me veti hyjnore të cilat i vë në shërbim të njerëzimit. Ai u fal njerëzve dashuri, mirësi, përkushtim duke u vetësakrifikuar dhe i jep atyre mesazhin se këto veprime e fisnikërojnë njeriun duke e afruar më shumë me Perëndinë.

Fyelli që gëzon dhe qan është poeti i cili gëzohet për njerëzit, por edhe vuan shpirtërisht. Këto vuajtje janë personale, por akoma më shumë sociale pasi shoqëria ende nuk e kupton atë dhe akoma me të rënda janë vuajtjet kombëtare për gjendjen në të cilën ndodhej Shqipëria.

Simboli *i zjarrit* në këtë poezi shpaloset në dy plane: filozofik dhe poetik.

Në planin filozofik është zjarri i perëndisë prej të cilit u formua bota dhe ai është i përjetshëm ashtu si zjarri në shpirtin e çdo njeriu qe shpreh dëshirën, dashurinë,shpresën.

Zjarri si simbol poetik është: 1-zjarri i jetës, 2-zjarri dashurisë për njerëzimin, 3-zjarri poetik

Përforcimi i mësimit - Tabela e figurave

Figura	Shpjegimi
Epitetet: mërgimet e shkreta, e zeza botë < + inversion >	Poeti shpreh dhimbjen e tij personale dhe shoqërore.
Antiteza: Botën e gëzuar, njerëz të helmuar	Misioni i poetit për të shprehur gëzimet dhe hidhërimet e njerëzve.
Metafora folje: psherëtin zemra ime...	Shprehja e dhimbjes poetike.
Shkallëzimi rritës: e ndriti, e nxehu, e buçiti.	Forcën e dashurisë që shtrihet kudo në univers e në shpirtin e njeriut dhe që është e përjetshme.

Vlerësimi: Vlerësim diagnostikues,vlerësim i vazhduar për njohuritë e nxënësve dhe për të menduarit kritik.

Detyrat dhe puna e pavarur: Vështrim krahasues midis simboleve të qiririt dhe fyellit të përdorura nga Naimi dhe nga poetët e Lindjes.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tema mësimore: Studim teksti: Lulja		**Situata e të nxënit:** Diskutim mbi zanafillën e krijimit të krijimit të botës.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca qytetare Kompetenca e të mësuarit për të nxënë			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: - diskuton në mënyrë individuale ose në grup mbi poezinë filozofike; - tregon emocionin që shpreh kjo poezi; - shpjegon aktin e krijimit të botës sipas Naimit; - komenton vargjet duke u ndalur tek emocioni që përçon; - krahason këtë poezi me poezinë me të njëjtën temë të P. Bogdanit.		**Fjalët kyçe:** Poezi filozofike Toka Hëna Dielli Rruzulli Lulëz	
Burimet: libri i nxënësit, vepra "Lulet e verës".		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** histori, filozofi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimit **Parashikimi: Stuhi mendimi** Diskutimi i detyrave të shtëpisë. Kjo detyrë do të shtjellohet dhe do të diskutohet me hollësi pasi ka lidhje me poezinë e re. Nxënësit do të diskutojnë për mënyrën e krijimit të botës sipas botëkuptimit fetar dhe sipas N. Frashërit. Do të interpretojnë mënyrën e krijimit të botës prej zjarrit të Perëndisë dhe të njeriut prej një shkëndije të tij. Cila është simbolika e fyellit? Si konceptohet në aspektin poetik dhe letrar simboli i zjarrit? **Ndërtimi i njohurive: Lexim dhe interpretim** Në këtë poezi autori kthehet shumë pas në kohë, kur gjithçka ishte lëndë dhe rikrijon botën në këtë poezi sipas këndvështrimit të tij. Autori thekson trupat kryesore kozmike, qiellore dhe mbi të gjitha veçon diellin, burimin e jetës, duke e cilësuar me figura të thjeshta si krahasimi në vargun e parë dhe epiteti në vargun e tretë, të dhëna këto në mënyrë të përshkallëzuar (si fener, shkëlqimtar).			
Gëzimi për krijimin e botës prej zjarrit që i dha jetë gjithçkaje, shprehet natyrshëm duke i përmbledhur në pak rreshta me anë të enumeracionit: ujë, bimë, frymorë. Por mbi të gjitha në këtë poezi të tërheq vëmendjen lulëza të cilës ai i drejtohet gjithë emocion dhe dashuri si simbol i së bukurës, i vajzës së ëndërruar, i dashurisë të cilën ai e kërkon edhe në aktin e krijimit të botës.			

Përforcimi i mësimit: Diagrami i Venit
Krahasoni poezinë "Lulja" të N. Frashërit dhe poezinë "Krijimi rruzullimit" të P. Bogdanit.



Vlerësimi:
Vlerësohen nxënësit për mënyrën e të nxënit të njohurive, për aftësitë e të shprehurit dhe mbi të gjitha të argumentuarit.

Detyrat dhe puna e pavarur: Përgatitje për përsëritjen e kapitullit të Romantizmit shqiptar. Përgatituni për diskutimin mbi romantizmin në krijimtarinë e De Radës dhe N. Frashërit.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi**	**Shkalla: V**	**Klasa: XI**
Tema mësimore: Përsëritje për letërsinë e Rilindjes		**Situata e të nxënit**: Tiparet e romantikëve në letërsinë e huaj dhe në atë shqipe. Tiparet kryesore të veprave.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca qytetare Kompetenca e të mësuarit për të nxënë			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: - diskuton mbi tiparet e Romantizmit në letërsinë shqipe; - dallon tematikën kryesore në veprat e romantizmit; - interpreton konceptet filozofike në poezinë e Naimit; - interpreton karakteristikat e veçorive krijuese të krijimtarive e De Radës; - vlerëson rolin e këtyre veprave në letërsinë tonë.		**Fjalët kyçe:** Romantizëm Humanizëm Iluminizëm Himnizimi natyrës shqiptare Himnizim i historisë Kombi mbi fenë	

Burimet:	**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikula.re:** histori
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Konkurs: Pyetje-përgjigje-Pyetje me shtjellim	

Organizimi i orës së mësimit

Konkurs

Ora e mësimit do të zhvillohet në formën e një konkursi me pyetje-përgjigje dhe pyetje me shtjellim.

Kjo përsëritje do të vlejë për përforcimin e njohurive të tyre dhe parapërgatitje për testimin e ardhshëm. Klasa do të ndahet në dy grupe dhe njëri prej nxënësve do të mbajë shënim pikët e secilit grup në varësi të përgjigjeve të sakta. Në fund do të shpallet fituesi.

- Pse letërsia e Rilindjes shqiptare dhe Romantizmi shqiptar u zhvilluan në të njëjtën kohë?
- Dalloni tiparet e romantizmit në letërsinë shqipe?
- Cilat janë tematikat kryesore në veprat e Naimit?
- Cilat janë dy motivet kryesore në poemën e De Radës?
- Cilat janë ato tipare të romantizmit që i shërbyen çështjes kombëtare?
- Dalloni konceptet filozofike në poezitë e Naimit?
- Ç'ndikime pati De Rada nga poezia popullore?

- Si shkrihen elementet natyrore me ato njerëzore në veprën e De Radës?
- Përshkruani heroin romantik të De Radës.
- Përmendni disa nga notat romantike në vëllimin "Lulet e verës".

Pas përfundimit të këtyre pyetjeve,nxënësit do t'u përgjigjen me shkrim 5-10 minuta pyetjeve me shtjellim të cilat kanë karakter formues, ku ata do të shfaqin jo vetëm njohuritë e tyre, por edhe të menduarin kritik.

Pyetje me shtjellim

- Si shtjellohen tiparet e konçizitetit dhe sintetizmit në veprën "Këngët e Milosaos"?
- Shpjegoni duke argumentuar dhe duke e ilustruar me shembuj se si e krijoi Naimi atdheun poetik.
- Analizoni ngjashmëritë dhe dallimet midis romantizmit në Shqipëri, romantizmit të arbëreshëve të Italisë dhe romantizmit evropian.
- Përmblidhni mendimin tuaj mbi interpretimet e kritikës letrare për të dy autorët e romantizmit shqiptar.
- Argumentoni si materializohet artistikisht ideali i bukurisë te Naimi dhe si shkrihet ai me parimet e tjera filozofike.
- Përmblidhni strukturën e poemës "Milosao" dhe përcaktoni novatorizmin e De Radës.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit pjesëmarrës, vlerësim i vazhduar, si edhe vlerësim motivues me shprehje për pyetjet me shtjellim.

Detyrat dhe puna e pavarur: Parapërgatitje për testimin përmbledhës të tremujorit të tretë, si edhe për bisedën letrare për romanin e Balzakut "Evgjeni Grande".

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

<table>
<tr><th>Fusha:</th><th>Lënda:</th><th>Shkalla:</th><th>Klasa:</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Punë me projekt “Hartimi i një reviste”
Faza e parë</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:
Synimi i projektit, hapat e punës për realizimin e një projekti, fazat e projektit.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit
Kompetenca e të menduarit
Kompetenca qytetare
Kompetenca e të mësuarit për të nxënë
Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin
Kompetenca personale
Kompetenca e të shkruarit
Kompetenca digjitale</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
- diskuton, hulumton, kërkon mbi tema të fushave të ndryshme;
- zhvillon të menduarit kritik;
- rrit aftësinë për punën në grup dhe socializmin e pjesëmarrësve;
- zhvillon te nxënësit aftësinë për të shkruar;
- rrit te nxënësit aftësitë e menaxhimit të një buxheti;
- nxit nxënësit të menaxhojnë veprimtari të ndryshme;
- motivon nxënësit.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:
Projekt
Revistë
Synim
Strukturë
Fazat e projektit
Grupet e punës</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: Teksti mësimor, fjalori i gjuhës shqipe, modele revistash të ndryshme.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: gjuhë shqipe, tik, arte etj.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve
Stuhi mendimesh-Prezantim-Punë në grupe</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizimi i orës së mësimit
Hapi 1: Stuhi mendimi.
Pasi mësuesi/ja u prezanton temën e projektit lëndor “Hartimi i një reviste”.
Nxënësit japin mendime të ndryshme në lidhje me revistën nëpërmjet pyetjeve të ndryshme:
Ç’është revista?
Si ndërtohet dhe botohet ajo?
Cilat janë fushat që mund të përmbajë një revistë?
Cili është afati kohor që mund të botohet një revistë?
Cilat janë dallimet midis gazetës dhe revistës?</td></tr>
</table>

***Hapi 2.* Prezantim**

Synimet e projektit:

- ➢ të mësohet se si krijohet një revistë;
- ➢ të fitohet përvojë në punën në grup;
- ➢ të përforcohen njohuritë e marra në shkollë dhe në fusha të tjera;
- ➢ të përsosen shkathtësitë e ndryshme.

Përcaktohen hapat që duhen ndjekur për realizimin e revistës:

- Përcaktohet emri i revistës, i cili duhet të jetë sa më tërheqës dhe të përputhet me qëllimin e saj.
- Përcaktohet qëllimi i revistës.
- Përcaktohen objektivat e revistës.
- Zgjidhen bashkëpunëtorët dhe ndahen detyrat sipas aftësive.
- Përcaktohet afati i botimit periodik të revistës.
- Përcaktohet formati dhe struktura e revistës.
- Përcaktohet preventivi i gazetës me qëllim përcaktimin e buxhetit dhe përkrahja që duhet t'u sigurohet nga organizmat e ndryshëm.

Përcaktimi i fazave të projektit:

Faza e parë: Ora e parë e projektit ku do të bëhet prezantimi i temës, përcaktimi i llojit të revistës dhe në bazë të saj do të bëhet dhe ndarja e punës në grupe dhe caktimi i detyrave dhe i afatit kohor.

Faza e dytë: Ndërtimi i draftit të produktit, ku do të jepen udhëzimet e fundit.

Faza e tretë: Prezantimi i revistës dhe vlerësimi i nxënësve.

Faza e parë

Prezantimi i projektit dhe strukturës së tij.

Përcaktohen metodat që do të përdoren si: Diskutim, punë në grupe, hulumtim etj.

Përcaktohet afati që deri orën tjetër të projektit (në fund të majit) të ketë mbaruar.

Përcaktohen burimet e informacionit: tekste shkollore, burime nga interneti, revista, albume katalogë, guida, manualë, dokumentarë, filma.

***Hapi 3.* Punë në grupe.**

Ndahen detyrat sipas grupeve të punës në bazë të aftësive dhe prirjeve:

Përcaktohet kryeredaktori, nxënësi me prirje më të mira menaxhuese dhe letrare.

Përcaktohen gazetarët e rubrikave:

Rubrika letrare, rubrika shkencore, rubrika e ekonomisë, rubrika e artit dhe kulturës, e modës.

Grupi i redaktorëve, grupi i korrektorëve letrarë.

Grupi i faqosjes, grupi i internetit që do të merret me botimin online.

Grupi i ekonomistëve që do të merret me preventivin e buxhetit dhe menaxhimin e tij.

Grupi i bashkëpunëtorëve që do të sigurojë përkrahjen e projektit nga organizmat e shkollës dhe jashtë saj.

Vlerësimi: Në këtë fazë të projektit nuk do të këtë vlerësime. Vlerësimi i nxënësve do të bëhet fazën e fundit të projektit në bazë të katër niveleve të arritjes. Nxënësit do të vlerësohen për aftësitë e të shkruarit, të mendimit kritik, të menaxhimit të një veprimtarie, të prezantimit në grup etj.

Detyrat dhe puna e pavarur: Kryeredaktori i zgjedhur do të përzgjedhë kryetarët e grupeve të gazetarëve të rubrikave, të cilët do të ndajnë punët brenda grupit.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

<table>
<tr><th>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</th><th>Lënda: Letërsi</th><th>Shkalla: V</th><th>Klasa: XI</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Realizmi</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Diskutim mbi kushtet historiko shoqërore, autorët, parimet.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit
Kompetenca e të menduarit
Kompetenca qytetare
Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
- diskuton mbi karakteristikat e Realizmit dhe përhapjen e tij në botë;
- tregon kushtet historike shoqërore në të cilat u zhvillua ky drejtim letrar;
- krahason tiparet e realizmit me ato të realizmit kritik dhe të natyralizmit;
- analizon tiparet e realizmit kritik dhe natyralizmit;
- përshkruan përhapjen e realizmit dhe përfaqësuesit kryesorë.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:
Realizëm
Natyralizëm
Realizëm kritik
Impersonalizëm ose pavetësi
Tipizim
Objektiv</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: Libri i nxënësit, vepra të autorëve të ndryshëm.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: histori, arte, filozofi.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve
Diskutim-Diagrami i Venit-Lexim i drejtuar-Harta e koncepteve-Praktikë e pavarur</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizimi i orës së mësimit
Hapi 1. Bashkëbisedim
Nxënësit diskutojnë mbi Realizmin si rrymë letrare që lindi në shekullin e 19.
• Lindi fillimisht në Francë e më pas në vende të tjera.
• Qëllimi: Të pasqyronte realitetin objektivisht.
• Arti duhet të shmangte çdo idealizëm.
• Pasi parulla liri-barazi-vëllazëri nuk e arriti qëllimin e saj, për shkak të ndryshimeve në teknologji dhe thellimit të konflikteve sociale midis borgjezisë dhe proletariatit dhe kjo solli zhvillimin e ideologjive të reja.
• Realizmi i zhvillua si rrymë në dy faza:</td></tr>
</table>

REALIZMI

Realizmi kritik	Natyralizëm
➢ Është më i fuqishëm	- Karakter shkencor
➢ Në kërkim të idealit pozitiv	- Impersonalizëm
➢ Ka elemente romantike	- Shkrimtari -shkencëtar social
➢ Formë më të lirë	- E vërteta është e bukur
➢ Kritikojnë shoqërinë borgjeze	- Njeriu kushtëzohet nga trashëgimia

Hapi 2. **Diagrami i Venit**

Realizmi si metodë (i paraqet gjërat ashtu siç janë) është hasur në letërsinë e të gjitha kohërave, që nga Dante, Shekspiri etj., por secila kishte karakteristikat e veta. Nxënësit së bashku me mësuesin/en ndërtojnë diagramin e Venit për realizmin në periudhë klasiciste, romantike dhe të realizmit si drejtim letrar.

Ndryshimet e mëdha dhe më të rëndësishme ndodhin brenda unit të personazhit
Ndryshimet ndodhin nga brenda-jashtë.

Autori regjistron ndryshimet e vazhdueshme që
Te personazhi realist njohim rrënjët sociale

HEROI



figurë skematike që lëviz brenda skemave të ngurta
përfaqësues virtytesh ose vesesh të rralla.
Zgjidhje skematike.

Njeriu real me të mirat dhe të metat

shpreh ndjenjat e vrullshme të autorit.
zëdhënës i ideve të autorit
Zgjidhje subjektive sipas ideve sublime të autorit.

Hapi 3. **Harta e koncepteve**



Hapi 4. **Praktikë e drejtuar**

Nxënësit do të vëzhgojnë me kujdes pikturat e periudhës realiste dhe do të diskutojnë në lidhje me veçoritë e tyre në mënyrën e zgjedhjes së temave, personazheve, zgjedhjes së këndvështrimit dhe të ngjyrave e teknikave. Duke pasur në vëmendje tiparet e Realizmit në letërsi do të vërejnë edhe pasqyrimin e tij në arte të tjera.

Vlerësimi: Vlerësim i vazhduar, vlerësim diagnostikues.

Detyrat dhe puna e pavarur: Sillni informacione mbi jetën dhe veprën e Balzakut.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tema mësimore: Jeta dhe krijimtaria e Balzakut		**Situata e të nxënit:** Diskutim, bisedë mbi krijimtarinë e Balzakut.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca qytetare Kompetenca e të mësuarit për të nxënë			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: - diskuton mbi vizionin e Balzakut në krijimin e "Komedisë njerëzore"; - dallon motivet kryesore në kryeveprën e Balzakut; - shpjegon konceptin e parasë si forcë lëvizëse në realitetin e Balzakut; - analizon kompozicionin prej piramide te vepra e Balzakut; - gjykon mbi risitë dhe vlerat që solli Balzaku në letërsi.		**Fjalët kyçe:** Tip Personazh Para Kompozicion Piramidë Migrimi i personazheve Monomani	
Burimet: libri i nxënësit, interneti, kritika letrare.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** histori.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Stuhi mendimesh-Lexim i drejtuar-Pyetje-përgjigje-Diagrami i Venit-Reflektim kuptimor			

Organizimi i orës së mësimit

Parashikimi - Stuhi mendimesh

Nxënësit do të përmbledhin materialin mbi jetën dhe krijimtarinë e Balzakut duke cilësuar vendi e tij në letërsinë e Realizmit.

- Krijuesi i romanit social.
- Mjeshtër i përshkrimit të shoqërisë franceze.
- Ka për qëllim të analizojë tipat njerëzorë.
- Kaloi një fëmijëri të vështirë dhe të privuar nga dashuria e nënës.
- Kishte një interes të madh për librat.
- Studioi drejtësi në Paris.
- Veprat e para me temë historike, komike e fantastike nuk patën sukses.
- Punoi si gazetar duke njohur kështu shoqërinë franceze dhe botoi romanin "Shuanët", i cili i hapi rrugën drejt suksesit dhe njohja me Hygonë i hapi dyert e shoqërisë së lartë parisiane.
- Duke njohur sallonet parisiane, e kuptoi se me të shkruarit do të fitonte pasuri dhe vazhdoi të shkruante romane dhe novela monografi, kujtime etj.
- Shkëlqimi i famës së tij do të vazhdojë me "Lëkurën e Shangrenit" dhe shkruan një tregim në 15 ditë.

- Në 1845 përfundon "Komedinë njerëzore" si kundërvënie ndaj Dantes, ku pasqyronte një tablo të plotë të

epokës së tij.

- Jeta e tij i ngjante personazheve të krijuara prej tij.

Ndërtimi i njohurive-lexim drejtuar, Pyetje-përgjigje, Diagrami i venit

Lexohet materiali mbi "Komedinë njerëzore" dhe nxënësit mes pyetjeve-përgjigjeve e shtjellojnë atë.

- Cilat janë motivet kryesore në vepër?
- Si është organizuar kompozicioni në Komedinë njerëzore?



- Si krijohet njeriu sipas Balzakut?
- Pse Balzaku rimerr personazhet nga një vepër në tjetrën?

Diagrami i venit

Balzaku



Zbulon shpirtin e brendshëm të personazheve.
Zbërthen pasionet e fuqishme.
Shkrimtari ka funksion edukativ.
Arti ka qëllim moralizues.

Pasqyroi tiparet njerëzore në shoqërinë e kohës.
Studioi tipat njerëzorë në thellësinë e tyre.
Hetoi në thellësinë e karaktereve të tyre.
Pikturoi në letërsi epokën e tij.

Përforcimi i mësimit-Reflektim kuptimor

Nxënësit reflektojnë mbi realizmin vizionar të Balzakut dhe risitë që ai solli në letërsinë e kohës.

Risitë e Balzakut

- Krijoi karaktere tipash që vuajnë nga monomania.
- Ka një saktësi të madhe nëpër shkrim.
- Krijoi një unitet mes sendeve dhe shpirtit.
- Krijoi romanin social.
- Krijoi realizmin atmosferik me elemente objektive.
- Krijoi një panoramë shoqërore dhe çmitizoi vlerat borgjeze.
- Vepra e tij ka karakter ciklik.
- Krijoi tipa dhe stereotipe me tipare fikse te një grupi shoqëror duke krijuar tipizimin e personazheve.
- Krijoi 2000 personazhe me histori personale ku mbizotëronin dy tipat mashtruesi dhe i mashtruari.
- Pasqyroi me vërtetësi rolin e të riut në shoqërinë njerëzore.
- Kritika marksiste e quante "protokollist të shoqërisë së kohës", ai e quante veten kronist të shekullit të XX.

Vlerësimi: Bëhet vlerësim diagnostifikues.

Detyrat dhe puna e pavarur: Përmblidhni në një ese paraqitëse vlerësimin kritik për Balzakun.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

Fusha:Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda: Letërsi**	**Shkalla:V**	**Klasa:XI**
Tema mësimore: Analizë: Romani "Xha Gorio"		**Situata e të nxënit:** Bisedë, diskutim mbi veçoritë e romanit të Balzakut.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca qytetare Kompetenca e të mësuarit për të nxënë			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: - diskuton për temat, strukturën, linjat e romanit; - shpjegon këndvështrimin e Balzakut në këtë vepër; - dallon mentalitetet familjare e sociale që ndeshen në roman; - argumenton përfaqësimin e personazheve si dukuri shoqërore; - gjykon mbi personazhet kryesore si personazhe tipike në rrethana tipike.		**Fjalët kyçe:** Tipizim Monomani Ves Dramë familjare Filozofi shoqërore	
Burimet: Libri i nxënësit, vepra e plotë.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** gjuhë shqipe, arte, histori, filozofi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Stuhi mendimesh-Lexim dhe shpjegim-Studim hap pas hapi-Praktikë e drejtuar-Rrjeti i diskutimit			

Organizimi i orës së mësimit

Hapi 1. **Stuhi mendimi.**

Nxënësit diskutojnë për detyrat e shtëpisë mbi esenë paraqitëse për kritikat letrare mbi veprën e Balzakut.

Nxënësit kujtojnë gjithçka u vjen ndër mend për romanin "Xha Gorio".

- ✓ Është botuar në vitin 1834.
- ✓ Balzak është i pari shkrimtar në botë që krijoi një vepër me strukturë dhe përmbajtje tërësisht realiste.
- ✓ Përbën boshtin e kryeveprës Komedia Njerëzore.
- ✓ Është udhëkryqi ku takohen disa prej heronjve kryesorë që do të ndeshen edhe në romane të tjera.
- ✓ Tema kryesore në këtë vepër është ajo shkatërrimit të qelizës kryesore të shoqërisë, familjes, duke vënë në pikëpyetje ekuilibrat e së ardhmes.
- ✓ Kjo temë është temë universale për çdo kohë e për çdo vend.

Hapi 2. **Lexim dhe shpjegim.**

- Nxënësit lexojnë me kujdes materialin e paraqitur në libër, si edhe materialet e tjera nga interneti dhe burime të tjera.
- Xha Gorioi përfaqëson në letërsinë realiste një gur të rëndë themeli.
- Në qendër është drama e një babai të braktisur nga të bijat, për dashurinë ndaj të cilave ai kishte sakrifikuar gjithë jetën e tij.
- Është gjithashtu drama e një të riu provincial që përjashtohet nga jeta e kryeqytetit.
- Drama e Rastinjakut qëndron në bazë të gjithë Komedisë njerëzore.
- Monomania e Gorioit është dashuria e pakufishme për të bijat e cila është kthyer gati në ves, sepse ai vetëm jep e jep dhe nuk merr asgjë në këmbim, as respektin e tyre.
- Personazhet kryesore në këtë vepër përfaqësojnë filozofi dhe ide të ndryshme shoqërore.

Hapi 3. **Studim hap pas hapi.**

Si fillim nxënësit do të diskutojnë mbi subjektin e romanit.

Hapësira ku zhvillohen ngjarjet është pensioni Voker, një hotel për të varfrit, ku autori ka përdorur me mjeshtëri kontrastin midis lartësisë së ndërtesës dhe lartësisë së klasës shoqërore. Sa më shumë te biesh poshtë nga shkalla shoqërore dhe pasuria, aq më lart ngjiteshin në katet e ndërtesës.

- Figura e Xha Gorioit

Figura e tij është tragjike si e mbretit Lir të Shekspirit, por në këtë rast akoma edhe më tragjike.

Nëse mbretin Lir e pret njëra prej vajzave, Kordelia, Gorioi braktiset dhe nuk e pret asnjë. Dashuria pa kufij për të bijat i është kthyer në mani, gati-gati në vesin e tij.

Mospërfillja e bijave ndaj të atit është ves jo vetëm i tyre, por i një shoqërie që po degradon.

Kontrasti midis jetës që bënte Gorio kur kishte humbur gjithë pasurinë e tij dhe shkëlqimit të shoqërisë së lartë ku bënin pjesë vajzat, ishin për shkak të sakrificave që kishte bërë ai duke shitur gjithë pasurinë.

Dhe në fund të jetës së tij, ai vdes i vetëm në prani të një njeriu të panjohur.

- Personazhet dhe mjedisi

Marrëdhëniet personazh-mjedis jepen në varësi të njëra-tjetrës.

Personazhe tipike në rrethana tipike:

Xha Gorioi i varfër jetonte në hotelin e varfër.

Në shtëpinë e pasur të të bijave hynte nga dera e shërbëtorëve.

Rastinjaku, djali nga provinca, i cili nuk gjen veten në shoqërinë e lartë të kryeqytetit.

Përplasja e mentalitetit provincial, prej nga vjen Rastinjaku, me vetveten, por sidomos me familjarët e tij,

Përplasja mes mentalitetin cinik dhe meskin të shoqërisë dhe shkëlqimit të saj të rremë dhe naivitetit prej provinciali të Rastinjakut.

- Stili i Balzakut

Struktura e romanit zhvillohet në linja paralele, në pensionin Voker dhe në sallonet e shoqërisë së lartë.

Dramaticiteti i theksuar i ngjarjeve çon deri në tragjedi.

Përshkrimi i detajuar, sa disa kritikë e quajnë *stili proliks*.

Hapi 4. **Praktikë e drejtuar**

Nxënësit plotësojnë tabelën me personazhet dhe funksionin që kryejnë dhe idenë që përfaqësojnë.

Personazhi	Funksioni që kryen në roman	Ideja që përfaqëson
Xha Gorioi	Plak tashmë i varfër	Maninë e dashurisë pa kufi për të bijat
Vajzat e xha Gorioit	Shoqëria e lartë	Vesi i braktisjes së njerëzve të familjes
Rastinjaku	Një i ri provincial	Përjashtimin e tij nga jeta e kryeqytetit
Vortreni	Një ish i dënuar	Të keqen shoqërore,dhunën
z. Voker	E zonja e hotelit	Tipin mikroborgjez, të etur pas parasë.
z. De Bosua	E afërmja e Rastënjakut	Cinizmi i shoqërisë së lartë.
Bjanshon	Shoku i Rastënjakut	Rrugën e drejtë, ndershmërinë

Hapi 5. **Rrjeti i diskutimit**

Nxënësit diskutojnë mbi figurën e xha Goriot në marrëdhënien mes atij si baba dhe si biznesmen.

Si ka ndryshuar ky raport në kohën e njeriut modern?

Ky diskutim duhet parë në aspektin e lidhjes që ekziston midis parimeve të rrepta dhe aftësive menaxhuese të një prindi dhe një biznesmeni. A është toleranca dhe zemërgjerësia dobësi e babait apo e biznesmenit?

Në kohët moderne si është ky raport?

Prindi shihet si një burim i pakushtëzuar. Sot te fëmijët është bërë mani që t'u ofrohet gjithçka e gatshme në jetë nën pretekstin e përgjegjësive prindërore. Roli i prindërve sot është: udhëzues, këshillues apo ofrues?

Vlerësimi: Vlerësim i vazhduar për realizimin e detyrave të shtëpisë, për të menduarit kritik dhe njohuritë e marra.

Detyrat dhe puna e pavarur: Vështrim krahasues mes Gorioit dhe mbretit Lir.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda: Letërsi**	**Shkalla: V**	**Klasa: XI**
Tema mësimore: Studim teksti: Pensioni i zonjës Voker		**Situata e të nxënit:** Diskutim, studim teksti.	

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit

Kompetenca e të menduarit

Kompetenca qytetare

Kompetenca e të mësuarit për të nxënë

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: - diskuton mbi veçoritë realiste të romanit; - dallon tiparet realiste në përshkrimin e mjedisit; - shpjegon ndërthurjen e tipareve përshkruese të mjedisit me ato të përshkrimit të personazheve; - interpreton përdorimin e epiteteve, ironisë; - similitudave dhe enumeracionit në përshkrimin e asaj që quhet realizëm atmosferik.	**Fjalët kyçe:** Pension Zonja Voker Realizëm atmosferik Ekspozicion Mjedis Personazhe tipike Rrethana tipike
Burimet: libri i nxënësit, romani Xha Gorio etj.	**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** gjuhë shqipe, histori, arte etj.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme-Lexim e shpjegim-Diskutim-Punë e pavarur	

Organizimi i orës së mësimit

Hapi 1. **Lidhja e temës me temat e mëparshme.**

Nxënësit prezantojnë detyrat e shtëpisë dhe diskutojnë rreth tyre. Japin vlerësime për punën e njëri-tjetrit dhe në fund mësuesi/ja jep vlerësimet përfundimtare për to.

Do të realizohet lidhja e kësaj teme me temat e mëparshme meqë do të trajtohet si studim teksti për të njëjtën vepër "Xha Gorio".

Nxënësit përmbledhin njohuritë e tyre rreth realizmit si drejtim letrar.

Realizmi

- Paraqitja me saktësi dhe vërtetësi e realitetit shoqëror aktual.
- Paraqitja reale e karaktereve tipike të tipave shoqërore.
- Paraqesin tablo besnike të jetës shoqërore të epokës që jetonin.
- Gjuha e qartë dhe kuptueshme, e përshtatshme për personazhe të kategorive të ndryshme.
- Pasqyron kontradiktat më të thella të jetës.
- Krijojnë personazhe tipike në rrethana tipike.
- Heroi i veprës dhe fati i tij jepen të lidhur ngushtë me rrethanat shoqërore dhe temën që trajtohet.
- Shkrimtari duhet të jetë impersonal, nuk duhet të marrë pozicion.

Risitë që solli Balzaku me krijimtarinë e tij.

- Romani social;
- Realizmi atmosferik;
- Pasqyroi shoqërinë me gjithë mekanizmat që e vënë në lëvizje(para,pushtet,përfitim, akumulim);
- Migrimi i personazheve nga një vepër te tjetra;
- Personazhe që vuajnë nga monomania e cila u është kthyer në ide fikse që u është kthyer në pasion i cili i shkatërron.

Hapi 2. **Lexim dhe shpjegim.**

Lexohet fragmenti i fillimit të romanit ku autori bën një përshkrim detajues të mjedisit duke u ndalur në çdo detaj për të dhënë një tablo të plotë të mjerimit dhe papastërtisë që ka mbuluar këtë pension ku do të zhvillohet shumica dërrmuese e ngjarjeve.

Autori synon të bëjë një përshkrim të hollësishëm të këtij mjedisi pasi këtu do të përplasen personazhet kryesore të tij: Xha Gorio, Rastinjaku, Votreni, madje edhe të bijat e Gorioit.

Kjo përputhet plotësisht me prirjen realiste të autorit për të pasqyruar me objektivitet rrethanat e mjedisit në harmoni të plotë me personazhet e tij. Kjo varfëri dhe papastërti që qëndron në ambientin ku jetojnë, do të depërtojë edhe në jetët dhe shpirtrat e tyre.

Pjesa përbëhet nga tri përshkrime kryesore:

- Përshkrimi i pjesës hyrëse të pensionit, një dhomë me një varfëri, braktisje dhe erë tepër të rëndë.
- Përshkrimi i dhomës së ngrënies mes mbretërisë së skamjes që sundonte kudo dhe zhulit që hidhte shtresat e tij njëra mbi tjetrën.
- Përshkrimi i zonjës Voker i cili nuk mund të imagjinohej ndryshe nga sa e ka paraqitur Balzaku, pasi vetëm një portret i tillë i përshtatej ambientit të mësipërm.

Përshkrimi i ambientit është aq i detajuar sa të duket se para syve tanë po shfaqet një film dokumentar me temën e jetës së atyre viteve.

Hapi 3. **Punë e pavarur.**

Duke lexuar me kujdes fragmentin, nxënësit do të zbulojnë fragmentet më të detajuara që nxjerrin në pah karakteristikat e mjedisit. Plotësohet tabela e mëposhtme me shpjegimin përkatës për detajet më të rëndësishme dhe mjetet artistike që përdor autori.

Detajet kryesore të fragmentit	Shpjegimi i fragmentit	Mjeti artistik që përdor autori
Piktura e Kalipsosë... ka 40 vjet që kjo pikturë u shkas shpotive të të rinjve qiraxhinj... duke u tallur me drekën e mjerë që u shtron skamja...	Piktura e magjishme në mur është vendosur në këtë përshkrim për të thelluar hendekun midis dëshirës së qiraxhinjve dhe asaj që ofronte ky mjedis.	Ironia për at theksuar idenë e tij dhe varfërinë e mjedisit. Metonimia
Salla qelbet si han, si kazermë, si spital.	Autori e përforcon edhe më tej papastërtinë që mbizotëron kudo.	Krahasimi, polisidenti, shkallëzimi ngjitës.
...për të shpjeguar se sa të vjetra, të plasura, të kalbura, të shkallmuara...	Përshkrimi i hollësishëm i detajeve që e rëndon edhe më shumë gjendjen e mjedisit të lënë pas dore.	Enumeracion, epitete, shkallëzim ngjitës etj.
Është mbretëria e mjerimit	Sinteza e gjithë përshkrimit të autorit për një mjedis që ka kohë që pushtohet nga mjerimi dhe me sa duket do të sundojë gjatë.	Metafora
Znj. Voker, fytyra e plakur bullafiqe... hunda si sqepi i papagallit, fytyra e ftohtë si ngricat e vjeshtës. Ajo ka sy të ftohtë e të shpëlarë.	Pamja e padrones së këtij pensioni është përshtatur mjaft mirë me atmosferën që mbizotëron duke realizuar kështu realizmin atmosferik. Sytë që janë pasqyra e shpirtit janë të akullt ashtu si edhe shpiti i saj përfitues dhe manipulues.	Krahasimi Epitete

Hapi 4. **Diskutim.**

Balzaku shquhet për aftësitë e tij përgjithësuese. Si shfaqet kjo aftësi te ky fragment?

Vlerësimi: Vlerësim diagnostikues për disa nxënës dhe i vazhduar për disa të tjerë për aftësitë e zgjedhjes së detajeve tipike dhe shpjegimin e tyre.

Detyrat dhe puna e pavarur: Krijoni një minifjalor me fjalë dhe shprehje tipike të Balzakut.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

<table>
<tr><th>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</th><th>Lënda: Letërsi</th><th>Shkalla: V</th><th>Klasa: XI</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Studim teksti: Një djalosh pa përvojë</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Diskutim, bisedë, studim teksti</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit
Kompetenca e të menduarit
Kompetenca qytetare
Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
- diskuton mbi veçoritë e mënyrës së përshkrimit të personazheve në këtë fragment;
- identifikon detajet që pasqyrojnë shkëlqimin e rremë të mjedisit dhe imoralitetin e mbuluar nga fasada;
- shpjegon fazat nëpër të cilat kalon gjendja shpirtërore e personazhit kryesor;
- analizon gjendjet dhe sjelljet e personazheve nëpërmjet shembujve të përdorur;
- krahason personazhin e Rastinjakut me atë të Çajld Haroldit.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:
Student
Zonjë
Kont
Shoqëri e lartë
Xha Gorio</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: Teksti i nxënësit, vepra e plotë, kritika letrare.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: histori.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve
Analizë përmes shembujve-Diagrami i Venit-Praktikë e pavarur</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizimi i orës së mësimit
Hapi 1. Analizë përmes shembujve.
Ky fragment është shkëputur nga momenti i vizitës së Rastinjakut në familjen Dë Resto. Në këtë fragment pasqyrohet qartë hipokrizia në marrëdhëniet në familje e shoqëri, ku marrëdhënia në çift është thjesht një fasadë pas së cilës vlonte hapur tradhtia bashkëshortore.
Çifti Dë Resto jetonte mes cinizmit dhe hipokrizisë dhe përballë tyre vihet naiviteti dhe papjekuria e një djaloshi pa përvojë. Rastinjaku shkon të vizitojë Anastasinë, pa e ditur që ajo është e bija e Xha Gorioit me të cilin po jetonin së bashku në varfërinë ekstreme të pensionit. Për të fshehur prejardhjen e ulët shoqërore të saj, ajo e kishte braktisur të atin duke e vizituar vetën në çastet e saj të vështira për t’i kërkuar para për të mbuluar shpenzimet dhe borxhet e saj. Kjo pjesë bazohet në kontrastin midis fasadës së jashtme plot shkëlqim, etikë, sofistikim dhe cinizëm brenda saj, me naivitetin dhe mungesën e përvojës së Rastinjakut provincial që përpiqet të gjejë rrugën e duhur për të depërtuar në shoqërinë e lartë.
Aty, ai shikon se si tradhtia bashkëshortore pranohet hapur, ku bashkëshorti e toleron të dashurin e gruas dhe kur zbulohet e vërteta e Anastasias gjithçka përmbyset dhe etika merr fund.</td></tr>
</table>

Gjendja shpirtërore e Rastinjakut kalon nëpër katër faza:
- *Faza I* - është kur Rastinjaku përballet me ftohtësinë e Anastasias, pasi e kishte vizituar në një moment të papërshtatshëm. Ai ndihet i ndrojtur, i pavendosur dhe i ofenduar nga reagimet e tri personazheve të tjerë.
- *Faza II* - është kur përmendja e një mbiemri me titull ndryshon qëndrimin e dy personazheve të tjerë si me shkop magjik. Ratinjaku lehtësohet dhe gjallërohet.
- *Faza III* - Rastinjaku në bisedën e këndshme me Z. Dë Resto ndihet i sigurt dhe i kënaqur sepse po rrit shpresat e tij për t'u futur në shoqërinë e lartë.
- *Faza IV* - Pasi përmend Gorionë, dy personazhet e tjerë ndryshojnë qëndrim dhe Rastinjaku fillon të ndihet i turbulluar dhe i shqetësuar për situatën që krijoi.

Shembujt që ilustrojnë më së miri fragmentin dhe gjendjet shpirtërore të Rastinjakut:

Shembuj nga fragmenti	Analiza e shembujve
Znj. Dë Resto hyri fluturimthi... hodhi vështrimet ne ftohta e pyetëse.	Me anë të ndajfoljeve dhe mbiemrave epitete, jepet natyra e saj zotëruese, pasi nuk e realizoi qëllimin e saj për të larguar Rastinjakun.
Ky ndryshim si me anën e shkopit magjik...	Krahasimi së bashku me metaforën shërbejnë për të treguar tjetërsimin e qëndrimit të tyre pasi morën vesh mbiemrin e famshëm...
Shikonte kthjellët në atmosferën misterioze	Kontrasti midis naivitetit të Rastinjakut dhe hipokrizisë së shoqërisë së lartë.
.....emër të zbukuruar me fjalën *xha*	Autori ironizon për të treguar se Rastinjaku e përdori këtë fjalë për t'u mburrur me afërsinë me të, por në të vërtetë për çiftin Dë Resto ishte një ofendim i madh dhe do të vuloste përfundimisht prishjen e marrëdhënieve mes tyre.
Rastinjaku vështronte i skuqur, i turbulluar... Fytyra e Anastasias *ishte e ftohtë e thatë...* *tani ai e ndjente veten si një njeri ....*	Mbiemra për të përshkruar gjendjen shpirtërore të Rastinjakut dhe Anastasias. (epitete të përshkallëzuara). Krahasim i zgjatur, similitudë

Hapi 2. **Diagrami i Venit.**



- Të dy personazhet largohen nga mjedisi i tyre shoqëror të zhgënjyer nga realiteti dhe mentaliteti i prapambetur shoqëror.
- Rastinjaku është realist në mendimet dhe veprimet e tij. Për të hyrë në shoqërinë e lartë vendos të përdorë çdo mjet dhe të harrojë vlerat, dashurinë, humanizmin, ndershmërinë.
- Çajld Haroldi është romantik rebel, i zhgënjyer nga realiteti, ai nuk tjetërsohet si Rastinjaku, por lufton deri në fund kundër padrejtësive me shpirtin e tij human e rebel për të vendosur liri e drejtësi...

Hapi 3. **Punë e pavarur.** • Nxënësit punojnë me rubrikën: Fjala dhe përdorimi i saj. • Shpjegohet roli i dialogut. • Në fillim të fragmentit nuk krijohet dialog midis Rastinjakut dhe Anastasias pasi ajo me natyrën e saj kërkon ta shmangë. Më pas, dialogu që formohet mes Z. Dë Resto dhe Rastinjakut është ai që nxit rrjedhën e ngjarjeve dhe ndryshon gjendjen shpirtërorë të Rastinjakut.
• Por nuk ndodh kështu me Znj. Dë Resto, ku dialogu me të në këtë rast është tepër i shkurtër dhe i tensionuar, sipërfaqësor duke treguar mungesën e sinqeritetit të saj dhe dëshirën e Rastinjakut për t'u larguar. ❖ Nxënësit më pas shpjegojnë fjalët që shprehin mendime të ndryshme për Rastinjakun. --- Qëndrimi dhe biseda e Z. Dë Resto pasi merr vesh për mbiemrin e famshëm të Rastinjakut, fjalët, qëndrimet e tij. -- Në rastin tjetër jepet ndryshimi i fjalëve edhe i qëndrimit të tij pasi merr vesh që ai e njeh Xha Gorionë. - Dhe në fund të fragmentit ai i thotë Morisit të mos e pranojë më atë.
Vlerësimi: Vlerësim diagnostikues për disa nxënës dhe i vazhduar për disa të tjerë për aftësitë e zgjedhjes së detajeve tipike dhe shpjegimin e tyre.
Detyrat dhe puna e pavarur: Shkruani një ese me temë: "Hipokrizia e shoqërisë lufton vlerat dhe të renë në çdo kohë". Mblidhni material mbi romanin Evgjeni Grande, veçanërisht personazhin e plakut Grande.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda: Letërsi**	**Shkalla: V**	**Klasa: XI**
Tema mësimore: Studim teksti: Agonia e xha Gorioit		**Situata e të nxënit:** Diskutim, studim teksti.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca qytetare Kompetenca e të mësuarit për të nxënë			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: - diskutojnë mbi situatën në të cilën ndodhet xha Gorio; - dallon detajet që shprehin dilemat e tij, dhimbjen shpirtërore dhe adhurimin prindëror; - analizon dhimbjen dhe ndërgjegjësimin e xha Gorioit; - krahason dy figura etërish si plaku Grande dhe xha Gorio; - vlerëson mesazhin universal që përcjell Balzaku.		**Fjalët kyçe:** Ati Agoni Krim Braktisje Dhimbje Prindërim	

Burimet: Libri i nxënësit, vepra, kritika letrare.	**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Kjo temë lidhet me atë të orës së kaluar.

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve
Lexim i drejtuar-Punë në grupe-Vështrim krahasues

Organizimi i orës së mësimit

Parashikimi: Lexim i drejtuar, diskutim

Pasi lexohet fragmenti, nxënësit diskutojnë mbi momentet kryesore të këtij fragmenti.
Në këtë fragment pasqyrohen momentet e fundit të xha Gorioit, i ngelur vetëm dhe mbi kokë ka Rastinjakun dhe asnjë nga vajzat nuk u interesua për të. Në këto momente ai flet në përçart si në jerm duke shpërthyer në një monolog të dhimbshëm në dhomën e tij në katin e fundit, në të cilin është ngjitur vit pas viti pasi të bijat e shkatërruan nga pasuria, por kjo ngjitje shënon rënien e tij materiale dhe shoqërore. Ky moment do të jetë momenti i së vërtetës, ku ai do të analizojë gjithçka të mirë apo të keqe që ka bërë në jetën e tij. Në këtë gjendje ai ka ardhur vetëm nga një ndjenjë që iu bë ves, dashuria për vajzat e tij. Vërtet dashuria për fëmijën është e pakufishme, pasi as etërit nuk i zgjedhin fëmijët e tyre, dhe as fëmijët nuk i zgjedhin prindërit e tyre, ndaj kjo dashuri është e pakushtëzuar. Por në këtë rast ajo është e njëanshme, pasi vetëm babai i donte vajzat e tij dhe për to sakrifikoi jo vetëm paratë dhe pozitën e tij shoqërore, por edhe dinjitetin dhe jetën e tij. Ashtu si te mbreti Lir, braktisja e atit prej vajzave, është atëvrasje që prish gjithë ekuilibrat shoqërorë, pasi është lëkundur qeliza, boshti që mban shoqërinë, familja. Marrëdhëniet mes atit dhe bijave jepen në kulmin e shpërfytyrimit të familjes. Ato e deshën babanë derisa i zhvatën gjithë pasurinë. Por në thelb të karakterit të tij Gorioi është një baba egoist që në vend që t'i edukonte ato, e blinte dashurinë e tyre me para.
...i desha aq shumë sa prapë shkova te to, si ai kumarxhiu në bixhoz. Vajzat e mia ishin vesi im...
Kjo monomani e varësisë së dashurisë të babait ndaj vajzave është e ngjashme me një sëmundje patologjike që s'kishte shërim, ishte ves, por jo dashuri, sepse dashuria është një marrëdhënie reciproke, por xha Gorio vetëm ka dhënë dhe nuk ka marrë asgjë në këmbim.
...kaq e madhe ishte dashuria ime për to, saqë s'mbetej më vend për dashurinë e tyre ndaj meje...
Gjatë gjithë kohës, frika se mos humbasë të bijat ka qenë gjithmonë e pranishme dhe kjo e ka nxitur të blejë dashurinë e tyre.
Tipizimi i personazheve më shumë se kudo në roman shfaqet këtu në këtë fragment, dhe me këtë tipizim përgjithësues të Balzakut, Gorio shndërrohet në një baba të braktisur universal në çdo kohë e në çdo vend... *unë protestoj, atdheu do të shembet në qoftë se prindërit merren nëpër këmbë...*
Balzaku është mjeshtër në thellimin e detajeve dhe pikave dramatike të subjektit për t'i kthyer në pika kulmore. Në këtë agoni, ai herë kthjellohet dhe herë shkon në gjendje zjarrmie e përçartjeje, herë lutet, herë shan, herë kujton dhe gjykon, herë mallkon dhe në fund përsëri bekon sepse në fund të fundit ai është at.
Është tipike në agoninë para vdekjes së një njeriu,që frikësohet se mos vdes vetëm.

Ndërtimi i njohurive: Punë në grupe

Grupi i parë do të punojë me rubrikën: Analizo përmes shembujve.
Gripi i dytë do të punojë me rubrikën: Kuptim dhe shpjegim teksti.
Grupi i tretë do të punojë me rubrikën: Analizoni monologun e xha Gorioit nga ana gjuhësore të mbushur me fjali nxitëse, pyetëse, dëshirore në kontekstin e lutjes, forma urdhërore për t'i sjellë vajzat pranë, sharje, pasthirrma etj., dhe të shpjegojnë qëllimin e përdorimit të tyre në një shtrat vdekjeje.

Përforcimi i mësimit - Vështrim krahasues
Përballë njëri-tjetrit.



Të dy këto personazhe i përkasin realitetit Francez të kohës së Bazakut. Janë nga shtresat e ulëta të shoqërisë që u bënë të pasur nga rrethanat e kohës.
Janë personazhe tipike që jetojnë në rrethana tipike, por që kthehen në personazhe përgjithësues, universalë. Të dy këto personazhe kanë krijuar varësi nga monomanitë e tyre. Kjo mani e tyre u është kthyer në varësi si një sëmundje patologjike.

- Xha Gorioi nga dashuria për të bijat, e cila iu kthye në një ves, sakrifikoi gjithçka që zotëronte vetëm që të blinte dashurinë e tyre, pa e kuptuar se kështu i keqedukonte ato dhe shkatërronte veten. Deri në fund të jetës e bleu dashurinë e tyre me para dhe në fund vdiq i braktisur nga vajzat e tij.
- Plaku Grande kishte si mani dhe pasion të tij, paranë, fitimin. Për të grumbulluar sa me shumë para ai sakrifikon gjithçka, edhe veten e tij duke jetuar në kushte varfërie me kursim ekstrem, ndërkohë që paratë e tij sa vijnë e shtohen. Paraja është qëllimi i jetës së tij. Ajo ia ka veshur sytë dhe e ka zhveshur nga ndjenjat njerëzore. Përpara parasë ai nuk sheh asgjë edhe njerëzit e familjes, duke u kthyer ne një tiran në shtëpi.

Vlerësimi: Vlerësim diagnostikues për disa nxënës dhe i vazhduar për disa të tjerë për aftësitë e zgjedhjes së detajeve tipike dhe shpjegimin e tyre.

Detyrat dhe puna e pavarur: Rubrika: Detyra dhe këshilla. Mblidhni informacion mbi Floberin.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tema mësimore: Gustav Flober, jeta dhe vepra		**Situata e të nxënit:** Risitë e Floberit në letërsi, veprat kryesore.	

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit
Kompetenca e të menduarit
Kompetenca qytetare
Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: - diskuton në mënyrë individuale dhe në grup duke shkëmbyer informacion; - identifikon veprat kryesore të Floberit dhe risitë që solli ai në letërsi; - vlerëson rolin e Floberit në letërsinë realiste dhe veçanërisht në lëvrimin e romanit psikologjik.	**Fjalët kyçe:** Realist Natyralist Subjekt psikologjik Objektivizëm Impersonalizëm Bovarizëm
Burimet: libri i nxënësit, burimet e internetit, kritika letrare etj.	**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** gjuhë shqipe, histori, tik.

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve
Pema e mendimeve-Punë në grupe-Diskutim-Stuhi mendimesh

Organizimi i orës së mësimit
Parashikimi: Pema e mendimit



Ndërtimi i njohurive: Punë në grupe, diskutim

Grupi i parë: Jeta dhe arsimimi i Floberit
Grupi i dytë: Krijimtaria e tij
Grupi i tretë: Risitë që solli në letërsinë e realizmit

Grupi i parë: Jeta dhe arsimimi i Floberit

Etapat kryesore të jetës	Veprimtaritë
Fëmijëria	Kalloi një fëmijëri të qetë, lini në Ruan dhe jetoi në Kruase. Ndoqi liceun ku aty lexoi kryeveprat botërore.
Krijimet e para	"Kujtimet e një të marri", ku përshkruhet dashuria e adoleshencës dhe simboli i dashurisë i përjetësuar në romanin "Edukimi i ndjenjave".
Udhëtimet e para	Studimet në Paris dhe udhëtimet e shpeshta që bënte në Pirenej, Korsikë, Itali e frymëzuan për romanet: "Edukimi i ndjenjave". Tregime biografike etj.
Tërheqja në Kruase	Vdekjet e njerëzve të dashur e tërhoqën në shtëpinë e tij, ku priste shkrimtarë e artistë. Aty përjetoi dhe lidhjen e dashurisë me Luiz Kole. Mori pjesë në disa episode revolucionare të cilat e zhgënjyen. Filloi të shkruante romanin: "Tundimi i Shna Ndout".
Kryeveprat	Më 1856 botoi Znj. Bovari në një revistë dhe një vit më vonë e botoi në libër. Me këtë roman u hodh në gjyq për fyerje ndaj moralit. 1858 romani "Salambo", më pas romani "Edukimi sentimental". Në vitet e fundit punoi për romanin "Buvar dhe Pekyshe", i cili u botua pas vdekjes.
Vitet e fundit	U detyrua të shiste gjithçka **për të ndihmuar mbesën e tij.** Bashkë me gjendjen ekonomike u rëndua edhe gjendja shëndetësore, derisa goditja e një E një hemorragjie cerebrale i mori jetën.

Grupi i dytë: Flober shkroi në prozë. Ndarja e veprave sipas llojeve letrare.

Tregimet - Tregimet e para të tij kanë karakter autobiografik: "Një aromë ose akrobatët", "Zemërim dhe impotencë", "Pasion dhe virtyt", "Leksion i historisë natyrore", si dhe vepra "Tre tregime"

Romanet
"Edukimi i ndjenjave", "Znj. Bovari" "Tundimi i Shna Ndout", "Buvar e Pekyshe" satirë e hidhur.
Vepër me aspekte estetike dhe ekzotike: "Salambo".
Nxënësit e këtij grupi diskutojnë mbi tematikën dhe strukturën e këtyre veprave.

Grupi i tretë: Diskuton mbi risitë që solli Flober në letërsi.
Flober duke pasur prirje shkencore nga i ati punoi shumë me analizat e ftohta të ngjarjeve dhe personazheve

▪ Eksperimentoi me regjistra të ndryshëm gjuhe te kryeveprat e tij. ▪ Dallohen dy stile në krijimtarinë e tij nga njëra anë stili i zhveshur impersonal dhe nga ana tjetër proza pompoze, ritmike që rindërtonte qytetërime të largëta. Shpeshherë i alternon të dy stilet. ▪ Impersonalizmi ose pavetësia ishte një nga parimet bazë dhe ideali suprem është arti. ▪ Antiromantizmi shfaqej dukshëm dhe u bë tipar kryesor, objektivizmi është parimi tjetër i tij. ▪ Mjeshtër i realizmit ku shquhet për objektivitet të paraqitjes pa asnjë koment. ▪ Në veprën e tij ndihet një rrëfim i dyfishtë me dy ritme të kontraktuara dhe të zgjeruara. ▪ Vepra e tij dallohet par saktësi fjalë, efekte realiste dhe simbolike. **Përforcimi i mësimit: Diskutim** A mendoni se Flober në romanin "Znj. Bovari" i zotëron të tri teknikat e përshkrimit sipas natyralizmit, realizmit, realizmit kritik?
Vlerësimi: Vlerësim i vazhduar për njohuritë e zotëruara dhe për bashkëpunimin në grup.
Detyrat dhe puna e pavarur: Komentoni shprehjen: "Zonja Bovari jam unë"...

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda: Letërsi**	**Shkalla: V**	**Klasa: XI**
Tema mësimore: Analizë "Zonja Bovari"		**Situata e të nxënit:** Diskutim mbi subjektin, raportin e autorit me personazhet.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca qytetare Kompetenca e të mësuarit për të nxënë			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: - diskuton në grup dhe individualisht mbi temën e caktuar; - analizon strukturën e romanit dhe raportin e tij me personazhet; - vlerëson kontributin e Floberit dhe risitë që solli në letërsi.		**Fjalët kyçe:** Mjedis Marrëdhënie Stil Natyralizëm Roman psikologjik Bovarizëm Objektivizëm Impersonalizëm	
Burimet: teksti i letërsisë, fjalor, vepra e plotë.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** gjuhë shqipe, gjuhë e huaj, histori, tik.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Stuhi mendimesh-Pema e mendimit-Diagrami i Venit-Pyetje-përgjigje			

Organizimi i orës së mësimit

***Hapi 1.* Stuhi mendimi.**

Nxënësit lexojnë detyrat e shtëpisë duke interpretuar frazën e famshme të Floberit: "Ema Bovari jam unë". Për të shpjeguar këtë shprehje ata do të mbështeten tek antiromantizmi i Floberit, sipas së cilës përmbajtja nuk duhet të jetë kurrë subjektive, por objektive dhe e distancuar. Ai arrin deri në mazokizëm në shkatërrimin e një pjese ëndërrimtare të vetvetes, ndaj me këtë shprehje ai kërkon të shkatërrojë tiparin fantastik të romantizmit të projektuar te heroina e tij. Nga ana tjetër ai kritikon tek ajo një pjesë të vetes së tij.

Duke marrë shkas nga detyra e shtëpisë, nxënësit rikujtojnë njohuritë në lidhje me Floberin.

Mjeshtër i realizmit

Shquhet për metodën rigoroze të artit të tij.

Impersonalizmi ose pavetësia, ku shkrimtari duhet të jetë i distancuar, gati i padukshëm, pra duhet të ndihet, por jo të duket.

Realizmi i tij rigoroz shkon deri në antiromantizëm, por gjithmonë në shërbim të idesë së tij.

Stili i tij shquhet për një saktësi të madhe të fjalëve me të cilat përshkuan objektet, personazhet shpeshherë duke marrë vlerë simbolike.

***Hapi 2.* Pema e mendimit.**

Nxënësit diskutojnë mbi romanin, subjektin e tij, personazhet dhe përmbledhin njohuritë e tyre.

Pikënisja e romanit

Ky roman ndërtohet mbi një ngjarje të vërtetë,me vetëvrasjen e një gruaje e cila bëri bujë në shtypin e kohës, për mentalitetin e kohës, për tabutë që theu.

Lloji i romanit

Ky roman është një roman psikologjik, pasi ngjarjet rrëfehen mbi detaje që nuk tregojnë veprime por gjendje në brendësi të shpirtit të heroinës, madje edhe ngjarjet e jashtme paraqiten si refleks i asaj që ndodh në shpirtin e personazhit. Këtu do të shfaqet novatorizmi i Floberit, se këtu do të fillojë pikënisja e romanit modern.

Personazhet

Janë njerëz të zakonshëm të një epokë të palavdishme. Ema, Sharli, Leoni, Rodolfo, janë njerëz të zakonshëm që nuk bëjnë asgjë të veçantë. Autori i përshkruan ata në përditshmërinë e tyre.

Mjedisi

Subjekti vendoset në provincë atje ku liria e individit shihet si një dënim me vdekje dhe ku mentaliteti i prapambetur është mbytës. Shoqëria e provincës përbëhet nga njerëz me horizont të ngushtë, meskinë, pa ideale dhe projekte për jetën.

Raporti i autorit me personazhet

Autori në këtë rast duket sikur ka dalë jashtë objektivizmit dhe impersonalizmit, pasi ai i ka nxjerrë ata nga vetja e tij. Ema është personazh tip social dhe kulturori gruas në Francën e shek. të XIX. Ema përherë është romantike, ashtu si në thellësi të shpirtit të Floberit, është një dashuri për kohërat e largëta që ai është munduar ta rrënjosë thellë. Në shqetësimet e Sharlit shihet një jehonë e fëmijërisë së autorit.

Bovarizmi

Prirja e Emës për të ëndërruar dhe për t'u zhgënjyer pafundësisht na realiteti quhet bovarizëm. Ajo dëshiron të jetë ndryshe, kërkon një jetë tjetër e konceptuar sipas romaneve që e kishin edukuar. Ema e kërkon jetën tjetër në tradhtinë bashkëshortore, në ëndrrat e saj, duke i idealizuar dhe duke u bërë viktimë e ëndrrave të veta dhe e mentalitetit mbytës të provincës. Duke u zhgënjyer nga gjithçka dhe në pamundësi për të dalë nga situata ku ishte futur në borxhe

të mëdha, vendos të vrasë veten. Ajo e nis jetën si romantike dhe vdes si e tillë se nuk pranon të shohë jetën në sy dhe ta sfidojë atë.

Risitë e romanit

Ky roman shënon një kthesë të re në traditën e romanit realist të kohës duke krijuar traditën e një romani të ri, atë të natyralizmit, i cili qëndron më pranë realitetit dhe logjikë së personazheve. Ema nuk mund të quhet as pozitive as negative, por thjesht njeri me në kuptimin e plotë të fjalës.

Hapi 3. **Diagrami i Venit.**



Përshkrimi që autori i bën Emës jo pa qëllim fillon me edukimin e saj në kuvendin e murgeshave, pasi kuvendi me rregullat e tij të rrepta do të ishte burgu i parë i saj shpirtëror. Viktimë e ëndrrave të saj, me botën e saj të vogël të librave që kishte lexuar, duke e shndërruar realitetin e saj në fiction, si në librat që ka lexuar, ndaj kritika me të drejtë e quan variantin femëror të Don Kishotit.

Të dy personazhet i bashkon ëndërrimi, shndërrimi i realitetit si realiteti i romaneve kalorësiakë të Don Kishotit dhe romanet romantike të Emës.
Por Don kishoti kërkonte të vendoste drejtësi në botë duke u bërë altruist, kurse Ema ishte egoiste, nuk mendonte se me ëndërrimet e saj dhe tradhtinë bashkëshortore, nuk do të dëmtonte vetëm veten, por edhe njerëzit e saj të dashur, që pothuajse i kishte harruar që ekzistonin.

Hapi 4. **Pyetje-përgjigje.**

Cila është arsyeja e ëndërrimeve të Emës?
Pse Ema është një personazh universal?
Ç'pjesë të personalitetit të Floberit nxjerr në pah Ema?
Cili është raporti që vendos Floberi me personazhet e tij?
Pse vepra e Floberit është paraardhëse e kohëve moderne?

Vlerësimi: Vlerësim i vazhduar për njohuritë e zotëruara dhe për bashkëpunimin në grup.

Detyrat dhe puna e pavarur: Përshkruani romantizmin e Emës duke ndjekur ndjenjat dhe veprimet e saj.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tema mësimore: Studim teksti: Mërzia		**Situata e të nxënit:** Studim teksti	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca qytetare Kompetenca e të mësuarit për të nxënë			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: - diskuton mbi fragmentin dhe paralajmërimin e asaj që do të ndodhë; - dallon gjendjen shpirtërore të Emës dhe zbulon shkaqet e saj; - zbulon detajet përshkruese që ilustrojnë mërzinë nga monotonia; - analizon marrëdhënien që krijon autori me personazhet e tij; - vlerëson stilin e shkrimtarit dhe saktësinë e gjuhës.		**Fjalët kyçe:** Mërzia Ema Sharli Provincë Monotoni Trishtim Largim	
Burimet: Libri i nxënësit, vepra.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** gjuhë shqipe, filozofi, psikologji.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Lexim-shpjegim-Pyetje-përgjigje-Ditar dypjesësh-Tabela e figurave			

Organizimi i orës së mësimit

Hapi 1. **Lexim dhe shpjegim.**

Nxënësit lexojnë detyrat e shtëpisë ku nëpërmjet përshkrimit kanë portretizuar Ema Bovarinë nisur nga përjetimet e saj dhe nga raporti i autorit me të.

Lexohet fragmenti: Mërzitja

Fragmenti pasqyron në mënyrë të qartë e të hollësishme**, sëmundjen patologjike** t**ë Emës, mërzin**ë**, trishtimin, pasi** ajo priste me padurim që diçka të ndodhte dhe ajo nuk po vinte. Asgjë e jashtëzakonshme, aventurore, fantastike që ajo priste të ndodhte nuk po dukej dhe tani ajo e kuptoi "asgjënë" që po jetonte. Gjithçka prej saj shihej me trishtim dhe me sy kritik. Autori aq detajues e rigoroz në përshkrim, ka arritur të kapë elemente që plotësojnë tablonë e monotonisë. Çdo gjë i dukej si e ngrirë dhe e palëvizshme.

Paragrafi i dytë paralajmëron me korridorin e errët dhe derë e pahapur, një të ardhme të paqartë dhe të padëshiruar për të jetuar dhe duket se këto po afrojnë fundin tragjik të Bovarive.

Përshkrimi dhe mjedisi

Romanet realiste janë tipike në përshkrimin e detajeve që përcaktojnë gjendjet shpirtërore të personazheve. Përshkrimi kalon në këto mjedise:

- Mjedisi në shtëpi.

Ema mërzitet me gjithçka në shtëpi, sa ajo i la të gjitha muzikën, vizatimet, qëndisjen.

- Mjedisi jashtë.

Ky mjedis e përforcon mërzitjen e Emës. Një jetë monotone fshati, ku të gjithë jetojnë të programuar duke bërë çdo ditë të njëjtat gjëra. Në kontrast me të tjerët, për të cilët e diela është një ditë e gëzueshme, për Emën ajo është një ditë si gjithë të tjerat, njësoj e mërzitshme.

- Kopshti i shtëpisë.

Zakonisht te romantikët, kopshti ishte një mjedis ku ëndrrat bëheshin realitet. Por për Emën asgjë nuk lëvizte, ishte si e përgjumur.

- Veprimet e njerëzve.

Gjithçka jepet e programuar si një film i regjistruar që shfaqet herë pas here.

- Muzika e organos, ishte e vetmja që e shkëputste nga realiteti, po kjo e thellonte më shumë trishtimin.
- Marrëdhëniet me Sharlin.

Çdo gjë që bënte Sharli e nervozonte. Fakti që ata qëndrojnë në një tavolinë dhe nuk kishin dialog, tregon se kjo monotoni ishte edhe në marrëdhëniet e tyre në çift. Autori në mënyrë mjeshtërore ka reduktuar dialogun për të treguar se dashuria mes tyre kishte përfunduar (nëse kishte pasur ndonjëherë).

- Buqeta e martesës.

Ajo i shpoi gishtat si një vjeturinë që të sjell veç probleme. Hedhja e saj në zjarr është një veprim i egër që tregon kulmin e zhgënjimit të saj nga martesa.

Hapi 2. **Pyetje-përgjigje.**

A përkon zvarritja e fjalisë së parë me titullin e pjesës?
Pse gjendja emocionale e Emës merr rëndësinë dielën?
Cila është pika kulmore e fragmentit?
Cilat janë raportet që vendosen midis pamjeve të kopshtit dhe të dhomës?
Si shpjegohet përdorimi i ligjëratës së drejtë nga autori?

Hapi 3. **Ditar dypjesësh.**

Nëpërmjet detajeve të fragmentit do të shpjegohet gjendja emocionale e Emës.
Nxënësit plotësojnë tabelën.

Detajet e fragmentit	Shpjegimi
Ditët do të pasonin njëra-tjetrën...	Mungesa e diçkaje të papritur, krijimi i monotonisë. E bëjnë Emën që të kuptojë realitetin gri që po jeton.
Përse të merrej me të? Kush e dëgjonte? Ç'i hynin në punë?	Pyetje pa përgjigje për të nënkuptuar mungesën e dëshirës për të vazhduar këtë monotoni.
Sa e trishtuar ishte e diela kur binin kambanat...	E diela me ritualin fetar të meshës nuk e afronte Emën me Zotin, por ia bënte ditën më të mërzitshme, aq me tepër për të tjerët kjo ditë ishte e gëzueshme, kurse për të jo.
Në kopsht nuk dëgjohej asnjë cicërimë zogu...	Lidhja me natyrën nuk ia ndryshonte aspak mërzinë Emës romantike.
Ëndërrimet nga muzika e organos e çonin sa në një ëndërr në tjetrën, sa në një trishtim në tjetrin.	Edhe ëndërrimet e romaneve të lexuara ia shtonin edhe më shumë trishtimin.
E hodhi buqetën në zjarr. U dogj si një fije kashte.	Ky detaj tregon fundin e marrëdhënies së tyre dhe paralajmërimin për atë që do të ndodhë më vonë.

Hapi 4. **Tabela e figurave.**

Në përshkrimin e mjedisit dhe gjendjes së Emës, autori ka përdorur epitete dhe krahasime për të përshkruar detajet ,si edhe metaforat dhe kontrastin për të treguar raportin mes ëndrrës dhe realitetit.

Figurat	Fragmenti
Epitete	E zhytur në gjumë, korridor i errët, tastierën e fildishtë, muzika e përvajshme
Krahasime, similituda	Si ndonjë fllad, si nëpër xhama akulli, si bimët rrëzë murit, hardhia si ndonjë gjarpër, sikur ia shtronin aty në pjatë hidhërimin e saj, si ndonjë kaçube me hi...
Metafora	...Ngriheshin nga vesa dantella të argjendta, afshe neverie, u zhdukën fluturimthi
Kontrasti	Duke u endur sa nga njëra ëndërr te tjetra nga njëri resh-tim te tjetri.

Vlerësimi: Vlerësim i vazhdueshëm për njohuritë e tyre, për të shprehurit e mendimit të tyre të pavarur e kritik.

Detyrat dhe puna e pavarur: Krahasoni detajet e përshkruara në libër me ato të ekranizuara në film.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda: Letërsi**	**Shkalla: V**	**Klasa: XI**
Tema mësimore: Studim teksti: Panairi bujqësor		**Situata e të nxënit:** Diskutim, studim teksti	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca qytetare Kompetenca e të mësuarit për të nxënë			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: - identifikon në fragment atmosferën që mbizotëron; - analizon ndodhitë gjatë panairit që zbulojnë veçoritë e epokës që pasqyron autori; - shpjegon satirën e përdorur nga autori dhe qëllimin e saj; - përshkruan pasqyrën e shoqërisë së kohës dhe mentalitetin konservator.		**Fjalët kyçe:** Panair Iluzione Kujtime Çmime Satirë	
Burimet: Libri i nxënësit, vepra e plotë.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** histori, gjuhë shqipe, bujqësi.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Lexim dhe shpjegim teksti-Praktikë e drejtuar-Ditar dypjesësh-Tabela e figurave-Praktikë e pavarur

Organizimi i orës së mësimit

***Hapi 1.* Lexim dhe shpjegim teksti.**

Lexohen detyrat e shtëpisë dhe nxënësit diskutojnë mbi to.

Lexohet fragmenti në libër dhe së bashku me mësuesin/en diskutojnë duke e shpjeguar.

Fragmenti është shkëputur nga panairi bujqësor, ku në mënyrë sporadike autori vendos paralelisht fjalimet e oratorëve në panair me deklaratat e dashurisë së Rodolfos. Ema pëlqehet nga meshkujt dhe pas një idili që pati me Leonin, me të cilin i bashkoi shpirti romantik, ngelet përsëri e dëshpëruar, pasi ai u largua pa shpjegim, duke treguar natyrën e tij egoiste. Ndërkohë, Rodolfo, një beqar 40 vjeçar, duke parë natyrën ëndërrimtare të Emës, i shfaq deklaratat e tij të dashurisë. Autori ka arritur të gërshetojë fjalorin banal të panairit rreth çmimeve për shitjen e plehut, për dashin merinos, për racën e derrave, me shprehjen e ndjenjave sentimentale të Rodolfos, duke nxjerrë më shumë në pah shtirjen e tij. Në dukje, atmosferat nuk kanë lidhje me njëra-tjetrën, por arti i Floberit i gërshetoi bashkë. Fragmenti është detajues, ku bashkë me idilin e Rodolfos dhe Emës,bëhet edhe pasqyra e realitetit të kohës, si nga ana e mënyrës së organizimit të jetesës, marrëdhëniet shoqërore, paragjykimet mbytëse. Detajet të japin idenë e një shoqërie ku mbizotëron vëllazërimi, barazia e harmonia, por ajo përmbyset në fund të fragmentit, ku gjithçka tregon që është fasadë. Të gjitha u kthyen në hierarkinë e tyre, ku pronari shfrytëzon shërbëtorin e këta kafshët, e të gjithë përpiqen të shprehin pushtetin e tyre mbi inferiorët.

Fragmenti mbyllet në mënyrë groteske me figurën qesharake të gardës kombëtare. Autori me detaje satirike kritikon realitetin e kohës, i cili me cinizmin e hipokrizinë e tij ndërton thjesht fasada duke ndrydhur dëshirat dhe pasionet me mentalitetin konservator.

***Hapi 2.* Praktikë e drejtuar.**

Nxënësit do të ndajnë pjesën në paragrafë në bazë të paraqitjes së ideve.

Paragrafi i I: Tablo e panairit bujqësor me detaje tipike të mbushura me zhurmat e kafshëve, fjalët e njerëzve, fjalimet që si dëgjon kush.

Paragrafi II: Idili i Rodolfos me Emën ku ai bën edhe një pasqyrë të mentalitetit të prapambetur të kohës.

Paragrafi i III: Ema zhytet në kujtimet e së shkuarës, duke marrë shkas nga detaji i aromës dhe karrocës.

Paragrafi i IV: Jep gërshetimin e deklaratave të Rodolfos me fjalimin e kryetarit.

Paragrafi i V-VI: Autori shkëputet nga idili duke pasqyruar fasadën vëllazërore të panairit dhe mentalitetin konservator e hipokrit.

Hapi 3. **Ditar dypjesësh.**

Fragmenti	Komenti
...Shkelen me këmbë e poshtërohen instinktet më fisnike, simpatitë më të çiltra...	Nëpërmjet fjalëve të përzgjedhura me kujdes të Rodolfos, tregohet mentaliteti konservator e mjedisi mbytës.
Duke parë rrugës, vuri re Dallëndyshen karrocën me të cilën vinte Leoni ta takonte e me atë iku e s'u kthye më...	Kujtimet e së shkuarës, detaji i karrocës e zhyt Emën në botën e ëndërrimeve dhe e bëjnë që ta shikojë realitetin e Rodolfos të tjetërsuar.
Djali i ri i shpjegonte vajzës së re se nëpërmjet largësisë që na ndante si dy lumenj që rrjedhin pranë...	Këto deklarata romantike të Rodolfos janë tipike si frazat e romaneve që Ema i lexonte dhe Rodolfo, si mjeshtër i mashtrimit të grave, dinte si t'i përdorte ato.
Mitingu kishte mbaruar, turma u shpërnda, dhe tani që ishin mbajtur fjalimet, secili zinte atë rang që kishte në shoqëri...	Shfaqja e barazisë dhe e vëllazërisë falco mbaroi dhe përsëri hierarkia filloi të shfaqej si më parë.

Hapi 4. **Tabela e figurave.**

Figura	Komenti
...instinktet më fisnike, simpatitë më të çiltra, dy shpirtra të gjorë... epitete	Të shprehura me mbiemra në shkallë sipërore, për të shprehur intensitetin e ndjenjës në presionin e mentalitetit mbytës.
Ajo shquante në sytë e tij rreze të vogla të arta që shkëndijonin... metaforë	Në sytë e Rodolfos, Ema shihte ndryshimin, shpresën për diçka tjetër, që do ta nxirrte nga asgjëja që e rrethonte.
Si dy lumenj që rrjedhin për t'u bashkuar... Unë do të jem në jetën tuaj si një hije kalimtare... ajo dridhej si një turtulleshë e kapur... krahasime, similituda.	Mënyra e shprehjes së ndjenjave të tyre janë tipike për romanet romantikë. Rodolfo i shfrytëzon mjaft mirë dhe Ema vazhdon të ëndërrojë.

Hapi 5. Praktikë e pavarur.

Nxënësit do të punojnë me rubrikën: Fjala dhe përdorimi i saj.

Vlerësimi**:** Vlerësohen nxënësit për mënyrën e të nxënit të njohurive, për aftësitë e të shprehurit dhe mbi të gjitha të argumentuarit.

Detyrat dhe puna e pavarur: Organizoni një debat me temë: Ema Bovari viktimë apo fajtore? Shkruani një dialog tjetër mbi dy personazhet të vendosura në një mjedis tjetër.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tema mësimore: Bisedë letrare Realizmi, karakteristikat, analizë romani: "Evgjeni Grande"		**Situata e të nxënit:** Rëndësia e letërsisë realiste, Sfondi historik, përfaqësuesit kryesorë, analizë vepre.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca qytetare Kompetenca e të mësuarit për të nxënë			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: - diskuton mbi kontekstin historik dhe letrar të realizmit; - identifikon karakteristikat dhe parimet e realizmit; - analizon një vepër përfaqësuese të këtij drejtimi letrar; - vlerëson rolin e kësaj rryme në jetën shoqërore të kohës.		**Fjalët kyçe:** Realizëm Objektivizëm Pozitivizëm Personazhe tipikë Rrethana tipike	
Burimet: tekste letrare, kritika letrare, interneti, vepra e plotë.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** histori, gjuhë shqipe, filozofi, tik.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Diskutim-Ritregim-Shkrim funksional			

Organizimi i orës së mësimit

Kjo bisedë letrare do të zhvillohet për drejtimin e realizmit.

Hapi 1. **Diskutim, Stuhi mendimesh.**

Nxënësit do të diskutojnë mbi drejtimin letrar të realizmit, duke i përmbledhur njohuritë e tyre në skemën e mëposhtme.



Hapi 2. **Ritregim, analizë e veprës "Evgjeni Grande".**

Nxënësit diskutojnë për subjektin e romanit duke e ritreguar atë. Më pas do ta analizojnë atë sipas: Subjektit, temës, personazheve, vlerave artistike.

- Mjedisi, provinca Somyr në familjen Grande.
- Tema është forca shkatërruese e parasë.
- Konflikti kryesor: Përplasja e atit me të bijën e adhuruar.
- Motivi qendror: Dhembja për mosshpërblimin e virtytit të viktimave të shoqërisë grabitqare.
- Personazhet: Evgjeni Grande
- Në qendër të romanit qëndron portreti i një vajze të re, me botë të pasur njerëzore dhe altruiste, por është e rrethuar nga njerëz me synime kontradiktore. Në fillim të romanit, ajo na paraqitet si një vajzë e brishtë dhe e ëmbël e cila nuk e njihte realitetin e ashpër. Dashurohet me pasion me Sharlin, por përplasja me të atin, për paratë e humbura, vdekja e nënës, pritja pa shpresë e Sharlit, e përndjekur nga gabimi i saj, e tjetërsojnë. Në fund, e martuar pa dashuri, ajo e ngrys jetën e vetmuar, e ve, duke u kthyer në një trashëgimtare të denjë të të atit, pasi e kuptoi që virtyti nuk mund të mbijetonte.
- Plaku Grande.

Grande plotëson tablonë e tipave koprracisë të pasqyruar me shumë mjeshtëri. Ky personazh është dhënë në evoluim, rruga e tij nga vozaxhi në një fajdexhi të pasur, duke shfrytëzuar të gjitha rrugët për të shtuar pasurinë.

Ndryshimet e mëdha të gjendjes shoqërore u shoqëruan me ndryshime të mëdha në statusin mendor dhe shpirtëror... sa më shumë e shtonte pasurinë, aq më shumë koprrac bëhej. Etja e çmendur për pasuri e ka zhvendosur në shpirtin e tij çdo ndjenjë njerëzore dhe e ka shndërruar në një mostër.

- Sharl Grande

Nipi i Grandesë i cili, megjithëse i rritur në një mjedis fajdexhinjsh, në shpirt kishte ngelur i pastër, dashurohet çiltërsisht me Evgjeninë, por dëshira për t'u pasuruar sa më shpejt, e ktheu atë në një njeri të ftohtë, duke e braktisur Evgjeninë dhe duke u martuar me një vejushë të pasur.

➢ Ideja Balzaku ka trajtuar me mjeshtëri në këtë roman idenë e madhe se rritja e rolit të parasë në jetën shoqërore sjell ndryshime rrënjësore në zakonet, sjelljet dhe në karakterin e njerëzve. ➢ Vlerat artistike Në këtë roman, Balzaku arrin të ndërthurë në mënyrë organike përshkrimin e karakteristikave të personazheve me kontradiktat shoqërore që veprojnë në rrethana të përcaktuara qartë. Pena e Balzakut arrin të jetë bujare në përshkrimin e virtyteve njerëzore, por është akoma më e rreptë në demaskimin e veseve. ***Hapi 3.*** **Shkrim funksional.** Mënyra e tipizimit të personazheve dhe dukurive të jetës prej Balzakut është një gur themeli në realizëm. Përshkruajeni me shkrim këtë mënyrë tipizimi duke e ilustruar me shembuj**.**
Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për m**ënyrën e të nxënit të njohurive**, për aftësitë e t**ë** shprehurit dhe mbi të gjitha të argumentuarit.
Detyrat dhe puna e pavarur: Mblidhni materiale rreth Dostojevskit dhe ndërtoni nj**ë** referat.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda: Letërsi**	**Shkalla: V**	**Klasa: XI**
Tema mësimore: Testim për tremujorin e dytë		**Situata e të nxënit:** Studim teksti, analizë vepre	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: - dallon tiparet kryesore të Rilindjes shqiptare dhe të Romantizmit shqiptar në fragmentet e dhëna; - identifikon parimet kryesore të Realizmit dhe Natyralizmit në fragmentet e veprave të Balzakut dhe Floberit; - komenton dhe interpreton mbi fragmentet e pasqyruara në test duke pasqyruar nivelin e njohurive të tyre dhe mendimin e tyre kritik; - analizon mbi veçoritë e stilit të këtyre autorëve; - vlerëson rolin e personazheve të realizmit si personazhe universalë.		**Fjalët kyçe:** Romantik Motivi atdhetar Ligjërimi i pasur Realizëm Objektivitet Pavetësi Tipizim	

Burimet: Libri i nxënësit, burime nga interneti, kritika letrare.	**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** gjuhë shqipe, histori, tik.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Prezantim-Diskutim-Punë e pavarur	

Organizimi i orës së mësimit

Hapi 1. **Prezantim-Diskutim.**

Prezantohen tezat me fragmentet mbi të cilat do zhvillohet testimi për periudhën e romantizmit shqiptar dhe realizmit evropian.

Pyetjet do të ndërtohen mbi autorët kryesorë si: De Rada, Naim Frashëri, Balzak, Flober.

Diskutime dhe sqarime rreth tyre për pyetjet e testeve.

Pyetjet janë ndërtuar sipas niveleve të të nxënit dhe janë me alternativa, me shtjellim dhe në formë analize dhe interpretimi.

Hapi 2. **Punë e pavarur.**

Nxënësit do të punojnë në mënyrë të pavarur për rreth 45 minuta.

Hapi 3. **Mbledhja dhe vlerësimi i testeve.**

Model testi

Për pyetjet e mëposhtme rrethoni alternativën e saktë.

Çdo përgjigje e saktë vlerësohet me një pikë.

1- Romantikët shqiptarë himnizuan:
- **a.** Natyrën folklorike
- **b.** Natyrën aristokratike
- **c.** Natyrën shqiptare

2- Letërsia romantike arbëreshe thelloi karakterin:
- **a.** Mitologjik dhe folklorik
- **b.** Patriotik dhe demokratik
- **c.** Politik dhe shoqëror

3- Romani në vargje "Këngët e Milosaos"i përket llojit:
- **a.** Epiko-dramatik
- **b.** Epiko-tragjik
- **c.** Epiko-lirik

4- Cili është mesazhi në vargun deradian... "Bie, por s'dua të fle"..:
- **a.** Pikëllimin
- **b.** Lumturinë
- **c.** Lodhjen

5- Naim Frashëri solli i pari në letërsinë shqipe poezinë:
- **a.** E mirëfilltë lirike
- **b.** E mirëfilltë filozofike
- **c.** E mirëfilltë meditative

6- Tipizimi i personazheve është veçori e krijimtarisë së:
- **a.** Balzakut
- **b.** Floberit
- **c.** Zolas

7- Migrimi i personazheve është veçori e stilit të:
- **a.** Floberit
- **b.** Balzakut
- **c.** Dostojevskit

8- Përmblidhni në diagramin e Venit dallimet kryesore dhe të përbashkëtat midis romantizmit shqiptar dhe romantizmit evropian.



5 pikë

9- Në poemën "Këngët e Milosaos" elementet e natyrës jepen në paralelizëm me gjendjet shpirtërore.
- **a.** Gjeni këto elemente në fragmentet e shkëputura.
- **b.** Interpretoni fjalën kyç lis në këngën e parë dhe të fundit.
- **c.** Analizoni një veçori të stilit që dallohet në këto fragmente.

Bota kish ndërruar lisa
Ujët të ri në det
Kaltëronte n' ditën e re.

Bie po s'dua të fle
mos e mbyll ti derën
Le të hyjë era e detit
Vodhit
Të më freskojë
Të hyjë dielli i pafajshëm

Fryjti erë e maleve
e rrëzoi hijen e lisit
gjaku im te lumi i

a. Elementet e natyrës---------- 3 pikë

b. Fjala lisës---------- 2 pikë

c. Veçoritë e stilit---------- 2 pikë

10- Në poezinë filozofike të Naim Frashërit "Fyelli" analizoni duke e ilustruar me vargje:

a. Simbolikën e fyellit---------- 1 pikë

b. Simbolikën e zjarrit---------- 3 pikë

c. Konceptin e metempsikozës---------- 2 pikë

gjithë bota më dëgjojnë O rrëmet i njerëzisë O more zjarr i bekuar
po së jashtësmi më njohin zëri i fyellit s'është erë unë me ty jam përzjerë
dëshirën s'ma kuptojnë ky është zjarri i dashurisë pa jam tretur e kulluar
zjarrin e brendshëm s'ma njohin që i ra kallamit të mjerë po të kam shpirt mos më lër.

11- Romani "Xha Gorio"është një gur themeli në krijimtarinë e Balzakut. Në fragmentin e mëposhtëm
analizoni:
a- veçoritë e tipizimit të personazhit 2 pikë
b- personazhin universal 1 pikë
c- mesazhet universale shoqërore e familjare 2 pikë

.....Vajzat ,vajzat e mia. Dua t'i shoh. Dërgoni t'i merrni me policë,me forcë! Drejtësia është me mua, të gjithë me mua janë, natyra, Kodi civil. Unë protestoj! Atdheu do të shkatërrohet, në qoftë se prindërit merren nëpër këmbë .Kjo është e qartë. Boshti, rreth të cilit sillet shoqëria është atësia: të gjitha do të shemben, në qoftë se fëmijët nuk i duan prindërit e tyre...

12- Interpretoni termin **"bovarizëm".** Pse Ema Bovari është cilësuar si Don Kishoti fem ër? 2 pikë

Tabela e vlerësimit

Pikët	0-7	8-11	12-15	16-19	20-23	24-27	28-32
Nota	4	5	6	7	8	9	10
Niveli	I	II	II	III	III	IV	IV

Vlerësimi: Vlerësimi individual me notë

Detyra: Përgatitje për bisedën letrare. Analizë romani: "Evgjeni Grande".

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 54 Dt.___/____/__

<table>
<tr><th>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</th><th>Lënda: Letërsia</th><th>Shkalla: V</th><th>Klasa: XI</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Bisedë letrare.
“Vëllezrit Karamazov” Fjodor Dostojevski</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Nxënësi njeh dhe kupton rrethanat në të cilat lindi vepra si dhe percepton karakteristikat e letërsisë realiste.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
Kompetenca e të mësuarit për të nxënë
Kompetenca personale
Kompetenca qytetare
Kompetenca digjitale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
- tregon me fjalët e tij subjektin duke e ilustruar me detaje dhe shembuj nga teksti;
- demonstron njohje të kontekstit historik, kulturor, ekonomik, politik, shoqëror në të cilin është shkruar teksti;
- përshkruan dhe analizon mjedisin dhe kohën (koha, vendi, detajet fizike, situatat);
- analizon dhe interpreton elementet e përmbajtjes dhe të formës së tekstit, si: tema dhe motivet, idetë, rrëfimtari, marrëdhëniet mes personazheve, fabula dhe subjekti;
- analizon personazhet duke u bazuar në përshkrimet e autorit dhe mendimet, fjalët, veprimet, bindjet e tyre.
- analizon se si ndryshon ose zhvillohet një personazh;
- reflekton, në mënyrë kritike, përmes analizave, interpretimit, vlerësimit dhe sintezës së tekstit.</td><td>Fjalët kyçe:
Roman tragjedi
Vepër voluminoze
Realizëm
Psikologji
Krim
Udhërrëfyes i modernizmit
Larmi personazhesh
Frazë e goditur
Sentenca kuptimore</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet:
Vepra e plotë, interneti, studime kritike ndaj veprës, analiza të veprës letrare.</td><td>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:
arte, histori, gjeografi, TIK, arte, gjuhë shqipe.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Prezantim, përmbledhje e strukturuar-Diskutim-Pyetje-përgjigje- Ditar dypjesësh
Ritregim-Shkrim funksional-Të shkruarit tregues, përshkrues, shpjegues</td></tr>
</table>

Organizim i orës mësimore

***Shënim*:** Nxënësit gjatë kësaj ore mësimore do prezantojnë punën e tyre sipas detyrave paraprake individuale apo në grup, sipas modelit të mëposhtëm:

Detyra individuale për çdo nxënës:

Kartela e tekstit:
Autori: Fjodor Dostojevski
Rryma letrare: Realizmi.
Shkurtimisht karakteristika të letërsisë realiste.

Rrethanat e formimit të botëkuptimit të shkrimtarit.

Rrethanat: jeta tragjike, por vepra me vlera të mëdha

Jeta momentet kryesore që ndikuan në krijimtari

Veprimtaria ea utorit

Fabula dhe Subjekti: Nxënësi rrëfen shkurtimisht fabulën e romanit.
Struktura e tekstit:
Kompozicioni i jashtëm: Pjesët përbërëse
Kompozicioni i brendshëm:
Temat
Linjat
Motivet
Rrëfimtari: Lloji rrëfimtarit

Një ese me temë "Krijimtaria e Dostojevskit dhe vendi i saj në letërsinë botërore".

Detyrat e dhëna sipas punëve në grupe

Grupi i parë: Përshkruaj sfondin në të cilin zhvillohen ngjarjet.

Sfondi	
fizik-mjedisi ku zhvillohen ngjarjet	
historik	
kulturor	
politik	
social	
filozofik	

Grupi i dytë: Sistemi personazheve: Klasifikoji ata dhe trego si i prezantohen marrësit.

Sistemi personazheve	
Klasifikimi i tyre: Roli, funksioni	
Planet në të cilat prezantohen	
Marrëdhëniet mes personazheve	
Trajtat e ligjërimit dhe mjetet me anë të të cilave prezantohen.	

Si prezantohen te marrësi personazhet	
vetzbulohen nga mënyra si mendojnë, veprojnë	
zbulohen gjatë dialogut	
zbulohen nga personazhet e tjerë	
nga vetë rrëfimtari	
Si jepen	
njëherazi	
shkallë-shkallë	

Grupi i tretë: Analizo veçori të gjuhës së veprës.

Gjuha	**Veçori**
Aspekte themelore të gjuhës në nivelin:	
Leksikor	
Morfologjik	
Sintaksor	

Grupi i katërt: Pasi të keni identifikuar mjetet stilistike shpjego kuptimin dhe funksionin e përdorimit të tyre.

Figurat letrare	**Interpretimi i tyre**

Grupi i pestë: Vlerësime për krijimtarinë e autorit.
- Kanë thënë për autorin:
- Dostojevski ka thënë:

Vlerësimi: Vlerësimi për të nxënë
(i vazhdueshëm)
Vlerësimi i nxënësit do të bëhet për punën individuale dhe në grup. Për punën individuale do të ketë një peshë prej 60 % dhe për punën në grup rreth 40 %.

Detyrat dhe puna e pavarur: Përshkruaj Rusinë e kohës kur jetoi e shkroi Dostojevski.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 55 Dt.___.____. ___

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tema mësimore: Fjodor Dostojevski. Jeta dhe vepra		**Situata e të nxënit:** Veprat e para. Etapat e krijimtarisë. Tipare të veprës së Dostojevskit	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: - klasifikon krijimtarinë e autorit në drejtimin letrar/ periudhën letrare; - liston veprat kryesore të Dostojevskit; - përshkruan momentet kryesore të jetës së Dostojevskit dhe ndikimin që patën në krijimtarinë e tij; - diskuton rreth risive që sjell krijimtaria e tij; - vlerëson ndikimin e Dostojevskit në letërsinë e shekullit XX.		**Fjalët kyçe:** Realizëm Kryevepra Konflikte klasore Konflikte të brendshme Narracion elektrizues Drama njerëzore Risi	
Burimet: Teksti mësimor/libri i nxënësit, libri digjital, informacione nga interneti, romani "Vëllezrit Karamazov", studime letrare për autorin.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** historia, gjeografia, Tik.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Pema e mendimit-Përmbledhje e strukturuar-Stuhi mendimesh-Punë me grupe-Diskutim			

Organizimi i orës së mësimit

Hapi 1. **Pema e mendimit**. Rikujtohen njohurit mbi realizmin si drejtim letrar.

Kushtet në të cilat lindi: ndryshime të mëdha në të gjitha fushat; progresi teknologjik; industrializimi; zhvillimi ideologjive etj.

Vendet ku u shfaq së pari: Franca, Anglia, Rusia.

Realizmi

Perfaqësuesit kryesor: Balzak,Stendal, E.Zola, U.Theker, Ç.Dikens, Flober, A.Çehov, N.Gogol, Turgenjev, L.Tolstoj, Dostojevski.

Veçoritë kryesore/tiparet: sipas kushteve reale të jetës, mjedise reale; tematika sociale; e kthen vështrimin tek e tashmja; gjuha e qartë, e kuptueshme

Gjinitë dhe llojet letrare: novela; romani; drama.

Hapi 2. **Stuhi mendimi**

- Cilët janë figurat më përfaqësuese të realizmit rus?
  - Përfaqësuesit më të njohur të realizmit rus janë: Pushkin, Gogol, Turgenjev, Ostrovski, Çehov, L.Tolstoj, F.Dostojevski etj.

Me Dostojevskin dhe Tolstoin romani fitoi një kuptim mirëfilli filozofik, u ngrit në lartësinë e epopesë dhe të tragjedisë, dhe zbuloi jetën ruse me të gjitha karakteristikat e saj.

- Ç'dini ju për Fjodor Dostojevskin dhe krijimtarinë e tij/veprat e tij?



Hapi 3. **Nxënësit punojnë në grupe me pyetjet përkatëse për secilin grup:**

G1- Cilët faktorë ndikuan në formimin e Dostojevskit?
G2- Cilat ishin veprat e para të autorit si dhe karakteristikat e tyre?
G3- Çfarë e rëndoi psikologjinë e tij? Përvojat e tmerrshme dhe pasojat psikologjike e fizike.
G4-Veprimtaria pas kthimit në Petërsburg.
G5- Periudha e shkrimit të kryeveprave, dhe ngjarjet e jetës gjatë kësaj periudhe.
G6- Përtej realizmit për nga e orienton Dostojevski narrativën e tij?
G7- Risitë që sjell në letërsi.

Hapi 4. **Përmbledhje e strukturuar.** Një nxënës për çdo grup plotëson pjesën përkatëse në tabelë.

Vitet e para të jetës së autorit	**Veprat e para si dhe karakteristikat e tyre**	**Përvojat e tmerrshme dhe pasojat psikologjike e fizike**	**Veprimtaria pas kthimit në Petërsburg**	**Periudha e shkrimit të kryeveprave**	**V l e r ë s i m e nga publiku**	**Karakteristika të veprës dhe përtej realizmit**
Dhuntinë e artistit të fjalës e trashëgon nga e ëma - vdekja e nënës kur ai ishte 16 vjeç - babai i alkoolizuar dhe i dhunshëm - diplomimi për inxhinieri ushtarake	Novela "Njerëz të varfër", pritet shumë mirë nga kritika - Shkruan me nxitim dhe i shet veprat të pambaruara për arsye ekonomike	- arrestimi në moshën 28 vjeçare - dënohet me vdekje, nuk ekzekutohet - rëndohet nga ana shëndetësore(epilepsia e shfaqur që në fëmijëri) - dënimi me punë të detyruar për 4 vite, në Siberi - jeta e vështirë dhe pas dënimit - jeta si ushtar në Siberi - martesa dhe dështimi i saj	- përvojë e pasur jetësore bashkëthemeloi me të vëllanë revistën "Koha" - udhëton shpesh në Europë - censura i mbyll revistën - themelon revistën "Epoka"	- mbyllja revistës Epoka - romanet "Krim dhe ndëshkim ", "Kumarxhiu " u konceptuan në një periudhë të vështirë kur kërcënohej me sekuestrimin e pasurisë - largohet nga Rusia për arsye shëndetësore dhe ekonomike, jeta në Gjermani, Itali, Francë - boton "Idioti" - kthehet në Rusi dhe boton "Djajtë"	- që në gjallje cilësohej si shkrimtari më i madh rus - mirënjohje nga lexuesi - 1877 zgjidhet anëtar i Akademisë së Artit dhe Kulturës - mbajti fjalimin për Pushkinin dhe misionin e popullit rus - zuri vend mes shkrimtarëve më të dashur të shekullit.	- procedon nëpërmjet "akumulimit" - bën analizë psikologjike të personazheve duke paraqitur idetë e tij etike, filozofike dhe fetare. - dialogu dhe monologu luajnë rol të veçantë - paraqet "inetelektualë" të shqetësuar e problematikë - orienton rrëfimin drejt një dimensioni ekzistencial e metafizik

***Hapi 5.* Diskutim.**

- Sa ndikoi vepra e Dostojevskit në letërsinë e shekullit XX dhe çfarë ndikimi pati?

Ndikimi ka qenë i madh. Krijoi një protagonist të mohuar nga shoqëria dhe në kërkim të shpengimit. Portrete të paharruara dhe drama tronditëse kanë hyrë në letërsinë botërore me cilësinë e figurave klasike. Vlerësohet për përpjekjet e tij të palodhura në kërkim të së vërtetës, për forcën e madhe të mjeshtërisë së tij realiste dhe mbi të gjitha për krijimin të figurave të pavdekshme. Në novelat e tij ai eksploron temat e mëkatit, moralitetit dhe shpengimit të njeriut modern.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen:

- për përmbledhjen e materialit të lexuar.
- për arsyetimet gjatë diskutimit për ndikimin e veprës së Dostojevskit në letërsinë e shekullit XX

Detyrat dhe puna e pavarur:

Grupi i parë

- Duke iu referuar veprave (që keni lexuar)të Dostojevskit, argumento se John Gray ka të drejtë kur shprehet: "Kur Fjodor Dostojevski përshkroi në romanet e tij se si idetë kanë fuqinë të ndryshojnë jetët e njerëzve, ai dinte se për çfarë po shkruante."

Grupi i dytë

- Si dhe sa lidhen rrethanat jetësore të autorit me karakterin e krijimtarisë së Dostojevskit?

Disa studiues mendojnë se klima e tensionit të vazhdueshëm, krijoi terrenin e duhur për zhvillimin e romaneve të tij. Po ju a mendoni kështu? Argumento përgjigjen tënde.

Grupi i tretë

- Trego fabulën e romanit "Vëllezrit Karamazov".

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda: Letërsi**	**Shkalla: V**	**Klasa: XI**
Tema mësimore: Analizë e veprës "Vëllezërit Karamazov"		**Situata e të nxënit:** Jeta e një shkrimtari ndikon në formimin e botëkuptimit të tij letrar. Struktura e romanit. Temat e romanit. Mesazhet e romanit. Studim teksti.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. Kompetenca personale Kompetenca digjitale			

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: - demonstron njohje të kontekstit historik, kulturor, politik, shoqëror në të cilin është shkruar teksti; - analizon dhe interpreton elementet e përmbajtjes dhe të formës së tekstit, si: tema, idetë, përshkrimi i kohës dhe i mjedisit, rrëfimtari, marrëdhëniet mes personazheve, fabula; - analizon faktorët ideologjikë, shoqërorë dhe biografikë që ndikuan në krijimtarinë letrare të Dostojevskit; - përshkruan dhe analizon mjedisin dhe kohën (koha, vendi, detajet fizike, situatat); - veçon tiparet e stilit dhe analizon e shpjegon se si ndikojnë ato te lexuesi; - gjykon për vlerat artistike të romanit "Vëllezërit Karamazovë".	**Fjalët kyçe:** Roman shumëplanësh Situata dramatike Tension Konflikt i brendshëm Krim në familje Personazhe kompleks Mesazhe etike, filozofike Përsiatje Pasione njerëzore
Burimet: Teksti mësimor, vepra e plotë, tnterneti.	**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** arte, qytetari, filozofi, histori, TIK.

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Pema e mendimit-Organizuesi grafik-Lexim i drejtuar-Pyetje-përgjigje

Organizimi i orës së mësimit

Hapi 1. **Kontroll dhe diskutim i detyrës së shtëpisë.**

- Një nxënës tregon fabulën e romanit "Vëllezrit Karamazov". Cilat janë temat dhe linjat që trajtohen në vepër?

Hapi 2. **Pema e mendimit.**

- Cili është sfondi në të cilin u krijua dhe botua romani "Vëllezërit Karamzov"?

Konteksti historiko-politik- Rusia e shekullit XIX

Konteksti

Konteksti letrar - Letërsia realiste. Ndërmjet viteve 60 e 70-të (që përbëjnë periudhën e tretë të krijimtarisë së tij) Dostojevski botoi kryeveprat e tij të njohura, romanet "Idioti", "Djajtë", "Vëllezërit Karamzov" si dhe romanin Adoleshenti".

Hapi 3.

Kompozicioni i jashtëm i verës. Si është strukturuar ajo.

Struktura e romanit: dy vëllime.

Roman 1	Parathënia	Autori thekson se do trajtojë rininë e një njeriu të "papërcaktuar" mirë, por që mbart në vetvete thelbin e së tërës.				
Roman 1	Pjesa e parë	3 Libra	Libri 1	5 kapituj	Historia e një familjeje të vogël	Pjesa e parë dhe e dytë e romanit na njeh me përbërjen e familjes Karamazov dhe kuptimin e tyre për jetën. Po ashtu nga njeh me jetën e murgjve të Kuvendit. Në këtë pjesë bëhet lidhja e pikave kyçe të subjektit, duke shpalosur ide të rëndësishme shumëplanëshe. Aliosha është personazhi kryesor i romanit.
			Libri 2	8 kapituj	Një mbledhje krejt pa vend	
			Libri 3	11 kapituj	Epshorët	
Roman 1	Pjesa e dytë	3 Libra	Libri 4	7 kapituj	Makthi	
			Libri 5	7 kapituj	Pro dhe kundër	
			Libri 6	3 kapituj	Murgu rus	
Roman 2	Pjesa e tretë	3 Libra	Libri 7	4 kapituj	Aliosha	
			Libri 8	8 kapituj	Mitja	
			Libri 9	9 kapituj	Hetimi paraprak	
Roman 2	Pjesa e katërt	3 Libra	Libri10	7 kapituj	Djemtë	
			Libri11	10 kapituj	Vëlla Ivan Fjodoroviç	
			Libri12	14 kapituj	Gabimi gjyqësor	
Roman 2	Epilogu				Projekte për ta shpëtuar Mitjën	
					Një minutë gënjeshtra u bë e vërtetë	
					Varrimi Iliusheçkës. Fjala pranë gurit	

Hapi 4. **Lexim i drejtuar** i materialit (stili i romanit)

Veçori të stilit të autori të cilat shfaqen në roman:

- Gjuha e gjallë dhe e kuptueshme për lexuesin; sintaksë dhe leksik i thjeshtë, stil origjinal.
- Sfondi realizohet nëpërmjet përshkrimeve realiste, të detajuara (por pa rënë në përsëritje apo detaje të tepërta).
- Mbizotëron dialogu, me anë të të cilit zbulohet vuajtja e brendshme e personazheve;
- Çdo personazh ka ritmin dhe karakteristikën e tij të veçantë (karakterizimi i tyre realizohet nëpërmjet të folurit, të menduarit, veprimit);
- Përshkruhen tipa të larmishëm si: të mirin, të ligun, të pabesin, dyshuesin, egoistin, kriminelin etj.;
- Ngjarjet ndjekin linjën kronologjike;
- Përsëritje e përemrit të vetës së parë njëjës (duke zbuluar ndonjë element personal si ndjenja e vetëfajsisë/katarsisit);
- Depërton në psikologjinë e personazhit;
- Libri të mban në tension deri në faqen e fundit lexuesin;
- Karakteri i ngjarjeve, kronikat penale dhe fati tragjik i personazheve i japin veprës karakter tragjik, ndaj romani është cilësuar roman-tragjedi.

Aliosha, Ivani, Smerdiakovi, Grushenjka e dhjetëra të tjerë heronj të rrëmbyer shfaqen me profile të realizuara me mjeshtëri e bukuri të rrallë.

Hapi 5. **Pyetje-përgjigje**

Përse themi se romani shfaq botëkuptimin e autorit në disa plane/ rrafshe? (përqendro përgjigjen te konteksti, konfliktet që trajtohen dhe mesazhet që përcillen në vepër)

- Në roman shprehet urrejtja ndaj pushtetit të parasë, ndaj shtrirjes, mashtrimit. Ai zbulon shpërbërjen/kalbëzimin e një shoqërie që e ka bazën te bjerja/rënia shpirtërore e individit (duke na dhënë një tablo reale të Rusisë së asaj kohe)

- Trajtohen një sërë konfliktesh e raportesh:
  - individi me shoqërinë
  - individi me veten
  - bijtë me babain
  - e mira me të keqen (konflikt universal)
  - jeta me vdekjen
  - e moralshmja me pasionanten e të ndaluarën
  - dashuria me urrejtjen etj.

- Romani synon shërimin e shoqërisë nëpërmjet predikimit fetar, promovimit të vlerave etike e përsiatjeve filozofike.

Kështu autori ka zbuluar pikëpamjet e botëkuptimin e tij.

Vlerësimi: i vazhdueshëm. Nxënësit vlerësohen:
- për përmbledhjen e materialit të lexuar;
- për arsyetimet gjatë diskutimit.

Detyrat dhe puna e pavarur: Lexoni fragmentin: Ferri është vuajtje për atë që nuk mund ta duash më.
a) Nxirr kuptimin e autorit për dashurinë në plan universal.
b) Ky fragment u ngjason më tepër me Purgatorin apo Ferrin dantesk? Argumento përgjigjen.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tema mësimore: Koment. Fragmenti: Ferri është vuajtje për atë që nuk mund ta duash më.		**Situata e të nxënit:** - Lexim i poezisë të **Roland Kipling** - Në mundesh. *Një himn i mrekullueshëm për jetën (që Kipling ia kushton të birit). Një reflektim në vargje që mëson si të rritesh.* *Të qenin burrë e përbëjnë vlerat, liria dhe vullneti për të vlerësuar çdo hap të ekzistencës sonë si një ecje drejt diçkaje të re.* - Studim teksti.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca qytetare Kompetenca personale Kompetenca digjitale			

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: - përdor organizuesit grafikë në funksion të të kuptuarit të koncepteve e ideve të tekstit; - mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti; - tregon se si një tekst e informon lexuesin rreth natyrës njerëzore; - bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme; - zbulon mesazhet që përcillen me anë fragmentit; - dallon veçoritë e stilit të autorit.	**Fjalët kyçe:** Degjenerim Pasion Mëkat Vuajtje Besim Krenari Dashuri Psikologji Realitet: politik, ekonomik, social, kulturor
Burimet: Teksti mësimor Vepra letrare "Vëllezrit Karamazov" Inetrneti Poezia e **Roland Kipling** - Në mundesh... (fragment) Letra e lamtumirës së Markezit "**Sikur Zoti të më falte pakëz jetë**".	**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** gjuhë shqipe, filozofi, histori, TIK.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Stuhi mendimesh-Lexim i drejtuar-Punë në grupe-Pema e mendimit Diagrami i Venit-Pyetje-përgjigje-Punë e pavarur-Përmbledhje e strukturuar	
Organizimi i orës së mësimit Kontroll i detyrave të shtëpisë dhe diskutojmë rreth kryerjes së saj. ***Hapi 1.* Stuhi mendimesh.** Cilat janë porositë që Kipling i drejton të birit, por njëkohësisht edhe ne si lexues? **Roland Kipling** - Në mundesh...Në mundesh të rrish në pritje, nga pritja pa u lodhur E kur të urrejnë, urrejtje të mos ushqesh Madje ndaj shpifjeve të rrish pa folur Me thjeshtësi, me to pa rënë ndesh… .... Në durofsh dot që thëniet e tua të drejta Në kurthe për trutharet, kopuket do t'i kthejnë, Të thyejnë gjërat më të shtrenjta, e prapë t'i ndërtosh Me vegla pune që nuk vlejnë! .... Në i detyrofsh dot muskul, nerv, dhe puls e zemër Të të shërbejnë edhe kur gjithçka të duket e kotë E të qëndrosh, kur s'ka asgjë veç vullnetit, Që veç një fjalë, 'qëndro' gjithnjë të thotë. .... Në mundesh të mbushësh ti minutat, Aq të rënda, me vepra që peshojnë, Dije, dhe mos ki asnjë dyshim E jotja do jetë bota me ç'ka brenda Dhe burrë do jesh, o biri im…	

Hapi 2. **Lexim i drejtuar: Punë në grupe - Pema e mendimit.**

Ndajeni tekstin në pjesë.
Duke u ndalur në pjesën e parë zbulo:

Grupi i parë: - kuptimin e Dostojevskit mbi shtresat klasore të Rusisë së kohës.
Grupi i dytë: - realitetin social, fetar, politik rus.

Shtresat e larta Degjenerimi vjen nga lart dhe rritet me orë.

realiteti social fetar politik rus

Mbështeten vetëm te shkenca
Kërkojnë të rregullojnë gjithçka sipas mendjes së tyre, pa ndihmën e Zotit
Predikojnë se s'ka mëkat, s'ka krim

Populli
- është qelbur në vodkë dhe nuk heq dorë prej saj-vandalizëm prej saj, egërsi ndaj gruas e fëmijëve;
- Fëmijë të mitur në punishte, fabrika-fjalë të pista, vodkë;
- Ende beson tek e vërteta, e pranon Zotin;
- Veçohen: kulakët parazitët tregtarët që kërkojnë nderime e hiqen si njerëz me kulturë;
- Kur janë injorantë përçmojnë me paturpësi zakonet e të parëve;
- Kërkojnë të lidhen me princër e kontër kur vetë janë muzhikë të pagdhendur;
- Do sjellë shpëtimin e Rusisë, me anë të bindjes e krenarisë së tij;
- Krenar paçka se mban erë të qelbur mëkatesh, paçka se është bërë si lypsar;
- Ka dy vjet që vuan në skllavëri, por s'e ka ulur kokën;
- Është i lirë, nuk di t'i përbuzë të tjerët;
- Nuk është hakmarrës, nuk është ziliqar.

Hapi 3. **Diagrami i Venit.**

Identifiko në fragment pika takimi dhe të veçanta për konceptet: Dashuri për Zotin - Dashuri tokësore.



Hapi 4. **Pyetje-përgjigje.**

- Kujt i drejtohen thirrjet e autorit te pjesa e dytë?
- Si jepet në fragment rrugëtimi drejt gëzimit shpirtëror?
- Si e kuptoni pyetjen: O Zot, kush thotë që edhe populli ka mëkate?
- Përse autori i referohet etërve dhe mësuesve?



Hapi 5. **Përmbledhje e strukturuar.**

Dallo në tekst veçori të stilit të autorit.

Veçori të gjuhës	Mjete stilistike	Funksioni i tyre
Përdorim i dendur i mbiemrave Përdorim të dendur të detajeve	Epitetet Enumeracionet	Përvijimin e sfondit Depërton në psikologjinë e personazheve
Fjalitë pyetëse	Pyetja retorike	Nxitja e lexuesit për të reflektuar
Përsëritje e fjalëve	Thirror	Thekson idenë/problematikën
Fjalë me ngjyresa kuptimore	Ironia	Godet fenomenet/dukuritë problematike
Përdorim të dendur të lidhëzave Lidhëzat kundërshtore	Polisidenti	Një imazh më i qartë
... trepikëshi Fjali thirrmore	Retiçenca	Efektet emocionale I lë hapësirë lexuesit
Foljet në mënyrën urdhërore		Nxitja e lexuesit për të reflektuar Mesazhet moralizuese

- Me stilin e cilit shkrimtar ngjason (në këtë fragment) stili i Dostojevskit?
- Me Balzakun, proliksitetin e tij.

Hapi 6. **Punë e pavarur.**

Sipas Dostojevskit Nëse je i dhunshëm, ti s'mund të jesh njeri me të ardhme të mirë, ti vetvetiu e ke dënuar veten.

- Ndërto disa sentenca të tjera kuptimore, që dalin nga teksti.

Vlerësimi:

Nxënësi vlerësohet për:

- aftësinë për t'iu përgjigjur pyetjeve;
- aftësinë e të punuarit në grup;
- aftësinë për të mbajtur qëndrime e reflektuar ndaj situatave të dhëna.

Detyrat dhe puna e pavarur:
Lexo fragmentin ***Ferri është vuajtje për atë që nuk mund ta duash më***, nga romani "Vëllezërit Karamazov" dhe letrën e lamtumirës së Markezit "**Sikur Zoti të më falte pakëz jetë**". Cilat janë mesazhet e që autorët u drejtojnë lexuesve?

"Sikur Zoti të harronte për një moment që unë jam një dordolec i ndrequr me rrecka dhe të më dhuronte një copëz jetë, mbase nuk do t'i thosha të gjitha ato që po mendoja, por sigurisht do t'i mendoja ato që po them. Do i jepja rëndësi gjërave jo për vlerën, por për domethënien e tyre. Do flija pak, do ëndërroja më shumë, sepse çdo minutë që mbyllim sytë humbasim 60 sekonda dritë. Do vazhdoja kur të tjerët do ndalonin, do zgjohesha kur të tjerët do flinin. Do dëgjoja kur të tjerët do flisnin, dhe sa do e shijoja një akullore me çokollatë!!!

Nëse Zoti do më jepte një copëz jetë, do vishesha thjesht, do shtrihesha përballë diellit duke e lënë të pambuluar jo vetëm trupin, por edhe shpirtin tim.

Ah Zoti im, sikur të kisha një copëz jetë, nëse do mundesha, do shkruaja urrejtjen time mbi akull, dhe do prisja të dilte dielli. Nuk do t lejoja të kalonte as edhe një ditë pa i thënë njerëzve që dashuroja se i dashuroja. Do të bëja çdo burrë dhe grua të besojnë se janë njerëzit që dua dhe do të dashurohesha me dashurinë. Te njerëzit do të tregoja se sa gabim bëjnë kur besojnë se ndalojnë së dashuruari kur plaken, pa kuptuar se plaken kur ndalojnë të dashurojnë. Fëmijës së vogël do t'i jepja pendë, por do ta lija të mësonte vetë sesi të fluturojë. Pleqve do t'u tregoja se vdekjen nuk e sjell pleqëria por "harresa".

Mësova kaq gjëra nga ju, njerëzit. Mësova se të gjithë duan të jetojnë në "majën e malit", pa kuptuar se lumturia qëndron në mënyrën se si zbret "faqen e pjerrët".

Mësova se kur fëmija i porsalindur shtrëngohet mbi pëllëmbën e tij të vogël, për herë të parë gishti që zgjatet i babit të tij e robëron përgjithmonë.

Mësova se njeriu ka të drejtë ta shohë tjetrin nga lart, vetëm kur duhet ta ndihmojë të çohet…. Të thuash gjithmonë atë që ndjen dhe të bësh gjithmonë atë që mendon…

Nëse do ta dija që sot do të ishte hera e fundit që do të të shihja duke fjetur, do të të përqafoja fort, fort dhe do t'i lutesha Zotit që të bëhesha roja e shpirtit tënd.

Nëse do e dija se kjo do ishte hera e fundit që do të të shihja të dilje nga dera, do të të përqafoja dhe do të të jepja një puthje dhe do të të thërrisja përsëri që të të jepja edhe të tjera.

Nëse do ta dija që kjo do të ishte hera e fundit që do ta dëgjoja zërin tënd, do të regjistroja çdo fjalë tënden që të mund të të dëgjoja përsëri, përsëri…

Nëse do të dija që këto do të ishin momentet e fundit që do të të shihja, do të të thosha "të dashuroj" dhe do të supozoja jo logjikisht se e dije më parë.

Ekziston gjithmonë një e nesërme dhe jeta na jep edhe mundësi të tjera që t'i bëjmë gjërat siç duhet, por nëse bëjmë gabime na mbetet vetëm e sotmja.

Do të doja të të thoja se sa shumë të dua dhe se kurrë s'do të të harroj. E nesërmja nuk është e sigurt për askënd, si i ri, si i vjetër.

Sonte mund të jetë hera e fundit që i shikon njerëzit që do. Prandaj mos prit më, bëje sot sepse e nesërmja nuk vjen kurrë.

Sigurisht do pendohesh për ditën kur nuk gjete kohë për një buzëqeshje, një përqafim, një puthje dhe sepse ishe i zënë për të realizuar një dëshirë të tyren.

Mbaji ata që dashuron pranë vetes, thuaju duke mërmëritur se sa shumë ke nevojë për ta, dashuroji, sillu mirë, gjej kohën për ta, thuaju "më vjen keq", "më fal", "faleminderit" dhe të gjitha fjalët e dashurisë që di. Asnjëri nuk do të të mbajë mend për mendimet e tua të fshehta…"

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

<table>
<tr><th>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</th><th>Lënda: Letërsi</th><th>Shkalla: V</th><th>Klasa: XI</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Koment. Fragmenti: Mitjën e Marrin</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Kuptimi mbi absurdin. Vepra të shkrimtarëve ekzistencialist për të demonstruar kuptimin mbi absurdin dhe fatalitetin.
Studim teksti.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
Kompetenca e të menduarit
Kompetenca digjitale
Kompetenca qytetare
Kompetenca personale</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
- përdor organizuesit grafikë në funksion të të kuptuarit të koncepteve e ideve të tekstit;
- mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti;
- bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme;
- zbulon mesazhet që përcillen me anë fragmentit;
- dallon veçoritë e stilit të autorit;
- shpjegon funksionin e përdorimit të mjeteve gjuhësore e stilistike;
- realizon përshkrimin e personazheve në plane e aspekte të ndryshme.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:
Krim
Dënim
Absurd
Moral
Turmë
Drejtësi
Faj
Fat
Fatalitet
Vuajtje
Besim
Krenari
Dashuri</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: Teksti mësimor, vepra e plotë, interneti, letërsia moderne.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: psikologji, TIK, qytetari, gjuhë shqipe.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Punë me grupe-Organizuesi grafik-Lexim dhe shpjegim teksti-Ditari dypjesësh-Rrjeti i diskutimit</td></tr>
</table>

Organizimi i orës së mësimit

Hapi 1. Kontroll dhe diskutim i detyrës së shtëpisë.

Hapi 2. Mësimi fillon me organizimin e jashtëm/kompozicionin e jashtëm të tekstit (Pjesa e tretë, ku bën pjesë fragmenti).

Në ndihmë të nxënësit për të kuptuar zhvillimin e ngjarjeve.

PJESA E TRETË		
LIBRI I SHTATË **Aliosha**	**LIBRI I TETË** **Mitja**	**LIBRI I NËNTË** **Hetimi paraprak**
I. Era e kalbëzimit	I. Kuzma Samsonovi	I. Fillimi nëpunësit Perhotin
	II. Ljagavi	II. Alarmi
II. Çfarë minute	III. Miniera e arit	III. Rruga e shpirtit përmes provash: Prova e parë
	IV. Në errësirë	IV. Prova e dytë
III. Bulbi	V. Një vendim i papritur	V. Prova e tretë
	VI. Po vij vetë	VI. Prokurori e zuri Mitjën në fjalë
IV. Kana e Galilesë	VII. Pari, i diskutueshmi	VII. E fshehta e madhe e Mitjës, e vërshëllyen
	VIII. Dalldia	VIII. Pohimet e dëshmitarëve, vocërraku
		IX. Mitjën e marrin

Dostojevski e parapërgatit lexuesin për pasojat që lindin (në ato rrethana) për Mitjën.

I shqetësuar e në hall të madh. Dy alternativa e mundonin Dimitri Fjodoroviçin: "ose ai, Mitja, ose Fjodor Pavlloviç".
Gruneshka vërtet e dashuroi me gjithë shpirt për një orë, por dhe e torturoi pa mëshirë.
Ndoshta, duke qenë i vetëdijshëm për konfliktin e turpshëm me babain për shkak të një femre, ai nuk mund të merrte me mend një rrezik më të madh për vete.
Ai ëndërronte t'ia mbathnin me Gruneshkan nga ky vend i mallkuar... kështu do niste gjithçka nga e para.
Ndërgjegjja e vriste për paratë e vjedhura Katerina Ivanovës.
Shpresonte një jetë të re me Grenushlkën, një jetë pa mëkate vetëm me virtyte.
Kur e kishte përpara gruneshkën atij i zhdukej çdo shenjë xhelozie e bëhej fisnik e besimplotë, madje zinte e qortonte veten për ndjenjat e ulëta. Ama kur s'e kishte pranë niste e dyshonte për çdo poshtërsi nga ana e saj.
Zonjë ju me të vërtetë jeni doktori kurse unë jam i sëmuri i vërtetë.
Për minierat e arit s'kam menduar kurrë

Hapi 3. Punë me grupe-Organizuesi grafik-Lexim dhe shpjegim teksti-Ditari dypjesësh

Grupi i parë: Cilët janë personazhet që marrin pjesë në këtë fragment?:

Personazhet:

Nikollaj Parfenovi – gjyqtari
Mavrik Marikieviç – shef i rojave
Trifon Borisiç
Agrafena Aleksandrovna (Grushenka)
Dimitri Fjodoroviç (Mitja)

Grupi i dytë: Portretizoni Dimitrin (Mitjan) me detajet më karakterizuese nga fragmenti.

Grupi i tretë: Identifikoni mjetet gjuhësore me anë të të cilave karakterizohen personazhet dhe mjedisi/sistemi/shoqëria si dhe shpjego funksionin e tyre.

Mjete gjuhësore	**Funksioni përdorimit**
Trepikëshi	
Foljet në të tria kohët: e shkuar e tashme e ardhme (në dy aspekte)	
Veta e parë njëjës	
Veta e parë shumës	
Veta e dytë shumës	
Veta e dytë njëjës	
Fjalitë thirrmore	
Përdorimi i thonjëzave dhe kllapave	
Fjalët me ngjyresa kuptimore/konotacioni	
Lidhëza kundërshtore	
Përsëritja e fjalëve	
Fjalia pyetëse	
Ligjërimi zyrtar	
Shkalla krahasore e sipërisë	

Grupi i katërt: Identifikoni mjetet stilistike me anë të të cilave karakterizohen personazhet dhe mjedisi/sistemi/shoqëria si dhe shpjego funksionin e tyre.

Mjetet stilistike	Funksioni përdorimit
Retiçenca	
Epitetet	
Shprehje frazeologjike	
Metaforë	
Pyetje retorike	
Pasthirrma	

Grupi i pestë: Shpjego karakteristikat dhe rolin e dialogut në fragment.

- Dialogu mes Mitjas dhe personazheve të tjerë.
- Roli që luan dialogu.

Grupi i gjashtë: Identifiko në tekst fjalë të cilat lidhen me fushën leksikore GJYQ

Fjalët: protokoll, gjykatës, i pandehur, akuzë, fajtor, nen, hetim, prokuror, provë, kod penal etj.

Hapi 4. **Rrjeti i diskutimit.**

- A mund ta perceptojmë si absurd gjyqin ndaj Mitjas?

Po_____Jepni kuptimin mbi absurdin _____ Jo

Absurdi – ç'kuptojmë me këtë nocion? Tregoni mbi një vepër të absurdit në të cilën nuk gjykohet krimi, por sjellja e të akuzuarit në të shkuarën dhe pikëtakimet e tij me absurdin.

- A jeni dakort me atë çka shkruan Pushkini në thënien e mëposhtme?

Xhelozia! Otello nuk ishte xheloz, ai vetëm beson - *shkruan Pushkin* - atij i ka vdekur ideali i tij.

Po Jo

Vlerësimi: Vlerësimi për aftësitë e nxënësve mbi:
- Zhvillimin e detyrës së dhënë.
- Portretizimin që i bën personazheve.
- Zbulimin e karakteristikave të sistemit të kalbur rus.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Kamy do t'i drejtohej botës: "Shkrimtari nuk mund të vihet në shërbim të atyre që bëjnë historinë, por të atyre që e pësojnë atë…

Duke iu referuar veprës së Dostojevskit a mund të themi se kjo shprehje është e vërtetë?

Argumento përgjigjen.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 59 Dt.___/____/__

<table>
<tr><th>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</th><th>Lënda: Letërsi</th><th>Shkalla: V</th><th>Klasa: XI</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Koment. Fragmenti: Ivani dhe Djalli/Djalli, ankthi i Ivan Fjodoroviçit</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Nxënësi vlerëson letërsinë si element i rëndësishëm që nxit reflektimin dhe mendimin kritik krahas funksionit estetik që ajo mbart. Studim teksti</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
Kompetenca e të mësuarit për të nxënë
Kompetenca personale
Kompetenca digjitale</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
- përdor organizuesit grafikë në funksion të të kuptuarit të koncepteve e ideve të tekstit;
- mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti;
- bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme;
- zbulon mesazhet që përcillen me anë fragmentit;
- identifikon në tekst veçoritë e stilit të autorit;
- shpjegon funksionin e përdorimit të mjeteve gjuhësore e stilistike;
- - realizon përshkrimin e personazheve në plane e aspekte të ndryshme.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:
alterego
përballje
transformim
moral
ndërgjegje
djall
djallëzi
filozofi
vlera njerëzore
e vërteta</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:
Teksti mësimor, vepra e plotë, interneti, teoritë e personalitetit.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: psikologji, TIK, qytetari, gjuhë shqipe.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Pyetje-përgjigje-Kllaster-Lexim dhe shpjegim teksti-Punë në grup-Ditar dypjesësh-Diskutim</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizimi i orës së mësimit
Hapi 1. Kontroll i detyrë së shtëpisë dhe diskutimi rreth kryerjes së saj.
Hapi 2. Pyetje-përgjigje; Kllaster
- Ku përfshihet ky episod nëse i referohemi strukturës së veprës?
Fragmenti: “Ivani dhe Djalli” apo “Djalli, ankthi i Ivan Fjodoroviçit” bën pjesë në pjesën e katërt, librin e dymbëdhjetë
Çfarë ju sugjeron titulli?</td></tr>
</table>

Struktura e tekstit

Jepet në mënyrë të strukturuar **Pjesa e Katërt,** në të cilën bën pjesë fragmenti në libër.

PJESA E KATËRT					
LIBRI i dhjetë		**LIBRI i njëmbëdhjetë**		**LIBRI i dymbëdhjetë**	
Djemtë		**Vëlla Ivan Fjodoroviçi**		**Gabim gjyqësor**	
I	Kolja Krasotkini	**I**	Te Grushenka	**I**	Dita fatale
		II	Këmba e sëmurë	**II**	Dëshmitarë të rezikshëm
II	Fëmijët	**III**	Djallushi	**III**	Ekspertiza mjekësore dhe një funt lajthi
				IV	Mitjës i buzëqesh fati
III	Shkollari	**IV**	Himni dhe e fshehta	**V**	Katastrofa e papritur
		V	Jo ti, jo ti	**VI**	Fjala e prokurorit, karakteristika
IV	Zhuçka	**VI**	Takimi i parë me Smerdiakovin	**VII**	Vështrim historik
				VIII	Traktati mbi Smerdakovin
V	Pranë shtratit të Ilushës	**VII**	Vizita e dytë te Smerdiakovi	**IX**	Psikologji me revan; Trojka e harbuar Finalja e fjalës së prokurorit
				X	Fjala e avokatit, shkopi me dy anë
VI	Zhvillim i parakohshëm	**VIII**	Takimi i tretë dhe i fundit me Smerdiakovin	**XI**	Para nuk kishte, grabitje nuk kishte
		IX	**Djalli, ankthi i Ivan Fjodoroviçit**	**XII**	As vrasje nuk kishte
VII	Iliushka	**X**	"Ai më tha"	**XIII**	Mohuesi i mendimit
				XIV	Muzhikët mbrojnë veten

Hapi 3. **Lexim dhe shpjegim teksti.**

- Kush është Ivani?
- Në cilat tematika kanalizohet biseda midis Djallit dhe Ivanit?

Hapi 4. **Punë në grupe, Ditar dypjesësh.**

- Nënvizo në tekst:

G.1- Shprehje në trajtën e sentencave kuptimore
G.2- Shprehje frazeologjike
G.3- Figurat letrare
G.4- Shpjego rolin e dialogut në fragment dhe karakteristikat e tij.
G.5- Përcakto kohën e foljeve të përdorura në tekst. Cili është funksioni përdorimit të së tashmes dhe të shkuarës në fragment?

Pasi nxënësit kanë zhvilluar punën në grup strukturojnë përgjigjet e tyre.

Shprehjet	Shembujt	Shpjegimi / interpretimi
Shprehje në trajtën e sentencave kuptimore	• Për fat të keq e vërteta gjithmon qëllon jo fort e mençur. • Humbi doktori i dikurshëm që të shëronte nga çdo sëmundje. • Në shekullin tonë, prapanik është ai që beson te Zoti kurse, kurse unë jam djall, tek unë mund të besoni... • Njerëzit marrin seriozisht këtë komedi, me gjithë mendjen e ndritur që kanë. Këtu qëndron tragjedia e tyre. • Vuajtje do të thotë jetë. • Ç'kënaqësi do të ishte ajo pa vuajtje? • Unë mendoj pra unë ekzistoj. • Uni im ekziston pra kohësisht dhe individualisht... • Unë vuaj e megjithatë nuk jetoj.	
Shprehje frazeologjike	Gur në zemër më mbeti. Nuk jam përlyer në këtë punë.	
	Enumeracionet: Retiçencat: Pasthirrmat: Pyetjet retorike: Antitezat:	
Autori e quan djallin:	Djalli –Xhentëlmeni	

- Ndërto portretin e Ivanit, Djallit, si dhe zbulo filozofinë e Dostojevskit mbi moralin, krimin, ndërgjegjen, gënjeshtrën, të vërtetën, raportin me Zotin.
- Analizo transformimin shpirtëror dhe moral të rusëve në kohën kur jetoi.

Dialogu mes tyre zbulon filozofinë e Dostojevskit

Hapi 5. Diskutim

Diskutoni rreth mendimit që Djalli është një alterego e Ivanit. Mbështetuni te mendimi i Tomas Man.

Ego përbëhet nga një aftësi e ndërgjegjshme për të përceptuar dhe për t'u marrë me realitetin në mënyrë inteligjente.

Vlerësimi: Vlerësimi për të nxënë. Nxënësi vlerësohet për punën në grup, pjesëmarrjen gjatë diskutimit dhe argumentimin e përgjigjeve. (i vazhdueshëm)

Detyrat dhe puna e pavarur: Ese me temë: "Sa më shumë të më mohosh, aq më shumë më beson".

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 60 Dt.___/____/__

<table>
<tr><th>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</th><th>Lënda: Letërsia</th><th>Shkalla: V</th><th>Klasa: XI</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Përsëritje</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:
Autorët më të rëndësishëm të realizmit. Veprat e tyre
Tablotë e jetës dhe temat e mëdha që u bënë pjesë e veprave të realizmit.
Analizimi i raporteve qe kanë me personazhet e tyre.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
Kompetenca e të mësuarit për të nxënë
Kompetenca personale
Kompetenca qytetare
Kompetenca digjitale</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
- demonstron njohje të kontekstit historik, kulturor, politik, shoqëror në të cilin është zhvilluar realizmi;
- analizon kushtet historike dhe shoqërore, në të cilat lindi dhe u zhvillua realizmi;
- njeh dhe identifikon tipare të estetikës realiste, në tekste të ndryshme të shkrimtarëve realist të studiuar;
- dallon dhe analizon parimet në të cilat mbështetet letërsia realiste;
- përcakton gjinitë dhe llojet letrare që u lëvruan më shumë nga shkrimtarët realistë;
- mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti;
- bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme;
- krahason vepra të ndryshme realiste për të evidentuar pikëtakime dhe dallime mes tyre;
- shpjegon zhvillimin e letërsisë realiste në vende të ndryshme e shkrimtarë realist.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:
estetika realiste
natyralizëm
mjedise reale
personazhe realë
situata reale
aktualitet
gjuhë e qartë
tema sociale, shoqërore
objektivizëm</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:
Teksti mësimor, vepra të shkrimtarëve realist, studime dhe kritika letrare, interneti</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:
arte, histori, gjeografi, TIK, arte, gjuhë shqipe.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Pema e mendimit-Pyetje-përgjigje-Analizë përmes shembujve-Punë në grupe-Prezantim-lexim dhe interpretim-Bashkëbisedim</td></tr>
</table>

Organizimi i orës së mësimit

Hapi 1. **Kontroll dhe diskutim i detyrës së shtëpisë.**

Hapi 2. **Pema e mendimit.**

Rikujtojmë njohuritë mbi realizmin duke i klasifikuar sipas skemës së mëposhtme.

Hapi 3. **Pyetje-përgjigje**

- **Ç'kuptoni me realizëm?**
- Cilat janë temat kryesore që trajtojnë në veprat e tyre shkrimtarët realistë?
- A ndikoi jeta e shkrimtarëve në veprat e tyre? Nëse po, si ka ndikuar? (konkretizo përgjigjen me njohuri mbi jetën e Floberit, Balzakut, Dostojevskit dhe veprave të studiuara të tyre)

Hapi 4. **Analizë përmes shembujve, Punë në grupe.**

Paraprakisht klasa ndahet në tri grupe me disa nëngrupe (duke dhënë detyra specifike për secilin nëngrup) për t'u bashkuar më pas për të përmbledhur konkluzionet për secilin grup përkatës.

Lexo tekstin e mëposhtëm dhe analizoje atë për nga veçoritë karakteristike të një teksti realist.

Grupi i parë 1: **Fragment nga romani "Evgjeni Grande"**

Fytyra plot nur, tiparet aq femërore, të cilat qejfet e jetës nuk i kishin lënduar dhe as prishur freskinë, u përngjanin vijave, që mezi shquhen në horizontin e largët të liqeneve të kredhur në qetësi. Kjo pamje e qetë dhe me aq shumë ngjyresa femre, ajo fytyrë e ndritur dhe e çelur, si lulja kur bulon, shprehte atë qetësi shpirti dhe atë ndërgjegje të pa cënuar, që ia shtonte hijeshinë dhe femërinë. Evgjenia ndodhej ende në pragun e jetës, në atë stad të saj, kur lulëzojnë iluzionet femërore. Në këtë moshë, kur nuk e njihte ende se ç'ishte dashuria, duke soditur veten në pasqyrë, ajo nuk mund të mos mërmërinte: "A nuk do të m'i hedhë sytë, vallë? Mos jam aq e shëmtuar sa nuk do të m'i hedhë?" Pas kësaj hapi derën e dhomës, që të nxirrte në çardak dhe zgjati kokën se mos dëgjonte ndonjë zhurmë.

Grupi i parë 2: **Fragment nga romani "Evgjeni Grande"**

"Nuk po ngrihet," - tha me vete, tek i zunë veshët të kolliturën e Nanosë, e cila vërdallosej nëpër shtëpi: fshinte, ndizte zjarrin, lidhte qenin dhe bisedonte me gjënë e gjallë në stallë. Aty për aty Evgjenia i zbriti shkallët dhe iu afrua Nanosë, që po milte lopën.

- Nano, xhanka ime, përveç kafesë, më përgatit dhe krem për kushëririn tim!
- Mirë, mirë, zonjushë, po duhej të ma kishit thënë dje,- iu përgjigj Nanoja, duke ia shkrepur të qeshurit.
- Se unë vetë nuk bëj dot krem, de! Kushëriri juaj është i bukur, po, ai është me të vërtetë i hijshëm. Pa ta shikoje rrobën e natës prej mëndafshi të qëndisur me ar. Unë e pashë. Ka ca të brendshme të bardha, të holla si kota e zotit abat.

- E po, na bëj pite, atëherë, Nano!

- Po ku t'i gjej drutë për të nxehur furrën! Ku ta gjej miellin, gjalpin? - iu përgjigj Nanoja, e cila në cilësinë e kryeadministratorit të zotit

Grupi i parë 3: **Fragment nga romani "Evgjeni Grande"**

Grande i jepte vetes ndonjëherë një peshë shumë të madhe para syve të Evgjenisë dhe të së ëmës së saj.

– Mos duhet ta vjedhim zotërinë për të kremtuar ardhjen e kushëririt tuaj? Kërkojini ju vetë gjalpë, miell, dru, se kush e di… ndoshta mund t'ju japë, se ai babai juaj është. Ja tek po vjen për të parë si jemi me ushqimet. Evgjenia vrapoi e llahtarisur për në kopsht, kur dëgjoi shkallët të dridheshin nga hapat e të atit. Kishte filluar të bëhej e turpshme dhe ndjente atë lloj turpi të veçantë, që na e sjell lumturia e na duket se, ndoshta, ç'kemi në zemër, është e pasqyruar në ballin tonë dhe mund ta lexojë tjetri. E gjora vajzë, i vinte plasje tek e shihte shtëpinë ashtu të zhveshur, të rregulluar pa pikën e shijes. I shtohej marazi, tek e krahasonte me elegancën e kushëririt. Dhe aty për aty e ndjeu që diçka duhej të bënte për kushëririn e saj. Po çfarë? As vetë s'e dinte. E ku ta dinte? Ashtu e padjallëzuar dhe tepër e sinqertë siç ishte, ia dorëzoi veten natyrës së vet engjëllore pa pikën e mosbesimit, pa dyshuar as në përshtypjet dhe as në ndjenjat e përjetuara.

Materiali i përmbledhur për grupin e parë:

Model përgjigjeje: Evgjenia, një vajzë province sheh se si rinia e saj ikën, ditë pas dite, në shtëpinë e saj ku nuk depërtojnë rezet e diellit, nën diktatin e babait të saj plak e koprrac, i cili nuk bën gjë tjetër veçse grumbullon ar pareshtur, me një mani të tërbuar, dhe nënës së saj, e cila nuk ka guxim të marrë frymë para bashkëshortit të saj. Prania e përkohshme kushëririt, e Karlit, e bën Evgjeninë e mjerë t'i ngjallen iluzione dashurie. Një ndjenjë e cila ngacmon ëndrrat e së resë të cilat ajo i ruan në zemrën e saj për pesë vite me radhë.

Lloji i tekstit - roman realist

Tema që trajtohet - mania për para dhe ndikimi negativ i tyre në jetën e individit dhe shoqërisë.

Sfondi - real, të shtëpisë pa diell, babai ka rol vendimtar, gruaja inferiore.

Personazhet -

Evgjenia - një vajzë province;
- nën diktatin e babait të saj plak e koprrac;
- nuk ka guxim të marrë frymë para të atit;
- i ngjallen iluzione dashurie nga prania e Karlit.

Babai, plaku Grande - plak e koprrac;
- që nuk bën gjë tjetër veçse grumbullon ar pareshtur;
- si një maniak i tërbuar;
- tirani i shtëpisë.

Karli - i ngjall Evgjenisë iluzione dashurie etj.

Raporti i karaktereve tipike dhe mjediseve tipike te Balzaku:

- Njerëz të zakonshëm që mendojnë e veprojnë në mjedise të zakonshme. Balzaku kujdesej të harmonizonte veprimet e personazheve me veçoritë e mjedisit duke krijuar tipa letrar në rrethana tipike.

E veçanta e qëndrimit të Balzakut ndaj realitetit?

- Balzaku ka pohuar idenë se jeta duhet treguar ashtu siç është, por pa rënë në "grackën" e natyralizmit. Për të "detyrë e artit nuk është kopjimi i natyrës, por shprehja e saj. Duhet kapur thelbi i saj."

Gjuha dhe karakteristika të saj:

- Detajimet-stili proliks, përshkrimet e hollësishme. Gjuha rrjedh natyrshëm duke kaluar nga përshkrimet e detajuara drejt shpjegimeve, intrigës e konflikteve, duke konkluduar nëpërmjet sentencave kuptimore. Gjuha e tij, transparente lartëson virtytin njerëzor dhe godet vesin , i cili shkatërron jo vetëm atë që e mbart por dhe personat rreth tij.

Ndërtimi kompozicional i përsosur, përshkallëzimi logjik i ngjarjeve, qartësia e shkak-pasojës së veprimit.

Shënim: *E njëjta procedurë do të ndiqet dhe nga grupet e tjera.*

Lexo tekstin e mëposhtëm dhe analizoje atë për nga veçoritë karakteristike të një teksti.

Grupi i dytë 1: **Flober Zonja Bovari (fragment)**

Ajo do të kishte dashur që emri Bovari, që ishte edhe i saji, të bëhej i famshëm, të gjendej kudo nëpër librari, të përmendej vazhdimisht nëpër gazeta, ta njihte e tërë Franca. Mirëpo Sharli ishte njeri pa pikë pikësynimi në jetë! Një herë një mjek nga Ivtotoja, me të cilin para pak kohësh po bënte konsultë, e kishte poshtëruar disi mu përpara shtratit të të sëmurit, në prani të të afërmve që ishin mbledhur aty. Kur ia tregoi Sharli këtë ndodhi në darkë, Ema u nxeh shumë me kolegun e tij. Sharli u prek nga reagimi i së shoqes. E puthi në ballë me lot ndër sy. Mirëpo ajo ishte e pezmatuar nga turpi, i vinte ta rrihte, doli në korridor të hapte dritaren dhe thithi ajrin e freskët për t'u qetësuar. - Sa i humbur që është! Sa i humbur që është! – thoshte ajo me zë të ulët, duke kafshuar buzët. Dhe sa vinte dhe më tepër e merrte inat. Me kalimin e moshës, ai fitonte gjithmonë e më shumë shprehi prej të pagdhenduri; mbas darke priste me thikë tapat e shisheve bosh; pasi hante, lëpinte dhëmbët me gjuhë; kur rrufiste supën, kuaçiste si klloçkë në çdo gllënjkë, dhe, ngaqë dhjamosja po e zaptonte gjithandej, sytë, tashmë të vocërr, dukeshin sikur po i ngjiteshin drejt tëmthave prej mbufatjes së mollëzave.

Lexo tekstin e mëposhtëm dhe analizoje atë për nga veçoritë karakteristike të një teksti.

Grupi i dytë 2: **Flober Zonja Bovari (fragment)**

Ashtu si detarët në rrezik për t'u mbytur, ajo shikonte vetminë e jetës së vet me sy të dëshpëruar, duke kërkuar diku larg ndonjë velë të bardhë në mjegullnajën e horizontit. Nuk e dinte cili do të ishte ai rast, as se në ç'breg do ta nxirrte, i shtyrë nga era deri tek ajo, as në do të ishte barkë a anije me tri kuverta, ngarkuar me vuajtje apo mbushur deng me lumturi. Mirëpo çdo mëngjes, sa zgjohej, ajo shpresonte se do t'i vinte gjatë ditës, dhe dëgjonte të gjitha zhurmat, brofte befas, çuditej që nuk vinte, pastaj, si perëndonte dielli, më e trishtuar se kurrë, dëshironte që të gdhihej në çast e nesërmja zemra e saj mbeti e zbrazët përsëri dhe atëherë filloi sërish vargu i ditëve të njëllojta. Ato do të pasonin pra kështu njëra-tjetrën, gjithmonë të njëjta, të panumërta dhe pa sjellë asgjë! Të tjerët, sado të rëndomtë ta kishin jetën, prapëseprapë shpresonin të paktën se do t'u ndodhte diçka. Nganjëherë një aventurë mund të sjellë të papritura pambarim, bile edhe mjedisi sikur ndërrohet.

Lexo tekstin e mëposhtëm dhe analizoje atë për nga veçoritë karakteristike të një teksti.

Grupi i dytë 3: **Flober Zonja Bovari (fragment)**

Mirëpo për të nuk ndodhte asgjë; kështu e kishte thënë zoti! E ardhmja e saj ishte si një korridor krejtësisht i errët dhe që përfundonte me një derë të pakapshme. Ajo e braktisi muzikën. Përse të merrej me të? Kush do ta dëgjonte? Përderisa s'kishte për të ndodhur kurrë që, veshur me fustan të kadifenjtë me mëngë të shkurtra, ulur para ndonjë pianoje "Erard", për të dhënë koncert, duke i rënë me gishtërinjtë e saj të lehtë, tastierës së fildishtë, të ndiente t'i frynte si ndonjë fllad rreth vetes gumëzhitja e të mahniturve, ishte e kotë të lodhej duke studiuar. I plasi në dollap edhe kartonët e vizatimit edhe qëndismat. Ç'i duheshin? Ç'i hynin në punë? Qëndisja i ngrinte nervat përpjetë. - S'kam ç'të lexoj më, - thoshte ajo me vete. Dhe kohën e kalonte duke skuqur mashën në zjarr ose duke parë shiun që binte.

Lexo tekstin e mëposhtëm dhe analizoje atë për nga veçoritë karakteristike të një teksti.

Grupi i tretë 1: **Fjodor Dostojevski,** fragment nga **"Vëllezërit Karamazov"**

Edhe në mesin e popullit ka vend vetmia, vetmitarë gjen në radhët e fshatarëve të pasur, tek ata që shfrytëzojnë punën e të tjerëve, tregtarët janë duke kërkuar çdo ditë sa më shumë nderim, ç'nuk po bëjnë që të duken sa më të shkolluar pa qenë me shkollë, në të njëjtën kohë këta gjithë më tepër po i përbuzin dhe po i mënjanojnë nga vetja zakonet e vjetra, madje edhe besimin e etërve. Po kërkojnë të lidhen me princër, në një kohë që nuk janë tjetër vetëm se fshatarë të shprishur. Sa shumë egërsi ndaj gruas ka në familje, ndaj fëmijëve, dhe të gjitha vijnë nga dehjet. Populli dehet me vodkë, nuk heq dot dorë prej saj. Kam parë në fabrika fëmijë dhjetë vjeç, të dobët, të sëmurë, të kërrusur dhe të shprishur para kohe. Po pse këto i duhen një shpirti njomëzak, siç është ai i fëmijës? Atij i duhet diell, i duhen lodra fëmijësh, i duhet gjithkund shembulli i mirë dhe pak dashuri.

Lexo tekstin e mëposhtëm dhe analizoje atë për nga veçoritë karakteristike të një teksti.

Grupi i tretë 2: **Fjodor Dostojevski,** fragment nga **"Idioti"**

Në njërin nga vagonët e klasit të tretë, kur ra agu, u gjenden karshi njëri-tjetrit te dritarja dy udhëtarë; që të dy të rinj, që të dy me humor të mirë, të veshur jo kushedi çfarë, por jo dhe keq. Që të dy ndien dëshirën t'i hapnin bisedë shoqishoqit. Sikur ta dinin se ç'gjë i shquante që të dy në atë minutë, sigurisht që do të mbeteshin gojëhapur, që rasti i kishte ulur ashtu njëri karshi tjetrit sot në këtë vagon të klasit të tretë të trenit Petërbug-Varshavë. Njeri ishte trupvogël, rreth njëzet e shtatë vjeç, me flokë të zinj kaçurrela, me sy të veckël përshkënditës bojë gri. Hundën e kishte të flashkët, të shtypur, fytyrën me mollëza të dala; buzët hollake bënin ç'bënin dhe formonin një si buzëqeshje qesëndisëse, tallëse dhe, madje edhe dashakeqe; por ballin e kishte të lartë, të vizatuar bukur, ai ia hijeshonte dhe tërë pjesën e poshtme të fytyrës, që në vetvete nuk shquhej për ndonjë fisnikëri, Të binte në sy veçanërisht ajo zbehtësia e fytyrës verdhacuke si e një meiti, që i jepte djaloshit pamjen e një njeriu fuqiprerë edhe pse ishte truplidhur, por njëherazi shquhej tek ai një karakter terë pasion, i ndjeshëm ndaj dhembjes që, nga ana e vet, nuk puqej aspak me buzëqeshjen qesëndisëse e shpotitëse dhe me shikimin e vrazhdë prej njeriu të vetëkënaqur. Ishte veshur trashë, me një qyrk të bollshëm gëzofi qengji, me ngjyre të zezë dhe natën e kaloi mirë, ndërkohë që fqinji që i detyruar të duronte tërë mizorinë e natës së lagësht dhe të akullt të nëntoreve ruse. Dukej açik që ai nuk kishte qenë i përgatitur për këtë. Kishte veshur një pelerinë të gjerë stofi, me një kapuç të madh tamam si ata që përdorin rëndom në dimër jashtë shtetit udhëtarët diku në Zvicër apo në Italinë e Veriut, pa i thirrur fare mendjes se ishte duke udhëtuar nga Ejdkuneni në Petërburg. Kështu veshja e menduar për udhëtim përmes krahinave të Italisë doli fare e papërshtatshme në Rusi.

Lexo tekstin e mëposhtëm dhe analizoje atë për nga veçoritë karakteristike të një teksti.

Grupi i tretë 3: **Fjodor Dostojevski,** fragment nga **"Idioti"**

Djaloshi me pelerinën me kapuç ishte dhe ky nja njëzet e gjashtë, njëzet e shtatë vjeç, me shtat pak më të hedhur se mesatari, me një bashkë flokësh të verdhë e me faqe të rëna, si dhe me një mjekërzi të vogël majuce thuajse të bardhë. Sytë i kishte të mëdhenj, të kaltër, hetues; shikimin e qetë por të rëndë, mbushur me atë shprehje të çuditshme nga e cila shumëkush mund ta gjente menjëherë se ai njeri vuante nga sëmundja e tokës. Veçse, sidoqoftë, fytyrën e kishte të këndshme, hollake dhe thatime, ndonëse disi të strengur e të zhubravitur, të mavijosur krejt nga të ftohtit. Mbante në prehër një bohçe prej mësalle mëndafshi të fërkuar nga përdorimi, ku kishte mbështjellë, siç dukej, tërë katandinë e vet prej udhëtari. Kishte mbathur këpucë me qafa me shoje të trashë, të bëra jo në Rusi. Fqinji flokëzi, që rrinte i pështjellë mirë me qyrkun e ngrohtë, i vuri re që të gjitha këto dhe ashtu me nge siç ishte e pyeti me atë nënqeshjen qesëndisëse, përmes së cilës pa teklif e shkujdesshëm buiste ajo farë kënaqësie aspak e njerëzishme që kësi tipash provojnë kur hasin ndokënd që s'i ka prirë e mbara.

- Ftohtë, ë...

Dhe spërdrodhi supet. - Shumë, - iu përgjigj sakaq fqinji, - dhe është ende vjeshtë...

Po në dimër si do bëjmë? S'e kishte pandehur që këtu të bënte kaq ftohtë.

Qenkam çmësuar.. i paskam harruar...

- Vjen që jashtë shtetit? Nga jashtë vjen?

- Po, nga Zvicra.

Hapi 5: **Prezantim. Përgjigje e strukturuar**

Nxënësit paraqesin punimin përfundimtar të grupit pasi nëngrupet janë mbledhur së bashku për të konkluduar me veçoritë më karakteristike për autorin si dhe ato të realizmit.

Realizmi			
Autorët	**Teoria letrare, risitë, dukuritë letrare**	**Karakteristika të përgjithshme të krijimtarisë**	**Gjuha dhe stili**
Balzaku	Krijoi tipin letrar	Si heroi, mjedisi dhe ngjarja përfaqësojnë një shumësi vetish të përbashkëta për shumë individë dhe situata.	- Detajimet-stili proliks, përshkrimet e hollësishme. Gjuha rrjedh natyrshëm duke kaluar nga përshkrimet e detajuara drejt shpjegimeve, intrigës e konflikteve, duke konkluduar nëpërmjet sentencave kuptimore. Gjuha e tij, transparente lartëson virtytin njerëzor dhe godet vesin, i cili shkatërron jo vetëm atë që e mbart, por dhe personat rreth tij etj.
Floberi	Objektivizmi, impersionizmi Bovarizmi .	Kërkon që artisti të jetë objektiv dhe impersonal, pra të rrëfejë saktësisht duke mos i detyruar personazhet dhe ngjarjet ku ata veprojnë, pra logjika artistike duhet të përputhet me logjikën e jetës. **Objektivizmi:** trajtimi i shpirtit njerëzor me paanshmërinë e shkencave fizike.	Shfrytëzim të mjeteve shprehëse Lakonizmi, por figuracion domethënës Ironia si mjet goditës Përshkrim i kursyer Idetë e fshehura dalin në formë përfundimesh etj.
Dostojevski	romani tragjedi, pararend letërsinë moderniste	Depërtimi në psikologjinë e personazhit	Fraza mbresëlënëse në trajtën e sentencave kuptimore , përshkrime shumëplanëshe me detaje Etj.

- Realistët marrin atë çka u nevojitet nga realiteti dhe i japin asaj vlerë pergjithësuese duke krijuar te lexuesi iluzionin e vërtetësisë së plotë.
- Qëllimi i veprës realiste nuk është kritika ndaj shoqërise njerzore, por dënimi i vesit dhe ngritja lart e virtyteve njerzore.
- Realistët përpiqen të shkruajnë me një gjuhë te kuptueshme për të gjithë. Figurën letrare ata nuk e shohin si qëllim ne vetvete, por si veshje te domosdoshme të materialit letrar.
- Realizmi ka një synim të pergjithshëm që vepra të jetë realiste në të gjithë përbërësit e saj: subjekt, rrëfim, personazh e deri ne parashtrimin dhe interpretimin e fakteve.

Hapi 6. **Metoda e bashkëbisedimit**

Nx**ënësit lexojnë dhe interpretojnë kuptimin e shprehjeve të autorëve realist. (mund të punojnë dy nxënës me një** shprehje)

Dostojevski

- Lumturia nuk qëndron në vetë lumturinë, por në arritjen e saj.
- Kur ndaloni së lexuari libra, ju pushoni së menduari.
- Lumturia nuk vjen nga rehatitë tokësore, por fitohet përmes vuajtjes.
- Nuk duhet shumë për të shkatërruar një person. Gjithë sa do ju duhet të bëni është ta bindni se puna që ai bën është krejt e padobishme dhe e pakuptimtë.
- Heshtja është gjithmonë e bukur, dhe një person i heshtur është gjithmonë më i bukur se një që flet.
- Është e pabesueshme se çfarë mund të bëjë vetëm një rreze dielli, për shpirtin tënd.
- Njeriu duhet të flasë hapur me të tjerët, në një mënyrë që zbulon mendimet e veta të brendshme përmes fytyrës së tij, që zbulon hallet e tij, direkt përmes fjalëve. Një fjalë e thënë me bindje, me sinqeritet të plotë dhe pa hezitim, ndërkohë që e sheh tjetrin në sy, ka më shumë kuptim se dhjetëra faqe nga një libër.
- Edhe një njeri që i ka duart e lidhura mund të bëjë shumë mirë, nëse do.
- Bukuria do ta shpëtojë botën.

Flober

- Zemra është pasuri, që as nuk shitet, as nuk blihet por dhurohet.
- E ardhmja na mundon, e shkuara na mban pas, e tashmja në shpëton duarsh.
- "Mos lexoni siç bëjnë fëmijët, për t'u zbavitur apo siç bëjnë ambiciozët për të mësuar. Jo, lexoni që të jetoni."

Balzaku

- Vetmia është e mirë, por gjithsesi të duhet dikush, që të të thotë se vetmia është e mirë.
- Mençuria është kuptimi i atyre gjërave hyjnore, te të cilat shpirti ngjitet përmes dashurisë.
- Prej kur ekziston shoqëria, një qeveri, në mënyrë të pashmangshme, ka qenë gjithmonë një kontratë sigurie midis të pasurve kundër të varfërve.
- Të lexuarit na sjell miq të panjohur.

Vlerësimi: Vlerësimi për të nxënë. Nxënësi vlerësohet për punën në grup dhe argumentimin e përgjigjeve.

(i vazhdueshëm)

Detyrat dhe puna e pavarur: Zbërthe kuptimin filozofik mbi dashurinë te kjo pjesë e shkëputur nga romani "**Lufta edhe Paqja**" e Tolstoit. Po për ty ç'është dashuria? "Dashuria? Çfarë është dashuria?" mendoi. "Dashuria i vë gardhe vdekjes. Dashuria është jetë. Gjithçka, gjithçka që unë kuptoj, e kuptoj vetëm sepse dashuroj. Gjithçka është e kufizuar vetëm nga dashuria. Dashuria është Zoti, dhe të vdesësh do të thotë për mua, një grimcë dashurie të kthehet mbrapsht tek origjina universale edhe e përjetshme e dashurisë."

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsia	Shkalla: V	Klasa: XI
Tema mësimore: Punë me shkrim (ora e parë)		**Situata e të nxënit:** Shkruajmë letra për **çështje** letrare	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale Kompetenca qytetare Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: - dallon llojet e ndryshme të letrave; - identifikon veçori karakteristike të letrave sipas llojeve të tyre; - shpreh mendimin e tij për çështje dhe dukuri të ndryshme letrare; - reflekton në mënyrë kritike përmes argumenteve të mbështetura fakte e detaje; - analizon modele letrash joformale për nga struktura dhe gjuha.		**Fjalët kyçe:** Letër personale Strukturë Stil Komunikim Dhënës Marrës Kanal Shkrim	
Burimet: Fletore të punëve me shkrim, portofoli i nxënësit Interneti.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** TIK, gjuhë shqipe.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Rrjeti i diskutimit-Skema e komunikimit gjuhësor-Lista e ideve Harta e ideve-Shpjegimi			
Organizim i orës mësimore ***Hapi 1.*** Kontroll i detyrave të dhëna dhe diskutimi i tyre. ***Hapi 2.*** Rrjeti i diskutimit. Po - A ju ka ndodhur t'i shkruani letër një miku a të afërmi që e keni larg. Jo -A kanë një përdorim të gjerë sot letrat në komunikimin mes dy individëve? Pse?			
- Ç'dini për letrat? Letra është mesazh i shkruar për të përcjellë informacion në distancë. Letrat janë pasqyrë e personalitetit të atij që shkruan, ndaj edhe për to duhet treguar po aq kujdes në planifikim dhe shkrim, sa edhe për llojet e tjera të të shkruarit.			

Hapi 3. Skema e komunikimit gjuhësor

Si realizohet komunikimi përmes elementeve të skemës së komunikimit?

Hapi 4. Harta e ideve**.** Shpjegimi.

Letrat dhe llojet e tyre. Bëni dallimet mes letrave zyrtare dhe atyre personale.



Letrat ndahen në dy grupe:

Letrat formale/zyrtare

Shkruhen për të komunikuar me institucione të ndryshme ose përfaqësues të tyre, për të kërkuar informacione, për të bërë ftesa, ankesa ose për të falënderuar.

Këto letra u drejtohen institucioneve, bizneseve ose organizatave të ndryshme. Duhet ruajtur mirësjelljen në të shprehur edhe nëse letra përmban një ankesë.

- ❖ Është bërë praktikë e zakonshme që letrat zyrtare të shkruhen në të ashtuquajturat *Letra me kokë*, të cilat kanë të vendosura në krye të faqes emrin dhe adresën e institucionit, së bashku me numrin e telefonit dhe të *email*-it.
- ❖ Poshtë kokës vihet data, zakonisht në anën e majtë të letrës, lënda (një rresht i shkurtër që përmbledh gjithë përmbajtjen e letrës), marrësi i letrës dhe titulli i tij (pas të cilit vendoset edhe adresa) dhe përshëndetja për të.
- ❖ Në mbyllje të letrës vihet përshëndetja mbyllëse, si dhe emri, funksioni dhe nënshkrimi i letërshkruesit, ose i titullarit që përfaqëson institucionin që ka shkruar letrën, si dhe vula, për ato institucione që e kanë një të tillë.
- ❖ Gjuha e këtyre letrave duhet të jetë gjithmonë e zgjedhur dhe toni zyrtar.
- ❖ Këto letra duhet të jenë objektive dhe jo emotive.
- ❖ Struktura e letrave zyrtare është e thjeshtë.

Letrat joformale – personale/miqësore

Letrat joformale njerëzit i shkruajnë për të mbajtur kontakte me njerëzit e tjerë, për të krijuar miqësi të reja etj.

Zakonisht këto letra i drejtohen një miku, të afërmi, të njohuri.

- ❖ Gjuha është konfidenciale, i ngjan stilit të ligjërimit bisedor.

- Për çfarë çështjesh mund të shkruajmë letra? Letrat mund të trajtojnë çështje të ndryshme.

Letrat janë shpesh pjesë e veprave letrare, në të cilat jepet korrespodenca mes personazheve të veprës. Kështu mund të veçojmë Letrën e Tatjanës drejtuar Onjeginit.

Hapi 5. Lexim i orientuar. Ditari dypjesësh
Letra e Tatjanës drejtuar Onjeginit

Po marr guximin që t'ju shkruaj...
Ç›do dështim veç shpirtit tim?
E di, se është e drejta juaj
Të më dënoni me përçmim.
Po ju që e shihni si po vuaj
Me pak mëshirë, sadopak,
Nuk do më mprapsni zemërak!
Më parë desha të rri qete
Për turpin tim m'besomëni,
Ju s'do të dinit kur se si,
po të mund të shpresoja vetë
Që, kur e kur me plot hare
të kem t'ju shoh këtu tek ne
Që t'ju dëgjoj si kuvendoni,
T'ju them një fjalë dhe pastaj

Në zemër veç një mall të mbaj,
Veç gjersa rish të më takoni..
Fraza hyrëse: Po marr **guximin** që t'ju shkruaj
Retiçence :**...**
Tatjana i drejtohet nëpërmjet vetës së dytë shumës
t'ju shkruaj
Përse? - Ç'tregon ky fakt?
Foljet në shumës: dënoni, m'besomëni, shihni
Pronori – juaj etj.

Hapi 6. Shkrim i strukturuar
Realizoni skedën e letrës për letrën drejtuar një miku për mbresat nga leximi i një libri artistik.

Struktura: Data	
Marrësi	
Ajo për të cilën bën fjalë letra	
Formula hyrëse	
Trupi i letrës – ajo çka do kumtojmë	
Formula e mbylljes dhe e përshëndetjes:	
Dërguesi i letrës	

Vlerësimi: Vlerësim paraprak motivues.

Detyrat dhe puna e pavarur: Shkruaj shkurtimisht subjektin e librit për të cilin do të doje të flisnit me një mikun tuaj. Shpjego arsyet e përzgjedhjes së këtij libri për të ndarë impresionet me një mik.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

<table>
<tr><th>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</th><th>Lënda: Letërsia</th><th>Shkalla: V</th><th>Klasa: XI</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Punë me shkrim (ora e dytë)</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Shkruajini një letër një mikut tuaj, ku të përshkruani mbresat tuaja nga libri i fundit që keni lexuar.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
Kompetenca e të mësuarit për të nxënë
Kompetenca personale
Kompetenca qytetare
Kompetenca digjitale</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
- dëshmon se njeh formatin e shkrimi të letrës drejtuar një miku, në aspektin strukturor dhe në planin gjuhësor;
- shpreh mendimin e tij për çështje dhe dukuri letrare të hasura në veprën e përzgjedhur për të ndarë mbresat me shokun;
- përdor një gjuhë të zgjedhur kur i referohet veprës letrare të lexuar, si dhe një gjuhë më të çlirët në pjesët e tjera të letrës;
- formulon mendimet, ndjenjat dhe opinionet e tij rreth tekstit të lexuar, personazheve, vlerave estetike;
- reflekton në mënyrë kritike përmes argumenteve të mbështetura në tekstin e lexuar;
- përdor shprehje, fraza nga libri në funksion të pasurimit të leksikut , si dhe në trajtën e argumenteve përse zgjedh të shkruaj për të;
- përzgjedh këtë formë komunikimi si një mundësi e përforcimit të marrëdhënies së dy miqve;
- përdor drejt rregullat drejtshkrimore dhe shenjat e pikësimit.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:

Letër personale
Strukturë
Stil
Komunikim
Leksik
Frazë
Shprehje
Përshëndetje
Qëllim
Sugjerim
Emocion</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: Fletore të punëve me shkrim, Portofoli i nxënësit.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: gjuhë shqipe.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Shkrim sipas modelit
Shkrim i lirë</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizim i orës mësimore
Tema: Shkruajini një letër një mikut tuaj, ku të përshkruani mbresat tuaja nga libri i fundit që keni lexuar.</td></tr>
</table>

Hapi 1. Rikujto njohuritë mbi shkrimin e një letre personale: struktura; gjuha ***Hapi 2.*** Shkrim i letrës duke respektuar njohuritë letrare, të strukturë së një letre joformale dhe veçori të gjuhës. Formula hyrëse Trupi i letrës – ajo për të cilën do shkruajmë Formula e mbylljes dhe e përshëndetjes Përdor drejt rregullat e drejtshkrimit Përdor drejt shenjat e pikësimit Përzgjedh leksik, sintaksë e stil tërshtatshëm Integron njohuritë mes letërsisë dhe gjuhës për të përcjellë emocion te marrësi dhe për të bindur marrësin mbi përzgjedhjen e drejtë të veprës letrare.
Vlerësimi: Vlerësimi i të nxënit (përmbledhës)
Detyrat dhe puna e pavarur: "*Librat janë miqtë më të qetë dhe më të përhershëm; ata janë këshilltarët më të gjindshëm dhe më të mençur dhe mësuesit më të durueshëm.*" – Shprehet Charles William Eliot. A jeni dakord me thënien e shkrimtarit? Interpreto kuptimin e saj.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda: Letërsia**	**Shkalla: V**	**Klasa: XI**
Tema mësimore: Letërsia e fundshekullit XIX (1orë)		**Situata e të nxënit:** Konteksti shoqëror, politik e letrar i gjysmës së dytë të shek. XIX.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale Kompetenca qytetare Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: - përdor organizuesit grafikë në funksion të të kuptuarit të koncepteve e ideve të tekstit, dhe memorizimit të informacionit; - përcakton disa nga zhvillimet e reja në letërsinë e gjysmës së dytë të shekullit XIX; - dallon përfaqësuesit kryesorë, si dhe përcakton llojet letrare që shkruanin; - krahason letërsinë realiste me prirjet dhe zhvillimet e reja; - mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti; - bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme.		**Fjalët kyçe:** Simbolizëm Ndjeshmëri Ankth metafizik Dekadentizëm Parnasizëm Modern Shqisa Kundërvënie	

Burimet: Teksti mësimor, poezi të poetëve modernist, materiale historike, Interneti.	**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurri-kulare:** arte, histori, gjeografi, TIK, arte, gjuhë shqipe.

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Harta e ideve-Pyetje-përgjigje-Organizuesi grafik me tri kolona-Punë me grupe-Ditari dypjesësh-Diskutim-Pema e mendimit

Organizim i orës mësimor

Hapi 1. Kujtojmë njohuritë mbi hapat që ka ndjekur letërsia përgjatë zhvillimit të saj.
Zhvillimi që ka ndjekur letërsia që në fillesat e para e deri në shekullin XIX.



Shpjego karakterin kolektiv të letërsisë gjatë Mesjetës dhe përse nuk pati një zhvillim të madh.

Hapi 2. **Harta e ideve**.



Hapi 3. **Pyetje-përgjigje, Organizuesi grafik me tri kolona**

- Cilat janë gjinitë letrare që u lëvruan nga shkrimtarët e fundshekullit XIX?
- Cilat janë karakteristikat themelore të gjinive letrare?

Kujto njohuritë mbi gjinitë letrare (llojet dhe karakteristika të tyre). I përmbledhim informacionet kryesore në tabelë, të strukturuara.

GJINITË LETRARE					
EPIKA		**LIRIKA**		**DRAMATIKA**	
Llojet	**Karakteristi-kat**	**Llojet**	**Karakteristikat**	**Llojet**	**Karakteristikat**
-**Poemat**: *epike-heroi-ke;kalorësiake; didaktike; alegorike;* - përrallat, legjendat, gojëdhënat, fabulat, baladat, romani, novela.	- mund të jenë në vargje ose në prozë. - rrëfimi bëhet në vetën e tretë, por edhe në të parën - ka personazhe - tema e veprës është kryesisht heroike - ka fabul - ndërthur trajta të ndryshme të ligjërimit etj.	Elegjia Idili Soneti Himni Vajet Odeja	Autori nuk rrëfen ngjarjet, ai shpreh ndjenjat dhe mendimet e tij. Temat dhe motivet lirike mund të jenë të shumta. S'ka fabul, s'ka personazhe të cilat do ta vinin në lëvizje veprimin. - Rritëm Figuracion	Tragjedia Komedia Drama	Dialogu Monologu Personazhet Didaskalitë Akte Skena Autori fshihet pas personazheve vepruese që flasin nëpërmjet dialogut ose monologut

Hapi 4. **Punë me grupe. Ditari dypjesësh**

Grupi 1: Përcakto llojin letrar, gjininë, motivet, karakteristikat kryesore: sfondi, toni, rima, ritmi, gjuha, figuracioni, imazhi.

Fragment nga **"Korbi" të Edgar Allen Poe,** Përktheu F.Noli

…N'odë prapë më të kthyer
Shpirti ndezur, zemra thyer,
Përsëri vjen një trokitje
Pak m'e fortë se më parë.
"Padyshim, pa fjalë, thashë,
Dikush është aty jashtë.
Duhet vajtur, duhet parë
Që të zgjidhet ky mister.
Hesht, moj zemër e zhuritur,
Që ta zgjidh këtë mister!
Era ësht' e asgjë më".
Hap ahere xhamen time
Kur me shumë fërfëllime
Brënda hyn një Korb i mvrejtur
Madhështori kohës vjetër.
As u fal, as përshëndoshi,
As bën tjatër punë boshi,
Po si zot më shkon trimoshi
Dhe qëndron mi derën time –
Ngjitet mi një bust Pallade

Lloji i tekstit:
Gjinia:
Tema:
Motivet:

Mun mbi derë t'odës sime –
Ngjitet, rri, dhe s'bën gjëmë.
Këtë desha të çkoqitnja
Po as fjalë nuk i flisnja
Korbit që me sy prej prushi
Zemrën si me zjarr ma mbushi;

Karakteristikat kryesore:

Sfondi
Toni
Rima
Ritmi
Gjuha
Figuracioni
Imazhi/et

Grupi 2: Përcakto llojin letrar, gjininë, motivet, karakteristikat kryesore

" Ëndrra **ime e zakonshme"** Pol Verlen

Shpeshherë gjumin e natës një ëndërr ma trazon
Një grua e panjohur, që e dua e me do,
e që s'është asnjëherë gjithmonë po ajo,
por as dhe ndonjë tjetër, e më do e më kupton.
Ngase me kupton, ndaj shpirtin tim prej fëmije
Vetëm ajo, mjerisht, ma sheh si në një pasqyrë,
Vetëm ajo, dhe brengën e rrudhat në fytyrë
Vetëm ajo m'i largon, me dhele dashurie.
Brune është, bardhoshe a zeshkane? - nuk e di
Emri saj? Di që rrjedh i butë, i ngrohtë, plot magji
Si emrat e atyre për të cilët shpirti u tha.
Vështrimi i saj i thellë i ngjan detit që nuk fle
Dhe, ai zë disi i largmë, e i qetë, e i shkruar,
Ka kumbimin e zërave të shtrenjtë që s'rrojnë me.

Lloji i tekstit:
Gjinia:
Tema:
Motivet:
Karakteristikat kryesore:
Sfondi
Rima
Ritmi
Gjuha
Figuracioni
Imazhi/et

- Cilat janë veçoritë karakteristike të dy poezive?

Atmosfera e të panjohurës që prek lexuesin, ndjeshmëria, përvijimet e imazheve falë leksikut, aliteracionit dhe metrikës së përdorur nga poetët.

***Hapi 5* Diskutim**

Diskutojmë mbi lirinë e artit si domosdoshmëri. Çfarë është autonomia e artit dhe arti për art?

***Hapi 6.* Pema e mendimit**

Me anë të një skeme përmbledhim njohuritë mbi drejtimet letrare të letërsisë së fundshekullit XIX si dhe veçoritë karakteristike të tyre.



Vlerësimi: Vlerësimi për të nxënës. Nxënësi vlerësohet për aftësinë e tij për të strukturuar informacionin dhe bashkëpunimin në grup. (i vazhdueshëm)
Detyrat dhe puna e pavarur: Edgar Allan Poe shprehet: "*Ata që ëndërrojnë ditën njohin shumë gjëra që ju shpëtojnë atyre që ëndërrojnë vetëm natën.*" - Si e kuptoni këtë thënie? Po ju a mendoni kështu? - Sillni në klasë poezi të poetit simbolist, Sharl Bodler.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda: Letërsia**	**Shkalla: V**	**Klasa: XI**
Tema mësimore: Sharl Pier Bodler Jeta dhe vepra.		**Situata e të nxënit.** Kritiku më i madh i artit të shek. XIX. Krijimtaria letrare e Bodlerit dhe risitë.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale Kompetenca qytetare Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: - përdor organizuesit grafikë në funksion të të kuptuarit të koncepteve e ideve të tekstit; - mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti; - bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme; - zbulon mesazhet që përcillen me anë fragmentit; - identifikon në tekst veçoritë e stilit të autorit; - shpjegon funksionin e përdorimit të mjeteve gjuhësore e stilistike.		**Fjalët kyçe:** Poet Modern Simbolist Evokon Muzikalitet Kritik Përkthyes Imazh	
Burimet: Teksti mësimor, vepra e plotë**,** studime dhe kritika letrare, interneti		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** arte, histori, gjeografi, TIK, arte, gjuhë shqipe.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Harta e ideve-Pyetje përgjigje-Harta e mendimit-Lexim i drejtuar-Diskutim			
Organizim i orës mësimore ***Hapi 1.*** **Lexim dhe diskutim i detyrave të shtëpisë.** Nxënësve u është kërkuar të sjellin poezi të Bodlerit. Ku e klasifikojmë krijimtarinë e Bodlerit? ***Hapi 2.*** **Harta e ideve** Rikujtojmë njohuritë mbi Simbolizm			



Ndalemi te kuptimi i poezisë për simbolistët.

<u>Për simbolistët poezia</u>:

- nuk është predikim moral, politik, filozofik;
- nuk është përshkrim i realitetit të jashtëm, por përvijon: ritme, ndjesi, emocione, imazhe të cilat lidhen me realitetin e brendshëm;
- nuk është analizë psikologjike e vetes;
- nuk rrëfen, por sugjeron;
- nuk shfaq subjektin, por i vesh atij kuptime të mistershme.

Gjuha: e çliruar nga mbingarkesat ideore.

Shërben për të aktivizuar një sërë shqisash.

Ka si qëllim shkrirjen në poezi të arteve të tjera.

Arti simbolist i drejtohet receptuesve intelektualë dhe elitar. Ai nuk mund t'i përgjigjet një lexuesi të gjerë ashtu sikurse arti realist.

***Hapi 3.* Pyetje-përgjigje - Harta e mendimit**

- Cili ishte ai shkrimtar simbolist që mishëroi mitin e "poetit të nëmur"?
- Cilat janë momentet kryesore të Sharl Bodler që ndikuan në formimin e botëkuptimit të tij?
- Listo disa nga veprat kryesore të poetit.
- Në cilat fusha shprehet veprimtaria e Bodlerit?
- Vlerësime për krijimtarinë e Bodlerit:



Kontributi për letërsinë: Në drejtim të letërsisë moderne të gjuhës franceze dhe angleze, ndikimi i tij ishte i madh. Ai e orientoi poezinë në drejtime të reja. I hapi udhë rrymave poetike të shekullit XX deri te surrealizmi.

Veprat letrare

Fanfarlo 1847
Arti romantik 1852
Salloni (1846 -1859)
Ditari intim (1851-1862)
Parajsat artificiale (1860)
Kuriozitete estetike (1868)
Reliktet 1866
Lulet e së Keqes (1857, 101 poezi -1861, 127 poezi)
Spleen i Parisit (1869)

} **risitë që sjell në letër si krijimtaria e Bodlerit**

***Hapi 4.* Lexim i drejtuar. Pyetje-përgjigje**

Lexojmë poezinë "Himni i Bukurisë"

- Çfarë ju sugjeron poezia?
- Identifikoni antitezat dhe kontrastet në poezi. Ç'funksion ka përdorimi i tyre?
- Ndjesitë që u përcjell poezia.
- Ç'vend zë në krijimtarinë e poetit ky krijim?
- Trego se si autori e sheh të Bukurën.

"Himni i Bukurisë" *Bie* prej **qiellit** a *ngrihesh* prej **humnerës** së thellë, O Bukuri! Shikimi yt hyjnor dhe i djallëzuar, **Krimin** me **mirësinë** *ngatërruar*, përherë na e *ndjell,*	**O** Bukuri!- thirror/apostrof; bie – ngrihesh; qiellit –humnerës hyjnor-i djallëzuar antiteze O Bukuri! Shikimi yt hyjnor dhe i djallëzuar, personifikim **Krimin - mirësinë**
Duke i ngjarë aq shumë shijes së verës së bekuar. analogjia me verën: joshja/ ndjellja , por dhe Dehja	**shqisat**: të të parit; të nuhatjes; të të ndjerit; të shijuarit efektet: trima vogëloshët kurse heronjtë të qajnë Foljet: *strehojnë – shpërndajnë – bën*;
Sytë e tu *strehojnë* çdo perëndim dhe aurorë; E si një natë e stuhishme parfume *shpërndajnë*; Puthjet e tua janë melhem, goja jote një amforë, Që i bën **trima vogëlushët** e **heronjtë të qajnë**.	honeve - yjeve**;** të zi - të zjarrtë**;** fjalia pyetëse retorike
Fati i magjepsur *të ngjitet* pas fundeve si një qen; *Gurgullon* honeve **të zi** a yjeve **të zjarrtë** *digjesh*? Ti gjithçka në botë *sundon* e askujt s'i *përgjigjesh*, E kudo, rastësisht, gjëmën dhe harenë *shpërthen*.	relacioni me të Bukurën me anë të përemrit vetor TI, krahasimi: si një qen të ngjitet-gurgullon-digjesh-sundon përgjigjesh gjëmën - harenë
Bukuri, ti *marshon* mes kufomave që *ke përçmuar*; Nga xhevahirët e t'u, Tmerri nuk *ka* më pak E Krimi, mes gjithë stringëllave të tua më i çmuar, Mbi barkun tënd, krenarisht *vallëzon* plot dashuri.	Bukuri ti *marshon* – personifikim (imazhi që përvijon) magji, xhevahirët – magji-i çmuar – stringëllave-krenarisht -plot dashuri Kufomave – Tmerri - E Krimi
Flutura e natës e verbuar pas teje, *të vjen* afër, qiri, *Ferfëllin*, *ndizet* e thotë: I bekuar *qofsh* pishtar!	

I dashuruari ethshëm përkulet mbi të dashurën e tij, Si ai i plagosuri për vdekje *përkëdhel* të tijin varr. S'ka rëndësi nëse Parajsën apo Ferrin *ke* për nënë, O Bukuri! Mostër e frikshme, e paanë, e lindur e lirë! O Vallë buzëqeshja jote, syri yt, këmba, hapur ma lënë Portën, për atë pafundësi kurrë të njohur aq mirë? S'ka rëndësi *je* **Djall** apo Zot! **Engjëll** a Sirenë *të jesh*, S'ka rëndësi nëse zanë me sy kadife që xixëllojnë butë O parfum, ritëm, kthjelltësi, o e vetmja ime mbretëreshë! o e vetmja ime Bën universin më pak të shpifur, më pak të rëndë çdo minut'.	Flutura e natës, qiriri, *të vjen – Fërfëllin – ndizet – përkulet – përkëdhel* I dashuruari **ethshëm -** Si ai i plagosuri për vdekje përkëdheltë tijin varr – similitudë Parajsën - Ferrin Bukuri! **Mostër** e frikshme, e paanë, e lindur, e lirë Buzëqeshja – syri – këmba **Djall – Engjëll – Zot – Sirenë** O parfum, ritëm, kthjelltësi, mbretëreshë Çfarë bën bukuria? Bën universin më pak të shpifur, më pak të rëndë çdo minut'.

Poetin e mahnit kjo bukuri e pamasë, edhe pse ajo shndërrohet në djall, engjëll, sirenë.
Bukuria ka trajtën e asaj femrës joshëse që ofron përherë dashuri fizike edhe shpirtërore, që heroin e kthejnë në fëmijë dhe fëmijën e bëjnë trim. Bukuria është shija e jetës.
Bodler në poezinë e tij nuk përshkruan, as analizon, por evokon emocione, ndjesi që lidhen me përjetimet e brendshme të qenies. Ai veprimet që i vishen bukurisë i shndërron në përjetësi.
E bukura nuk ka të bëjë me të mirën dhe as me moralin, por konceptohet si e vërtetë absolute. E keqja në jetë bëhet e bukur në art. Kjo është ideja që përcjell Bodler-i te Himni i Bukurisë.

***Hapi 5.* Diskutim**

- Kuptimi estetik dhe filozofik i Bodlerit mbi të Bukurën. Po për ty ç'kuptim ka e bukura?
- *"Unë jam i bindur se do të vijë një ditë kur çdo gjë që kam shkruar do shitet shtrenjtë*", kështu i shkruante Sharl Bodler së ëmës me 11 tetor 1860. Çfarë tregon ky pohim i Bodlerit për poezitë e tij?

Vlerësimi: Vlerësimi për të nxënë. Nxënësit vlerësohen për përzgjedhjen e materialit më të rëndësishëm dhe për mbrojtjen e ideve me detaje konkretizuese. (i vazhdueshëm)

Detyrat dhe puna e pavarur: Kërko informacion mbi veprën "Lulet e së keqes" të Bodlerit. Lexo poezinë: "Korrespodenca".

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

<table>
<tr><th>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</th><th>Lënda: Letërsia</th><th>Shkalla: V</th><th>Klasa: XI</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Analizë e veprës: “Lulet e së keqes” Koment. Poezia “Korrespondenca”</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Gjuha dhe stili i veprës
Kriteret strukturore. Poetika: simbolizmi dhe alegorizmi. Studim teksti</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
Kompetenca e të mësuarit për të nxënë
Kompetenca personale
Kompetenca digjitale</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
- përcakton veprat kryesore të Bodlerit;
- veçon risitë që solli Bodleri me veprën e tij në drejtim të motiveve dhe të shprehjes artistike;
- shpjegon kuptimin e titullit;
- interpreton, analizon, gjykon dhe vlerëson poezinë e dhënë;
- - gjykon mbi vlerat estetike të veprës së Bodlerit.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:
Korrespodencë
Analogji
Shëmbëllim
Përvijim
Natyrë
Dualitet</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:
Teksti mësimor,
vepra e plotë,
fjalor terminologjik.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:
arte, histori, gjeografi, TIK, arte, gjuhë shqipe.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Shpjegim-Pyetje-përgjigje-Paraqitje grafike-Stuhi mendimi-Lexim i drejtuar –Ditar dypjesësh-Diskutim.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizim i orës mësimore
Hapi 1. Shpjegim i kuptimit të titullit.
Shpjegoni gërshetimin dhe shndërrimin kuptimor të fjalës lule dhe e keqe në përbërje të titullit.
Le Fleur – Lulet
Du Mal – e keqja, në gjuhën frënge fjala përfshin njëkohësisht një sërë shtresash kuptimore, si: fatkeqësi, dhimbje, djallëzi, boshllëk, apati...</td></tr>
</table>

LULET E SË KEQES



• **E keqja në vepër**: - nga mjedisi (prej së jashtmi) ndikon/depërton së brendshmi në shpirt;
- nga brenda shpirtit shpërthen së jashtmi me: pesimizmin, trishtimin, dhimbjen.

brenda jashtë

• **dy rrafshet**: - e bukura e së keqes;
- e bukura në të keq.

Titulli paraqet idenë e shndërrimit të së keqes në imazh. Nëpërmjet përmbysjes kuptimore gjen shtegun të sjellë risi kundrejt tradicionales që e asocionte lulen me vlerën natyrore, bukurinë, pastërtinë.

Hapi 2. **Pyetje-përgjigje**
- Çfarë tregon fakti që autori ka botuar vetëm një vëllim poetik?
Libri i vetmi vëllim me poezi i autorit dëshmon kërkesat e larta ndaj artit (si dhe L. Poradeci kërkues ndaj artit).
Struktura e librit
Gjithçka jepet në vijueshmëri logjike – duke vizatuar historinë shpirtërore të poetit.

Hapi 3. **Përvijim i informacionit nëpërmjet paraqitjes grafike.**

Spleen dhe ideali
tabllo pariziane
vera
lulet e së keqes
revoltë
vdekja

Strukturimi i veprës sipas kriterit tematik dhe formal sugjerojnë konceptimin e vëllimit në formën e një "poeme".

Hapi 4. Stuhi mendimi
-Cilat janë raportet e Bodlerit me lexuesin? Si e quan ai lexuesin e poezisë tij?
-Veçoritë më karakteristike të poetikës të vëllimit "Lulet e së keqes"
Poetika e veprës

simbolizmi — alegorizmi

Hapi 5. Lexim i drejtuar. Ditari dypjesësh
Ç'kuptoni me sonet/tingëllimë?
Krijime lirike në katër strofa (2 strofa x 4 vargje + 2 strofa x 3 vargje = 14 vargje)

Çfarë ju sugjeron titulli i poezisë?
Korrespondenca - analogji, shëmbëllim, i përgjigjet, përkon, njësoj, derivon…

Natyra është një tempull ku kolona të gjalla,
Lënë ngandonjëherë **fjalë pa kuptim** t'u shpëtojnë;
Njeriu **ndjen** sy familjarë që nguitas e vështrojnë
Kur kalon nëpër këto *simbole* pyjesh **të gjalla e të rralla**

Njësoj*si jehonat e përzgjatura që përngjizen* ,
Në një **bashkësi të thellë** e **të errët**, **diku në largësi**
Si nata dhe drita e hënës, të pamasa gjer në pafundësi ,
Parfumet, ngjyrat dhe tingujt **përgjigjen.**

Ka parfume të freskët , si mish i butë i një fëmije ,
Si tingull i ëmbël oboe, si luadhe, që gjelbërimet i **mbulojnë,**
Ka dhe të tjerë , ngadhnjimtarë , të korruptuar , plot pasuri

Që gjërat e pafundme dëshirojnë të **zaptojnë**
Si rrëshira **erëkëndshme**, si ai qelibar, ai myshk e temjan,
Që **këndojnë** dalldisjen e ndienjave dhe të shpirtdrave tanë.

.

Natyra :
një tempull ,
një vend i shenjtë,
mister.
} Ku çdo gjë ka kuptim të fshehur "pyll simbolesh" BUKURI-MISTER

Parfumet, ngjyrat dhe tingujt përgjigjen-korrespondojnë –njësoj në natyrë dhe jetë
Misteri, magjia e ndërlidhjes reciproke të elementeve të natyrës, shkrirja në njësi të pamasë të kundërtash: nata dhe drita e hënës

Dualitetet :Parfumet:
1. të freskët , si mish i butë
si mish i një fëmije
Si tingull i ëmbël oboe,
si luadhe, që gjelbërimet i mbulojnë
2.të tjerë:
ngadhnjimtarë , të korruptuar , plot pasuri
Si rrëshiraerëkëndshme,si ai qelibar,ai myshk, temjan,

<u>K</u>ëndojnë *dalldisjen* e ndjenjave, <u>të shpirtdrave</u> tanë.

Hapi 6. **Ditari dypjesësh**

Klasifiko në një tabelë elementet e përdorura në poezi duke i grupuar sipas shqisave dhe imazheve që përvijojnë.

Elementet	**Imazhet përvijuese dhe shqisat që realizojnë përvijimin.**
Elementet natyrore: Kolonat, pyje, jehonat, nata, drita e hënës, pafundësi, luadhet, gjelbërimi, rrëshira erëkëndshme, qelibari, myshku, temjani.	Shqisat e të parit: Shqisat e nuhatjes: Shqisat e të dëgjuarit: Shqisat e të prekurit: Shqisa e të shijuarit:
Elementet njerëzore: Fjala, njeriu, sytë familjarë, vështrojnë, mish fëmije, ngadhënjimtarë, të korruptuar, plot pasuri, zaptojnë, këndojnë, dalldisje, ndjenja, shpirt.	Shqisat e të parit: Shqisat e nuhatjes: Shqisat e të dëgjuarit: Shqisat e të prekurit: Shqisa e të shijuarit:

Hapi 7**:** Diskutim.
Përse Valter Beniamin e quajti Bodlerin "sipërrmarrës së vetevetes"?

Vlerësimi: Vlerësimi për të nxënë. Nxënësit do të vlerësohen për përgjigjet e dhëna dhe pjesëmarrjen në diskutim. (i vazhdueshëm)

Detyrat dhe puna e pavarur: Lexoni poezinë "Përjetësia" të Lasgush Poradecit për të kuptuar se si realizohet procesi i njohjes së botës përmes shqisave.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

<table>
<tr><th>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</th><th>Lënda: Letërsia</th><th>Shkalla: V</th><th>Klasa: XI</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Koment. Poezia “Albatrosi”</td><td colspan="2">Situata e të nxënit. Prezantim i
Studim teksti</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
Kompetenca e të menduarit
Kompetenca personale
Kompetenca qytetare
Kompetenca digjitale</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
- përdor njohuritë gjuhësore për të vlerësuar gjuhën e tekstit letrar;
- interpreton figurat kryesore: epitetin, krahasimin, metaforën, simbolin;
- demonstron shkathtësitë e fituara gjatë komentit të poezisë;
- veçon risitë që solli Bodleri me veprën e tij në drejtim të motiveve dhe të shprehjes artistike;
- interpreton, analizon, gjykon dhe vlerëson poezinë e vëllimit “Lulet e së keqes”.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:
Lule
Mërzi
Plogështi
Mospranim
Imazh
Shqisa
Trajektore
I bukur
I shëmtuar</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:
Teksti mësimor, vepra e plotë, interneti.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: arte, histori, gjeografi, TIK, arte, gjuhë shqipe.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Stuhi mendimi-Pyetje-përgjigje-Lexim i strukturuar-Ditari trepjesësh-Diagram i Venit-Punë me grupe-Diskutim-Pesëvargësh</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizim i orës mësimore

Hapi 1. Stuhi mendimi – Pyetje-përgjigje
- Çfarë ju sugjeron titulli i poezisë? Pjesë e cilës vepër është kjo poezi? Kujto strukturën e veprës.
- Ç’dini ju për Albatrosët?</td></tr>
</table>

Struktura e vëllimit

SPLEEN dhe IDEALI

TABLO PARIZIANE

VERA

"Lulet e së keqes"

VDEKJA

REVOLTË

LULET e së KEQES

- Ç'vend zë në vëllimin "Lulet e së keqes" poezia Albatrosi?
- Përse autori ka zgjedhur këtë rendim të poezisë?

Vëllimi me poezi "Lulet e së keqes" bëhet shprehje e tensioneve dhe shqetësimeve të shpirtit njerëzor të epokës.

Model përgjigjeje: Poezia Albatrosi vjen e dyta, pas poezisë Bekimi, në ciklin e parë SPLEEN dhe IDEALI. Vetë emërtimi i ciklit të poezive (pjesë e së cilës është dhe Albatrosi) shpreh një gjendjeje mërzie, çdo gjë e keqe. Në të kundërt është idealja, aty ku ekziston dashuria dhe ndjenjat janë të shfaqura gjer në intensitetin më të lartë.
Autori ka zgjedhur të çelë këtë vëllim me dy poezi të cilat zbulojnë filozofinë e Bodlerit mbi krijimin artistik, si dhe misionin e poetit në këtë mjedis.

Hapi 2. **Lexim i strukturuar i poezisë. Ditari trepjesësh.**

ALBATROS

Shpesh marinarët për t'u zbavitur kapin,

Albatrosët, k'ta zogj viganë që mes kthetrave,
Moskokëçarës u ngjiten anijeve që shkasin,
Përmes thellësive të hidhura të detrave

Ky Sovran i kaltërsisë, pas kuvertës ngjitur,
Si i zënë ngushtë nga pamundësia e tij
Mjerisht, krahët e bardhë i lë zvarritur,
Si një çift rremash të vozitura me ngadalësi.

K'tij udhëtari të plogët, ngordhalaq, qesharak!
Të shëmtuar, po dikur aq të bukur në k'të bot'!
Një marinar sqepin me çibuk ia përflak,
Tjetri shpotinë jep sakatit që s'fluturon dot

Kështu është dhe Poeti ky princresh,
Që me harkëtarët qesh e mes stuhive vërtitet,
Po i mërguar në tokë endet me thumbimin i rënë ndesh,
Ashtu penguar nga krahët e gjatë, mezi çapitet

Rryma letrare
Sfondi
Toni
Lloji i rimës
Elementet që ndërtojnë ritmin/ muzikalitetin
Fjalët kyçe
Veçori të gjuhës
Nënvizo figurat letrare

Subjektet	Detajet që lidhen me subjektet përkatëse	Figurat letrare/ simbolika
Deti	**Thellësi të hidhura** **Stuhi**	
Anijet	- Shkasin përmes thellësive të hidhura të detrave	
Marinarët	- për t'u zbavitur kapin Albatrosët - sqepin me çibuk ia përflakin Albatrosit - shpotinë i japin sakatit që s'fluturon dot	
Albatrosët	- zogj viganë - moskokëçarës u ngjiten anijeve - Sovran të kaltërsisë - Si i zënë ngushtë nga pamundësia e tij - Mjerisht, krahët e bardhë i lë zvarritur - krahët e bardhë i lë zvarritur, Si një çift rremash të vozitura me ngadalësi - udhëtari plogët, ngordhalaq, qesharak! - Të shëmtuar - po dikur aq të bukur në k'të bot' - Një marinar sqepin me çibuk ia përflak - Tjetri shpotinë i jep sakatit që s'fluturon dot - Që me harkëtarët qesh e mes stuhive vërtitet - Po i mërguar në tokë endet me thumbimin i rënë ndesh, - Ashtu penguar nga krahët e gjatë, mezi çapitet	
Poeti	ky princresh, si dhe Albatrosët Që me harkëtarët qesh e mes stuhive vërtitet, Po i mërguar në tokë endet me thumbimin i rënë ndesh, mezi çapitet	
Të tjerë subjekte: rretë; toka;		**Simbolika**

Hapi 3. **Diagram i Venit**

Autori përball Albatrosët me Marinarët dhe përngjasin Poetin me Albatrosët. Cili është funksioni i këtij procedimi?



Kështu dhe poeti

Nevoja për Liri, hapësirë
Lartësimi: sovran, princ
Moskokëçarja
Krenaria
Moskuptimi nga të tjerët
Vetmia (jep vetminë e poetit)
Përballja me vështirësi të natyrave të ndryshme
Pengesat
Vuajtja
Fluturimi si nevojë fizike tek Albatrosët dhe ndjesore te poetët
njerëzit i robërojnë, poetët; i tallin.

Hapi 4. Punë me grupe
Identifiko detajet që përvijojnë gjendjen e Albatrosëve. Ç'imazh ju përvijojnë? Cili është stilistik që përftohet nga përballja e dy gjendjeve?

Grupi i parë: **Para se të kapen nga marinarët**: Sovran; viganë; moskokçarës; me harkëtarët qesh e; të bukur në k'të bot'; me krahë të gjatë vërtiten.
Imazhi: _____
Grupi i dytë: **Pasi kapen nga marinarët**: i zënë ngushtë nga pamundësia e tij; endet me thumbimin i rënë ndesh penguar nga krahët e gjatë, mjerisht; s'fluturon dot; Si një çift rremash të vozitura me ngadalësi; sakat; mezi çapitet.
Imazhi: _____
Nëpërmjet personifikimit me Albatrosin poeti dëshmon se e ndjen veten të huaj, mes një shoqërie e cila nuk e kupton. Poezia përcjell, kështu, simbolikën e ndryshimit/dallimit mes turmës dhe artistit.
Mjeti stilistik që përftohet është kontrasti.

Hapi 5. **Diskutim**
- Ku ndihet i realizuar poeti dhe Albatrosi? - Përse?
- A është figurë tragjike figura e Albatrosit? Nëse po ku konsiston tragjizmi i tij?

Albatrosi - Poeti

(ku ndihet si princ, sovran)



Deti **Toka**

Anijet - thellësitë - Marinarët
përballin me vështirësi, zbulojnë dy anët e qenies: të bukura dhe të shëmtuarën

Tragjizmi i Albatrosit nuk qëndron në shndërrimin e Albatrosit nga një shpend madhështor krenar në një krijesë të plogët, qesharake dhe të përqeshur. Tragjizmi i tij qëndron te moskuptimi i tij.

Po i mërguar në tokë endet me thumbimin i rënë ndesh,
Ashtu penguar nga krahët e gjatë, mezi çapitet.
Poetit si dhe Albatrosëve i duhet të përballet me realitetin mizor, të pandjeshëm e mosvlerësues. Atyre u duhet të sakrifikohen në misionin e tyre.

Hapi 6. **Ndërto një pesëvargësh me temë POETI.**

Emër-**POETI-**

Dy mbiemra — Mbiemri 1 — Mbiemri 2

Tre folje — Folja 1 — Folja 2 — Folja 3

Një fjali që paraget qëndrmin lidhur me temën.

Fjalë sinonime që përcakton thelbin e temës. — Sinonimi

Vlerësimi: Vlerësimi për të nxënë.
(i vazhdueshëm)

Detyrat dhe puna e pavarur: Në poezinë "Vdekja e Nositit" të Lasgush Poradecit zbuloni simbolikën e sakrificës së Nositit në disa aspekte, si: prind, qytetar, poet. Cili është misioni i poetit dhe poezisë?

Me zjarr ju flas..., me zjarr.
në gjirin t'im kam hapur varr...
që t'i jap shpresë-edhe t'j-a mar...

Un' ik liqerit zemërak
Fatlum dh'i pastër si zëmbak,
Po zemra ime kullon gjak:

Se vijnë-urtuar zoqtë-e mi,
dhe 'u jap ushqim me dashuri —
një dashuri për llaftari:

Pa nis ah! gjirin t'a godas...
dhe'e hap ah! — gjirin më një ças...,
dhe'i nginj ah! zoqtë-e vdes me gas!...

Ahere-helmohet e buçet
pas mallit t'im liqeri-i shkret.
e rrit tallazin posi det.

Ay e tund, ay e shkund,
Ay e hap sa me të mund,
gjer mun në gjit, gjer mun në fund,

E shpirtin dyke m'a përcjellë,
më thotë ah! shih sesa 'sht 'i fellë
ky gjir' i em që të pat pjellë

... .Me zjarr ju flas, me zjarr.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsia	Shkalla: V	Klasa: XI
Tema mësimore: Koment: "Mjellma"		**Situata e të nxënit:** Studim teksti	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale Kompetenca qytetare Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: - zgjeron njohuritë mbi ndërtimin e tekstit (përdorimin e mjeteve gjuhësore dhe stilistike); - interpreton figurat kryesore: epitetin, krahasimin, metaforën, simbolin; - demonstron shkathtësitë e fituara gjatë komentit të poezisë; - veçon risitë që solli Bodleri me veprën e tij në drejtim të motiveve dhe të shprehjes artistike; - interpreton, analizon, gjykon dhe vlerëson poezinë e vëllimit "Lulet e së keqes".		**Fjalët kyçe:** Antikitet Aktualitet Frikë Mjellmë Figurë njerëzore Paralelizëm Kundërvënie Kontrast	
Burimet: Teksti mësimor, vepra e plotë, interneti, fjalor mitologjik, fjalor i gjuhës shqipe.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** arte, histori, gjeografi, TIK, gjuhë shqipe.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Stuhi mendimi-Lexim i drejtuar i poezisë-Ditar dypjesësh-Punë në grupe-Diagram i Venit-Punë me grupe			

Organizim i orës mësimore

Hapi 1. **Kontroll dhe diskutim i detyrës së dhënë.**

Hapi 2. **Stuhi mendimi.**

Ç'dini për mjellmat?

Shpend i madh uji, me qafë të gjatë e të lakueshme, me krahë të gjerë, me pendë zakonisht të bardha e të shkëlqyeshme si bora, që shtegton.

Hapi 3. **Lexim i orientuar i poezisë.**

Ku bën pjesë poezia "Mjelma"? - *Poezia bën pjesë te "Tablo parisiane"*

Kujt i kushtohet kjo poezi? *Viktor Hygoit i cili ndodhej në një situatë të vështirë. (sqaruar në një letër shoqëruese të poezisë, drejtuar V. Hygosë)*

Mjellma Viktor Hygos
Andromakë, për ty **po mendoj**! Aq i shkurtër lumë,
Pasqyrë e shkretë dhe e trishtë e asaj kohe të shkuar,
Ku madhështia e zisë tënde të ndriste aq shumë;
E ajo Simoentë gënjeshtare prej vajit tënd harbuar

Kujtesën time ma **ka shtrirë** më të pamasë se deti,
Ja, **paprirur**, tek po kaloja ndan një Karuzeli të ri.
Parisi i vjetër s'është më (medet, **forma** e një qyteti
që ndryshon më shpejt se sa zemra tek një njeri);

K'të fushë barakash mund **ta shoh veç në shpirtin** tim.
Trungje kolonash në pirg, aty-këtu kapitole të skalitur,
Llagaçeve të ujit, barishte, tufa myshqesh në gjelbërim,
E rrangullina të shpërhapura xhamave duke rrezëllitur.

Atje, ku **dikur** një kafaz bishash të rralla ngjallte frikë;
Atje, një mëngjes, kur nën ca qiej të ftohtë e të lartë,
Puna **zgjohet** e nëpër hapësirë ngrihet një uragan i lig,
Prej grumbujve të plehrave drejt ajrit zhurmëpak,

Pashë një mjellmë prej kafazit të vet **arratisur**,
Që lëkurën e këmbëve **rripte** kalldrëmit të thyer
E puplat bardhoshe truallit gropa-gropa i linte **zvarrisur**.
Ndan një rrëkeje te përtharë me **sqepin e shqyer**,
Me krahët duke i kredhur në **pluhurin** tërë tërsëllimë,

Me zemrën plot me **ujin e bukuar** të liqenit nga kish dalë
Duke thënë:Kur do biesh,shi! Kur do gjëmosh, bubullimë?
Unë e kundroj atë fatkeqe - mit të çuditshëm dhe fatal

2. **Parisi ndryshon**, *por* jo, **asgjë brenda simes melankoli**
Stundet! Pallate të rinj, pirgje dheu, skela anembanë,
Lagjie të vjetra,gjithçka tej meje **shndërrohet në alegori**,
E kujtimet e dashura më të rënda se shkëmbinjtë më janë.

Këtu, përballë Luvrit, një imazh **po shtrydh shpirtin** tim:
E unë **mendoj** mjellmën time të madhe e të shqetësuar,
Me sjellje të marra, si çdo mërgimtar, qesharak e sublim,
Nga një dëshirë brejtur papushim! Pastaj ty **të kam**
menduar,

Andromake, në krahët e dhëndrit të shquar e rënë
Si një bishë frikacake, kur krenaria superbe e Pirros,
Të rreku të kërrusur ndaj një varri bosh të lënë;
Medet! Vejusha e Hektorit, e pastaj nusja e Helenës!

Pastaj mendoj at' **vogëlushe zezake** prej **veremit** tretur,
Që **sylebetitur** ecën e kërkon rrugëve, **përmes llucës,**
Arat e kokosit të superbes Afrikë në ndonjë cep mbetur,
Diku, **përtej murit të lartë e të pafund të mjegullës**;
Mendoj atë që ka humbur diçka që s'kthehet dot më,
Kurrë, kurrë! **Ata që lotët e hidhur i kanë fishkur**,
E Dhimbjen, **si thithat e një ujkonje bujare** pinë nën zë!
Mendoj dhe ata jetimët thatanik që **si lule janë vyshkur**!

E shoh ndonjëherë qiejve, si pasardhësi i Ovidit të ngratë,
Drejt atyre qiejve ironikë e asaj së pamëshirshmes kaltërsi,
Me qafën që në përpëlitje kokën e saj lakmitare mban lart,
Si të dojë të qortojë vetë Zotin dhe vendimin e tij!
Kështu, nëpër pyllin ku shpirti im është mërguar,
Një **kujtim i lashtë** i fryn me sa fuqi që ka bririt të tij!
Po unë mendoj akoma për ata marinarët në ishuj harruar,
Për **t'burgosurit, fitimtarët!** E për aq të tjerë me dashuri.

Hapi 4. **Ditari dypjesësh.**

Poezia **"Mjellma"**	
Konteksti	Po unë mendoj; Mendoj atë që ka humbur diçka që s'kthehet dot më, Vlerat e dikurshme po kthehen në rrënoja; Parisi i vjetër s'është më, ka ndryshuar shumë. Ata si lule janë vyshkur; shpirti im është mërguar;
Detajet që ndërtojnë kontekstin.	Baraka, trungje, pluhur, pirg, plehra, lluc 'mjegull e lartë'
Si shfaqet Parisi para lexuesve.	Parisi ndryshon më shpejt se sa zemra te një njeri fushë barakash; Trungje kolonash në pirg; aty-këtu kapitole të skalitur; grumbujve të plehrave drejt ajrit zhurmëpak
Personazhet	Mjellma; Andromaka; Ovidi; Poeti; Hektorit; Helenës
Lidhja që ekziston mes personazheve.	Analogji; marrëdhënie; kontradikta
Figurat letrare	Inversionet, pasthirrma, oksimora, anafora, metafora, similituda, krahasimi i zgjeruar, kontrasti, paralelizmi, epitete etj.

Hapi 5. **Punë me grupe**

G-1. Gjej në tekst detaje që përvijojnë imazhin e Parisit. Ç'gjendje na përcjell? Cili është qëllimi poezisë?

G-2. Identifiko personazhet. Klasifikoji ato. Ç'lidhje ekziston mes personazheve të antikitetit dhe atyre real?

G-3. Në ç'kohë përdoren foljet? Cili është qëllimi i lidhjes mes dy kohëve: asaj antike dhe asaj të kohës së poetit.

G-4. Përshkruaj gjendjen e mjellmës dhe ndjesitë që ngjallen. Cilat janë vetitë njerëzore që gjejmë te mjellma?

Diskutim i detyrave të dhëna gjatë punës në grup

Hapi 6. **Diagrami i Venit**

Nëpërmjet Diagramës së Venit gjej ngjashmëri dhe dallime mes Andromakës dhe Mjellmës.



Hapi 7. **Punë me grupe:** Gjeni detajet/fjalët që ndërtojnë kundërvëniet: G.1 – e re-e vjetër: G.2 – e tashme e shkuar: G.3 – realitet-kujtim: Cili është qëllimi i përdorimit të tyre? ***Hapi 8.*** **Bashkëbisedim** Çfarë ka humbur Mjellma pas ndryshimit që ka ndodhur në mjedis? Si rrinë bashkë poezia dhe proza në poezinë e Bodlerit?
Vlerësimi: Vlerësimi për të nxënë. (i vazhdueshëm)
Detyrat dhe puna e pavarur: Shkruani një ese me temë: "Gjithçka është një kujtim që vërteton humbjen e pandreqshme, por dhe një imazh i ri i qytetit tim". Sillni imazhe të këtyre zogjve të bukur e të bardhë ose mund t'i vizatoni duke realizuar përvijimin që ju përcjell poezia.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda: Letërsia**	**Shkalla: V**	**Klasa: XI**
Tema mësimore: Koment. Poezia "Spleen"		**Situata e të nxënit:** Studim teksti	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale Kompetenca qytetare Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: - zgjeron njohuritë mbi ndërtimin e tekstit (përdorimin e mjeteve gjuhësore dhe stilistike); - interpreton figurat kryesore: epitetin, krahasimin, metaforën, simbolin; - demonstron shkathtësitë e fituara gjatë komentit të poezisë; - identifikon veçoritë e poetikës së Bodlerit; - interpreton, analizon, gjykon dhe vlerëson poezinë e vëllimit "Lulet e së keqes".		**Fjalët kyçe:** Gjendje Ngashërim Trishtim Boshllëk Shpresë Shpirt	
Burimet: Teksti mësimor, vepra e plotë, interneti, fjalor.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** arte, histori, gjeografi, TIK, gjuhë shqipe, gjuhë angleze.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Brainstorming-Lexim i drejtuar-Harta e koncepteve-Punë me grupe dyshe-Ditari dypjesësh-Punë e pavarur individuale			

Organizim i orës mësimore

Hapi 1. **Kontroll i detyrave dhe diskutimi tyre.**

Hapi 2. **Brainstorming.**
Cili është kuptimi i fjalës SPLEEN?
Jepni ngjyresat kuptimore që u përvijon/jep.



Hapi 3. **Lexim i drejtuar**
- Cilën gjendje evokon poezia?

Kur qielli i plumbtë, i ulur e i rënduar si një mbulesë,
Mbi shpirtin vajtonjës, pre të ngashërimeve të gjata,
Gjithë vijën e horizontit **puth** e **përqafon** me dënesë,
Duke **shpërndarë** ditë të zeza më të trishta se nata;

Kur toka ka kyçur gojën brenda një të lagshte qeli,
Kur shpresa si t'ish lakuriq nate, dhimbshëm qan,
Krahët e ndruaitur pas murit i përplas gjithë fuqi,
E kokën thyen tërë zhurmë mbi të kalburin tavan;

Kur shiu me rrëketë e tij nëpër hapësira të shtrira,
Sikur imiton kangjellat e hekurit të një burgu të paanë,
Një popull i tërë memec merimangash të pështira,
Vjen të thurrë cergat e tij ne thellësi të truve tanë,

Papritur, prej këmbanave shpërthen tërbimshëm,
E drejt qiejve nis e turret' një i tmershëm vajtim,
Si nje shpirt pa atdhe, si endacak i rëmbimshëm,
Qe plot pasion e durim gjëmon me ulërimë.

Funerale aq të gjatë, pa tamburë e pa muzikë,
Në shpirtin tim fillojnë të marshojnë me ngadalsi;
Shpresa fitimtare kullon në lot e Ankthi despodik,
Mizor, mbi kafkën time ngul flamurin e tij tëzi"

Kujto strukturën e vëllimit poetik.

Lulet e së keqes

- **Spleen dheideali**
- **Tablopariziene**
- **Vera**
- **Lulet e sëkeqes**
- **Revoltë**
- **Vdekja**

Ku bën pjesë poezia Spleen?
te **Spleen dheideali**

Nga qielli drejt shpirtit-ngashërime-trishtim
Qielli i plumbtë, qielli **i ulur**, qielli **i rënduar**, qielli **si një mbulesë**
shpirtin vajtonjës
ditë të zeza - më të trishta se nata
Toka - ka kyçur gojën
shpresa - si t'ish lakuriq nate
shpresa - dhimbshëm qan
shpresa - krahët e ndruajtur pas murit i përplas
shpresa - kokën thyen tërë zhurmë
Shiu - imiton kangjellat e hekurit të një burgu të paanë,
shiu - me rrëke
shiu - nëpër hapësira të shtrira
ndikimi negativ, mbështjellja e trurit, dominimi trurit,

nga Toka drejt qiellit - vajtimi
pasoja: shpirti gjëmon me ulërimë.
Funerale: të gjatë, pa tamburë e pa muzikë
Në shpirtin tim fillojnë të marshojnë me ngadalsi funerale aq të gjatë, pa tamburë e pa muzikë.

Shpresa fitimtare kullon në lot; Ankthi despodik; Mizor
Kulmi i rënies emocionale: mbi kafkën time ngul flamurin e tij të zi"
Frikë paralizuese, rënie totale, dorëzim në një gjendje pa rrugëdalje. Edhe atëherë kur duket se mund të ngrihet ndonjë fije shpresë, ankthi triumfon dhe e mund atë përfundimisht.

***Hapi 4.* Harta e koncepteve**

Cilët janë elementet që autori përdor për të përcaktuar hapësirën e mendimit?

Pikat e referimit me anë të të cilave autori shënjon hapësirën e mendimit: Qielli-Shiu-Toka-Kambana-Funerali

Sfondi: jashtë – mendje – shpirt – mendje – jashtë

Tru *Jashtë* - **Qielli**





Shpirt Shpresë shpirti - *brenda* - **shpresa** (tru)

Flamur i zi

***Hapi 5.* Punë me grupe dyshe**

- Ndërto një listë me analogjitë që autori përdor për të dhënë lidhjen mes natyrës dhe gjendjes shpirtërore.
- Cili është qëllimi përdorimit të tyre?
- Cili është raporti mes simbolizmit dhe natyralizmit në poezi?

Forca dramatike

Përshkrimi realist

Përvijimi imazheve dhe aktivizimi i shqisave.

Lista e Analogjive:

qielli i plumbtë, i rënduar - shpirtin vajtonjës

Si një mbulesë - vijën e horizontit

Qelia - kyçur

Shiu - kangjellat e burgut

Një popull memec - merimangash të pështira

Cergat/rrjetat e merimangave - thellësi të truve tanë

Kambanave - i tmerrshëm vajtim

shpirt pa atdhe - si endacak i rëmbimshëm

shpërthen - gjëmon

shiu - kullon në lot etj.

-***Hapi 6.* Ditari dy pjesësh**

Toni	
ritmi	
Marrëdhënia: mërzi, shpresë, ankth	
Raporti simbolizëm-natyralizëm	
Mjetet gjuhësore	
Mjetet stilistike	
Veçori të stilit	

***Hapi 7.* Punë e pavarur individuale.**

Perifrazo secilën strofë të poezisë me nga një fjali. Mendo një titull për poezinë. Shpjego arsyen e përzgjedhjes.

Strofa 1:	**Kur qielli i plumbtë, shpërndan ditë të zeza** më të trishta se nata;
Strofa 2:	**Kur toka ka kyçur gojën shpresa dhimbshëm qan,**
Strofa 3:	**Kur shiu me rrëketë imiton kangjellat truri pështjellohet**
Strofa 4:	**Prej tokës drejt qiellit drejtohet i tmerrshmi vaj**
Strofa 5:	**Shpresa është vrarë**

Vlerësimi: Vlerësimi për të nxënë. (i vazhdueshëm)
Detyrat dhe puna e pavarur: Shkruani një ese me temë: "Mërzia është mbulesë, shpresa është lakuriq nate".

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda: Letërsia**	**Shkalla: V**	**Klasa: XI**
Tema mësimore: Përsëritje		**Situata e të nxënit** Kushtet në të cilat lindi letërsia e gjysmës së dytë të shekullit XIX. Identifikoni rrymat dhe degëzimet kryesore letrare të kësaj periudhe dhe specifikoni gërshetimet midis tyre. Shpjegoni rolet dhe përdorimin e figurave më të përdorura për simbolistët.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale Kompetenca qytetare Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: - përcakton disa nga zhvillimet e reja në letërsinë e gjysmës së dytë të shekullit XIX; - dallon përfaqësuesit kryesorë, si dhe përcakton llojet letrare që shkruanin; - identifikon veçoritë e poetikës së Bodlerit dhe poezisë së fundshekullit XIX, - shpjegon se cilat janë risitë që solli letërsia moderne kundrejt zhvillimeve të romantizmit dhe realizmit,si dhe në ç'rrethana u zhvillua; - demonstron shkathtësitë e fituara gjatë komentit të poezisë.		**Fjalët kyçe:** Simbolizmit Dekadentizmin Parnasianizëm Divizëm Poezi Ndjesi Imazh Figuracion i pasur Kundërshti Gjendje	

Burimet: Teksti mësimor, vepra të shkrimtarëve, studime dhe kritika letrare, interneti.	**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** arte, histori, gjeografi, TIK, arte, gjuhë shqipe.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Brainstroming-Punë me grupe-Ditari dypjesësh-Punë e pavarur-Harta e mendimit-Shkrim funksional-Bashkëbisedim/Diskutim	
Organizim i orës mësimore ***Hapi 1.*** **Kontroll i detyrave të dhëna dhe diskutim i tyre.** ***Hapi 2.*** **Brainstroming** - Lidhja e simbolizmit me dekadentizmin - Pse Bodler nuk është dakord me rolin e poetit mësues? ***Hapi 3.*** **Punë me grupe, Ditari dypjesësh** Pasi të keni përcaktuar llojin letrar, gjininë, rrymën letrare, temën, motivet për poezinë e dhënë, zbulo dhe shpjego: *Grupi 1:* Karakteristikat kryesore gjuhësore të tekstit, si: - ndryshimi i rendit të fjalëve; - lidhëzat, lloji, roli i tyre; - pasthirrmat; - toponimi, antroponimi; - trajtat zvogëluese; - neologjizmi-kompozitë etj.; - shumësi. *Grupi 2:* Figurat letrare dhe funksioni përdorimit. Fragment nga **"Ofelia" të Artur Rembo**	
Kur përgjumen yjet, në valën e heshtur e në errësirë E bardha Ofeli valëzon si një zambak i madh, Lehtë valëzon, me vellon e saj të gjatë, shtrirë. Nga të largët pyje, thirrje gjuetie mbrrijnë. Mbi njëmijë vjet janë që e trishtuara Ofeli Kalon, e bardha përhimë, përgjatë lumit të zi. Janë mbi njëmijë vjet që e ëmbla marrëzi Mërmërin një romancë në të mbrëmjes puhi. Era puth gjinjtë e saj, shndëruar në stoli Vellot e mëdha përkunden nga ujrat me butësi Shelgjet fëshfëritës mbi supet e saj lotojnë, Mbi ballin e gjerë ëndëruar përkulet çdo biskonjë.	Ninfat kalimthi përreth pshertijnë Nganjëherë Ofelia zgjon, në një verr që gjumon Ndonjë folezë prej nga, një fërfëllimë krahësh shpëton Dhe këngë të misterëshme yjet e artë lëshojnë. Oh, e zbehta Ofeli, dëborërash bukuri, E vdekur je vashëz, prej rrjedhës rrëmbyer, Erërat e Norvegjisë nga majat e larta Të kishin folur për të sertën liri. Dhe një duhi, çufkën e dendur shprishi, Dhe shpirtit ëndërimtar zhurmërimë të çuditëshme i çonte Por zemra tënde, këngën e natyrës dëgjonte. Në vajin e pemëve, në pshertimat e natës....

Figurat letrare – emërtimi	Funksioni përdorimit
Kur përgjumen yjet	
E bardha Ofeli	
si një zambak i madh	
me vellon e saj të gjatë, shtrirë	
Era puth gjinjtë e saj	
gjinjtë e saj, shndëruar në stoli	
të largët pyje	
Mbi njëmijë vjet janë që e trishtuara Ofeli Kalon,	
e bardha përhimë	
Shelgjet fëshfëritës	
Shelgjet fëshfëritës mbi supet e saj lotojnë,	
Ndonjë folezë prej nga, një fërfëllimë krahësh shpëton	
këngë të mistershme	
yjet e artë	
për të sertën liri	
Oh, e zbehta Ofeli, dëborërash bukuri	
Dhe shpirtit ëndërimtar zhurmërimë	
zemra tënde, këngën e natyrës dëgjonte.	
Në vajin e pemëve, në pshertimat e natës....	

❖ **Përshkruaj imazhet që ju përvijohen dhe shqisat me të cilat ju ngjallen.**

Shqisat pamore: errësirë
Lule: si një zambak i madh,
Lëvizje-valëzon
Vello
Dëborërash
yjet e artë
shqisat e nuhatjes: si një zambak i madh,
Shqisat e dëgjimit: valëzon
Thirrje këngë
folur
psherëtima
zhurmërimë
romancë
fëshfëritës
Mërmërin
psherëtijnë
fërfëllimë
shqisa e të ndjerit duhi
Erërat
Dëborërash
Etj.

Hapi 4. **Harta e mendimit.**

Çdo nxënës ngrihet në tabelë të shkruajë një nga **veçoritë**, për të plotësuar hartën e mendimit.



Hapi 5. **Bashkëbisedim/Diskutim**

Ç'mjete përdorën poetët simbolistë për të realizuar korrespodencat misterioze midis fjalës e muzikës, për të depërtuar në thelbin e poezisë?

Hapi 6. **Shkrim funksional**

- Cili ishte këndvështrimi i ri i marrëdhënieve poet vepër-lexues? *Konkretizo përgjigjen me krijime konkrete*

Vlerësimi: Vlerësimi për të nxënë. (i vazhdueshëm)

Detyrat dhe puna e pavarur: Provoni të shkruani një poezi ose prozë poetike me parimet e simbolizmit.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsia	Shkalla: V	Klasa: XI
Tema mësimore: Projekt. Faza II		**Situata e të nxënit.** Vlerësimi i projektit	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca personale Kompetenca qytetare Kompetenca digjitale Kompetenca e të menduarit			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: - harton plan pune të qartë me të gjitha elementet e nevojshme; - komunikon në grup duke dhënë ide vetjake; - dëshmon aftësi bashkëpunuese në punën grup dhe merr role dhe përgjegjësi; - demonstron aftësi hulumtuese/kërkuese, zbuluese të materialit interesant; - dallon intervistën, reportazhin, kronikën, reklamën, analizën; - evidenton drejt problematikat dhe i trajton ato me objektivitet; - ofron rrugëzgjidhje për problematika të caktuara; - dëshmon se di të menaxhojë burimet njerëzore dhe materiale etj.; - bashkëpunon me një grup të caktuar duke sjellë propozime konkrete.		**Fjalët kyçe:** Fazë Projekt kurrikular Diskutim Bashkëpunim Grupe pune Organizon Propozon Shpjegon Përzgjedh Argumenton	
Burimet dhe mjetet: Portofoli i nxënësit, teksti mësimor, interneti, biblioteka. **Mjetet**: CD, mjete shkollore, regjistrues, aparat fotografik, kompjuter, *materiale të ndryshme të nevojshme për punën me revistën e shkollës.*		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** arte, histori, gjeografi, TIK, gjuhë shqipe, shkenca shoqërore, matematikë.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: diskutim -, pyetje-përgjigje-bashkëbised-im-parashtrim.			
Organizim i orës mësimore Puna me projekt është një produkt i cili kalon në disa etapa/faza dhe alternon njohuri të disa fushave e lëndëve me metoda e praktika efikase. Në këtë fazë, në vijim të fazës së parë, nxënësit janë ndarë në grupe, kanë zgjedhur drejtuesin e grupit.			

- Çdo **nxënës**:
  - ka të përcaktuar detyrën, prandaj ka paraqitur planin e punës vetjak te drejtuesi i grupit;
  - ka mbledhur literaturën dhe materialet e nevojshme;
  - diskuton rreth materialeve që do të përmbajë revista;
  - selekton informacionin e duhur;
  - propozon titullin e revistës dhe tituj të materialeve përbërëse të saj;
  - angazhohet maksimalisht dhe dështmon konkretisht angazhimin;
  - ofron alternativa, rrugë, mjete.
- Çdo **drejtues** grupi:
  - kujdeset për dosjen e grupit, në të cilën janë përcaktuar detyrat individuale dhe në grup;
  - informon mbi angazhimin e secilit nxënës;
  - organizon dhe drejton diskutimet në grup;
  - njihet me punën e secilit nxënës;
  - ndan detyra sipas nevojave për fazën përfundimtare;
  - paraqet para nxënësve të klasës dhe mësueses planin e punës në grup, pasi kanë diskutuar rreth ideve të gjithë anëtarët e grupit;
  - shpjegon se si do të realizohet projekti;
  - informon mësuesen dhe nxënësit e grupeve të tjera mbi pritshmëritë e grupit;
  - shpjegon se sa është buxheti, burimin dhe si do menaxhohet ky buxhet.
- Të **gjithë**: kujdesen në realizimin e produktit përfundimtar për fazën e ardhshme.

Dosja e projektit në këtë fazë përmban:
Planet e punës individuale dhe në grup.
Materialet e nevojshme.
Relacionet e takimeve të grupit apo komunikimeve me adresë elektronike.
Raportim mbi pjesëmarrjen dhe angazhimin e gjithsecilit.
Vetëvlerësimin.
Detyra për fazën pasardhëse.

Vendi i prezantimit: Në shkollë, klasa.

Vlerësimi: Vlerësimi i të nxënit (përmbledhës). Vlerësimi i punëve të nxënësve do të bëhet në bazë të disa pikave paraprake:
aftësisë për të paraqitur idetë dhe për t'i strukturuar ato;
angazhimit në grup dhe punës individuale;
aftësisë për të përzgjedhur literaturën dhe materialet e nevojshme;
aftësisë për të parashtruar plane pune.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

<table>
<tr><th>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</th><th>Lënda: Letërsia</th><th>Shkalla: V</th><th>Klasa: XI</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Projekt. Faza III</td><td colspan="2">Situata e të nxënit. Vlerësimi i projektit</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
Kompetenca e të mësuarit për të nxënë
Kompetenca personale
Kompetenca qytetare
Kompetenca digjitale
Kompetenca e të menduarit
Kompetenca për jetën, sipërmarrjen, mjedisin</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
- komunikon në grup duke dhënë ide vetjake;
- dështmon aftësi bashkëpunuese në punën grup dhe merr role dhe përgjegjësi;
- demonstron aftësi hulumtuese/kërkuese, zbuluese të materialit interesant;
- evidenton drejt problematikat dhe i trajton ato me objektivitet;
- ofron rrugëzgjidhje;
- dështmon se di të menaxhojë burimet njerëzore dhe materiale etj.;
- bashkëpunon me një grup të caktuar duke sjellë produkte të plota mediatike.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:
Projekt kurrikular
Produkt
Periudhë
Bashkëpunim
Bisedë
Diskutim
Grupe pune
Mediatik
Prezantim
Format
Botim
Artikull</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe mjetet: Portofoli i nxënësit, teksti mësimor, interneti, biblioteka.
Mjetet: CD, mjete shkollore, regjistrues, aparat fotografik, kompjuter, materiale të ndryshme të nevojshme për punën me revistën e shkollës.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:
arte, histori, gjeografi, TIK, gjuhë shqipe, shkenca shoqërore, matematikë.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Prezantim-Pyetje-përgjigje-Bashkëbisedim
Metoda dhe teknika të nevojshme përgjatë realizimit të produktit: vrojtimi, punë individuale, punë në grup, organizuesit grafik, diskutim, analiza, hulumtimi/kërkimi, pyetësorë, zbatimi, intervista, role të specializuara në diskutime, kërkime në internet dhe burime të tjera informative, shkrimi i lirë shkrimi i revistës.</td></tr>
</table>

Organizim i orës mësimore

Nxënësit paraprakisht janë ndarë në grupe dhe sipas kësaj ndarjeje:

- Ata përshkruajnë hapat që kanë ndjekur për shkrimin e revistës.
- Shpjegojnë rrugën si ndërtohet një pyetësor dhe anketë.
- Argumentojnë përdorimin e teknikave në procesin e të shkruarit.
- Japin arsyet e përzgjedhjes:
  - së titullit, organizimit të materialeve;
  - së tematikave (të larmishme, aktuale dhe që zgjojnë interesin e tyre);
  - të formatit, ngjyrave, letrës, mjeteve të nevojshme të punës.
- Realizojnë tekstet informuese, shpjeguese, përshkruese, argumentuese, eseistike, kulturologjike, letrare.
- Dëshmojnë se mund të nxjerrin produkte duke menaxhuar burime informative, njerëzore e materiale.
- Vlerësojnë kontributin vetjak dhe të shokëve, duke argumentuar për çdo rast.
- Reflektojnë dhe mbajnë qëndrime mbi problematika të hasura.
- Anketojnë interesin e nxënësve të klasave të tjera për produktin.

Portofoli/dosja i/e punës përmban

Planin e projektit dhe të gjithë materialet në përmbushje të plan-projektit.

- Planet e punës se nxënësve dhe grupeve.
- Listën e personave që ishin pjesë e punës, ndarja e detyrave individuale dhe në grup, personat përgjegjës.
- Shënimet e mbajtura gjatë punës.
- Literaturën apo burimet e informacionit.
- Produktin e punës.
- Diskutime përfundimtare për realizimin e projektit.

Puna në grup	përzgjedhja	bashkëpunimi	organizimi	menaxhimi	prezantimi
Puna individuale	hulumtimi	listimi	skicimi	shkrimi	reflektimi

Vendi i prezantimit: Në shkollë, klasat e shkollës, mjedisi aktiviteteve të shkollës.
Përfituesit: Nxënësit e shkollës, mësues të lëndëve të integruara, komuniteti.

Vlerësimi: Vlerësimi i të nxënit (përmbledhës). Vlerësimi i punëve të nxënësve do të bëhet në bazë të disa pikave paraprake:

Dosja e projektit: *Produkti*
mënyra e prezantimit;
materialet ndihmëse;
metodologjia;
menaxhimi burimeve;
angazhimi në grup dhe puna individuale;
kreativiteti.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE Dt.___/____/__

<table>
<tr><th>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</th><th>Lënda: Letërsia</th><th>Shkalla: V</th><th>Klasa: XI</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Testi tremujorit të tretë</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Nxënësit kontrollojnë nivelin e përvetësimit të njohurive.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
Kompetenca e të menduarit
Kompetenca personale
Kompetenca qytetare</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
Nxënësi:
- përcakton drejtimin letrar të një vepre në prozë duke u nisur nga karakteristikat e saj;
- përshkruan dhe analizon mjedisin dhe kohën (koha, vendi, detajet fizike, situatat);
- analizon gjendjen e një personazhi në disa plane;
- interpreton, analizon dhe gjykon për vlerat artistike të romanit “Vëllezërit Karamazovë”.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:
Roman
Realizëm
Personazhe
Konflikt
Marrëdhënie
Shpjegim
Psikologji
Identifikim</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:
Fragmenti nga vepra “Vëllezërit Karamazovë”.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: gjuhë shqipe, shkencat shoqërore.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Punë e pavarur individuale.
Organizim i orës mësimore

Punë e pavarur individuale

Fragment nga romani“Vëllezërit Karamazovë”.

Dy alternativa e mundonin Dmitri Fjodoroviçin: “Ose ai, Mitja, ose Fjodor Pavlloviçi”. Nuk duhet harruar edhe ky fakt i padiskutueshëm: Mitja ishte i sigurt se Fjodor Pavlloviçi mund t’i propozonte Grushënkes (po të mos i kishte propozuar) martesë të ligjshme dhe nuk i shkonte në mendje që plaku i pacipë do të mjaftohej me tri mijë. Mitja arriti në këtë përfundim ngaqë ia njihte huqet Grushenkës. Ja përse mundtë dukej sikur pavendosmëria e saj e kishte burimin te fakti që ajo nuk dinte cilin të zgjidhte, cilin prej të dyve ishte më me leverdi për të.</td></tr>
</table>

Sa për kthimin e "oficerit" , njeriut që pat ruajtur rolin më fatal në jetën e Grushenkës dhe ardhjen e të cilit ajo e priste me aq padurim dhe frikë, ai, për çudi, as e çonte nëpër mend. Është e vërtetë që ditët e fundit Grushenka nuk i kishte folur fare për këtë mundësi "të tretë". Vetëm kur pat marrë letrën para një muaji, ajo diç i pat thënë, por ai as kish dashur t'ia dinte. Dhe nuk e kuptonte as vet përse; ndoshta, duke qenë i vetëdijshëm për konfliktin e turpshëm me babain për shkak të një femre, ai nuk mund të merrte me mend një rrezik më të madh për vete. Sa për "dhëndrin", që doli aq papritur pas një harrese pesëvjeçare, ai thjesht nuk e besonte, aq më pak ardhjen e tij. Pastaj, në letrën e "oficerit" shkruhej në mënyrë shumë të turbullt për kthimin tek e dashura e dikurshme; Grushenka nuk ia tregoi rreshtat e fundit, ku flitej më konkretisht për "kthimin së shpejti".

Më vonë Mitja sillte ndërmend që Grushenka mbajti qëndrim përbuzës ndaj letrës së ardhur nga Siberia. Më pas ajo nuk i foli më për konkurrentin e ri dhe ai shumë shpejt e harroi oficerin. Një gjë dinte me siguri Mitja: përplasja e tij me Fjord Pavlloviçin ishte e afërt dhe e pashmangshme.

Me gjak të ngrirë ai priste vendimin e Grushenkës, me shpresë se ai do të ishte në anën e tij. Ajo me siguri, do të vinte t'i thoshte: "Merrmë, jam e jotja, përjetë". Dhe çdo gjë do të shkojë në vendin e vet, ai do ta rrëmbente e do ta çonte në fund të botës, larg, sa më larg, në mos në fund të botës, të paktën në fund të Rusisë; do të martohej me të e do të zinte vend gjëkundi, që askush të mos e dinte, as këtu, as atje, asgjëkund. O, atëherë për ato të dy do të niste një jetë krejt tjetër! Për këtë jetë të re "të virtytshme" (patjetër, patjetër të virtytshme) ëndërronte orë e çast.

E donte këtë rinovim, këtë ringjallje. Llumi i ndyrë, ku qe zhytur me vetëdije e mundonte dhe, si shumë të tjerë, edhe ai shpresonte shumë në ndërrimin e vendbanimit: të mos kishte më pranë këta njerëz... t'ia mbathin nga ky vend i mallkuar... pastaj gjithçka do të ringjallej, do të niste nga e para! Kështu ëndërronte. Kishte ditë që vetëm ndiqte, përgjonte, mundohej,vuante, por... ndërkohë përgatitej vetëm për zgjidhjen e parë, aq fatlume për të. Mitja largonte çdo mendim tjetër. Pikërisht këtu zinte fill një rrethanë tjetër, e paparashikuar, fatale, e pazgjidhshme. Nuk dua ta zgjas më shumë e ta analizoj më thellë këtë rrethanë, por dua të theksoj: kjo ishte gjendja e tij shpirtërore.

Shkak për këtë gjendje mund të ishte edhe ndërgjegjja që e vriste për paratë që i pat vjedhur Katerina Ivanovnës: "Me njërën u tregova i poshtër, të bëhem edhe me këtë tjetrën i poshtër? – vriste mendjen, siç dëshmoi më vonë, – ama po e mori vesh Grushenka, nuk do të pranojë të martohet me një maskara të tillë. Po ku t'i gjej këto para të mallkuara? Pa to gjithçka vete dëm, o, sa turp!"

Për pyetjet me alternativa (nga 1-6) qarko përgjigjen e saktë.

Në veprat e Dostojevskit personazhet: **1 pik**ë

a) përtej konflikteve klasore torturohen nga konfliktet e brendshme komlepkse
b) i përkasin shtresave të larta shoqërore
c) nuk i shfaqin të fshehtat e tyre të shpirtit
d) janë egoist

"Vëllezrit Karamazovë" është vepër e: **1 pik**ë

a) simbolizmit
b) romantizmit
c) klasicizmit
d) realizmit

Arti i Dostojevskit analizon mbi të gjitha: **1 pik**ë

a) mjerimin material
b) psikologjinë e njeriut
c) zhgënjimin nga tradhtia
d) raportin e njeriut me Zotin

Romanet e Dostojevskit janë konsideruar: **1 pik**ë

a) romane sociale
b) romane tragjedi
c) drama absurde
d) romane për "asgjënë"

Ç'mjet stilistik/figurë letrare është përdorur në fjalinë e mëposhtme: 1 pikë
"Kishte ditë që vetëm ndiqte, përgjonte, mundohej, vuante, por... ndërkohë përgatitej vetëm për zgjidhjen e parë..."

a) asidenti
b) metafora
c) shkallëzimi
d) elipsa

Nga pranëvënia e gjendjes, në të cilën ndodhet Mitja, me jetën e re që do niste, me Grushenkan përftohet**:**
1 pikë

a) paralelizmi
b) kontrasti
c) antiteza
d) anafora

Identifiko në fragment një shprehje frazeologjike dhe shpjego funksionin e përdorimit. **2 pik**ë

shprehja frazeologjike _____

funksioni përdorimit _____

Cilat janë detajet (dy prej tyre) që zbulojnë thelbin e marrëdhënies së Mitjas me **babanë e tij? Si do ta emërtonit raportin mes tyre?** **3 pik**ë

detaji _____
detaji _____
raporti mes tyre _____

Portretizo Mitjan në tri plane/aspekte. (përdor detaje nga teksti). **3 pik**ë

a) plani emocional
_____
_____

b) karakteri
_____
_____

c) gjendja në të cilën ndodhet
_____
_____

Ç'rol luan Grushenka në jetën e Mitjas? Çfarë ndikimi ka ajo. (përgjigjen mbështete me detaje nga teksti) **2 pik**ë

roli që luan Grushenka në jetën e Mitjas: _____
_____

ndikimi i Grushenkës te Mitja:

_____

_____

Duke u ndalur te fjalitë zbulo dy karakteristika të Grushenkës: **2 pik**ë

Mitja arriti në këtë përfundim ngaqë ia njihte huqet Grushenkës. Ja përse mund të dukej sikur pavendosmëria e saj e kishte burimin tek fakti që ajo nuk dinte cilin të zgjidhte, cilin prej të dyve ishte më me leverdi për të.

_____

_____

Përse autori shprehet: *"Pikërisht këtu zinte fill një rrethanë tjetër,e paparashikuar,fatale, pazgjidhshme"?* Për çfarë e paralajmëron lexuesin? **2 pik**ë

_____

_____

_____

Zbulo në tekst dy veçori të stilit të Dostojevskit. **2 pik**ë

a) _____

_____

b) _____

_____

Me anë të një paragrafi përshkruaj mjedisin në të cilin zhvillohen ngjarjet. (përdor detaje e shprehje nga teksti)

3 pikë

_____

_____

_____

_____

_____

_____

Nota	**4**	**5**	**6**	**7**	**8**	**9**	**10**
Pikët	**0-7**	**8-10**	**11-13**	**14-16**	**17-19**	**20-22**	**23-25**

Vlerësimi: Vlerësimi i të nxënit.

Detyrat dhe puna e pavarur: Lexo veprat për klasën e XII. (Jepet lista e veprave për klasën XII)